Brikena Kadzadej, Anila Omari,
Mimoza Kore, Sonila Sadikaj

Prof. Eqrem Çabej në Albanologji dhe në gjuhësinë europiane

Monografi e digjitalizuar, Open Access, mbi materiale autentike të papublikuara deri tani të perkthyera në shqip (letërkëmbim me personalitetet Prof. Gerhard Rohlfs, Tübingen, Prof. Hermann Ölberg, Innsbruck dhe Prof. Maximilian Lambertz, Leipzig)

ATHENA | wbv

Prof. Eqrem Çabej në Albanologji dhe në gjuhësinë europiane

Brikena Kadzadej, Anila Omari,
Mimoza Kore, Sonila Sadikaj

Albanische Universitätsstudien

Herausgegeben von Brikena Kadzadej

Band 12

Wissenschaftlicher Beirat:

- Prof. Dr. Johannes Holzner (Universität Innsbruck)
- Prof. Dr. Basil Schader (Pädagogische Hochschule Zürich, PHZH)
- Prof. Dr. Naxhi Selimi (Pädagogische Hochschule Schwyz)
- Dr. Dieter Nehring (Humboldt-Universität zu Berlin)

Brikena Kadzadej, Anila Omari,
Mimoza Kore, Sonila Sadikaj

Prof. Eqrem Çabej në Albanologji dhe në gjuhësinë europiane

Monografi e digjitalizuar, Open Access mbi materiale autentike të papublikuara deri tani, të përkthyera në shqip (letërkëmbim me personalitetet Prof. Gerhard Rohlfs, Tübingen, Prof. Hermann Ölberg, Innsbruck dhe Prof. Maximilian Lambertz, Leipzig)

ATHENA | wbv

Kjo Monografi u mundësua nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI) në kuadër të projektit "Prof. Eqrem Çabej në albanologji dhe në gjuhësinë europiane. Monografi e digjitalizuar, Open Access mbi materiale autentike të papublikuara deri tani, të përkthyera në shqip (letërkëmbim me personalitetet Prof. Gerhard Rohlfs, Tübingen, Prof. Hermann Ölberg, Innsbruck dhe Prof. Maximilian Lambertz, Leipzig)."

Agjencia Kombëtare e Kërkimit
Shkencor dhe Inovacionit

Një falenderim i veçantë shkon për znj. Brikena Eqrem Çabej.

Albanische Universitätsstudien, Band 12

Ein ATHENA-Titel bei wbv Publikation

2026 wbv Publikation
ein Geschäftsbereich der
wbv Media GmbH & Co. KG, Bielefeld

Gesamtherstellung:
wbv Media GmbH & Co. KG
Auf dem Esch 4, 33619 Bielefeld
service@wbv.de
wbv.de

Umschlaggestaltung: Rolf Duscha

Bestellnummer: I79592
ISBN (E-Book): 978-3-7639-7959-2
DOI: 10.3278/9783763979592

Diese Publikation ist frei verfügbar zum Download unter wbv-open-access.de

Diese Publikation mit Ausnahme des Coverfotos ist unter folgender Creative-Commons-Lizenz veröffentlicht: creativecommons.org/licenses/by-sa/4.0/deed.de

Für alle in diesem Werk verwendeten Warennamen sowie Firmen- und Markenbezeichnungen können Schutzrechte bestehen, auch wenn diese nicht als solche gekennzeichnet sind. Deren Verwendung in diesem Werk berechtigt nicht zu der Annahme, dass diese frei verfügbar seien.

Der Verlag behält sich das Text- und Data-Mining nach § 44b UrhG vor, was hiermit Dritten ohne Zustimmung des Verlages untersagt ist.

Bibliografische Information der Deutschen Nationalbibliothek
Die Deutsche Nationalbibliothek verzeichnet diese Publikation in der Deutschen Nationalbibliografie; detaillierte bibliografische Daten sind im Internet über http://dnb.d-nb.de abrufbar.

Exposé 7

Parafjala 11

Letra, letërkëmbimi dhe rrugëtimi 15

Eqrem Çabej – Formimi i shkencëtarit 29

Hermann Ölberg, indoeuropianisti i përkushtuar ndaj gjuhës shqipe dhe parahistorisë së saj 59

Letërkëmbimi i Ölberg-ut me Çabejn në shqip 71

Gerhard Rohlfs: Rrugëtimi biografik dhe shkencor 149

Letërkëmbimi i Rohlfs-it me Çabejn në shqip 163

Maximilian Lambertz dhe ndihmesa e tij në albanologji 181

Letërkëmbimi i Ölbergut me Çabejn në gjermanisht 199

Aneksi 221

Dy fjalë për autorët 395

Exposé

Die Monografie widmet sich dem wissenschaftlichen und menschlichen Profil des bedeutendsten albanischen Sprachwissenschaftlers des 20. Jahrhunderts, Prof. Dr. Eqrem Çabej (1908–1980).

Sie eröffnet einen bisher unbekannten Zugang zur Geschichte der albanischen Wissenschaft, indem sie den bislang unveröffentlichten Briefwechsel Çabejs mit drei herausragenden europäischen Sprachwissenschaftlern: Gerhard Rohlfs, Hermann Ölberg und Maximilian Lambertz, erstmals vollständig darstellt.

Das Werk vereint diese Briefe, die zwischen den 1950er- und 1970er-Jahren entstanden, und öffnet damit ein bis dahin verborgenes Kapitel der albanischen Wissenschaftsgeschichte.

Sie beleuchten nicht nur die wissenschaftlichen Diskurse jener Zeit, sondern auch den menschlichen und kulturellen Austausch über politische Grenzen hinweg.

Das Motto, das der Monografie vorangestellt ist „Non est ad astra mollis e terris via“ (*Epistulae Morales ad Lucilium*, 71), spiegelt sinnbildlich den Weg Çabejs wider: den mühsamen, aber unbeirrbaren Aufstieg eines Forschers, der sich der Wahrheit und dem Wissen verpflichtet fühlte.

Die Wahl des Themas ist sowohl wissenschaftlich als auch historisch von großer Bedeutung. Eqrem Çabej war eine der prägenden Figuren der modernen Albanologie. Sein Lebenswerk steht für die Einbettung der albanischen Sprache in den europäischen Sprachraum und für die Überzeugung, dass Wissenschaft keine politischen Grenzen kennt. Wie in der Monografie hervorgehoben wird: „Në historinë e studimeve shqiptare dhe të gjuhësisë indoeuropiane, emri i profesor Eqrem Çabejt është i lidhur pazgjidhshmërisht me përpjekjen për të vendosur gjuhën shqipe në qendër të një dialogu shkencor ndërkombëtar“ (In der Geschichte der albanologischen und indoeuropäischen Sprachforschung ist der Name von Professor Eqrem Çabej untrennbar mit dem Bestreben verbunden, die albanische Sprache in den Mittelpunkt eines internationalen wissenschaftlichen Dialogs zu stellen.) (Parafjla, S. 1). Damit rechtfertigt sich die Thematik auf zweifache Weise: Einerseits dokumentiert sie die Entwicklung der albanischen Sprachwissenschaft in einem schwierigen politischen Umfeld; andererseits stellt sie die Wissenschaft als Raum des freien Denkens in den Vordergrund. Çabej vertrat die Überzeugung, dass die Wissenschaft keine politischen Grenzen kennt und dass die Erforschung der Sprache ein Beitrag zum Verständnis der Menschheit ist. Diese Haltung verlieh seiner Arbeit eine moralische Dimension, die über die reine Sprachwissenschaft hinausgeht. Besonders in einem System, das Wissenschaft ideologisch kontrollierte, wurde Çabejs Beharrlichkeit zu einem Akt geistiger Freiheit.

Grundlage bilden die Originalbriefe aus dem Familienarchiv Çabej, die von seiner Tochter Brikena Çabej sorgfältig aufbewahrt und erstmals der Öffentlichkeit zugänglich gemacht wurden.

Die Monografie basiert auf einer historisch-dokumentarischen und sprachwissenschaftlich-analytischen Methode. Sie folgt einer methodisch klaren Linie, die auf Archivforschung, textlinguistischer Analyse und historisch-kultureller Kontextualisierung beruht. Ihre Autorinnen kombinieren drei Forschungsebenen:

Archivforschung: Die Briefe stammen aus dem Familienarchiv Çabej (der Tochter von Eqrem Çabej, Frau Brikena Çabej) und werden hier erstmals vollständig veröffentlicht. Im Anhang befinden sich die gescannten Originaltexte des Briefwechsels mit den drei Persönlichkeiten, die zudem ins Albanische übersetzt wurden.

Text- und Sprachanalyse: Der Brief wird als besondere Form der wissenschaftlichen Kommunikation untersucht, als „Mittel, durch das Gelehrte ihre Ideen prüfen, Bestätigung oder Kritik suchen" (Artmann 1996, 184).

Historisch-sozialer Kontext: Die politischen und gesellschaftlichen Bedingungen, unter denen Çabej arbeitete - Zensur, ideologischer Druck und Isolation –, werden historisch aufgearbeitet, um den Wert dieser Korrespondenz voll zu erfassen.

Es ist von besonderer Bedeutung hervorzuheben, dass die Briefe von Professor Eqrem Çabej nicht überliefert sind, da er eine Schreibmaschine benutzte, ohne Kopien seiner Schreiben aufzubewahren. Aus diesem Grund sind lediglich die Briefe der deutschen Gelehrten erhalten geblieben. Dieses Detail verleiht der Quelle einen außerordentlichen Wert, da sie sich dadurch von einer „Unbekannten" in eine „Bekannte" verwandelt und ihrer wissenschaftlichen Bewertung eine besondere Dimension hinzufügt.

Gerade deshalb unternimmt die vorliegende Monografie den Versuch, anhand dieser einseitig überlieferten Korrespondenz ein vielschichtiges Bild Eqrem Çabejs als Mensch und Sprachwissenschaftler zu zeichnen und zugleich die Verbindung des damals isolierten Albaniens mit der wissenschaftlichen Welt jener Zeit sichtbar zu machen.Die Briefe offenbaren, wie Çabej, trotz ideologischer Barrieren und politischer Abgeschlossenheit, eine geistige Brücke zur europäischen Forschung aufrechterhielt.

Diese Methodologie ermöglicht es, die Briefe nicht nur als persönliche Mitteilungen, sondern als Spiegel wissenschaftlicher, kultureller und ethischer Haltungen zu verstehen.

Das Hauptziel der Monografie ist es, Eqrem Çabejs Beitrag zur europäischen Sprachwissenschaft und seine Rolle als Mittler zwischen der albanischen und der mitteleuropäischen Forschung sichtbar zu machen.

Darüber hinaus sollen folgende Aspekte erreicht werden: die Erschließung eines bislang unbekannten Quellenbestands zur Albanologie – erstmals im Original (Deutsch) und in albanischer Übersetzung, wodurch der Zugang für albanische Forscher erleichtert wird; die Dokumentation des wissenschaftlichen Dialogs trotz ideologischer Schranken; die Förderung eines besseren Verständnisses für den Zusammenhang zwischen Sprache, Kultur und Geschichte; sowie die Würdigung der intellektuellen und moralischen Haltung Çabejs in einer Zeit der Unterdrückung.

Wie Hermann Ölberg in einem seiner Briefe an Çabej schrieb: , „Selten erhalte ich Briefe, die mich so freuen wie Ihre [...] Nicht minder hat mich Ihr grandioses Schriftverzeichnis beeindruckt, in das ich mich ganz vertieft habe [...] an dieser Leis-

tung sitze ich nun manche Stunden, sie ist so umfassend, dass ich Satz für Satz durchgehen muß." (Ölberg an Çabej, Brief 06.12.1964).

Diese Worte zeigen, dass Çabejs Arbeit weit über Albanien hinaus Anerkennung fand und eine Grundlage für viele spätere Forschungen bildete.

Die Monografie ist in mehrere thematische Kapitel gegliedert. Sie beginnt mit einer historischen Einführung über die Entwicklung des Briefes als Kommunikationsform und seine Bedeutung für den wissenschaftlichen Austausch. Darauf folgen Abschnitte über die sozialen, politischen und kulturellen Rahmenbedingungen der 1950er–1970er Jahre in Albanien, die den Kontext für Çabejs Korrespondenz bilden. Besonders wichtig ist die Darstellung, wie Wissenschaft als stiller Widerstand gegen Zensur und ideologische Bevormundung fungierte.

Çabej verstand seine Forschung als Beitrag zu einer offenen, grenzenlosen Wissenschaft: „Për E. Çabejn, shkenca nuk kishte kufij politikë, ajo ishte një përpjekje e përbashkët për të kuptuar më mirë natyrën e gjuhës dhe historinë e popujve." (Für E. Çabej hatte die Wissenschaft keine politischen Grenzen; sie war ein gemeinsames Bemühen, die Natur der Sprache und die Geschichte der Völker besser zu verstehen) (Parafjala S. 1).

In diesem Zusammenhang werden die drei Persönlichkeiten eingeführt, deren Briefwechsel den Kern der Monografie bilden:

Gerhard Rohlfs (1892–1980) war ein deutscher Romanist und Pionier der Erforschung süditalienischer Dialekte, der als einer der ersten die Bedeutung des Albanischen im mediterranen Sprachraum erkannte. Seine Arbeiten, wie das *Etymologische Wörterbuch der unteritalienischen Gräzität* (1964), zeigen den Einfluss der griechischen Sprache auf das Italienische Çabej bewunderte ihn als Forscher und bezeichnete seine Studien, „die Wörter und Sachen mit der Terrain- und der historischen Forschung in vorbildlicher Weise verbinden", als beispielhaft für wahren Humanismus in der Sprachforschung. (Çabej 1962, 115).

Hermann Ölberg (1922–2017), Professor in Innsbruck und enger Freund Çabejs, bezeichnete ihn als prägende Figur der modernen Albanologie, Jede albanologische Forschung muss ja schließlich bei Ihnen ausgehen." (Ölberg an Çabej, Brief 04.05.1964)

Ölbergs Briefe sind von großem Respekt, wissenschaftlicher Bewunderung und persönlicher Wärme geprägt und belegen die gegenseitige Hochschätzung der beiden Forscher.

Maximilian Lambertz (1882–1963), der erste systematische Forscher der albanischen Sprache im deutschsprachigen Raum, unterstützte Çabej früh und zeigte in seinen Briefen eine tiefe Verbundenheit mit der albanischen Kultur.

Diese drei Persönlichkeiten stehen exemplarisch für den europäischen Dialog, den Çabej trotz der politischen Isolation Albaniens aufrechterhielt. Ihr Austausch beleuchtet den Fluss wissenschaftlicher Ideen über Sprach- und Landesgrenzen hinweg.

Das Ergebnis der Monografie ist die Erkenntnis, dass Eqrem Çabej eine Brücke zwischen der albanischen und der europäischen Wissenschaftskultur bildete. Die Briefe dokumentieren nicht nur die wissenschaftliche Zusammenarbeit, sondern auch die persönliche Integrität und menschliche Größe des Gelehrten. Sein Name steht für die

Idee, dass wissenschaftliche Wahrheit unabhängig von Ideologie, Macht und politischer Kontrolle bestehen kann. Wie im Werk treffend zusammengefasst wird: „Letërkëmbimi i tij me personalitete të përmasave të tilla [...] dëshmon qartazi se puna shkencore e E. Çabejt ishte e njohur dhe e vlerësuar ndërkombëtarisht." (Sein Briefwechsel mit Persönlichkeiten von solchem Format [...] belegt eindeutig, dass die wissenschaftliche Tätigkeit von E. Çabej auf internationaler Ebene bekannt und hochgeschätzt war.), (Parafjala, S. 3).

So wird die Monografie nicht nur zu einem wissenschaftlichen, sondern auch zu einem moralischen Dokument einer Epoche, das zeigt, wie intellektuelle Freiheit inmitten von Kontrolle und Zensur bewahrt werden kann.

Die Briefe belegen nicht nur seinen Einfluss und seine Kompetenz, sondern auch seine menschliche Größe, Bescheidenheit und Standhaftigkeit in einer schwierigen Zeit. Sie dokumentieren, wie sich wissenschaftlicher Dialog als Form des stillen Widerstands behaupten konnte. Damit wird Eqrem Çabej zu einer Symbolfigur für Mut, Wissen und die Überzeugung, dass Wissenschaft, unabhängig von Grenzen, Ideologien und Machtstrukturen, immer ein universelles Gut bleibt.

Die Monografie zeigt, dass Eqrem Çabej als Forscher und Mensch eine vermittelnde Figur zwischen Ost und West war. Seine Korrespondenz dokumentiert nicht nur den wissenschaftlichen Austausch, sondern auch Mut, Menschlichkeit und intellektuelle Unabhängigkeit.

Der Wert dieser Arbeit liegt darin, dass sie eine historische Quelle der europäischen Sprachwissenschaft erschließt, den albanischen Beitrag zur europäischen Kulturgeschichte sichtbar macht und jungen Forschenden zeigt, wie wissenschaftlicher Dialog über politische Grenzen hinweg möglich ist.

Klaus Artmann (1996, 184) betont, dass der Briefwechsel für Gelehrte ein wesentliches Mittel darstellt, um ihre Ideen zu erproben, Bestätigung oder Kritik zu suchen und ihre Forschungsansätze kontinuierlich weiterzuentwickeln. Damit wird Çabejs Briefwechsel zu einem Denkmal wissenschaftlicher Kommunikation – einer Form des leisen Widerstands gegen die Isolation einer ganzen Nation.

Diese Monografie ist mehr als eine Sammlung von Briefen. Sie ist ein Dokument menschlicher Größe und wissenschaftlicher Solidarität. Sie hebt Eqrem Çabej als Forscher hervor, der durch Bescheidenheit, Tiefe und Offenheit bestach, und macht sichtbar, wie Wissenschaft Brücken schlägt, wo Politik Mauern errichtet. „Ai ishte dijetar që fitonte respektin e kolegëve të huaj edhe në periudha të ndërlikuara ndërkombëtare" (Er war ein Gelehrter, der selbst in komplexen internationalen Kontexten die Anerkennung und Wertschätzung seiner ausländischen Fachkollegen zu gewinnen vermochte.) (Parafjala, S. 3). Damit erfüllt das Werk seine Aufgabe, die Geschichte der albanischen Sprachwissenschaft im europäischen Gedächtnis zu verankern.

Brikena Kadzadej, Anila Omari, Mimoza Kore, Sonila Sadikaj

Parafjala

"Non est ad astra mollis e terris via."
Seneca, Epistulae Morales ad Lucilium, 71. Brief

Në historinë e studimeve shqiptare dhe të gjuhësisë indoeuropiane, emri i profesor Eqrem Çabejt (1908–1980) është i lidhur pazgjidhshmërisht me përpjekjen për të vendosur gjuhën shqipe në qendër të një dialogu shkencor ndërkombëtar.

Studiues i përkushtuar, dijetar me horizont të gjerë dhe themelues i shkollës moderne albanologjike, E. Çabej zhvilloi një korpus të gjerë kërkimesh që përfshijnë Historinë e gjuhës shqipe, Etimologjinë, Fonetikën historike, Morfologjinë historike, marrëdhëniet gjuhësore ballkanike etj. Ai mbrojti idenë se gjuha shqipe duhej të trajtohej jo vetëm si një sistem i mëvetësishëm, por si pjesë integrale e një mozaiku gjuhësor të përbashkët evropian.

Vepra e tij kërkon ende studime të reja, dhe kjo monografi me qasje të hapur i përgjigjet kësaj nevoje përmes paraqitjes për herë të parë të një arkive të veçantë: letërkëmbimi i tij me tre nga studiuesit më të rëndësishëm të gjuhësisë europiane të shekullit XX: prof. Gerhard Rohlfs (Tübingen), prof. Hermann Ölberg (Innsbruck) dhe prof. Maximilian Lambertz (Leipzig). Ky letërkëmbim, i ruajtur me përkushtim nga e bija e Profesorit, znj. Brikena Çabej, përfshin letra dhe kartolina origjinale në gjuhën gjermane, të shkëmbyera gjatë një periudhe të gjatë ,nga vitet 1955 deri në fund të viteve 1970.

Është e rëndësishme të theksohet se ne nuk disponojmë letrat e profesor E. Çabejt, pasi ai përdorte makinën e shkrimit pa ruajtur kopje, duke bërë që vetëm letrat e studiuesve gjermanë të mbijetojnë. Ky detaj e bën këtë burim jashtëzakonisht të vlefshëm, duke e kthyer atë nga një "e panjohur" në një "të njohur" dhe duke shtuar një dimension të veçantë në vlerësimin e tij.

Letrat përmbajnë reflektime të thella, komente kritike dhe vlerësime për punën shkencore të ndërsjellë. Ato janë jo vetëm një pasqyrë e bashkëpunimit dhe respektit mes studiuesve, por edhe një dëshmi e vlerësimeve profesionale për kontributet e çmuara të Çabejt. Të gjitha këto komente dhe vlerësime krijojnë një kontekst të pasur për të kuptuar më mirë rëndësinë e veprës së profesor E. Çabejt në lidhje me zhvillimet më të gjera të gjuhësisë ndërkombëtare.

Letërkëmbimi zbulon një rrjet të heshtur dijetarësh që, përmes letrave, ndërtuan ura komunikimi në një periudhë ku Shqipëria ishte e izoluar nga bota perëndimore. Megjithatë, për E. Çabejn, shkenca nuk kishte kufij politikë, ajo ishte një përpjekje e përbashkët për të kuptuar më mirë natyrën e gjuhës dhe historinë e popujve. Në këtë kuptim, "shkenca në Shqipërinë e pasluftës duhej të bënte përballje të vazhdueshme me kufizimet ideologjike dhe çdo produkt i saj përfaqësonte edhe një akt qëndrimi ndaj lirisë së dijes" (Kambo 2005, 92).

Letra akademike, siç e ka përshkruar Klaus Artmann, është një formë e ndërmjetme mes komunikimit privat dhe atij shkencor, që lejon liri në mendim dhe qartësi në

konceptim: "Letërkëmbimi është mjeti përmes të cilit dijetarët testojnë idetë e tyre, kërkojnë konfirmim apo kritikë dhe përpunojnë në mënyrë të pandërprerë qasjen e tyre kërkimore" (Artmann 1996, 184).

Në këtë kuptim, arkivi i letërkëmbimit të prof. E. Çabejt me gjuhëtarë të shquar gjermanishtfolës përfaqëson një burim të paçmuar për studimin e zhvillimit të shkencës gjuhësore shqiptare në kontekst ndërkombëtar dhe për perceptimet që kishte bota akademike europiane mbi gjuhën shqipe në veçanti e për studimet albanologjike, në përgjithësi.

Letërkëmbimi me Prof. Gerhard Rohlfs-in, një nga figurat më të shquara të romanistikës europiane, ka një rëndësi të veçantë. Rohlfs-i (1892–1980), i njohur për studimet e tij mbi dialektet italiane dhe marrëdhëniet mes greqishtes dhe gjuhëve romane, ishte një pionier në fushën e etimologjisë dhe në hulumtimet për ndikimet e gjuhës greke në gjuhët romane. Një ndër kontributet më të njohura të tij është *"Fjalor etimologjik i greqishtes së Italisë së Jugut"* ku ai thekson ndikimet e hershme greke në Italinë e Jugut, të cilat nuk lidhen me periudhën bizantine, por me kontaktet helenistike të mëhershme (Rohlfs 1964, 90–105). E. Çabej e vlerëson kontributin e Gerhard Rohlfs-it për studimin e gjuhës shqipe, veçanërisht të dialekteve arbëreshe në Kalabri dhe Siçili. Ai e përshkruan Gerhard Rohlfs-in si një studiues të rrallë që ndërthur analizën e fjalorit me kërkimin historik dhe gjeografik në mënyrë model, duke e cilësuar qasjen e tij si shprehje të një humanizmi të vërtetë shkencor. E. Çabej thekson rëndësinë e regjistrimeve të hollësishme të Rohlfs-it dhe vlerën që ato kanë për rikonstruksionin historik të shqipes dhe për kuptimin e kontakteve të saj gjuhësore: "Studimet që lidhin fjalët dhe sendet me kërkimin për terrenin dhe historinë [...] janë shembull për humanizmin e vërtetë në kërkimin gjuhësor" (Çabej 1962, 115). Për Çabejn, rëndësia e punës së Rohlfs-it shtrihet përtej dialektologjisë; ajo kontribuon në ndriçimin e zhvillimeve kulturore dhe gjuhësore të diasporës shqiptare dhe në dokumentimin e ndikimeve ndërgjuhësore.

Ndërkohë, Prof. Maximilian Lambertz-i, albanolog me një karrierë të gjatë në Europën Qëndrore, është ndër studiuesit e parë gjermanishtfolës që vëzhgoi sistematikisht shqipen si gjuhë e lashtë indoeuropiane. Interesi i tij i hershëm për Shqipërinë dhe përkrahja që i ofroi brezit të studiuesve shqiptarë, veçanërisht E. Çabejt, del në pah në tonin përkrahës dhe frymën bashkëpunuese të letrave të tij.

Prof. Hermann Ölberg-u, i njohur për përkushtimin e tij ndaj shqipes dhe gjuhëve të Europës Juglindore, është përmendur nga kolegët e tij si një figurë akademike që qëndronte me dinjitet dhe vendosmëri përballë vështirësive strukturore dhe mungesës së interesit institucional: "E njihja si ekspert për shqipen, që me këmbëngulje, edhe kur numri i studentëve ishte gjithmonë i kufizuar, ofronte rregullisht lëndë të specializuara. Për më tepër, ai ishte edhe redaktor i radhës shkencore *Innsbrucker Beiträge zur Kulturwissenschaft*" (Kienpointner & Schmeja 1987, 9). Pikërisht kjo frymë përkrahjeje dhe bashkëpunimi u dëshmua edhe në letërkëmbimin e tij me Çabejn.

Hermann Ölberg-u shpreh respektin dhe admirimin e tij të thellë shkencor ndaj E. Çabejt, duke e vlerësuar kontributin e tij si të jashtëzakonshëm për nga përmbajtja dhe rëndësia në fushën e gjuhësisë ballkanike dhe indoeuropiane

Në letrat e tij, drejtuar E. Çabejt, gjatë viteve 1964–1967, Hermann Ölberg-u e vlerëson Çabejn si figurën themelore të Albanologjisë moderne, me një ndikim të pakrahasueshëm në fushën e studimeve gjuhësore. Ai shprehet "Rrallëherë marr letra që më gëzojnë aq shumë sa e juaja [...] Po aq më ka lënë mbresë bibliografia juaj madhështore, në të cilën jam zhytur krejtësisht [...] Jam duke u marrë me këtë vepër prej orësh të tëra, është aq gjithëpërfshirëse, sa duhet ta lexoj fjali pas fjalie." (Öberg/Brief 06.10.1964)

Nga letërkëmbimi i gjerë midis Eqrem Çabejt dhe këtyre tri personaliteteve, prof. E. Çabej del si figurë e jashtëzakonshme e dijes shqiptare, e karakterizuar nga:

- thellësia shkencore dhe përkushtimi i rrallë ndaj studimit të gjuhës shqipe;
- modestia intelektuale, që bashkëjetonte me një autoritet të padiskutueshëm në Albanologji;
- mendjehapur dhe bashkëpunues, i interesuar për zhvillimin e dijes jo vetëm në Shqipëri, por në të gjithë hapësirën europiane;
- durimi dhe përkushtimi afatgjatë edhe në kushte të vështira politike e institucionale;
- kujdesi dhe mirësjellja njerëzore, që shihet në mënyrën se si reflektojnë letërkëmbyesit ndaj tij dhe si pasqyrohet raporti i tij me kolegët dhe bashkëpunëtorët.

Letërkëmbimi tregon jo vetëm aftësinë e E. Çabejt si dijetar, por edhe dinjitetin dhe maturinë e tij si njeri, që fitonte respektin e kolegëve të huaj edhe në periudha të ndërlikuara ndërkombëtare.

Letrat janë botuar në formë të digjitalizuar dhe me përkthim shqip, në mënyrë që të shërbejnë si burim i hapur dhe i qasshëm për studiues të gjeneratave të ardhshme.

Kjo përpjekje për të sjellë këtë material autentik të panjohur më parë nuk është thjesht një akt botimi, por një kontribut i rëndësishëm në trashëgiminë kulturore dhe shkencore shqiptare. Ajo rrit vlerën e komunikimit ndërkombëtar në shkencë dhe ndihmon në njohjen më të plotë të rolit që ka luajtur prof. Çabej si dijetar, si institucion dhe si urë midis shkollës shqiptare dhe mendimit gjuhësor europian.

Letërkëmbimi i tij me personalitete të përmasave të tilla si Rohlfs-i, Ölberg-u dhe Lambertz-i dëshmon qartazi se puna shkencore e E. Çabejt jo vetëm që ishte e njohur dhe e vlerësuar ndërkombëtarisht, por edhe që ajo ndikoi dhe u integrua në debatet më të rëndësishme të kohës për historinë e gjuhëve të Ballkanit dhe të gjuhëve indoeuropiane në përgjithësi. E kjo duket ne fjalët Öberg-ut: "Çdo kërkim albanologjik duhet, në fund të fundit, të nisë nga ju."
(Öberg/Brief 4.5.1964)

Kjo monografi përfshin, gjithashtu, një përmbledhje të kontributeve shkencore të katër personaliteteve të përfshira: E. Çabejt, G. Rohlfs-it, H. Ölberg-ut dhe M. Lambertz-it.

Brikena Kadzadej, Anila Omari, Mimoza Kore, Sonila Sadikaj

Bibliografia

Artmann, K. (1996). *Briefe in der Sprachforschung*. Tübingen: Max Niemeyer Verlag, fq. 184.

Kambo, E. (2005). *Arsimi në Shqipëri 1945–1960*. Tiranë, Akademia e Shkencave, fq. 92.

Rohlfs, G. (1964). *Etymologisches Wörterbuch der unteritalienischen Gräzität*. München: Beck, fq. 90–105.

Kienpointner, M. & Schmeja, H. (1987). *Sprache, Sprachen, Sprechen. Hermann Ölberg zum 65. Geburtstag*. Innsbruck: Innsbrucker Beiträge zur Kulturwissenschaft, fq. 9.

Çabej, E.: "Zum Wortschatz der albanischen Mundarten in Kalabrien" serta romanica, Festschrift für Gerhard Rohlfs zum 75. Geburtstag . Im Einvernehmen mit W. Theodor Elwert und Heinrich Lausberg herausgegeben von Rudolf Baehr und Kurt Wais, Max Niemeyer Verlag Tubingen 1968.

Letra, letërkëmbimi dhe rrugëtimi

Letra është një nga format më të vjetra të komunikimit njerëzor që daton që nga koha e shkrimit të parë. Ajo ka ecur krahas zhvillimit kulturor, teknologjik dhe shoqëror.

Që në ekzistencën e shkrimit, shfaqet edhe letra. Letrat janë ndër trashëgimitë e para historike në formë të shkruar. Si një mjet kontakti, letra gjithmonë ka pasur një rëndësi të madhe për mbajtjen, forcimin dhe konsolidimin e lidhjeve njerëzore në distancë. Lindja e letrës ndërpreu ritmin e jetës së përditshme dhe i dha asaj ngjyrë. "Letrat e tua janë për mua si njolla yndyre që notojnë mbi salcën e hollë të jetës" shkroi piktori dhe kamarieri Wilhelm von Kügelgen, më 9 dhjetor 1842 për vëllain e tij (von Kügelgen 1990, 123), duke përmbledhur kështu vlerën substanciale të letërkëmbimit të tyre të përbashkët.

Letra, si një formë komunikimi, filloi të shfaqet rreth 3500 vjet para Krishtit, në qytetërimet e lashta si Babilonia dhe Egjipti. Letrat e para ishin shkruar në pllaka argjile me shkrim të brendshëm (cuneiform) dhe përdoreshin kryesisht për qëllime administrative dhe tregtare (Krauße 2005, 2).

Me kalimin e kohës, letrat u zhvilluan në forma të tjera, si pergamenë dhe papir, duke u bërë më të lehta për t'u shkruar dhe transportuar.

Në Antikitet, letra shërbeu si mjet komunikimi i rëndësishëm për mesazhet politike, tregtare dhe personale. Pushtetarët grekë e romakë, i përdorën letrat për të dërguar urdhra dhe për të mbajtur kontakte me provincat e tyre. Ovidi dhe Horaci, shkruanin letra që shprehnin mendimet dhe ndjenjat e tyre personale, duke ndihmuar kështu në zhvillimin e letërsisë epistolare (Nickisch 1991, 13).

Gjatë Mesjetës, letra rezervohej kryesisht për elitën. Klerikët dhe aristokratët ishin ata që dinin të shkruanin, ndërsa shumica e popullsisë mbeti analfabete. Kjo periudhë shënoi një rritje të shkrimit të letrave në latinisht, e cila ishte gjuha e komunikimit zyrtar (Krauße 2005, 2).

Letra në këtë periudhë, shpesh, pati një ton formal dhe u përdor për marrëveshje tregtare dhe ngjarje të rëndësishme.

Me Rilindjen dhe Reformën, letra mori një rëndësi të re. Martin Luther përdori letrat për të shpërndarë idetë e tij reformuese, duke e bërë komunikimin më të qasshëm për masat. Kjo periudhë shënoi fillimin e një dialogu më të hapur midis shkencëtarëve dhe intelektualëve, ku letra shërbeu si një mjet për shkëmbimin e ideve (Leppin 2006, 245).

Me rritjen e tregtisë ndërkombëtare në shekullin XIV, letra u bë një mjet thelbësor për bizneset. Letrat tregtare u përdorën për të formalizuar kontratat dhe për të komunikuar rreth transaksioneve. Kjo periudhë shënjoi gjithashtu fillimin e një përdorimi masiv të letrës, duke e bërë atë një fenomen të zakonshëm në jetën e përditshme (Osterhammel 2007, 597).

Në shekujt XVIII–XIX, letra u pa si një medie e rëndësishme e komunikimit personal. Një grup i ri i shkruesve, përfshirë gratë, filluan të zgjerojnë rrethin e letërkëm-

bimit, duke e bërë letrën një mjet për shprehjen e ndjenjave dhe të mendimeve personale (Leymelrie 1967, 79).

Kjo periudhë qe një kulm i kulturës së letërkëmbimit.

Letërkëmbimi si mënyrë komunikimi, nuk qe term i panjohur për kulturën shqiptare pasi u zhvillua dhe nga studiues e shkrimtarë të mirënjohur shqiptarë si Sami Frashëri, Jeronim De Rada, Asdreni etj. Në shkrimet e para të shqipes, ndonëse të dokumentuara vonë, ndihet një dialog i njëanshëm; kemi gjurmë të rëndësishme të një lloji të veçantë letërkëmbimi, ku duket sikur autorët bashkëbisedojnë me lexuesit. Le të kujtojmë shkrimet e autorëve të vjetër, që nga Gjon Buzuku e deri te Pjetër Bogdani, ku vihet re një prirje për të këshilluar, për të udhëzuar dhe për të ndërtuar një marrëdhënie dialogu me lexuesin.

Edhe Jul Variboba, në veprën e tij Gjella e Shën Mërisë Virgjër, i drejtohet Krishtit si një bir i vërtetë, me tone emocionale dhe përplot dhimbje: "Bir, si të vranith, mua ku më lanith, si s'të panë..." (Variboba 2001, 262–263).

Me hapat e parë të letërsisë shqipe, filloi të qartësohej edhe letërkëmbimi si formë dhe funksion komunikimi letrar, duke evoluar nga një marrëdhënie e thjeshtë didaktike në një marrëdhënie më e ndërlikuar e dialogut dhe ndërveprimit me lexuesin.

Sot, letra vijon të ketë një rol të rëndësishëm në komunikimin njerëzor, pavarësisht nga zhvillimi i teknologjisë digjitale. Ajo mbetet një formë e çmuar e shprehjes, duke pasuruar marrëdhëniet njerëzore dhe duke dokumentuar histori të ndryshme. Studimi i historisë së letrës na ndihmon të kuptojmë evoluimin e komunikimit dhe rëndësinë e saj në zhvillimin e shoqërisë.

Burim hulumtimi

Hulumtimi i letrave si objekt studimi në gjuhësi është i lidhur ngushtë me gjuhësinë e tekstit dhe sociolinguistikën. Në gjuhësi letra analizohet si një formë komunikimi në variantet e saj të ndryshme, duke përdorur një qasje të bazuar në korpus për të hulumtuar letra autentike. Kjo analizë mund të bëhet si sinkronike ashtu edhe diakronike, për të identifikuar modelet historike të përdorimit të gjuhës dhe konventat e komunikimit (Ermert 1979, 174–176).

Letrat nuk janë vetëm objekte interesante për ilustrim të fenomeneve gjuhësore, por përfaqësojnë forma të veçanta të komunikimit. Ato reflektojnë aftësinë komunikuese të hartuesve si dhe pritshmëritë e marrësve dhe ofrojnë informacion në lidhje me "zakonet e komunikimit", të lidhura me kohën dhe kulturën. (Artmann 1996, 184).

Qëllimi kryesor i kërkimit në gjuhësi, është të shqyrtojë modelet e përdorimit të gjuhës dhe konventat që mund të vihen re në letra që shtrihen përtej strukturave gramatikore, ndërtimit të tekstit dhe modeleve të formulimit për veprime komunikative qendrore (Keller et al. 2013, 9–24).

Në sociolinguistikë në fokus, shpesh, janë letrat historike, të cilat janë studiuar që nga fundi i Mesjetës. Në këtë këndvështrim trajtohen variante diastratike të cilat janë të përcaktuara nga klasa shoqërore, gjinia, brezi apo mjedisi.

Ruajtja e dialekteve rajonale dhe veçorive gjuhësore përpara standardizimit përfundimtar të gjuhës gjermane të shkruar në shek. XX ofron njohuri të çmuara për raportet shoqërore.

Kultura gjuhësore, veçanërisht e borgjezisë së kulturuar, shfaqet si në shmangien e formave dialektore ashtu edhe në ruajtjen e një stili konversativ që dallon shtresat shoqërore. Një aspekt tjetër i letrave si objekt hulumtimi në linguistikë është shqyrtimi i shkrimit mediatik, siç përshkruhet nga Ehlich (2014). Letrat karakterizohen nga materialiteti i tyre specifik dhe kërkojnë zgjidhje për "situatën e zgjatur të të folurit" që është e shënuar nga mungesa e pranisë dhe pamundësia e ndërrimit të folësve. Disa nga karakteristikat qendrore të një letre përfshijnë autentifikimin e autorit përmes identifikimit të dërguesit, identifikimin e marrësit, si dhe procedurat gjuhësore për të tejkaluar distancën hapësinore dhe kohore (Ermert 1979, 55).

Përfundimisht hulumtimi i letrave tregon se ato ofrojnë njohuri të çmuara mbi proceset komunikative, strukturat sociale dhe dinamikën e identiteteve përmes kohës dhe hapësirës. Diversiteti i llojeve të letrave, nga letrat e dashurisë deri tek ato zyrtare, dhe funksionet e tyre specifike të komunikimit, theksojnë kompleksitetin e komunikimit të shkruar dhe ndërveprimin mes dimensioneve individuale dhe sociale (Ermert 1979, 66–110).

Letra dhe funksionet

Kur njerëzit komunikojnë me njëri-tjetrin përdorin në të shumtën e rasteve, mediumin e letrës, ku letra përbën një pjesë jo të parëndësishme të komunikimit me shkrim.

Goethe është përpjekur të bëjë një nga përcaktimet e para për letrën. Ai e shikon letrën si një nga monumentet më të rëndësishme të qenies njerëzore individuale, të cilat kanë një rëndësi të madhe për pasardhësit, megjithëse nuk janë të konceptuara për ta. (Henke 2007, 176.)

Nickisch e përshkruan natyrën e letrës si një proces komunikues midis dy individëve, në të cilin ndërtohet një deixis hapësirë-kohë dhe që shkon paralelisht me një situatë komunikimi të krijuar në mënyrë karakteristike. (Metzler 1991, 260: 9.)

Sipas Ebert "Në kuptimin prototip, komunikimi me letra është një formë e komunikimit me shkrim që vonohet në kohë dhe lidhet me një instancë transmetimi ndërmjet një shkruesi personalisht përgjegjës i drejtpërdrejtë, dhe një marrësi të vetëm të caktuar ose të disave." (Ebert 2001, 21)

Csáky nga një këndvështrim kulturoro-teorik, e sheh letrën si një komunikim ose mesazh të shkruar me përmbajtje të pacaktuar që përfshin një dërgues dhe një marrës. Ai përmend edhe distancën fizike ndërmjet pjesëmarrësve, e cila e bën të pamundur shkëmbimin verbal, prandaj duhet përdorur një formë e shkruar komunikimi. (Csáky 2005,17)

Më tej, ai shpjegon se kultura mund të shihet si një hapësirë komunikimi dhe se dërguesi dhe marrësi janë për këtë arsye në një hapësirë të përbashkët komunikimi që

përfshin një kontekst social. Brenda kësaj hapësire flitet e njëjta gjuhë, si të thuash, duke përdorur disa kode të njohura për të dy.

Shprehjet, format e të drejtuarit dhe përshëndetjet, pasqyrojnë mjedisin ekzistues të jetesës së të përfshirëve. (Csáky 2005, 17)

Matthews-Schlinzig dhe të tjerë në veprën e tyre "Handbuch Brief" *i* mbështesin këto përcaktime dhe bëjnë të qartë se puna me letrat tregon ndërdisiplinaritet shkencor dhe lejon prioritete të ndryshme. Në thelb ata si Eberti e shohin letrën, si një "medium i komunikimit me shkrim kryesisht personal i vonuar në kohë e në distancë hapësinore." (Matthews-Schlinzig et.al 2020, XI).

Si tipare të pandryshuara të kësaj medie Matthews-Schlinzig dhe të tjerë e shikojnë letrën si (1) tekst, (2) objekt material dhe (3) ngjarje ose veprim.

Sipas Nickisch si funksion i parë bazë i letrës është përcjellja e informacionit. Ai është, si të thuash, bartës i përmbajtjeve të ndryshme, të cilat mund të jenë faktike, për çështje bisnesi, shkencore apo personale. Më pas vjen funksioni i saj apelativ. Kjo lejon që të formulohen dëshirat, urdhërat, kërkesat ose rregullat. Sipas Nickisch, funksioni i tretë bazë i letrës është ai i vetëshprehjes. Këtu shprehet vetvetja e shkrimtarit dhe letra shërben si mjet për atë që Nickisch e quajti "vetëshprehje", "vetëportretizim", "vetërefllektim" dhe "vetëinterpretim"

Ebert shton se "vetëpërfaqësimi apo vetëportretizimi" me letra nuk është thjesht një "qëllim në vetvete", pasi shkrimtari i tregon edhe personit tjetër se si do të donte të perceptohej dhe si duhet ta haste. (Ebert 2001, 27)

Csáky është i mendimit se letrat japin një pasqyrë të mjedisit social dhe kulturor të shkrimtarit dhe pasqyrojnë mentalitetin dhe botëkuptimin e asaj kohe dhe, për këtë arsye, janë gjithashtu dëshmi kulturore. Në këtë kontekst ai përmend "përmbajtjet e një tradite" që mund të mos përmenden në mënyrë eksplicite, por megjithatë janë të pranishme në "memorien sociale".(Csáky 2005, 21)

Në mënyrë të përmbledhur, mund të thuhet se letra ofron një sërë mundësish në diskutim. Në thelb, është një medium i shkruar me karakterin e një mesazhi që të kujton një bisedë dhe lejon autenticitet dhe individualitet. Mes dy individëve krijohet në distancë, si të thuash, një hapësirë komunikimi, me anë të së cilës mund të mbulohet mungesa e tjetrit. Letra ka edhe një karakter roli, i cili mund të shpjegohet me konstituimin e vetes dhe të tjetrit.

Letrat mund të shërbejnë si bartës informacioni, si një apel dhe si mjet vetëshprehjeje dhe kështu të veprojnë si zëvendësues i asaj që flitet. Ato gjithashtu përcjellin kontekstin social dhe kulturor të shkrimtarëve dhe ofrojnë hapësirë për subjektivitet, reflektim dhe diskutim, me funksionin psikologjik që merr rëndësi me kalimin e kohës.

Dialogu, shkëmbimi ndërsubjektiv dhe dinamikat komunikative

Dialogu, një term që rrjedh nga Mikhail Bakhtin, përshkruan dyzimin dhe polifoninë brenda komunikimit njerëzor.

Dialogu (greq. διάλογος) përfshin shkëmbimin midis dy ose më shumë aktorëve dhe gjen një shprehje të veçantë në mediumin e shkruar të letrës. Letra nuk kuptohet vetëm si një komunikim i njëanshëm, por si një shkëmbim ndërsubjektiv, në të cilin zërat e shkrueseve dhe marrësve janë të pranishëm dhe ndërveprojnë me njëri-tjetrin. Bakhtin thekson se çdo shprehje është në lidhje me bisedat e mëparshme; kjo do të thotë se konteksti dhe zërat e të tjerëve hyjnë në fjalën e vet.

Langeheine vërente se karakteri dialogjik i letrave është thelbësor, sepse ato përfshijnë zërat e partnerëve të bisedës që shkëmbejnë radhën në dialog. Kjo shprehet në "sinjalet e kontaktit" si përshëndetje dhe forma të adresimit, që e sqarojnë marrëdhënien midis partnerëve të komunikimit (Metzler Lexikon Literatur 2007, 152–153).

Ndërsa disa teoricienë e pranojnë natyrën dialogjike të letrave si të dhënë, Mattenklott dhe Schlaffer argumentojnë se lexuesi duhet të mendojë për "portretet e adresatëve" për të mos e kuptuar letrën si "hije të paqarta" (Mattenklott dhe Schlaffer, 1988, 15). Kjo perspektivë ngre pyetje rreth vërtetësisë së dialogimit në komunikimin me letra.

Bohrer (1987, 213) shton se në një letër të vërtetë, autori flet kryesisht për veten, çka çon në një ndërtim të vetes që manifestohet në prezantimin e saj.

Buddemeier flet për "komunikimin e trilluar dialogjik", në të cilin letrat përmbajnë elemente dialogjike, edhe pse në fakt nuk ka një dialog në kuptimin klasik. Ai identifikon pesë karakteristika të kësaj forme komunikimi (përfshirja e mëparshme e marrësit, lidhja me bisedat e mëparshme, referimi në marrëdhënie sociale, formimi i sekuencave (p.sh. pyetje-përgjigje), ndërrimi i roleve midis shkruesit dhe lexuesit (Buddemeier, 1973, 47–52).

Kallmeyer (1981) dallon tri nivele të konstitucionit të interaksionit në letrat: konstitucioni i veprimit dhe kuptimit, organizimi i tekstit dhe konstitucioni i marrëdhënies dhe i identitetit. Sidomos niveli i fundit është relevant, pasi tregon se si kuptimi i tjetrës përfshihet në komunikim.

Ebert (2001, 26 f) argumenton se, përveç informimit dhe vlerësimi, lidhshmëria dhe afërsia luajnë një rol në letrat private. Këto aspekte shprehen përmes formave specifike të adresimit, gjuhës së besueshme dhe ndarjes së përvojave të përbashkëta.

Haug (1997, 23) thekson se "komunikimi i marrëdhënieve" është i lidhur me rrezikun, sepse ata që shkruajnë shpalosin një pjesë të identitetit të tyre dhe nuk janë të sigurt për reagimin e marrësit.

Në përgjithësi, është e qartë se dialogimi në letër është një fenomen kompleks që përfshin si ndërveprimin e zërave të ndryshëm, ashtu edhe ndërtimin e identiteteve dhe marrëdhënieve.

Letrat funksionojnë si hapësira të rëndësishme për shkëmbimin ndërsubjektiv, edhe pse ato nuk ofrojnë gjithmonë një dialog të menjëhershëm në kuptimin klasik.

Rrethanat kohore, shoqërore, kulturore dhe politike të letërkëmbimit të prof. Eqrem Çabejt me prof. Hermann Ölberg, prof. Gerhard Rohlfs dhe prof. Maximilian Lambertz

"Shpesh, kur i shkruan një miku, është më shumë rasti, sesa tema e letrës..." (Goethe, 1891, 11).

Letërkëmbimi i prof. Eqrem Çabejt me:

- Prof. Hermann Ölberg nga Universiteti i Insbruck-ut, përfshin 70 letra dhe kartolina të shkëmbyera midis viteve 1964–1980.
- Prof. Gerhard Rohlfs nga Universiteti i Tübingen-it, përfshin 100 letra dhe kartolina midis viteve 1960–1980.
- Prof. Maximilian Lambertz nga Universiteti i Leipzigut, përfshin 30 letra dhe kartolina (disa të dërguara nga bashkëshortja e tij pas vdekjes së Profesor Lambertz) gjatë viteve 1955–1965.

Këto dokumente na janë besuar nga e bija e prof. Çabejt, znj. Brikena Çabej, dhe janë të shtypura me makinë shkrimi. Për fat të keq, nuk disponojmë kopjet e letrave të dërguara nga vetë prof. Çabej, pasi, sipas B. Çabejt, ato hartoheshin pa ruajtur kopje.

Hapësira kohore e këtij letërkëmbimi është e lidhur ngushtë me rrethanat shoqërore, kulturore dhe politike të veprimtarisë së Profesorit dhe pasqyrohet drejtpërdrejt apo nëpër rreshta në këtë letërkëmbim. Ky komunikim zbulon marrëdhënie të caktuara midis veprimtarisë njohëse individuale dhe kolektive, si dhe historike.

Sipas Lacan, "Gjuha kryen një komunikim në të cilin dërguesi merr mesazhin e tij në formë të anasjellë nga marrësi. Kjo tregon se dërguesi dhe marrësi pasqyrohen, nga ana tjetër, ndodh një dërgim dhe marrje e njëkohshme, ose e thënë ndryshe: "Çdo thënie tashmë nënkupton një përgjigje për personin tjetër, edhe nëse ai nuk ka folur fare, por flet vetëm atëherë kur flet edhe dërguesi." (Widmer 1997, 66).

Arsimi dhe shkenca

Prof. Çabej veprimtarinë e tij e shtriu në një periudhë jo shumë të lehtë për popullin shqiptar, si në aspektin historiko-shoqëror ashtu edhe në atë ekonomik.

Pas studimeve të doktoratës Çabej vendosi të kthehej përfundimisht në atdhe, pasi: "Balta e mëmëdheut për të sapodiplomuarin shqipar ishte më e ëmbël dhe më joshëse se bulevardet e kryeqytetit të ish-Perandorisë Austro-hungareze. Ajo e ftonte atë të kthehej në gjirin e popullit të tij për t'i shërbyer atij deri në fund të jetës." (Demiraj, 2008. 21.)

Arsimi dhe shkenca pas viteve '45 iu nënshtruan një reforme arsimore me ndryshime të rëndësishme në bazat ideologjike shkencore (Kambo 2005, 156). Në vitin 1948, pas prishjes me Jugosllavinë e Titos, arsimi dhe shkenca iu nënshtruan metodave të mësimdhënies sovjeto-marksiste.

Nga viti 1955, rusishtja u bë gjuhë e huaj e detyrueshme në arsimin shqiptar që orientohej nga modelet sovjetike. (Finger, 1993, 532).

Instituti Pedagogjik 2-vjeçar u hap më 20 dhjetor 1946. Me hapjen e tij, u hodhën themelet e shkollës së lartë, me vendimin e Këshillit të Ministrave për hapjen e këtij Instituti, fillimisht me 3 fakultete me afate 2-vjeçare që më tej do të bëheshin 4. Drejtuesit dhe pedagogët e parë të shkollave të larta ishin autoritete të njohura, por edhe emra që gradualisht u formuan si personalitete të fuqishme të arsimit dhe të shkencës shqiptare, si: Aleksandër Xhuvani, Kostaq Cipo, Eqrem Çabej, Dhimitër S. Shuteriqi, Aleks Buda... (Kambo, 2005, 152).

Në vitin 1951 u hapën tri institucione të reja të arsimit të lartë: Institut pedagogjik, Politeknik dhe ai Bujqësor. Më vonë, u hapën edhe ai Mjekësor, Ekonomik dhe Juridik.

Një ndër detyrat kryesore të organeve partiake me hapjen e institucioneve arsimore ishte "përmirësimi i përbërjes shoqërore të kuadrit." U rrit pjesëmarrja e elementëve nga klasa punëtore, shtresat e varfra... (Kambo, 2005, 92). Me gjithë mungesat në kuadrin arsimor, përzgjedhja bëhej mbi bazën e "kritereve biografike", të cilat u kthyen në normë (Kambo, 2005, 93).

Ata që kishin studiuar në Perëndim më herët dhe që ishin aktivë quheshin "kuadro të vjetër" dhe konsideroheshin si persona që ishin nën ndikimin e shkollave të Perëndimit dhe, si rrjedhojë, edhe nën zotërimin e "ideologjive borgjeze që vinin nga këto shkolla". (Dushku, 2020, 206).

Për të hyrë në shkollat e larta duhej të plotësoheshin standardet mbi qëndrimin politik, origjinën shoqërore e nivelin ekonomik të studentit, ku thelbësore ishte qëndrimi politik dhe besueshmëria ndaj sistemit. Detajet përfshiheshin jo vetëm për familjen, por edhe për rrethin familjar, nëse kishte të pakënaqur, të "burgosur", "të arratisur" me veprimtari armiqësore... (Kambo,2005, 93). Regjimi komunist kishte në qendër të vëmendjes "besueshmërinë politike që duhet të kishte te ai brezi i ri" (Logoreci, 1977, 169–170).

Për përpunimin politik e ideologjik të personelit mësimor, u përdorën jo vetëm institucionet dhe format e përgjithshme si shtypi, radioja, por edhe botimi i veprave teorike marksiste, konferencat politike, manifestimet publike për probleme të politikës së brendshme dhe ndërkombëtare etj. (Kambo, 2005, 104).

Për udhëheqjen e lartë komuniste, Arsimi i Lartë përfaqësonte jo thjesht një mundësi më tepër për shkollimin e popullsisë, por "çelësin" e zgjidhjes së problemit të përgatitjes së kuadrove të nevojshme e të përshtatshme për zhvillimin socialist të ekonomisë e të kulturës (Kambo, 2005, 149).

Gjashtë vjet më vonë, më 16 shtator 1957, u hap Universiteti i parë Shtetëror i Tiranës (UShT), si qendër jo vetëm për trajnimin e specialistëve të ardhshëm, por njëherazi edhe si qendra kërkimore.

Më 1972, u krijua Akademia e Shkencave nën drejtimin e Profesor Aleks Budës. E. Çabej ishte një ndër anëtarët themelues të AShSh-së. Me krijimin e Universitetit të Tiranës më 1957, Çabej rifilloi veprimtarinë e tij pedagogjike dhe shkencore këtu.

Rrethanat shoqërore, kulturore dhe politike në të cilat punuan këta shkencëtarë ishin ato të një shteti të diktaturës së proletariatit, ku të gjitha fushat e jetës duhet të

përshkoheshin nga ideologjia marksiste-leniniste. Shkenca dhe arsimi ishin nën kontrollin e shtetit dhe mjet i rëndësishëm për indoktrinimin ideologjik të brezit të ri. Madje dhe detyra e AShSh-së ishte mbështetja e rindërtimit socialist të vendit nën drejtimin e principeve marksiste-leniniste.

Për të mbajtur nën kontroll gjithçka, shteti përdorte Sigurimin e Shtetit, agjitacionin e propagandën, fletërrufetë, luftën e klasave etj.

Profesorët me origjinë fisnike, me formim dhe veprimtari jashtë vendit dhe mendje të hapur si prof. Çabej ishin një problem shqetësues për diktaturën dhe vetëkuptohet që survejoheshin pandërprerë dhe letërkëmbimet e tyre u nënshtroheshin kontrollit të Sigurimit të Shtetit. Në dosjen e përpiluar nga Sigurimi i Shtetit, ka shumë të dhëna në lidhje me vëzhgimin e prof. Çabejt.

Ai në këtë dosje, nisur nga origjina e tij fisnike, përshkruhet si pinjoll i shtresave të pasura, i një familjeje që "ka qenë kundra pushtetit" (AIDSSH, Dosja Formulare e E. Çabejt, fl. 23: Datë. 23. IX, 1947.).

Eqrem Çabej ishte nën mbikëqyrjen e vazhdueshme të Sigurimit të Shtetit, siç dëshmohet në raportin e datës 10 nëntor 1970 nga bashkëpunëtori "Noli." Në këtë raport theksohen takimet e tij të shpeshta me albanologun e njohur austriak Hermann Ölberg, i cili ishte në hotel "Dajti" gjatë vizitës së tij më 1970 në Shqipëri.

Çabej, duke i uruar mirëseardhjen menjëherë pas mbërritjes, tërhoqi vëmendjen e autoriteteve që ndiqnin me dyshim veprimtarinë e Ölbergut, duke e konsideruar si një person me mision të fshehtë. (AIDSSH, Dosja Formulare e Eqrem Çabejt1981, fl. 149–150).

Ky është në vija të përgjithshme konteksti shoqëror, kulturor dhe politik që na ndihmon për të kuptuar përmbajtjen e këtij letërkëmbimi.

Censurimi i letrave

Fjala latine "censura" merr në Epokën e Re kuptimin "kontrolli i shkruar" (Plachta 2011, 864). Letra e mbyllur përfaqëson sekretin e letërkëmbimit, i cili garanton një komunikim jopublik midis dërguesit dhe marrësit (Bohn 1997, 41). Kjo e drejtë për fshehtësinë filloi të regjistrohet ligjërisht për herë të parë në Kushtetutën e Paulskirches 1848 (Badura 2014, 13).

Sekreti i postës u vendos për herë të parë si detyrë për postierët për të ruajtur fshehtësinë në vitin 1690 (Burgdorf 2015, 1999), por në praktikë shpesh mbeti i kufizuar. Me krijimin e shërbimeve postare rajonale, shtetet mund të kontrollonin dhe lexonin informacionin.

Në Epokën e Re, u krijuan departamente shtetërore që merreshin me censurën e letërkëmbimit, siç ishin "kabinetet e zeza" (Grillmeyer 1999). Këto zhvillime çuan në nevojën për të koduar mesazhet, pasi mbikëqyrja e postës ishte e përhapur gjerësisht.

Martin Luther-i, në shkrimin e tij "Von den heimlichen und gestohlenen Briefen" (1528), thekson rëndësinë e fshehtësisë së letërkëmbimit. Ai e akuzon Dukën Georg të Saksonisë për hapjen e një letre private dhe e quajti këtë veprim si vjedhje dhe falsifi-

kim. Luther thotë: "Një vjedhës është një vjedhës, qoftë ai vjedhës i parave apo vjedhës i letrave". Ai argumenton në vijim se hapja e letrës pa lejen e dërguesit e deformon tërë mesazhin dhe qëllimin e tij (Ebeling 1999, 27–28). Kështu, Luther mbështet një të drejtë morale për të ruajtur sekretin e letërkëmbimit, duke reflektuar një qëndrim që shfaqet edhe në legjislacionin e asaj kohe.

Në RDGJ, sekreti i letërkëmbimit u përfshi si një e drejtë themelore në Kushtetutat e 1949, 1968 dhe 1974 (Neni 8 dhe Neni 31). Megjithatë, kjo e drejtë themelore mund të kufizohej në rastin e rrezikimit të "sigurisë së shtetit socialist" ose në kuadër të ndjekjeve penale (neni shtesë 31 i Kushtetutës së 1969).

Posta Gjermane punonte ngushtësisht me Ministrinë e Sigurisë Shtetërore, e cila ishte përgjegjëse për censurën. Në vitin 1989, departamenti "Shërbimi 12" kishte rreth 2200 punonjës, të cilët kontrollonin sistematikisht postën (Labrenz-Weiß 2005, 3–5).

Censura e mendimeve, letërkëmbimit

Në Shqipërinë komuniste, censura e mendimeve dhe e letërkëmbimit ishte një komponent qendror i kontrollit politik. Qeveria nën Enver Hoxhën i trembej çdo forme të mendimit ndryshe dhe përdori masa të gjera për të mbikëqyrur dhe shtypur komunikimin e qytetarëve, gjë që solli pasoja të thella në jetën individuale dhe shoqërore të njerëzve.

Fletërrufetë ishin një nga format më të përdorura dhe më të ashpra të saj. Ato shërbenin për të denoncuar individë që konsideroheshin si "armiq të popullit" dhe që devijonin nga ideologjia e Partisë. Ato, shpesh të varura në hapësira publike si shkolla, ndërmarrje, ose rrugë, ishin afishe me akuza dhe përmbajtje denigruese, të cilat synonin turpërimin e individëve. Ato kishin për qëllim të shërbenin si shenja të përjashtimit dhe dëshmonin fuqinë e sistemit për të mbajtur nën kontroll çdo mendim ose veprim të pakënaqshëm. Përveç rolit të denoncimit, fletërrufetë krijonin një atmosferë frike, duke i detyruar qytetarët të jetonin në një klimë ku çdo mendim i shprehur mund të shndërrohej në një kërcënim për karrierën dhe mirëqenien e tyre. Kjo çonte në një formë të vetëcensurës, ku individët shmangnin shprehjen e mendimeve që mund të dukeshin të kundërta me linjën e Partisë.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm ishte krijimi i një "klime shoqërore të përndjekjes", ku njerëzit fillonin të spiunonin njëri-tjetrin. Ky presion çonte në formimin e një grupi të ngushtë dhe të besuar që mbante nën kontroll mendimet dhe veprimet e individëve, duke forcuar një ndjenjë pasigurie dhe frike që mbizotëronte në çdo aspekt të jetës sociale.

Kështu fletërrufetë ishin jo vetëm mjet për të ndëshkuar dhe përjashtuar individët, por edhe një mekanizëm për të ruajtur dhe forcuar një sistem të fuqishëm të censurës dhe të kontrollit shoqëror. Për periudhën e fletërrufeve të prof. Çabejt jemi bazuar në shënimet e së bijës së profesorit, Brikena Çabej, dhe në arkivin e familjes Çabej, të ruajtur me kujdes të veçantë prej saj.

Sipas arkivit të familjes Çabej, përndjekja me fletërrufe filloi në dimrin e vitit 1967, në kuadër të një revolucioni kulturor të ngjashëm me Revolucionin Kulturor Kinez. Kjo periudhë shënoi një ndryshim të thellë në Shqipëri, pas ngjarjeve të 6 shkurtit, kur E. Hoxha mbajti fjalimin e njohur të ashtuquajturin "Fjalimi i 6 Shkurtit". Pas këtij fjalimi, nëpër shkolla dhe institucione shpërtheu një stuhi presioni, e shoqëruar me dhunë verbale dhe psikologjike, duke e bërë atmosferën të mbushur me frikë dhe terror. Kjo dhunë shpesh u shoqërua me fletërrufetë, një formë e veçantë akuzash të publikuara dhe të shfaqura në muret e shkollave, rrugëve, ndërmarrjeve dhe lagjeve. Termi "fletërrufe" ishte një huazim i konceptit kinez "dacibao" që do të thotë një formë denoncimi publik, ku emrat e individëve akuzoheshin për veprime ose mendime të huaja, armiqësore ndaj regjimit. Këto fletërrufe ishin letra afishe të mëdha, që shpesh nisnin me fjalën "Fletërrufe" dhe më pas emrin e individit të akuzuar. Qëllimi i këtij akti ishte që të krijonte një presion të fortë publik ndaj individëve dhe t'i turpëronte ata për "gabimet" që ishin bërë të dukshme në publik.

Një nga personat që u vu në shënjestër nga këto fletërrufe ishte prof. Çabej, emër i shquar në gjuhësisë shqiptare. Fletërrufeja e parë kundër tij u shfaq në pranverën e vitit 1967, kur u var në muret e Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë, ku ai jepte mësim. B. Çabej thekson që këto afishe ishin të mëdha dhe të dukshme që përhapnin akuzat, duke e bërë Çabejn objekt të turpit publik. Edhe kur Instituti i Gjuhësisë u transferua në një godinë tjetër, këto afishe e ndoqën Çabejn, duke u varur sërish në muret e Institutit të ri. Qëllimi i këtyre fletërrufeve ishte të vendosej një lloj presioni publik mbi të, duke e bërë të ndihej i përjashtuar dhe i sulmuar për dijet e tij.

Në atë kohë, kushdo që vihej në shënjestër të një fletërrufeje duhej të përballej me to duke bërë autokritikë dhe pranim të detyruar të fajësisë që shpesh ishte e paqenë, thjesht për t'u shpëtuar përndjekjeve. Nëse nuk përgjigjeshe "me përulje", ndëshkimi mund të ashpërsohej, siç ndodhi me Çabejn, ndaj të cilit autorët e fletërrufeve këmbëngulën pa pushim për më shumë se një vit, duke mos u tërhequr deri sa atë e detyruan të largohej përfundimisht nga mësimdhënia në Universitet.

Kjo periudhë e përndjekjeve përmes fletërrufetëve ishte një nga metodat më të dhunshme dhe të turpshme të diktaturës komuniste për të mënjanuar dhe për të shkatërruar individët intelektualë dhe kritikë të regjimit. Çabej i ruajti këto shënime nga mbledhjet në trajtën e procesverbaleve me shkurtime, për t'i pasur parasysh dhe për t'u mbrojtur, duke lënë kështu dhe një dëshmi të fortë për kohën. Të gjitha këto tekste janë ruajtur në një zarf të shënuar me të kuqe: "Fletërrufe." (Çabej, B, dorëshkrimi)

Ato mbetën një kujtesë e heshtur e një kohe kur shoqëria shqiptare përpiqej të ndrydhej nga një sistem që shfrytëzonte çdo mjet për t'i hequr individit të drejtën për të shprehur hapur dhe lirshëm mendimin e tij. Fletërrufetë nuk ishin thjesht një mjet për të ndëshkuar individë të veçantë, por një sistem i tërë për të mbajtur të gjithë shoqërinë në gjendje gatishmërie të vazhdueshme, duke bërë që çdo qytetar të ndihej i vëzhguar, i kontrolluar dhe i frikësuar për të shprehur hapur dhe lirshëm mendimin e tij. Policia sekrete shqiptare, Sigurimi, mbikëqyri të gjitha format e komunikimit duke përfshirë dhe letërkëmbimin. Letrat jo vetëm që ishin të censuruara, por shpesh hapeshin dhe lexoheshin. Kjo ndërhyrje në privatësi synonte që të siguroheshin se nuk do të përhape-

shin mendime kritike apo ide opozitare. Edhe telefonatat dhe bisedat personale nuk ishin të sigurta.

Informatorët u infiltruan në shoqëri për të raportuar shprehje të dyshimta. Frika nga zbulimi e detyroi shumicën e njerëzve të mbanin mendimet e tyre të fshehta dhe madje të flisnin me kujdes edhe në rrethin më të ngushtë. Frika nga survejimi dhe pasojat e saj ndikonin rëndë në marrëdhëniet akademike të kohës. Një shembull i qartë ishte heshtja, moskompetenca për vendimmarrje e studiuesve shqiptarë dhe e Akademisë së Shkencave ndaj letrave të albanologut të njohur, Babinger, i cili, me kërkesë të vetë këtij institucioni, përpiqej të siguronte fonde për libra. Në këtë proces, prof. Çabej shfaqej si urë lidhëse, ndërmjetësuese dhe figurë mendjehapur, e aftë dhe korrekte, e vlerësuar nga Babinger në letërkëmbimin e tyre. Ai nuk ngurronte të diskutonte dhe ta mbështeste atë, pavarësisht pasojave (Kadzadej – Krasniqi 2024, 257).

Në dosjen formulare, përpiluar nga Sigurimi i Shtetit, ka shumë të dhëna në lidhje me vëzhgimin që i bëhej prof. Çabejt. Sigurimi i Shtetit në fund të vitit 1952 e rriti nivelin e "elementit kundërshtar Eqrem Çabej" nga niveli II B, në të cilin ishte, në nivelin II A, sipas raportimeve kundër tij. Sipas kësaj, Çabej kryente "Aktivitet antipopullor, kundër atdheut dhe popullit" Arsyetimi për kalimin në nivelin II A mbështetej prej tyre në këtë raport, në shkollimin e Eqremit në Vjenë, ku sipas tyre, rridhnin edhe tendencat naziste që ai i kishte përforcuar gjatë viteve në Itali në kohën e Luftës së Dytë Botërore, si përfaqësues i "Ernest Koliqit". (AIDSSh, Dosja formulare e Eqrem çabejt, NR. 2383, fl. 6. Raportpropozimi për survejim në nivelin II B për Eqrem Çabej, Data mungon, po aty, fl. 16, Raport kategorizimi në II A për Eqrem Çabejn, më 6 tetor 1952, shih: Ledia Dushku, "Armik i pushtetit popullor", 210.)

Profesor Çabej u përpoq të qëndronte larg politikës dhe presioneve të ndryshme të kohës dhe kontributi shkencor për gjuhën shqipe, përqendrimi në hulumtim, shmangia e provokimeve e bëri të mbijetojë. S. Mansaku përmend qëndrimin e Çabejt ndaj sistemit jodemokratik, se ai edhe në kushtet e një sistemi jodemokratik që e kishte shpallur hapur dhe kërkonte nënshtrimin e çdo veprimtarie shkencore ndaj politikës dhe ideologjisë partiake sunduese të kohës, mundi ta ruajë pa cënuar vetëdijen e kërkimit shkencor objektiv e të pavarur, duke qëndruar larg presioneve e ndikimeve politike të kohës dhe retorikave nacionaliste e amatoreske. (Mansaku 2008, 31)

Me rënien e regjimit në vitin 1990 dhe hapjen politike të Shqipërisë erdhi gjithashtu mundësia për të reflektuar mbi censurën dhe nënshtrimin e mendimeve. Letra dhe dokumente të tjera private, të cilat ishin krijuar gjatë diktaturës, u bënë dëshmitare të rëndësishme që dokumentonin realitetin e jetës nën një regjim totalitar.

Sot, mbikëqyrja dhe censura e komunikimit mbetet gjithashtu një temë e rëndësishme në komunikimin modern elektronik, pasi monopoli shtetëror mbi dërgimin e letërkëmbimit është zhdukur në epokën e internetit.

Bibliografia

Artmann, Klaus (1996). *Briefe in der Sprachforschung.*

Baasner, Klaus (1999). *Die Konventionalisierung von Briefen.*

Beyrer, Klaus (2007). Die Schwarzen Kabinette der Post", in: Zensur im Jahrhundert der Aufklärung. Hg. v. Wilhelm Haefs u. York-Gothart Mix. Göttingen.

Bohn, Cornelia (1997). "Ins Feuer damit: Soziologie des Briefgeheimnisses", në: Aleida Assmann / Jan Assmann (Hg.): *Schleier und Schwelle.* Bd. 1: *Geheimnis und Öffentlichkeit.* München.

Bohrer, Karl Heinz (1987). *Der romantische Brief. Die Entstehung ästhetischer Subjektivität.* München, Wien: Hanser.

Buddemeier, Heinz (1973). *Kommunikation als Verständigungshandlung.* Frankfurt/Main: Athenäum.

Burgdorf, Wolfgang (2015). *Protokonstitutionalismus. Die Reichsverfassung in den Wahlkapitulationen der römisch-deutschen Könige und Kaiser 1519–1792.* Göttingen.

Çabej, Brikena. Dorëshkrim i ruajtur në arkivin familjar Çabej. Dosja "Fletërrufe".

Demiraj Shaban: Eqrem Çabej. Një jetë kushtuar shkencës. Akademia e Shkencave, Tiranë, 2008.

Dushku, Ledia (2020). "Armik i pushtetit popullor" që shkencërisht "punon për ne": Shteti komunist dhe studiuesi Eqrem Çabej (1944–1954)", në: *Studime Historike,* 3–4.

Ebeling, Gerhard (1997). *Luthers Seelsorge. Theologie in der Vielfalt der Lebenssituationen an seinen Briefen dargestellt.* Tübingen.

Ebert, Helmut (2001). "Zum Zusammenhang von Strategie, Struktur und Stil am Beispiel der >Anatomie < eines Privatbriefes", në: Werner M. Bauer et al. (Hg.): *Ich an dich.* Innsbruck.

Csáky, Moritz: Zwischen Oralität und Literalität. Überlegungen zum Brief aus einer kulturtheoretischen Perspektive. In: Der Brief in der österreichischen und ungarischen
Literatur. Hrsg. v. András F. Balogh und Helga Mitterbauer. Budapest: ELTE Germanistisches Institut 2005. (Budapester Beiträge zur Germanistik. 45.).

Ehlich, Konrad (2014). "Eine kurze Pragmatik des Briefs", në: *Fontanes Briefe.* Hg. v. Hanna Delf von Wolzogen u. Rainer Falke. Würzburg.

Ermert, Karl (1979). *Briefsorten. Untersuchungen zu Theorie und Empirie der Textklassifikation.* Tübingen.

Finger, Zuzana (1993): Schulsystem, in: Grothusen, Klaus-Detlev (Hrsg.): Albanien Sudosteuropa-Handbuch Band VII: Vandenhoeck & Ruprecht, Göttingen.

Foschepoth, Joseph (2009). "Postzensur und Telefonüberwachung in der Bundesrepublik Deutschland (1949–1969) ", në: *Zeitschrift für Geschichtswissenschaft,* 57(5): 413–426.

Grillmeyer, Siegfried (1999),"Habsburgs langer Arm ins Reich. Briefspionage in der Frühen Neuzeit", in: Streng Geheim. Die Welt der verschlüsselten Kommunikation. Hg. v. Klaus Beyrer. Heidelberg.

Grillmeyer, Siegfried (2005). [Art.] "Briefzensur", in: Enzyklopädie der Neuzeit, 2.

Goethe, J. W. . Weimarer Ausgabe, 1. Abt., 46. Band, 1891

Haug, Walter (1997). "Das Geständnis. Liebe und Risiko in Rede und Schrift." Në: Gespräche – Boten – Briefe. Berlin: Schmidt.

Henke, Silvia: Eigensinnige Briefe. Zwischen Literatur- und Medienëissenschaft. In: Weiterlesen. Literatur und Wissen. Hrsg. v. Ulrike Bergermann und Elisabeth Stroëick. Bielefeld: 2007.

Kadzadej / Krasniqi (2024). "Eqrem Çabej në këndvështrimin e studiuesit Franz Babinger". Prof. E. Çabej përmes letërkëmbimit me kolege dhe kolegë të gjuhës gjermane. Punime të Konferencës Shkencore Ndërkombëtare. Tiranë.

Kallmeyer, Werner (1981). "Aushandlung und Bedeutungskonstitution". Në: Sprache der Gegenwart, Bd. 54.

Kambo, Enriketa (2005). "Arsimi në Shqipëri 1945–1960". Akademia e Shkencave e Shqipërisë.

Keller, Reiner; Hubert Knoblauch; Jo Reichertz (2013)."Der Kommunikative Konstruktivismus als Weiterführung des Sozialkonstruktivismus – eine Einführung in den Band", në: Kommunikativer Konstruktivismus. Wiesbaden.

Kraußе, Erika (Hg.) (2005). Der Brief als wissenschaftshistorische Quelle. Berlin.

Kügelgen, Wilhelm von (1990), Bürgerleben. Die Briefe an den Bruder Gerhard 1840–1867. Hg. V. Walter Killy. München.

Labrenz-Weiß, Hanna (2005). Abteilung M (MfS Handbuch). Hg. v. BStU. Berlin http://www.nbnresolving.org/urn:nbn:de:0292–97839421301720.

Langeheine, Volker (1983). Textpragmatische Analyse schriftlicher Kommunikation am Beispiel des Briefes. URL: https://ids-pub.bszbw.de/frontdoor/deliver/index/docId/1977/file/Langeheine_Textpragmatische_Analyse_1983.pdf.

Leppin, H. (2006). Martin Luther: Der Brief als Kommunikationsmedium. Leipzig.

Leymelrie, A. (1967). Die Kultur der Briefe im 18. und 19. Jahrhundert. Hamburg.

Logoreci, A. (1977). The Albanian – Europe's Forgotten Survivors. Londër.

Mansaku, Seit (2008). "Eqrem Çabej – një model i dijetarit objektiv", në: Studime Filologjike, Nr. 2.

Matthews-Schlinzig, Marie Isabel [u. a.] (Hrsg.): Handbuch Brief. Von der frühen Neuzeit bis zur Gegenwart. Band 1: Interdisziplinarität – Systematische Perspektiven – Briefgenres. Berlin, Boston: de Gruyter 2020

Metzler Lexikon Literatur (2007). *Begriffe und Definitionen*. Hrsg. von Dieter Burdorf et al. Stuttgart, Weimar: Metzler.

Nickisch, R. (1991). *Die Funktionen der Briefe in der Geschichte*. München: Wissenschaftsverlag.

Osterhammel, Jürgen (2007). "Globalgeschichte", në: Hans-Jürgen Goertz (Hg.): *Geschichte. Ein Grundkurs*. Reinbek bei Hamburg.

Plachta, Bodo (2011)."Zensur", në: Helmut Reinalter / Peter J. Brenner (Hg.): *Lexikon der Geisteswissenschaften*. Wien u. a.

Widmer, Peter: Subversion des Begehrens. Eine Einführung in Jacques Lacans Werk. Wien: Thuria + Kant 1997.

Burimet arkivore

AIDSSH, Dosja Formulare e Eqrem Çabejt, fl. 6: Raportpropozimi për survejim në nivelin II B për Eqrem Çabej.AIDSSH, Dosja Formulare e Eqrem Çabejt, fl. 16: Raport kategorizimi në II A për Eqrem Çabej, më 6 tetor 1952.

AIDSSH, Dosja Formulare e Eqrem Çabejt, fl. 23: Përmbledhje e materialit të korrespondencës të Prof. Eqrem Çabej, datë 23. IX. 1947.

AIDSSH, Dosja Formulare e Eqrem Çabejt, fl. 149–150: Vendim mbi arshivimin e dosjes në Kontroll Operativ 2/B të Eqrem Hysen Çabej. Tiranë, më 16.1.1981.

Çabej, Brikena: *Dorëshkrim në arkivin Çabej*. Dosja "Fletërrufe"-Aneks.

Eqrem Çabej – Formimi i shkencëtarit

Jeta e studimeve albanologjike nuk është shumë e gjatë, por kur shohim rrugën e zhvillimit të saj, vepra e Eqrem Çabejt (1908–1980) zë vendin qëndror për nga përmasat e jashtëzakonshme, për nga zgjidhja që iu dha shumë prej problemeve të vështira e madhore jo vetëm të gjuhësisë, por dhe të historisë dhe kulturës së popullit shqiptar.

Eqrem Çabej lindi më 7 gusht 1908 në një familje intelektuale të qytetit të Gjirokastrës. Arsimin fillor e kreu në Gjirokastër, por falë vetive të tij personale, ai fitoi një bursë të Bashkisë së qytetit për të vazhduar për 12 vjet studimet në Austri: tetëvjeçaren në St. Pölten (në familjen Rienmüller) ku për një vit mësoi gjermanishten. Pas kësaj merr dy klasa njëherësh në gjimnazin e Klagenfurtit, të cilin e përfundoi në vitin 1926 me rezultate të shkëlqyera. Në vitin 1927–1928 u regjistrua në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Gracit ku ndoqi studimet për dy semestra dhe më tej vijoi në Universitetin e Vjenës. Dega e gjuhësisë në këtë universitet kishte një traditë të vyer. Aty kishin dhënë mësim profesorët e shquar, si: Franc Miklosich, Vatroslav Jagić, Wilhelm Meyer-Lübke. E. Çabej pati fatin të ishte student i indoeuropianistit dhe grecistit Paul Kretschmer, albanologut Norbert Jokl, arkeologut dhe historianit Karl Patsch. Në këtë qendër universitare kishte një traditë të mirë në studimet e historisë së gjuhës shqipe dhe të popullit shqiptar. Gjatë kohës që kryente përgatitjen si student, ai u përfshi edhe në një punë shkencore në fushën e gjuhësisë dhe të letërsisë. Të viteve të para studentore janë artikujt e tij: "Një shkrim i panjohur i De Radës" dhe "Kundër pseudofilologëve" (1929).

N. Jokl-i e mbajti afër studentin shqiptar e midis tyre pati një bashkëpunim të frytshëm. Punën shkencore E. Çabej e finalizoi në përfundim të universitetit me mbrojtjen e tezës së doktoratës me temën: "Studime Italo-Shqiptare" (*Italo-albanische Studien*) më 7 tetor 1933 me rezultatin *Shkëlqyeshëm* (Ausgezeichnet). Për realizimin e kësaj teme ai shkoi dhe mblodhi material tek arbëreshët e Sicilisë në vitin 1932. Universiteti i Vjenës propozoi që E. Çabej të punonte si asistent-pedagog i N. Jokl-it, por i riu shqiptar, i pajisur me dije shkencore, disiplinë të lartë, me talent e dëshirë për punë, preferoi të kthehej dhe të kontribuonte në atdheun e tij me dëshirë të madhe dhe besim për të ndihmuar edhe vetë në ndriçimin e historisë së gjuhës e kulturës së tij kombëtare.

Ende në të njëzetat e jetës së tij, ai kreu disa punime serioze e çeli rrugë të reja në fushën e folklorit, etnografisë, mitologjisë dhe historisë së letërsisë shqipe, që u botuan kryesisht në revista shkencore europiane. Ato u pritën me interes dhe u cituan gjerësisht, sidomos në literaturën historike e gjuhësore europiane të viteve '30 të shekullit të kaluar, nga autorë si Norbert Jokl, Carlo Tagliavin-i, Georg Stadtmüller etj. Për t'u përmendur janë artikujt "Sitten und Gebräuche der Albaner" (Tradita dhe doke të shqiptarëve) (1935); "Rumänisch-albanische Lehnbeziehungen" (Marrëdhënie huazimi rumuno-shqiptare) (1936); "Albaner und Slaven in Süditalien" (Shqiptarë dhe Sllavë në Italinë e jugut) (1938); "Miszellen" (Shkrime të ndryshme) (1938), në *Revue Internati-*

onale des études balkaniques; "Mundartliches aus Italien" (Elemente dialektore nga Italia) (1936) në *Glotta*; "Volkstum und Volksname der Albaner" (Karakteri kombëtar dhe emri kombëtar i shqiptarëve) dhe "Kult und Fortleben der Göttin Diana auf dem Balkan" (Kulti dhe mbijetesa e perëndeshës Diana në Ballkan) (1941) botuar në *Leipziger Vierteljahrsschrift für Sudosteuropa*; "Der albanische Dichter Gjergj Fishta" (1941) (Poeti shqiptar Gjergj Fishta) botuar në *Südost-Forschungen*. Ai mori pjesë si bashkëpunëtor edhe në hartimin e Enciklopedisë Kroate (Hrvatska Enciklopedija) të botuar në vitin 1941. Me këto punime E. Çabej u bë zëri më i dëgjuar, në mos i vetmi, i shkencës shqiptare në Europë, qysh në vitet '30 të shekullit të kaluar.

Në atdhe filloi punë si mësues i letërsisë në Gjimnazin e qytetit të Shkodrës dhe në vitin 1935–1936 si mësues në shkollën e mesme Normale të Elbasanit. Pas kësaj, emërohet në Ministrinë e Arsimit ku iu besua drejtimi i arsimit të mesëm, post që E. Çabejt nuk i pëlqente ta mbante, prandaj kërkoi të lirohej nga ajo detyrë. Në vitin 1938–39 punon si mësues i letërsisë ndërthurur edhe me njohuri gjuhësore në Liceun e Gjirokastrës, e më vonë, deri më 1940 në Gjimnazin e Tiranës. Po ketë vit ai shkoi për kërkim shkencor në Akademinë e Shkencave në Romë. Këtu ai punoi për te realizuar *Atlasin gjuhësor shqiptar*. Gjatë qëndrimit në Itali, më 1942 qeveria italiane e më vonë dhe pushtuesit gjermanë në 1943, i kërkuan të bëhej ministër i Arsimit, por E. Çabej nuk pranoi bashkëpunim me pushtuesit e huaj. Në kujtimet e tij autobiografike ai thotë "Kam hedhur poshtë çdo propozim për bashkëpunim me të huajin, çdo gjë që nuk pajtohet me nderin tim si shqiptar dhe me të mirën e vendit dhe të popullit" (Demiraj, 1990, 72). Në vitin 1957 hapet Universiteti i Tiranës e në të dhe dega Gjuhë dhe letërsi shqipe, ku E. Çabej filloi punë si pedagog dhe njëkohësisht punonjës shkencor. Punën në këtë universitet e vijoi për shumë vite duke dhënë lëndët e *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe* dhe *Fonetikë historike* si pedagog i jashtëm, sepse ndërkohë ishte punonjës shkencor në Institutin e Shkencave që më vonë u quajt Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë

E. Çabej u nda nga jeta në Romë, më 13 gusht 1980.

Prurjet në Albanologji

Vepra albanologjike e E. Çabej është e pasur dhe e shumanshme. Kontributi u shtri në të gjitha fushat e albanologjisë: gjuhësi, etnografi, mitologji e folklor shqiptar, histori e Shqipërisë dhe letërsisë shqipe, etj.

Metoda shkencore e punës së E. Çabejt

Në rrafshin e përgjithshëm të metodologjisë shkencore, E. Çabej është njëri nga gjuhëtarët e parë shqiptarë që përvetësoi, zbatoi në mënyrë krijuese në pajtim të veçantë me veçoritë dhe rrethanat e shqipes dhe integroi në mënyrë të natyrshme në gjuhësinë historike shqiptare parimet teorike, metodat dhe kërkesat e shkencës gjuhësore europi-

ane të kohës. Në veprën e prof. E. Çabejt kanë gjetur zbatim krijues dhe mishërim metodat, arritjet dhe konceptet shkencore të disa prej shkollave dhe drejtimeve gjuhësore kryesore të fundit të shekullit XIX dhe të gjysmës së parë të shekullit XX, të cilat ai pati mundësi t'i njihte nga afër edhe gjatë kryerjes së studimeve të mesme e të larta në Austri dhe më pas përmes ndjekjes sistematike të literaturës shkencore në disa gjuhë të huaja klasike dhe moderne.

E. Çabej vlerësoi dhe përvetësoi arritjet në fushën e fonetikës së krahasuar, zbatimin e një metode të rreptë shkencore në veprimin e ligjeve fonetike të gjuhës, e cila do t'i shërbente atij në studimet për fonetikën historike dhe në studimet etimologjike të shqipes për t'u dhënë atyre saktësinë dhe rreptësinë shkencore (Mansaku 2018, 221) Për këtë ai u mbështet së pari te Shkolla e Gramatikanëve të Rinj (Çabej 1986, 17) shkolla më e madhe e gjuhësisë krahasuese e gjysmës së dytë të shekullit XIX me përfaqësues kryesorë K. Brugmann, A. Leskien, H. Paul, H. Osthoff etj.

Me gjithë arritjet në kohën e tyre, metodat dhe qëllimet e neogramaristëve janë kritikuar për reduktimin e objektit të hetimit duke u kufizuar në përshkrimin e dukurive sipërfaqësore; mbivlerësimi i gjuhëve historike dhe neglizhimi i atyre bashkëkohore. Për këtë arsye ai u mbështet në një tjetër shkollë në atë të Fjalëve dhe Sendeve, një drejtim tjetër gjuhësor i shpallur së pari nga Jakob Grimm dhe i themeluar në fillim të shek. XX nga gjuhëtari Rudolf Meringer. Parimi shkencor që ndoqi E. Çabej ishte ai sipas të cilit historia e fjalëve duhej studiuar bashkë me historinë e sendeve të emërtuara prej tyre, e kjo gjen zbatim kryesisht në studimet etimologjike.

Çabej do të shkruante: "Parimi që mendojmë se duhet të ndjekë dijetari është kërkimi objektiv i së vërtetës në përpunimin e materialit dhe në paraqitjen e fakteve shkencore. Veçse të qenët objektiv nuk do të thotë që dijetari të jetë indiferent, sidomos në trajtim të problemeve që janë me rëndësi njëkohësisht shkencore dhe nacionale" (Çabej 1965, 289) Për këtë bashkëjetesa e metodologjisë shkencore me frymën kombëtare në veprën e Eqrem Çabejt gjen shprehjen e vet në moton "të jemi objektivë, por jo indiferentë".

Një parim tjetër i rëndësishëm i metodologjisë shkencore të zbatuar me konsuekuencë në veprën e Eqrem Çabejt, sidomos në studimin e problemeve të etnogjenezës dhe të studimeve etimologjike ka qenë pikënisja e kërkimit nga shqyrtimi i dukurive gjuhësore të leksikut dhe i strukturës gramatikore së pari brenda gjuhës shqipe dhe të folmeve të saj, pra e njohjes së mirë të gjendjes së brendshme të saj, duke zbatuar krahasimin e brendshëm historik midis gjendjes së sotme dhe asaj që paraqitet në tekstet e vjetra të shekujve XVI-XVIII, dialekteve dhe të folmeve të shqipes, dhe vetëm pas shqyrtimit të plotë të gjendjes së brendshme, kalohet në krahasime me gjuhë të tjera për një ndriçim të mëtejshëm të burimit të fjalës dhe për ta përfshirë shqipen edhe në marrëdhëniet e saj me gjuhë të tjera ballkanike e europiane.

Çabej zbatoi dhe parime të disa drejtimeve të reja të gjuhësisë moderne sosyriane e passosyriane, sidomos konceptet themelore që kanë të bëjnë me vështrimin sistemor të zhvillimeve gjuhësore, me aspektin funksional të gjuhës dhe sidomos disa teori të reja të gjuhësisë së përgjithshme që arrijnë të shpjegojnë më mirë dukuri të gjuhësisë indoeuropiane, siç janë teza e Ferdinand de Saussure-it mbi sistemin primitiv të zano-

reve të gjuhëve indoeuropiane, teoria e rrënjëve e E. Benvenist-it, teoria fonologjike e N. Trubetskoi-t, teza e Jerzy Kuryłowicz-it për apofoninë në gjuhët indoeuropiane etj. (Mansaku 2018, 243)

Çabej për historinë e gjuhës shqipe

Në krye të interesave shkencore të E. Çabejt ishte historia e popullit shqiptar dhe e gjuhës shqipe. Kjo kërkonte që ai të thellohej në studimin diakronik të parahistorisë dhe historisë së popullit të tij. Me hyrjen e E. Çabejt në shkencën gjuhësore dhe kulturore shqiptare të viteve '30 të shekullit XX nis një fazë e re dhe shënohet një kthesë në studimin shkencor të historisë së gjuhës shqipe dhe të kulturës shpirtërore të shqiptarëve nga vetë shqiptarët. Kontributin e E. Çabejt në këtë fushë e mirëpritën dhe e vlerësuan dhe studiues të huaj, që deri më atë kohë, ishin marrë me këto probleme. Midis vlerësimeve të larta që iu bënë veçohet ai që vjen nga një personalitet i lartë i gjuhësisë europiane dhe albanolog i shquar, siç ishte gjuhëtari danez Holger Pedersen, i cili, pasi kishte lexuar disa nga punimet e E. Çabejt, në një letër që i dërgonte në vitin 1938 e falënderonte dhe e përgëzonte me këto fjalë: "Është e gëzueshme që tani, për herë të parë, një shqiptar i lindur trajton gjuhën dhe historinë e popullit të vet, duke zotëruar mirë metodën e zhvilluar në Europën Perëndimore"[1].

Ai u mor në mënyrë ballore me çështjet më themelore të historisë së gjuhës shqipe: prejardhjen e popullit shqiptar dhe të gjuhës së tij, vendin e formimit të gjuhës shqipe si dhe me çështjen e autoktonisë. Tezën e prejardhjes ilire të shqiptarëve dhe autoktonisë së tyre nuk e kanë shtruar dhe mbrojtur të parët studiuesit shqiptarë, por studiues të njohur të Europës. Për to, para Çabejt, kishte folur J. Thumann, G. Von Hahn, G. Meyer, H, Pedersen, N. Jokl etj. Të gjithë pajtoheshin me prejardhjen ilire të gjuhës shqipe apo më saktë nga një apo disa dialekte të ilirishtes jugore. Në shek. XX të tjerë historianë dhe gjuhëtarë të huaj, si: K. Paul, H. Hirt, G. Weigand, V. Georgiev etj. hodhën idenë e prejardhjes trake të gjuhës shqipe duke e mbështetur kryesisht atë me argumente gjuhësore. Tashmë ishte koha e E. Çabejt të përballej me ta. Prej kohësh ishte bërë e qartë se shqipja zinte vendin e saj në kuadër të gjuhëve IE duke lënë pas hipoteza e gjykime që, përtej detajeve diferencuese, të shpien te konstatimi i përgjithshëm: shqipja është gjuhë indoeuropiane e tipit s*atəm*.

Në linjën Meyer-Jokl edhe E. Çabej theksoi lidhjet e shqipes me grupin e gjuhëve IE. veriore (gjuhët gjermanike, baltosllave). Mbetej të përcaktohej nga cili popull antik i Ballkani vinte populli shqiptar dhe gjuha shqipe. Ideja e vjetër për prejardhjen e gjuhës shqipe nga ilirishtja, pas sprovave për të përcaktuar ilirishten si *centum* e trakishten si

1 Paragrafi i plotë: «Sehr geehrter Herr Doktor ! Ich danke Ihnen herzlich für die freundliche Zusendung Ihrer interessanten Aufsätze "Kostandini i vogëlith dhe kthimi i Odiseut", "Albaner und Slaven in Süditalien" und "Miszellen". Es ist sehr erfreulich, dass jetzt (wohl zum ersten Mal) ein geborener Albaner die Sprache und Geschichte seiner Volkes mit voller Beherrschung der in Westeuropa ausgebildeten Methode behandelt». I botuar ky paragraf i letrës nga M. Mandalà, (dhënë nga e bija B. Çabej) në Punime të Konferencës Shkencore Ndërkombëtare *Prof. E. Çabej përmes letërkëmbimit me kolege dhe kolegë të gjuhës gjermane*, Tiranë, 2024, f.23.
Kjo letër është botuar edhe në gjuhën shqipe në librin e Sh. Demirajt, *Eqrem Çabej*, f. 229.

satəm në dekadat e para të shek. XX, ishte vënë në dyshim duke theksuar njëherësh idenë për prejardhjen nga trakishtja *satəm*. Pas H. Hirt-it, tezën për prejardhjen trakase të shqipes e çoi më tej G. Weigand-i. Edhe H. Barić-i e mbështeti atë. Edhe në kohët tona këtë tezë e risollën K. T. Witczak (Witczak 1994, 21–26; Witczak 1995, 309–312) e më gjerësisht e gjejmë te G. Schramm (Schramm 1981; Schramm 1994) Qysh në tekstin e parë universitar të vitit 1947 "Hyrje në historinë e gjuhës shqipe" e cila u ribotua disa herë, E. Çabej u kushtoi vëmendje gjenezës së popullit shqiptar dhe të gjuhës shqipe si dhe çështjeve të lidhura me to. Këto probleme vijoi t'i trajtojë në një varg punimesh të tjera, si: "Problemi i autoktonisë së shqiptarëve në dritën e emrave të vendit" (1958); "Vendbanimet e hershme të shqiptarëve në gadishullin e Ballkanit në dritën e gjuhës dhe të emrave të vendeve" (1961); "Disa probleme themelore të historisë së vjetër të gjuhës shqipe" (1962); "Ilirishtja dhe shqipja. Çështje parimore" (1969), "Problemi i vendit të formimit të gjuhës shqipe" (1972); "Problemi i burimit të popullit shqiptar dhe të gjuhës së tij" (1976) etj. E. Çabej në fillim të këtyre problemeve parashtroi disa çështje teorike-metodike, duke sqaruar se bëhet fjalë për një autoktoni relative dhe jo pa cak. Vijimësinë ilire-shqiptare ai e mbështeti në një numër përkimesh si në leksik, në onomastikë, në fonetikë e fjalëformim. Një varg antroponimesh e toponimesh ilire, E. Çabej shpjegoi se, gjenin përgjegjësen e tyre vetëm në gjuhën shqipe, si: *Bardus, Barduli, Bato, Dasius, Epicadus, Gentius, Teuta, Dalmatae, Delmatae, Parthum, Taulanti, Drivastum, Dimalum, Drinus, Isamnus (Ishmi), Skardus, Scodra, Scodrinoi, Ulcinium (Ulqin), Mathis* (Mat – breg lumi), *Malontum* (mal) etj. Për herë të parë prej tij u fol edhe për përkime morfologjike.Te *Scodr-a* e *Scup-i*, ai pa shfaqjen e nyjës së prapme *-a, -i* që ka sot gjuha shqipe (ar-a, mal-i). Mbaresën *-e* të gjinores së shqipes e afroi me mbaresën e gjinores së mesapishtes, që vështrohet përgjithësisht si mbaresë e ilirishtes. (Domi 1988/3, 60) Ai shpjegoi se prapashtesës ilire *-esta, -este, -ist*, që del në emra vendesh të territoreve ilire si: *Ladesta, Tergeste, Palaeste* i përgjigjet në shqip prapashtesa *-(e)sht* që del në emra që shënojnë vend si: *vnesht vresht, bresht, kopsht* etj. dhe në emra fshatrash si *Fishtë, Ashtë* etj. Po kështu prapashtesës ilire *-atae, -ates* me të cilat formoheshin në ilirishte emra banorësh të fiseve ilire si *Dalmatae, Dokleatae, Labeates* i përgjigjet në shqip prapashtesa *-at,* që shërben për të formuar emra fisesh e fshatrash si: *Zekat, Progonat, Filat etj*. Vërejti parashtesën ilire *li-* (Liburni khs. Burni) *lë-* në shq. (*lëfyt* khs. *fyt*).

Në vitin 1927 u botua artikulli i famshëm i Gustav Weigand-it (1860–1930) "A janë shqiptarët pasardhës të ilirëve apo të trakëve?" (Sind die Albaner die Nachkommen der Illyrier oder der Thraker?).

Në atë kohë artikulli u kritikua nga studiues të huaj si Norbert Jokl-i, sepse gjuhëtarët shqiptarë të asaj kohe nuk ishin në gjendje të vlerësonin në mënyrë kritike punimin e një prej studiuesve më të njohur të gjuhëve të Ballkanit.

Në atë punim autori kishte arritur në përfundimin hipotetik se shqiptarët ka më shumë të ngjarë të jenë pasardhës të trakëve sesa të ilirëve. Implikimet historike të këtij përfundimi bënë që, kryesisht për arsye jashtëshkencore, ai punim të pranohej e mbështetej shumëkund e në veçanti në shtetet fqinje ballkanike. E. Çabej iu kundërvu tezave të G. Weigand-it, i cili midis shumë argumenteve që sjell në mbështetje të tezës së tij, përmend edhe atë që lidhet me terminologjinë e detarisë në gjuhën shqipe, duke

arsyetuar se terminologjia e lundrimit dhe e peshkimit në gjuhën shqipe është me burim të huaj. Nga ana tjetër, dihet se ilirët kanë qenë detarë dhe prandaj kanë pasur edhe terminologjinë e tyre të detarisë dhe të peshkimit. Po të ishin shqiptarët pasardhës të ilirëve do të kishin trashëguar prej tyre edhe terminologjinë e kësaj fushe, por nuk ka ndodhur kështu, përkundrazi, sipas tij, emrat e lundrimit, të peshqve dhe të veglave të peshkimit janë të huaj. Mbi bazën e këtij arsyetimi, si dhe të lidhjeve të ngushta të shqipes me rumanishten, Weigand-i nxjerr përfundimin se shqiptarët nuk janë autoktonë në viset e tyre të sotme në anët e bregdetit, por janë të ardhur nga vise më lindore të Ballkanit që i përkasin truallit të trakëve. E. Çabej provoi se jo e gjithë terminologjia e detarisë dhe e peshkimit në shqipe është me burim të huaj. Përkundrazi, një pjesë e fjalëve të kësaj fushe me karakter të përgjithshëm si *det, anije, va, shkulm, iriq deti, shul, pëlhurë, halë, ballë, valë* etj. janë të fondit të trashëguar të shqipes. Fjalët e huaja mbizotërojnë në terminologjinë e teknikës së detarisë, siç ndodh edhe në gjuhë të tjera.

Në kushtet e mungesës së mbishkrimeve nga ilirishtja e Ballkanit dhe të dokumentimit me shkrim vonë të shqipes, elementet nga greqishtja e vjetër dhe nga latinishtja, elementet e përbashkëta me rumanishten luajnë një rol të rëndësishëm për të hedhur dritë në çështjet e historisë së gjuhës shqipe dhe të autoktonisë. Prania e një numri huazimesh nga greqishtja e latinishtja, të përmendura më parë nga historiani J. Thunmann, u plotësuan me saktësi e konsiderata të reja shkencore nga E. Çabej. Ato janë dëshmi se historia e lashtë e shqipes është zhvilluar në kontakt të pandërprerë me latinishten e greqishten e vjetër, se stërgjyshërit e shqiptarëve kanë banuar në një territor ku u ndie për një periudhë të gjatë i fuqishëm veprimi i Romës së vjetër, po ashtu edhe se ata janë fqinjë me grekët e lashtë, fakte këto që të shpien patjetër te ilirët. (Domi 1983/3, 61) Çabej thoshte se tezat që i bien shqiptarët të ardhur në viset e sotme nga Veriu a nga Lindja e Gadishullit të Ballkanit nuk mund ta shpjegojnë praninë e elementeve nga greqishtja e vjetër në gjuhën shqipe (Çabej 1974, 9–27). Ai, në vijim të A. Thumb-it, (*Altgr. Elem.* IF 26 pp.1. 26) i cili vuri re 21 fjalë nga greqishtja e vjetër në shqipe, në një varg punimesh (Çabej 1960; 1964/1; 1976; 1982; 1987; 1997) e çoi në rreth 30 të tilla, si: *lakër* < λάχανα, *pjepër* < πέπων os, *presh* < πράσον, *mollë* < μάλον, *kumbull* < κοκκύμηλον, *qershi* < κερασία, *fier* < πτέρις, *shtambë* < στάμνος, *mokër* < μᾶχανά etj. Sot në vijim të punës së tij kanë shkuar në 40, çka është në të mirë të tezës së autoktonisë. Huazimet latine nga ana tjetër, iu nështruan një analize të thellë shkencore në artikullin "Karakteristikat e huazimeve latine në gjuhën shqipe" (Çabej, 1974/2, 15–53) në të cilin ai vërejti se ato kishin pësuar të njëjtin evolucion fonetik sikurse fjalët me burim autokton. Pra të gjitha rrethanat historike – gjuhësore dhe kulturore dëshmojnë se populli shqiptar me gjuhën dhe kulturën e tij është formuar dhe zhvilluar në një territor që ka qenë nën ndikimin e pandërprerë të gjuhëve dhe të kulturave klasike greke dhe latine. Çabej arriti në përfundimin se: ...sipas gjendjes historike dhe gjeografike që na paraqitet, fondin themelor të popullit shqiptar, pas gjase, e përbëjnë ilirët". (Çabej 1975, 205)

Kontributi në fushën e Fonetikës Historike të Shqipes

Për të sqaruar çështjet e historisë së gjuhës shqipe dhe në mënyrë të veçantë etimologjinë e fjalëve, E. Çabej dha një ndihmësë të çmuar edhe në fushën e Fonetikës historike të shqipes. Në pothuaj të gjithë artikujt e punimet e tij ai u mor me këto çështje, duke çuar më përpara arritjet e gjuhësisë së krahasuar lidhur me reflektimit e tingujve indoeuropianë në gjuhën shqipe, duke bërë saktësime, plotësime të rregullave fonetike, madje në shumë raste u formuluan edhe rregulla të reja. Në një varg punimesh si: "Disa aspekte të fonetikës historike të shqipes në dritën e gjuhës së Gjon Buzukut" (1959); "Mbi disa rregulla të fonetikës historike të shqipes" (1970/2); "Fonetikë historike dhe etimologji nga fusha e shqipes" (1978) si dhe teksti "Studime për fonetikën historike të shqipes" ai trajtoi çështje të fonetikës historike. Njëra nga veprat më të rëndësishme të tij, është "Hyrje në studimin krahasues të gjuhëve indoevropiane" (Prishtinë më 1986). Ky libër është mirëfilli një fonetikë historike e shqipes që ka si pikënisje indoeuropianishten, dhe për sa dimë, është punimi i parë i plotë i këtij lloji për gjuhën shqipe. Në të trajtohen zanoret e shkurtra, ato të gjata, diftongjet, sonantet, apofonia dhe laringalet, labialet (buzoret), dentalet (dhëmboret), guturalet, velaret e thjeshta, spirantet, nazalet (hundoret) dhe likuidet.

Ky albanolog i shquar, përcaktoi disa izoglosa kryesore, të cilat përcaktojnë vendin e shqipes në familjen indoeuropiane. Duke shqyrtuar e vlerësuar studiuesit e huaj që ishin marrë me këto probleme ai shqyrtoi çështjen e serive të guturaleve indoeuropiane në gjuhën shqipe, e cila hedh dritë në ndarjen e gjuhëve në *centum* dhe *satem*. Klasifikimi i shqipes në njërin nga këto grupe ishte i lidhur edhe me çështjen e prejardhjes së gjuhës shqipe. Prej shumë gjuhëtarëve ilirishtja konsiderohej gjuhë *centum*, kurse shqipja gjuhë *satem,* duke u mbështetur në reflektimin e tri serive të guturaleve indoeuropiane në gjuhën shqipe: **k,*g, *g^{h} ; *k' *g',*ǵ^{h} ; *k^{w}, *g^{w}, *g^{wh}*. Gjuhët *centum* i kanë shndërruar palatalet **k' *g'* në *k, g,* kurse ato *satem* në *s, z* dhe *sh, zh*. Ky konstatim e largonte shqipen prej ilirishtes. Pas shqyrtimit të të gjitha tezave të gjuhëtarëve të huaj për këtë problem (N. Jokl, F. Ribezzo, A. Meyer, H. Pedersen, W. Cimohowski etj), E. Çabej konstatonte se: "...po të jetë se ilirishtja të ketë shkuar me gjuhët perëndimore ose *centum*, puna që shqipja është gjuhë lindore (*satem)* nga kjo anë nuk përbën një argument të prerë për ta përjashtuar birërinë ilire të saj" (Çabej, 1969, 51). Dijetari ynë bashkohet me ata studiues që e konsideronin ndarjen *centum / satem* si çështje kronologjie, d. m.th si rezultat i zhvillimit fonetik të tingujve: një gjuhë që dikur mund të ketë qenë *centum* në rrjedhë të kohës mund të përfundojë në një gjuhë *satem*.

Në lidhje me pozicionin *verior* apo *jugor* që shqipja zinte në familjen indoeuropiane, ai mbështeti G. Meyer-in mbi reflektimin I. E. *ŏ*: shq. *a*, (**nox > natë*) sikurse në gjuhët gjermanike, balto-sllave, iraniane etj. Me këtë tipar shqipja bënte pjesë në gjuhët veriore të kësaj familjeje, duke u larguar nga latinishtja e greqishtja. Po kështu ai trajtoi bashkëtingëlloret e zëshme të aspiruara **bh, *dh, *gh* që në gjuhën shqipe u reflektuan në të zëshmet e thjeshta *b,d, g*. Me këtë tipar shqipja shkon përsëri me gjuhët gjermanike, balto-sllave, keltishten e iranishten.

Një tjetër izoglosë në fushën e fonetikës, që ndihmon përcaktimin e shqipes, është dhe trajtimi i sonanteve silabike *r̥ ,*l̥. E. Çabej e studioi enkas reflektimin e tyre në gjuhën shqipe, sepse disa gjuhëtarë, ndër të cilët dhe V. Porzig-u e kanë përdorur si argument për të ndarë shqipen nga ilirishtja dhe për ta bashkuar me trakishten. (Dodi 1988/3, 75). E. Çabej i hodhi poshtë këto teori duke vërtetuar se nuk ka divergjenca midis shqipes dhe ilirishtes në reflektimin e *r̥ në shqipe e ilirishte se shembuj të tillë, si: *dritë, krimb, brimë* etj. tregojnë afëri të këtyre gjuhëve. Për gjuhët indeuropiane Çabej dallon apofoninë kualitative dhe atë kuantitative. I ilustron ato me shembuj nga gr. e vjetër dhe latinishtja dhe shpjegon apofoninë *e-o* në gjuhën shqipe përmes rasteve *bie* (shkalla *e*) dhe *bart, bie, barrë* (shkalla *o*). Sipas Çabejt apofonia kualitative ka lidhje me theksin muzikor, ndërsa ajo kuantitative me theksin dinamik. Duke u ndalur tek kjo e fundit ai vë në dukje katër shkallët e saj, normale ose e plotë (Vollstufe), e zgjatimit (Dehnstufe), e reduktimit (Schwundstufe) dhe e zhdukjes (Nullstufe), duke i përkthyer për herë të parë këto terma në shqipe dhe duke i ilustruar me shembuj nga latinishtja dhe shqipja. Çabej, në pajtim me nivelin e kohës të zhvillimit të disiplinës, nuk ka mundur të shpjegojë lidhjen e ngushtë të apofonisë me laringalet, sidomos për shkallën e zgjatimit të zanoreve (Dehnstufe), edhe pse Saussure-i qysh në 1879 kishte hamendësuar ekzistencën e koeficientëve semantikë, të cilët duhet të ishin shkaku i zgjatjes së zanoreve të rrënjëve IE (G. Lafe 2024, 235). Megjithatë ai është i vetëdijshëm se "Sikur të vërtetohej që laringalet kanë ekzistuar dikur, kjo do të revolucionte mbarë fonetikën historike të gjuhëve i.e" (Çabej 1986, 78) duke lënë një shteg të hapur studimi për studiuesit e mëvonshëm.

E. Çabej ka shpjeguar qartë se gjuha shqipe ka ruajtur gjurmë të theksit nistor të ilirishtes si tek emrat e trashëguar ashtu edhe në disa toponime të vjetra. Lidhur me këtë dukuri ai do të shprehej: "...theksimi inicial ilir dhe rregullimi mekanik i theksit në gjuhën shqipe me parimin e shpërnguljes për në rrokjen e parafundit, i konstatuar prej N. Jokl-it, historikisht nuk anulojnë, por plotësojnë njëri-tjetrin" (Çabej 1972/4, 16). Ai e ilustron dhe me shembullin il. *Ísamnus* > shq. *Íshëm*. Çabej studioi evolucionin e sistemit zanor e bashkëtingëllor të shqipes. Ai hodhi dritë në disa çështje të rëndësishme të fonetikës historike, si mbi gjatësinë e zanoreve, hundorësinë dhe rotacizmin, zanoren *ë* të patheksuar e të theksuar, diftongjet, apofoninë, metafoninë etj.

Në lidhje me gjatësitë e zanoreve në disa fjalë të sotme të trashëguara nga IE, si *bē, dēt, mī, thī* ai vërejti se ato janë gjatësi të trashëguara ose gjatësi kompensatore (për shkak të rënies së tingujve brenda fjalës) në fjalë të ardhura nga latinishtja, si: *cubitus* > *cūt, medicus* > *mjēk, caballus* > *kālë* etj. Çabej studioi në fonetikën historike të shqipes edhe çështjen e reflektimit të diftongjeve IE në gjuhën shqipe, veçanërisht në punimin "Diftongje dhe togje zanoresh të shqipes" (Çabej 1958, 71–88). Ai arriti në përfundimin se diftongjet IE të shqipes janë reduktuar herët në zanore të thjeshta dhe shqipja më vonë krijoi togje zanoresh. Në fushën e vokalizmit, ai vërejti rënien e zanoreve të patheksuara në fillim të fjalës dhe rënien e zanoreve të shkurtra të patheksuara në fund të fjalës, po kështu edhe reduktimin dhe shpesh edhe rënien e zanoreve të patheksuara në trup të fjalës. Për dukurinë e metafonisë *a : e : i* E. Çabej vlerësoi mendimin e disa gjuhëtarëve pararendës duke u pajtuar me ta që shkakun e saj e gjetën te ndikimi asimilues prapavaj-

tës i mbaresës së hershme IE **i*, e cila la gjurmë edhe në qiellëzorëzimin e bashkëtingëllores para saj në shembuj si *dash-*i ~ desh*, *plak-*i ~ pleq*.

Ai erdhi te studimet fonetike kryesisht përmes etimologjisë. Përfundimet e paraardhësve, plotësimet dhe saktësimet e mëtejshme të tij i sistemoi, duke dhënë me saktësi tiparet fonetike konstitutive të shqipes:

- Theksi i fjalës është ngulitur në njërën rrokje, sidomos në rrokjen e parafundit ku nuk ndodhen treguesit gramatikorë.
- Zanoret e shkurtra të patheksuara fundore të periudhës IE kanë rënë që të gjitha, kurse zanoret e gjata kanë rënë pjesërisht, duke u rrëgjuar disa prej tyre në zanoren *ë*.
- Zanoret e patheksuara nistore të periudhës IE dhe të asaj latine kanë rënë.
- Diftongjet e shkurtra e të gjata të periudhes IE janë kthyer në zanore të thjeshta, shqipja gjatë evulucionit të saj të brendshëm krijoi diftongje të reja, që janë të shkurtra.
- Grupet bashkëtingëllore përgjithësisht janë asimiluar duke u kthyer në fonema të thjeshta.

Ndihmesa në Gramatikën Historike të Shqipes

Ndihmesa e çmuar e E. Çabejt në fushën e historisë së gjuhës bëri që t'i kushtonte vëmendje edhe disa problemeve të gramatikës historike të shqipes. Gjuha shqipe bart tipare gramatikore qysh nga periudha indoeuropiane, por nga ana tjetër ky sistem gramatikor ka pësuar një evolucion të dukshëm, i cili pa dyshim ndryshimet më të mëdha i ka pasur në shekujt e errët paraletrarë. Në këtë fushë nuk mund ta mënjanonte problemin aq të diskutueshëm edhe sot të nyjave të prapme dhe të përparme të shqipes. Deri në atë kohë sundonte mendimi i H. Pedersen-it sipas të cilit nyja shquese e gjuhës shqipe ka qenë vendosur para emrit ashtu si në gjuhë të tjera IE që e kanë zhvilluar këtë mjet gramatikor, si në gjuhët gjermanike, greqishte e në gjuhët romane. "Në ato rrethana, të mbroje një tezë të ndryshme për sistemin nyjor të shqipes, ishte një ndërmarrje shumë e guximshme që kërkonte njohje të thelluar të strukturës gramatikore të kësaj gjuhe në evolucionin e saj historik si dhe një mprehtësi gjykimi dhe argumentimi, dy cilësi këto që e kanë karakterizuar dijetarin tonë të shquar gjatë tërë veprimtarisë së tij shkencore" (Demiraj 1990, 96). Këtë problem ai e shqyrtoi në artikullin "Rreth disa çështjeve të historisë së gjuhës shqipe" (BShSh 1963). Pasi vë në dukje mendimin e pranuar nga shumë gjuhëtarë se si nyja e prapme dhe ajo e përparme janë risi në gjuhën shqipe, ai ndalet në kohën e lindjes së secilës, duke përcaktuar se cila prej tyre është më e hershme. Pas një trajtimi të gjerë, arriti në përfundimin e ri – përkundër mendimit më të përgjithshëm – se postpozicioni i artikullit në shqipen është më i vjetër se pozicioni proklitik dhe se ky i fundit ka rrjedhur prej atij në ngërthim të fjalisë, me anë të një përsëritjeje. Në po këtë punim, E. Çabej arsyeton se si rezultat i humbjes prej kohësh të mbaresave të hershme, mundi të shfaqej artikulli, si të thuash si një

zëvendësim i fundoreve të zhdukura të rasave (Likaj- A. Avrami 2024, 71) duke treguar tërthor edhe konceptimin e ri të rishfaqjes ciklike të gjendjeve gjuhësore.

E. Çabej trajtoi gjerësisht një tjetër problem të morfologjisë së shqipes me karakter historik në veprën *Shumësi i singularizuar në gjuhën shqipe* (1967). Ky studim monografik ishte botuar më parë në gjuhën gjermane në *Lingua Posnaniensis* (VII 1959) dhe (VIII 1960).

Me shumësat e singularizuar në gjuhën shqipe ishin marrë edhe gjuhëtarë si: N. Jokl-i, A. Xhuvani, G. Weigand-i, P. Skok-u etj., por merita e Çabejt qëndron në rrethanën që ai kësaj dukurie i dha një vend të veçantë dhe më të madh në gjuhën shqipe, jo vetëm se e pasuroi rrethin e shumësve të singularizuar, por edhe i shpjegoi formalisht e kuptimisht.

Sipas tij shkaku i kësaj dukurie qëndron në faktin se "...shumësi përveç detyrave të zakonshme për të shprehur një shumësi objektesh e konceptesh, ka dhe funkcionin e një intensivi, duke shprehur pra ndjenja të ngritura e të dëndësuara brenda jetës afektive. Në disa raste të veçanta ai është mbeturina gjuhësore e fundit e botëkuptimit magjik të njeriut primitiv..." (Çabej 1967, 19). E këtu sjell shembujt: *ligësitë, marrëzitë, turpet, dridhmët* etj. Këta shumësa më vonë u singularizuan, psh. nga forma bazë **halm* u kalua në *helme* e kjo më vonë në njëjësin *helm*. Çabej e vëzhgoi këtë dukuri në të gjithë shqipen, në dialekte e të folme të veçanta, duke i grupuar edhe sipa fushave leksikore. Ai konstatoi se kjo dukuri gramatikore është shumë më e shpeshtë në shqipen sa ishte menduar gjer në atë kohë. Ky proces është i pranishëm edhe në shumë gjuhë IE. Ai vazhdon "...mbulimi i njëjësit të mëparmë nga ana e shumësit ka qenë aq i plotë, sa që njëjësi jo pak herë është zhdukur pa lënë gjurmë dhe duhet aftësia gjurmuese e gjuhëtarit për ta diktuar." (Çabej 1967, 18) Sqarimi i drejtë i rasteve të shumësave të singularizuar në gjuhën shqipe, i dhanë mundësinë këtij dijetari për të dhënë mendime të sakta e për të rivlerësuar disa prej etimologjive të fjalëve të shqipes.

Çabej është marrë edhe me problemin e gjinisë në gjuhën shqipe. Ai trajtoi lëvizjen e gjinisë së disa emrave në rrymë të shekujve si dhe të gjininë asnjanëse. Kështu emra si: *qytet, shëndet, short* etj. në një fazë të hershme të shqipes, p.sh. te autorët e vjetër, dëshmohen si emra të gjinisë femërore, kurse sot janë integruar në gjininë mashkullore.

Duke shqyrtuar gjininë asnjanëse në gjuhën shqipe (Çabej 1977, 58), ai mbështeti, H. Pedersen-in (Pedersen 1897, 238–291) i cili pati meritën që përcaktoi përfundimisht ekzistencën e asnjanësit si gjini e tretë në gjuhën shqipe. Me studimin e gjuhës së Gj. Buzukut, Çabej vërtetoi mendimin e H. Pedersen-it se asnjanësit e vjetër të shqipes nuk kufizohen vetëm në emrat që shënojnë lëndë, të përdorur si kolektivë, por shtrihen edhe në emra të tjerë, mjaft prej të cilëve me burim latin. Në këtë mënyrë, përfundimet në të cilat arriti E. Çabej, dhe më pas Sh. Demiraj, përforconin dhe zhvillonin më tej, duke e pasuruar me dëshmi konkrete të gjuhës, idenë e Pedersen-it që gjinia asnjanëse në shqipe është e lashtë, ka karakter indoeuropian, dhe në kohën e huazimeve latine ishte ende mjaft e gjallë në shqipe, meqenëse shumë asnjanës latinë kanë hyrë si të tillë në këtë gjuhë.

Ai vërtetoi edhe një herë karakterin IE të saj e duke e krahasuar me shembuj nga gjuhët e tjera indoeuropiane: "...është tendencë përgjithësisht në gjuhët indoeuropiane që neutri sa vjen e zhduket. Edhe në shqipen, siç dihet, te autorët e vjetër, sot 300–400 vjet më parë ka pasur shumë më tepër asnjanës në përdorim gjuhësor se sa ka sot. Nëpër dialekte të shqipes asnjanësi është më i gjallë, kurse në gjuhën e rëndomtë e të shkrimit, po tërhiqet nga përdorimi, gati po zhduket" (Çabej 1986, 94). Ai arrin në përfundimin se sa më shumë evoluon një gjuhë, aq më shumë i humb format gramatikore, se pasuria e formave gramatikore nuk është shenjë kulture, por primitiviteti.

Në vështrim shkencor e krahasues me gjuhë të tjera ai mori në shqyrtim edhe mbiemrin, përemrin, numërorët në gjuhën shqipe, fjalët e pandryshueshme, kompozitat.

E. Çabej dha disa konsiderata të shkurtra edhe për Sintaksën. Krahasuar me gjuhët e tjera IE ai jep disa karakteristika në fushën e sintaksës, të cilat herë shkojnë me gjuhë të tjera të kësaj familjeje e herë kanë ndjekur rrugën e tyre. Karakteristikë e këtyre gjuhëve e po kështu edhe e shqipes është fjalia emërore (ose eliptike). Ky është një tip i lashtë që "në shqipe e gjejmë në shprehje stereotipe si: *Trimi i mirë me shokë shumë*" (Çabej 1986, 126). Krahas fjalisë emërore ai vëren edhe atë foljore, ku mungon subjekti, kryesisht një përemër. Sipas tij, në gjuhët IE mjafton fleksioni për të kuptuar përse bëhej fjalë, si në latishte: *Quod scripsi, scripsi* (atë që shkrova, shkrova)

Topikën, rendin a vendin e fjalëve në fjali, E. Çabej e lidh me fleksionin, pra, sa më e pasur është një gjuhë në sistem eptimi (fleksion) aq më e lirë është topika. Sa më shumë varfërohet eptimi, topika bëhet më e shtrëngueshme, më e ngulitur. Është me vlerë dhe për ditët e sotme konkluzioni që nxjerr Çabej: "Disa gjuhë më të mëdha, që përfaqësojnë edhe një kulturë më të lartë, ndikojnë në gjuhët e vogla dhe në punët e topikës së fjalive, pra në sintaksë të fjalisë" (Çabej 1986, 127)

Çabej dhe Etimologjia

Etimologjia e shqipes nisi jetën e saj, duke u përfaqësuar nga shkencëtarët e mëdhenj të kësaj fushe, si: Franz Bopp, Gustav Meyer, Karl Brugmann, Holger Pedersen e duke vijuar me gjuhëtarë të specialiteteve të veçanta, si: Franz Miklosich, Norbert Jokl, Karl Treimer, Leo Spitzer, Carlo Tagliavini, Wilhelm Meyer-Lübke e shumë të tjerë, përmendja e të cilëve do të shkonte tepër gjatë. Por studimet e këtyre dijetarëve, të botuara në kohë të ndryshme dhe në gjuhë të huaja, mbetën të shpërndara në libra e revista, në biblioteka e institucione shkencore të vendeve të Europës. Ai që i mblodhi të gjitha këto për t'i sjellë në vendin e tij dhe për t'i çuar më tej studimet e kësaj fushe, është E. Çabej. Në këtë mënyrë ai vlerësoi dhe trashëgiminë e studiuesve shqiptarë edhe pse nuk mund të flitej deri atëherë për studime të mirëfillta etimologjike mbështetur në parime të rrepta shkencore, si: P. Mazreku, N. Keta, E. Mashi, V. Dorsa, J. de Rada, Th. Mitko, dhe sidomos Dh. Kamarda e K. Kristoforidhi, Zgjidhjet që kishin dhënë shpesh ishin arbitrare, intuitive, megjithatë ai i vlerësoi me objektivitet dhe shumë prej tyre i pranoi. Ai mblodhi të gjitha kontributet e kësaj fushe për të krijuar një korpus me themele të

shëndosha, të mbështetur në rezultatet më të përparuara të gjuhësisë krahasimtare. Parimet e metodës së studimeve etimologjike të Çabejt dalin nga studimi i veprës së tij monumentale 7-vëllimshe *Studime Etimologjike në Fushë të Shqipes,* "opus vitae" e tij. Puna për studimin etimologjik të leksikut të shqipes filloi në trajtë artikujsh prej tij, të cilët u botuan fillimisht në "Buletinin e Universitetit Shtetëror të Tiranës" prej vitit 1960 deri më 1963 dhe në revistën "Studime Etimologjike" prej 1964 deri më 1968. Në vitet që pasuan E. Çabej i plotësoi më tej ato derisa në fundin e viteve '70 filloi puna për botimin e veprës *Studime Etimologjike në fushë të shqipes*.

Shkolla e Gramatikanëve të Rinj e Brugmann-it me të tjerë, "Wörter und Sachen" e Schuchardt-it dhe Meringer-it, gjeografia linguistike e Gilliéron-it, linguistika areale e Bartoli-t dhe e Pisani-t, shkolla sociolinguistike zvicerane e De Saussure-it e shumë drejtime e rryma të tjera të gjuhësisë bashkëkohore kanë gjetur mishërimin e tyre në punën ngulmuese në fushë të etimologjisë së shqipes, me të cilën u mor Çabej gjithë jetën. Ai shfrytëzoi elementet më pozitive të të gjitha drejtimeve gjuhësore, më të vjetra e më të reja, duke qenë në të njëjtën kohë edhe tradicional edhe modern dhe duke ia përshtatur gjithçka specifikës së shqipes. "Sudimet etimologjike paraqesin një varg vështirësish të mëdha edhe kur është fjala për gjuhë me një dokumentim të hershëm, siç janë greqishtja, indishtja e vjetër, latinishtja, gjuhët gjermanike, gjuhët sllave, të cilat kanë tërhequr prej kohësh vëmendjen e shumë gjuhëtarëve të shquar. E këto vështirësi kanë qenë pa krahasim më të mëdha në rastin e një gjuhe me një dokumentim shkrimor të vonë dhe me një evolucion të madh historik të sistemit të saj gjuhësor, siç është shqipja." (Demiraj 1990, 74–75)

Përveç shqyrtimit të punës së të tjerëve, E. Çabej ndërtoi të gjitha format e fjalës brenda shqipes e nga ana tjetër, në rastet kur etimologjia e një fjale, e dhënë prej të tjerëve, paraqitet e drejtë, ai përsëri e përforcoi atë me të dhëna të reja. Kjo vepër, nuk është një fjalor etimologjik klasik, por një studim i thelluar gjuhësor, kulturor i fjalës shqipe. Ka zëra në këtë vepër që nga përmasat e trajtimit, argumentet e shumta, shembujt nga të gjitha arealet e shqipes, krahasimet me indoeuropianishten e gjuhët e tjera mund të përbënin një artikull shkencor.

Objektiviteti shkencor e përshkon gjithë këtë vepër. E. Çabej nuk mori në shqyrtim vetëm fjalë të cilat mund t'i analizonte, krahasonte e në fund të jepte një përfundim bindës. Ai nuk iu shmang edhe atyre që mbeten ende të pazgjidhura, duke lënë një derë të hapur për ata që do të vijonin të merreshin me etimologji. Nga ana tjetër nuk i vuri vetes detyrë të shtonte me çdo kusht përqindjen e elementit të trashëguar të leksikut prandaj edhe për disa fjalë të shpjeguara si vendase ai mbajti qëndrim duke treguar shkencërisht se kishin hyrë prej një gjuhe të huaj, si: *i aftë, begati, binjak, borigë, i dobët, hir, kaçile, nofull, perëndi* etj. Po kështu i ktheu fondit autokton të shqipes fjalë që ishin interpretuar nga të tjerë si huazime: *arnoj, bërsi, bërryl, bishtajë, bjeshkë, bluaj, bollë, borë, cingël, cucë, dallëndyshe, dërrasë, dhelpër* etj. E. Çabej studioi vetëm fjalët e parme, sepse po të merrte në shqyrtim ato të prejardhura prej tyre, sasia e fjalëve vendase rritej edhe më tepër.

Punimi më serioz deri në atë këtë kohë në këtë fushë kishte qenë pa dyshim *Fjalori etimologjik* i G. Meyer-it, i botuar në vitin 1891 në Strasburg. Duke qenë vepra e parë

e këtij lloji për gjuhën shqipe dhe duke mbetur e vetmja gati për një shekull, ky fjalor ka luajtur një rol të madh në gjuhësinë historike shqiptare gjatë shekullit XX. Vërejtja themelore që i është bërë *Fjalorit etimologjik* të G. Meyer-it ka të bëjë me përfundimet që nxjerr ai, përmes statistikave që ka dhënë, lidhur me raportin midis fjalëve me burim të trashëguar dhe fjalëve të huazuara nga gjuhë të tjera në gjuhën shqipe. Kritika ka pohuar në mënyrë të përsëritur dhe studimet etimologjike të E. Çabejt e kanë vërtetuar se G. Meyer-i në shqyrtimet e tij etimologjike ka mbivlerësuar elementin e huaj në dëm të elementit vendës, në mënyrë të veçantë autori ka rritur numrin e elementeve me burim latino-roman duke u përpjekur të mbështesë tezën e formuluar edhe para tij nga F. Bopp-i e Hugo Schuchardt-i, që e patën cilësuar shqipen si gjuhë gjysmëromane. (Mansaku 2018, 285). Sipas statistikave që jep vetë G. Meyer-i në hyrje të Fjalorit, nga 5140 fjalë bazë që shqyrton ai nga ana etimologjike, rreth 4000 prej tyre i nxjerr me prejardhje nga gjuhë të tjera, nga të cilat 1420 me burim latino-roman. Fjalë të trashëgimisë indoeuropiane ka cilësuar vetëm 400, ndërsa 730 fjalë i ka lënë pa shpjegim etimologjik. E. Çabej në studimet e tij etimologjike ua nëshshtroi një analize të gjerë këto përfundime të G. Meyer-it duke i kthyer fondit autokton të shqipes shumë nga këto fjalë. E. Çabej, pas një pune të gjatë në fushën e studimeve etimologjike të shqipes, arriti në përfundimin: "...sasia e elementit të huazuar dhe sasia e elementit vendës tregojnë më një anë shkallën e ndikimit të huaj mbi shqipen, më anë tjetër, shkallën e qëndresës së kësaj gjuhe." (Çabej 982, 114) Sipas tij, elementi i trashëguar mbizotëron në atë pjesë të leksikut që ka lidhje me një jetë më afër natyrës e me një ekonomi e një kulturë më fort baritore e agrare, elementi i huazuar, në pajtim me vetë karakterin e huazimit, mbizotëron në atë pjesë të leksikut që i përket një veprimtarie njerëzore më të shumanshme në fushën e kulturës materiale e morale.

E gjithë vepra *Studime Etimologjike në Fushë të Shqipes* na krijon një ide të raportit të fjalës vendase me fjalët e huaja, e cila nga vëllimi në vëllim pa dyshim është e ndryshme, por përveç këtij përpjestimi, kjo pasqyrë është shprehje e historisë së popullit tonë, e kontakteve me kultura e popuj të tjerë, ku dallohet ndikimi më i madh nga gjuhët e pushtuesve historikë, si latinishtja, sllavishtja, turqishtja. Kjo i jep kësaj vepre jo vetëm karakterin e një fjalori thjesht etimologjik, por dhe atij historik e tregon qartë se nuk kemi qenë një popull i izoluar, por jemi përballur me kontakte intesive e të gjata. (Kore 2024, 223). Këtë e bën më të qartë dallimi prej autorit edhe të fazave nëpër të cilat ka kaluar fjala. Ai bën një shtresëzim kohor të leksikut, kështu e njëjta fjalë ka hyrë fillimisht nga latinishtja e më vonë përsëri nga italishtja duke i dhënë etimologji të dyfishtë fjalës, psh. lat. *desperare* dhe it. *disperare*.

Qëndrimi objektiv ndaj kërkimeve të kryera në këtë fushë, vëzhgimet e përimtuara të materialit gjuhësor, interpretimet e reja të mbështetura në argumentime shkencore e në një material të mjaftueshëm faktik e dokumentar, studimi i gjithanshëm i fjalëve duke përfshirë aspektin semantik e lidhjet frazeologjike, pajtimin e saj me rregullat e fonetikës historike, strukturën morfologjike e sintaksore, të dhënat dialektore, gjeografike e historike, janë disa nga parimet themelore që karakterizojnë metodën e tij të punës në këtë fushë studimesh, rezultatet e të cilave nuk mund të ishin ndryshe veçse tejet objektive e të pranueshme (Topalli 2008, 79). Ai e gjurmoi fjalën shqipe në të

gjitha trojet ku flitej ajo, në trevat e Veriut e të Jugut, në të folmet e Kosovës e te shqiptarët e Maqedonisë së Veriut, në diasporë përtej Adriatikut e deri thellë në tokën helene. Çabej nuk kishte qëllim që në këtë punim madhor të studionte shqipen si qëllim në vetvete e për vetveten, por synimi ishte më i gjerë se kaq: të përcaktohej nga ana e leksikut karakteri specifik i shqipes dhe vendi i saj në rrethin e gjuhëve të tjera indoeuropiane. Në të gjitha këto hulumtime, ku etimologjia zë vendin e parë, ai arriti në përfundime të sakta për origjinën e gjuhës shqipe dhe të popullit që e flet, si edhe për autoktoninë e tij në trojet ku banon.

Në pikëpamje të metodës, në kundërshtim me shumicën e etimologëve që fjalët e shqipes i krahasonin së jashtmi me ato të gjuhëve të tjera, E. Çabej u nis së pari nga studimi i brendshëm për të përfunduar tek i jashtmi. Kësisoj, ai studioi të gjitha lidhjet e brendshme të fjalës, shkallën e përhapjes e të prodhimtarisë së saj, marrëdhëniet me leksikun e përgjithshëm dhe dialektor, format e saj dhe ndryshimet në kohë, dokumentimin, raportet e krijuara me fusha të veçanta, sidomos me toponiminë e antroponiminë. Të gjitha këto i jepnin mundësi të shikonte nga brenda gjuhës pozicionin e çdo fjale në sistemin e përgjithshëm të saj duke lejuar të bëhen krahasime të qëlluara me fjalët e gjuhëve të tjera. Objektiviteti shkencor e përshkon gjithë këtë vepër. E. Çabej nuk mori në shqyrtim vetëm fjalë të cilat mund t'i analizonte, krahasonte e në fund të jepte një përfundim bindës. Ai nuk iu shmang edhe atyre që mbeten ende të pazgjidhura, duke lënë një derë të hapur për ata që do të vijonin të merreshin me etimologji.

Ndihmesa në Ballkanologji

Më 1829, gjuhëtari slloven J. Kopitar, në studimin e tij me titull "Albanische, walachische und bulgarische Sprache", vuri në dukje për herë të parë se ekzistojnë disa afri gjuhësore ndërmjet shqipes, rumanishtes dhe bullgarishtes. Dhe nga ajo kohë nuk kanë reshtur përpjekjet për sqarimin e kësaj problematike që gradualisht u bë objekt i një shkence të veçantë që tani njihet gjerësisht me emrin "Gjuhësi ballkanike". Shqipja bashkë me greqishten flitet prej një periudhe shumë të gjatë në Ballkan dhe si e tillë ajo në mënyra të ndryshme ka qenë pjesë e zhvillimeve në tërë këtë kohë, duke u bërë njëherësh dendurisht e pranishme në atë që quhet *Sprachbund Ballkanik*.[2] Në këtë lidhje gjuhësore shumë dukuri midis këtyre gjuhëve u afruan edhe më shumë se ç'i afronte përkatësia indoeuropiane.

Studimet ballkanistike në gjuhësinë tonë janë zhvilluar në kuadër të studimeve historike për shqipen dhe paralelisht me to, ku shpesh më të rëndësishme kanë qenë aspektet e rindërtimit të brendshëm dhe krahasues-historik, por qysh herët janë hetuar dhe aspekte areale dhe të mirëfillta ballkanike. Çështje themelore si: prejardhja e kësaj gjuhe ballkanike, vendi ku është folur qysh në krye të herës, pozicioni i saj në raport me gjuhët IE dhe marrëdhëniet e saj me gjuhët ballkanike do të përbënin ndër drejtimet

2 International Congress of Linguists in 1928 si parim gjuhësor për lidhje tipologjike të disa gjuhëve të caktuara. Lidhja gjuhësore ballkanike, u quajt kështu nga gjuhëtari rumun Alexandru Rosetti në 1958 dhe është shembull i konceptit të *Sprachbund-it*, i cili përdoret gjerësisht sot.

kryesore të orientimit të metodës kërkimore çabejane të trajtuara në një varg artikujsh. (Çabej 1979/4 80–81; 1975/1; 1976/1 123–135; 2, 1976/1 63–76; 1977, IV, 335–346). Ky dijetar i kishte të qarta parimet dhe metodën që duheshin ndjekur për të studiuar këtë fushë të dijes linguistike. Çështja sipas tij "do shikuar në një pamje më të gjerë, në dritën e marrëdhënieve të shoqishoqme të gjuhëve, të dukurisë së gjuhëve në kontakt", i larguar nga "ideja e qelizës gjuhësore", por të "ndërvartësisë së gjuhëve" (Çabej 1982, VI, 511). Gjuhët ballkanike nuk kanë qenë të izoluara nga njëra-tjetra. Më 1960, kësaj problematike E. Çabej, i ka kushtuar një krye të veçantë në librin e tij me titull Hyrje në historinë e Shqipes. Fonetika historike. Problemet e trajtuara në këtë libër, ndër të tjera, janë: Njësia gjuhësore ballkanike dhe bazat historike e gjeografike të saj; Afria kulturore e gjuhëve ballkanike; Analogjitë në morfologji, në sintaksë e në leksik; Lidhje ballkanike e lidhje të veçanta në mes dy a tri gjuhëve; Shpjegimi historik i ballkanizmave; Analogjitë në frazeologji; Folklori ballkanik (Çabej 1976, III 78). Po në këtë libër një krye të veçantë zënë edhe problemet e elementeve të shqipes në gjuhët e tjera të Ballkanit, si: Elementet shqipe në greqishten e re, në dialektet e saj veriore e në argotë; Elementet shqipe ne gjuhët sllave jugore, në dialektet e në argotë e tyre. Disa elemente të shqipes në turqishten . Kjo përbën përpjekjen e parë serioze për vështrimin e raporteve të shqipes me gjuhët ballkanike nga një studiues shqiptar.

Sipas Çabejt "afria e gjuhëve të Ballkanit nuk është një afri gjenetike ose farefisnore, formuar që në krye të herës, po një "bashkim gjuhësh", një lidhje që është quajtur "afri kulturale". Kjo lloj afrie nuk lindi menjëherë, por duke mbështetur edhe mendimin e H. Pedersen-it, ajo është diçka që u formua. Me fjalë të tjera, tiparet që bashkojnë sot këto gjuhë "u zhvilluan shkallë-shkallë në rrymë të kohës" (Çabej 1976, III 80). Sipas këtij studiuesi, në Ballkan rrojnë krah për krah e vise-vise edhe së bashku, gjuhë me gurrë të ndryshme. Së pari, dy gjuhë indoeuropiane më vete, greqishtja e shqipja; pastaj dy gjuhë sllave, bullgarishtja e serbokroatishtja (me sllovenishten); një gjuhë romane, rumanishtja me degëzimet e saj, më në fund një gjuhë joindoeuropiane, turqishtja. Çabej shtonte se secila gjuhë e Ballkanit, përveç lidhjeve të rendit të përgjithshëm ballkanik, ka edhe afrime të veçanta me ndonjë a dy gjuhë fqinje. Sipas tij, gjuhësia ballkanike merr në shqyrtim edhe analogjitë e përgjithshme dhe bashkëpërkimet pjesore.

Si historian i gjuhës shqipe, ai analizoi studimet e mëparshme në lidhje me shkakun e formimit të kësaj lidhjeje gjuhësore. Përsa i takon shqipes, e cila është vazhduesja e drejtpërdrejtë e një gjuhe të vjetër të Ballkanit, nuk mund të bëhet fjalë për ndikim të substratit, pasi hipoteza e substratit, siç e vuri ai në pah, parakupton mbishtresimin e një gjuhe mbi një gjuhë tjetër që zhduket. E. Çabej ka shkruar: "Si kudo në proceset gjuhësore, edhe në afrinë e gjuhëve ballkanike kanë ndihmuar disa rrethana të caktuara të rendit historik e gjeografik." (Çabej 1976, III 79)

Në pikëpamje *historike*, sipas tij, përhapja e Ilirëve nga *perëndimi* gjer në *lindje* të Gadishullit dhe përhapja e Trakasve nga *Lindja* gjer në *Perëndim* pat sjellë qysh në kohët e lashta të antikitetit një *rrafshim* të ndryshimeve nacionale. Këtë proces njësimi e plotësoi më vonë *shtrirja e kulturës* dhe *e gjuhës greke* nëpër gjithë bregdetet e në pjesën jugore të kësaj treve. Po ashtu *sundimi romak,* me përhapjen e latinishtes si gjuhë zyr-

tare të perandorisë, solli një nivelim të përgjithshëm dhe në këto anë, e zhduku shumicën e diferencimeve etnike. Në kohë të mesme ka ndihmuar në formim të njësisë ballkanike sundimi i gjatë i Bizantit me kulturën e tij gjysmë orientale e me *gjuhën e kishën greke*, që u përhap në më të madhen pjesë të Gadishullit. Edhe vendosja e Sllavëve e më vonë dyndja e Osmanëve shtuan, me përhapjen e tyre, disa karaktere të përbashkëta të popujve ballkanikë e të gjuhëve të tyre.

Edhe *rrethanat gjeografike* kanë pasur rëndësi vendimtare në formimin e njësisë ballkanike, të cilat gjer në një farë mase kanë përcaktuar dhe ngjarjet e historisë. Në këtë zonë janë rrasur qëmoti një tok gjuhësh në një territor relativisht të ngushtë. Kjo rrethanë bëri që marrëdhëniet në mes këtyre u zhvilluan në një mënyrë intensive. Vepra *Studime etimologjike në fushë të shqipes* e E. Çabejt për shkak edhe të krahasimeve të shumta që ka midis fjalëve të shqipes dhe fjalëve gjegjëse në gjuhë të tjera indoeuropiane e sidomos në gjuhët ballkanike, me gjuhët romane, me gjuhët sllave, me greqishten etj. merr një rëndësi të veçantë edhe për balkanologjinë, romanistikën, sllavistikën dhe helenistikën. Në këtë vepër për shumë zëra janë treguar jo vetëm lëvizjet e fjalëve brenda gjuhës shqipe, por edhe shtegtimi i fjalës shqipe në gjuhët fqinje.

Duke vlerësuar më pak bashkëpërkimet ballkanike në fushën e fonetikës ai thekson se me rëndësi janë disa dukuri në lëmë të gramatikës: 1. artikulli postpozitiv (nyja e prapme) në shqipe, rumanishte e bullgarishte; 2. zhdukja e infinitivit (paskajores) në shumicën e gjuhëve ballkanike dhe zëvendësimi i tij me lidhoren në greqishten e re, në bullgarishte, rumanishte e në dialektin toskë të shqipes; 3. futuri me foljen ndihmëse *dua* në vend të *kam* në greqishten e re, bullgarishten, serbokroatishten, rumanishten e shqipen; 4. parapëlqimi i ndërtimit të fjalive me parataksë (bashkërenditje) nga ai i hipotaksës (nënrenditje). Edhe në sintaksën e tyre gjuhët ballkanike kanë shumë pika takimi midis tyre.

Ai, gjithashtu, vërejti se afria e gjuhëve ballkanike shfaqet dhe në leksikun e tyre. Një tok fjalësh janë të përbashkëta në këto gjuhë, fjalë me burime të ndryshme, të cilat janë përhapur gati njësoj në to. Janë këto fjalë greke, latine, italiane, rumune, shqipe, sllave, turke etj., të cilat me përdorimin e tyre në shumicën e gjuhëve ballkanike kanë ndihmuar në formimin e njësisë gjuhësore të Ballkanit (Çabej 1970, 3–16). Sipas E. Çabejt një fushë e afrimit të gjuhëve ballkanike që paraqet një interes të veçantë, është edhe frazeologjia. Më të shumta janë këto midis shqipes, greqishtes së re e rumanishtes (me arumanishten), merr pjesë shpeshherë dhe bullgarishtja, po serbokroatishtja më rrallë. Nga punimet e para të tij për këtë çështje edhe pse shumë i ri, ndër gjuhëtarët e parë shqiptarë, E. Çabej ka kontribuar dukshëm në sqarimin dhe pasurimin me variantin shqip të disa njësive frazeologjike të përmendura nga P. Papahagi (1908) në recensionin e tij "Parallele Ausdrücke und Redensarten in den Balkansprachen" ("Shprehje paralele dhe mënyra të të folurit në gjuhët ballkanike", 1936).

Çabej u kushtoi vëmendje edhe konkordancave binare midis shqipes dhe gjuhëve të Ballkanit. Çështja nëse ka në gjuhën shqipe huazime nga greqishtja e vjetër apo jo (mohuar në shekullin e kaluar nga studiuesi i njohur i shqipes dhe i greqishtes, G. Meyer), mori një përgjigje pohuese që në fillim të këtij shekulli nga A. Thumb (*Altgr. Elem.* IF 26 pp.1. 26) dhe më pas edhe nga Çabej (Çabej 1972/4 21). Kjo çështje kishte

rëndësi edhe për sqarimin e autoktonisë së shqiptarëve, por në një plan më të gjerë edhe për ballkanologjinë. Ky studiues, më vonë u kushtoi vëmendje dhe huazimeve nga greqishtja bizantine dhe ajo e re. Çabej thekson se "Për kuptimin e marrëdhënieve të gjuhëve ballkanike në mes të tyre, është edhe kjo, që ndonjë e fjalë e greqishtes ka kaluar tek ato nëpërmjet shqipes, si: *στοιχείον* "element", që kaloi në serbokroatishten, *μανδραγόρα* "matërgonë" që shkoi në rumanishten e këtu edhe fjala *mesteacăn* nga shqipja *mështekën* e kjo vetë nga greqishtja e vjetër *μαστίχιον* "dru me rrëshirë)." (Çabej 1970/4, 7)

Nga sistemi verbal ai përmend pjesëzën *dot,* që përdoret në fjali mohore, kushtore e pyetëse, që nga shqipja ka kaluar edhe në greqishte *vτότι*.

Çabej ka shqyrtuar në veprën e tij dhe marrëdhëniet e shqipes me sllavishten ballkanike (Çabej 1976/1, 123–137; 1976/2, 63–77). Këto ndihmesa kanë të bëjnë jo vetëm me saktësimin e sllavizmave në gjuhën shqipe, por edhe evidentojnë fjalë të shqipes që kanë hyrë në sllavishte. Sllavizmat në gjuhën shqipe, sipas tij, janë periudhash të ndryshme. Më të hershme janë ato në të cilat ka ndodhur metateza e likuideve d. m.th pas gjysmës së shek. IX të erës sonë. Për fjalët *baltë, gardh, daltë* Çabej arriti në përfundimin që rrjedhin prej shqipes e jo prej sllavishtes (*blato, gradъ, dlato*). E do të vazhdonte edhe me fjalë të tjera që janë interpretuar si sllave, po i rezultojnë fjalë vendi, si: *acar, bungë, groshë, rrap, treg* etj. Kurse fjalë si: *gati, gatis, darovis, darovit, çudis, godit, gostis, habis* etj. kanë hyrë në shqipe prej sllavishtes. Duke u mbështetur në fakte historike, gjeografike dhe gjuhësore ai vërejti se huazimet sllave të shqipes kishin karakter dialektor. Trajtat si *opingë, mezhdë* të Shqipërisë jugore rrjedhin prej bullgarishtes, kurse trajtat *opangë, megje* e Shqipërisë së Veriut kanë depërtuar nga serbishtja. Në strukturën gramatikore ai pranon si të sllavishtes prapashtesat e parashtesat: *-ac, -aç, -ashkë, -ec, -icë, -nik, kolo-, po-* etj. Çabej vuri në dukje edhe rolin dhënës të shqipes. Fjalë nga shqipja kanë depërtuar në sllavishte: *bajgë, buzë, gushë, karpë, magar, vatër* etj.

Një vend të veçantë në veprën e Çabejt zënë punimet mbi lidhjet dhe afëritë midis shqipes dhe rumanishtes. Ky problem i rëndësishëm për historinë e të dyja gjuhëve, për gjenezën e pupujve të tyre ka vlerë edhe për gjuhësinë ballkanike, si dy gjuhë në qendër të *Sprachbund*-it. Dijetari ynë i ka trajtuar gjerësisht ato në artikuj të veçantë si dhe në studimet etimologjike. Ai ka bindjen se lidhjet që ekzistojnë ndërmjet këtyre dy gjuhëve mund të zëvendësojnë me një farë mënyre për të dyja ato periodën e tyre paraletrare. Që në krye thotë: "Duke iu afruar kësaj çështjeje nga pikëpamja e gjuhëtarit, vihet re aty një pajtim mjaft i madh që vërehet te paralelizmi i ngushtë në shqiptimin dhe zhvillimin historik të tingujve, po shfaqet edhe në strukturën morfologjike, si në fleksion, si në fjalëformim, në sintaksë të emrit, të foljes e të parafjalëve, në ndërtim të fjalive dhe në sintaksë ….pastaj edhe në frazeologji e në shprehjet proverbiale" (Çabej 1975/1, 49–67)

Bashkëpërkimet midis këtyre gjuhëve Çabej i vërejti si në huazimet latine dhe në elementin autokton të të dyja gjuhëve duke vënë theksin më tepër tek këto të dytat. Elementi latin si në rumanishten si në shqipen rrjedh prej latinishtes ballkanike. Duke dalë prej së njëjtës gurrë, këto elemente paraqesin një zhvillim paralel në të dy gjuhët. Nga fusha e fonetikës përmend: ndërrimi i *a*-së së pathekse në një zanore të mesme shq. *ë,*

rum *ă*, në fjalë si lat. *camisia*: shq. *këmishë* rum. *cămeasă;* ruajtja e *u*-së së hapët latine si *u*, p.sh. lat. *furca*: shq. *furkë* rum. *furcă*. Në konsonantizëm, grupi *ct* i latinishtes ka dhënë përfundime të afërta në të dy gjuhët, shq. herë *ft*, herë *jt*, herë *t*, kurse në rumanisht *pt*, ku rum. *pt* me labializmin e guturalit i përgjigjet shq. *ft*; khs. lat. *lucta*: shq. *luftë*, rum. *lupta*; lat. *directus*: shq. *drejt* (po te Buzuku *dëreq*, tosk. jugore e arbërishtja e Italisë *dreq*), rum. *drept*; lat. *fructus*; shq. *fryt*, te autorët e vjetër gegë *frujt*, rum. *frupt*; lat. *factura*: shq. *fytyrë fëtyrë*. Nuk është sqaruar arsyeja pse shqipja ka tri reflekse të këtij grupi latin. Grupi latin *x* (*ks*) ka dhënë në shqipen *fsh* e *sh*, në rumanishten, paralelisht me këto, *ps s*. Lat. *coxa* : shq. *kofshë* rum. *coăpsa*; lat. *fraxinus*: shq. *frashër frashën*, rum. *frasin*. Edhe këtu nuk dihet mirë shkaku i trajtimit të dyfishtë.

Në gramatikë Çabej kishte parë një paralelizëm të përsosur midis sistemit nyjor të shqipes e të rumanishtes (nyjes së prapme dhe atë të parme): shq. *vajz-a* rum *fat-a*, shq. *djal-i* rum. *cane-le*, shq. *ujk-u* rum. *lup-ul*; shq. *njeri i mirë* rum. *omul cel bun*. Duke folur për nyjën e prapme në shqipe dhe në rumanishte, E. Çabej, ka shkruar se në këtë pjesë të ligjëratës të dy gjuhët piqen deri në hollësitë më të imta si në mënyrën e përdorimit, në pozicionin sintaktik, gjë që flet në mënyrë të prerë kundër mendimit të një zhvillimi spontan në secilën nga këto gjuhë. Në bullgarishten, ka shkruar ai, ky artikull nuk duket të jetë fort i moçëm, sepse në dokumentet e bullgarishtes së vjetër ende nuk e ndeshim. Po kështu ngjashmëri këto dy gjuhë kanë në formimin e përemrave të pacaktuar dhe ndajfoljeve përkatëse me ndihmën e foljes së ngurosur *dua*: rum. *cineva, careva, ceva, undeva, cîndva, cîtva, cumva* të cilave në shqipe i përgjigjen: *kushdo, cilido, çdo, kudo, kurdo, sado, sido*. E po kështu ka përputhje në ndërtim e kuptim në fjalët: *oricine, oricare, orice, oriunde*. Një fushë ku piqen rumanishtja me shqipen është edhe formimi i fjalëve me anë sufiksesh. Kështu shq. – *onjë* në *ulkonjë* i përgjigjet rum. – *oaie* në *ursoaie* "harushë"; shq. *-ush* në *kalush* rum. *-us* në *lemnus* "druth"; shq. *-isht* në *shqiptarisht* rum. *-este* në *romaneste* etj. Kurse për bashkëpërkimet në lidhje me krijimin e ngjashëm të së ardhmes (futuri) me foljen *dua* dhe jo me *kam* apo zhdukjen e infinitivit, ai sugjeronte se shpjegimet duhen kërkuar në proceset komplekse të Sprachbundit.

Lidhjet e ngushta të këtyre dy gjuhëve Çabej, sikurse shumë gjuhëtarë rumunë[3] e më vonë ballkanologë të huaj, i konstatoi edhe në leksikun autokton. Ai vërejti si fjalë të përbashkëta: sh. *ajkë* – rum. *alcă*, shq. *avull* – rum. *abur*e, shq. *baltë* – rum. *baltă*, shq. *bardhë* – rum. *barză*, shq. *bredh* – rum. *brad*, shq. *brez* – rum. *brîu*, shq. *daltë* – rum. *daltă*, shq. *dhallë* – rum. *dzare*, shq. *fluturë* – rum. *fluture*, shq. *gardh* – rum. *gard*, shq. *gërresë* – rum. *gresie*, shq. *gropë* – rum. *groapă*, shq. *Gjon* – rum. *Ghionoaie*, shq. – rum. *hameş*, shq. *këlbazë* – rum. *gălbează*, shq. *kurth* – rum. *cursă*, shq. *moshë* –rum. *moş*, shq. *mugull* – rum. *mugur*, shq. *nepërkë* – rum. *năpîrcă*, shq. *përrua* – rum. *părîu*, shq. *qafë* – rum. *ceafă*, shq. *sorrë* – rum. *cioară*, shq. *shark*(ë) – rum. *sarică*, shq. *shkrumb* – rum. *scrum*, shq. *shtrep* – rum. *strepede*, shq. *shtrungë* –rum. *strungă*, shq. *tharbët* – rum. s*arbăd*, shq. *thërime* – rum.

3 Është një problem që ka tërhequr vëmendjen e pothuajse të gjithë historianëve të gjuhës rumune, duke filluar që nga gjysma e dytë e shekullit të kaluar me B. P. Hasdeu-n, *Istoria critica românilor I* 1873, dhe duke vazhduar në shekullin tonë me O. Densusianu-n, *Histoire de la langue roumaine*, 1901, ribotuar më 1929; I. A. Candrea-n, *Lingua albaneze in raportuarile ei cu limba romana*, 1931; A. Rosetti-n *Istoria limba Romina II*, 1964, Puşcariu-n, *Limba Româna I*, 1976; A. Philippide-n, *Originea românilor II*, 1983; T. Capidan-in *Dacoromania*; Papahagi-n, Ivanescu-n, Russu-n dhe tani së fundi me G. Brîncuş-in etj.

fărimă, shq. *udhos urlë* – rum. *urdă*, shq. *vjedull* – rum. *viezure*. Burimin e këtyre fjalëve të përbashkëta Çabej e shihte në tri mundësi 1. mund të jenë fjalë rumune; 2. mund të jenë fjalë të shqipes; 3. mund të vijnë nga një gurrë e tretë, e përbashkët. Përsa i përket mundësisë së parë, rumune, mendonte ai, nuk janë, sepse në atë gjuhë dalin të izoluara, nuk kanë shpjegim brenda sistemit. Prandaj ose i përkasin shqipes ose janë të burimit të përbashkët. Shumë dijetarë i shohin të substratit, ka të tjerë që e vënë në dyshim shpjegimin përmes substratit. Po të nisemi nga shpjegimi brenda shqipes, metodologjikisht duket më i drejtë mendimi i Çabejt se brenda shqipes shumë prej tyre nuk janë të izoluara, po gjejnë shpjegim brenda sistemit. p.sh. *hamës* etimologjikisht lidhet me foljen *ha* të shqipes; *këlbazë, gëlbazë* është me zgjerim -zë prej *kalb, *kalbëzë*; *avull* në raport me *valë, brez* me *brej*, *flutur* me *fluturoj* e *fletë, gërresë* me *gërryej, gropë* me *gërmoj, moshë* me *mot, shtrungë* me *shtroj, tharbët* me *ther, thërime, vjedhull* me *vjedh, Gjon* me emrin vetiak *Gjon*, prandaj fjalët përkatëse rumune dalin prej shqipes. Por kjo nuk mund të thuhet për të gjitha fjalët e përbashkëta. Shumë të tjera gjejnë shpjegim brenda sistemit indoeuropian, si *baltë, bardhë, gropë, kurth, sorrë, shark (ë), shkrumb*, etj. (Çabej 1976, III 77) Ky dijetar shumë herë theksoi se nëse për rumanishten mund të flitet për një substrat, për shqipen kemi të bëjmë me një trashëgimi e të gjitha këto sipas tij, tregojnë fqinjësinë e moçme të stërgjyshërve të shqiptarëve me ata të rumunëve, se "populli shqiptar e populli rumun dikur në historinë e tyre kanë qenë gjeografikisht më afër njëri me tjetrin, visevise mbase kanë qenë dhe në bashkëjetesë (simbiozë). (Çabej 1976, 74)

Ka rëndësi për gjuhësinë ballkanike mendimi i tij se në marrëdhëniet e shqipes me gjuhët fqinje, është e vërtetë që roli dhënës i saj është më i pakët se roli marrës, po megjithatë edhe ai është me rëndësi jo vetëm në vetvete, po edhe sepse ka lidhje me disa nga problemet me të cilat ka kohë që merret ballkanistika. Ky ndikim gjuhësor shkon dorë më dorë me një ndikesë në fushën etnografike, në mënyrë që disa dukuri të formave të jetës shqiptare, për arsye sociale dhe, nga sa duket, edhe për punë të karakterit të veçantë që zotërojnë, kanë depërtuar te popujt fqinjë. Në formimin e zhvillimin e mëtejmë të afërisë së veçantë të gjuhëve ballkanike, shqipja, me gjithë madhësinë numerikisht të vogël të popullit (rreth tre milion frymë), zë një vend *të rëndësishëm*. Për këtë ka disa arsye të ndryshme. Së pari, shqipja paraqet një nga gjuhët më të lashta e më herët të formuara të Gadishullit, e cila, si e tillë, që prej shekujsh, pjesërisht që prej mijëra vjetësh, ka pasur shkëmbime me gjuhët fqinje. Së dyti, trualli gjuhësor i shqipes, sikurse mund të vërtetohet, ka qenë më i madh nga ç'është sot, gjë që na përligj të pranojmë që këto lidhje gjuhësore dikur kanë qenë shtrirë edhe më tej. Së treti, vjen rrethana që shtegtimet dhe ngulimet të disa pjesëve të popullit shqiptar në viset fqinje kanë çuar te popujt përreth edhe të tjera elemente të gjuhës dhe të nomenklaturës topike të tyre. Këto janë disa nga rrethanat që kanë bërë që shqipja, me gjithë pozitën gjeografikisht periferike të saj, në një farë mënyre zë një vend *qendror* në trevën e gjuhëve ballkanike. (Çabej 1977/5, 335)

Çabej dhe Dialektologjia

Studimi i historisë së gjuhës shqipe dhe i etimologjisë së fjalëve, për shkak të mungesës së dokumentacionit të hershëm gjuhësor, e çoi punën shkencore të E. Çabejt në shfytëzimin e të dhënave të vetë gjuhës së gjallë të popullit, të dialekteve dhe të formave të veçanta të saj. Që në krye të herës Çabej u interesua në punën e tij të dallonte ndryshimet që vihen re midis dy dialekteve të shqipes. Ai mori në shqyrtim dallimet dialektore të sistemit fonetik e gramatikor të tyre (Çabej 1977, IV188–194) e duke u bazuar në kronologjinë e tyre u përpoq t'u jepte përgjigje çështjeve: tiparet që karakterizojnë këto dialekte a janë formuar afërsisht në të njëjëtn kohë apo një pas një?; a ka ndodhur ndonjë shpërngulje e strukturës gramatikore?; cili nga dialektet kryesore, për disa faza të mëparshme del më konservativ, e cili më inovues?; mund të diktohet kronologjia dhe vatrat eventuale të inovacioneve dialektore?. Duke shqyrtuar kronologjikisht tipare si nazalizmi, bigëzimin e *uo*-s në geg. *ue* e në tosk. *ua,* asimilimin e grupeve *kl, gl, ë*-në e patheksuar, ndërrimin e *a*-së në *ë* përpara një hundoreje, grupet *va*-e *vo*- nistore etj., ai arriti në përfundimin se "shihet qartë se zbërthimi dialektor i shqipes së sotme është përfundimi i një diferencimi të kryer shkallë-shkallë në rrymë të kohës" (Çabej 1977, IV 192). Ai mendonte se faktorë jashtëgjuhësorë si ata socialë-politikë, ekonomikë, shpërngulje të popullsisë nga katundet e qytetet gjatë luftërave me pushtuesit, pa dyshim kanë ndikuar në ndryshimet dialektore. Kjo bëri vazhdon ai këtu "[...] që në një periodë të mëparme, mesjetare, e cila mund të quhet periodë paraletrare, gegërishtja paraqitet më konservative, toskërishtja ka prirje për inovacion e për largim nga një tip gjuhësor i përbashkët". Edhe emërtimet *gegë* e *toskë* janë të vona, sepse në dokumentet mesjetare nuk dalin asgjëkund këta emra.

Si një burim të rëndësishëm për studimet dialektore atij i shërbyen të folmet e ngulimeve shqiptare. Në këto të fundit, të një rëndësie të dorës së parë, vinin ato të folme që ruanin trajta të hershme të fjalës shqipe, prandaj përveç hulumtimit në territorin brenda vendit, Çabej i shtriu kërkimet në të folmet e arbëreshëve të Italisë e të arvanitasve të Greqisë e kudo ku kishte ngulime të hershme. Si të folme të izoluara ato i kishin ruajtur më mirë trajtat arkaike të kohës kur ishin zhvendosur (shek. XIV-XV). Si student ende në Universitetin filozofik të Vjenës kur erdhi puna të zgjidhej një objekt studimi për punimin e diplomës së studentit të ri shqiptar, N. Jokl-i përfitoi nga rasti për t'i sugjeruar atij të merrej me arbëreshët me synimin e dyfishtë të përshkruante veçoritë e të folmeve të tyre dhe njëherazi t'i qasej trashëgimisë kulturore arbëreshe përmes metodave që kishte përdorur me sukses albanologu austriak për të studiuar kulturën shqiptare të Ballkanit. (Mandalà 2024, 19) Tema e diplomës me objekt të folmen e Horës së Arbëreshëve" (Vjenë 1933) me titullin "Studime arbëreshe" (Italoalbanische Studien), u vlerësua nga profesorët e tij N. Jokl, P. Kretschmer dhe K. Patsch si punimi shkencor. Ata ngritën lart metodologjinë e zbatuar dhe prurjet e reja që sillte në lëmin e dialektologjisë. Çabej asnjëherë nuk u shkëput nga bota arbëreshe dhe kontributi për të folmen dhe kulturën e tyre. Një nga punimet dialektologjike më të rëndësishme kushtuar të folmeve arbëreshe ishte dhe ai i vitit 1976 ku në dy numra të njëpasnjëshëm të "Zjarri" Çabej botoi studimin "Gli italo-albanesi e le loro parlate". Një varg

punimesh të tjera ndoqën të parat, si: "Çështja e prejardhjes së ngulimeve të arbëreshëve të Italisë në dritën kryesisht të gjuhës dhe të emrave vetjakë" (1963); "Shqiptarët në Itali të mesme dhe në Napoli" (1966); "Nga leksiku i dialekteve arbëreshe të Kalabrisë" (1968); "Ngulimet shqiptare në Itali dhe gjuha e tyre" (1968); "Histori gjuhësore dhe strukturë dialektore e arbërishtes së Italisë" (1975) etj. Si historian dhe etimolog i gjuhës shqipe E. Çabej u përpoq në këto studime për të folmet arbëreshe "...që të dallojë ç'është arkaike, e trashëguar nga një fazë më e vjetër e gjuhës, dhe ç'është risi në ato të folme e përftuar pas shpërnguljes së tyre në truallin italian" (Demiraj 1990, 108). Veçimi i të parave kërkonte edhe të përcaktohej se nga ç'vise shqiptare ishin shpërngulur arbëreshët. Për këtë ai ndërlidhi të dhënat gjuhësore (trajtat dialektore, emrat e familjeve, të vendeve, të shenjtorëve, gërmimin në regjistra kishtarë me ato të historisë e të etnografisë (elemente të zakoneve, gojëdhënave, kostumeve, këngëve). Ai arriti në përfundimin se arbëreshët e Italisë ishin shpërngulur nga vise të ndryshme të Shqipërisë, madje dhe nga arvanitasit e Greqisë. Duke ndjekur këtë rrugë ai i përcaktoi patronimet: *Gazulli, Riolo, Skutari* prej Shqipërisë veriore; *Gramshi, Keta, Manes, Muzaki, Rolisi, Rada, Skura* prej Shqipërisë së Mesme; *Borgia, Dirmi, Dorsa, Dragota, Gropa, Kuçi, Likursi* etj. prej Shqipërsisë së Jugut. (Çabej 1975/2, 53) Në të gjitha nënsistemet e gjuhës së arbëreshëve E. Çabej vërejti tipare arkaike.

Një kontribut i çmuar për dialektologjinë e shqipes mbetet dhe pyetësori i hartuar nga E. Çabej gjatë qëndrimit në Romë më 1943, një projekt për *Atlasin gjuhësor të shqipes*, i cili u ndërtua sipas modeleve të pyetësorëve të atlaseve të tipit të Zh. Zhilieronit (J. Gillièron, 1854–1926) dhe të M. Bartolit (M. Bartoli, 1873–1946), të cilët bëjnë objekt studimi fjalën e veçuar, përbërjen tingullore, formën, kuptimet dhe lidhjet sinonimike të fjalëve të veçanta. "Në pajtim me arritjet më të mira të gjeografisë gjuhësore të kohës, E. Çabej në pyetësorin e tij e vë theksin në aspektin leksikor të gjuhës. Aty gjen zbatim pikëpamja e K. Jaberg-ut sipas së cilës atlasi gjuhësor duhet të jetë fjalor dialektor nocionesh, i cili sistemon zhvendosjet e tyre gjeografike." (Beci 2013/2–3, 325). Për këtë projekt ai përpiloi një pyetësor të vëllimshëm me plot 2578 pyetje, që u botua në vitin 1943 nga shtypshkronja e famshme e Manastirit të Grottaferratës. Zgjedhja e fushave leksikore dhe e fjalëve për çdo fushë është bërë me kompetencë dhe me përgjegjësi të lartë shkencore e nga pozita të theksuara kombëtare. Ato pasqyrojnë fondin themelor të leksikut të shqipes dhe veçoritë kryesore ose atë që përbën specifikën dhe origjinalitetin e gjuhës dhe të kulturës së popullit tonë. Kolegët italianë e vlerësuan shumë punën e Çabejt (Martucci 2016/3-, 92)[4]. Gati dhjetë vjet më vonë ai bashkë me M. Domin, më 1953 hartoi një tjetër pyetësor dialektologjik me 63 pyetje me karakter të përgjithshëm dhe 41 pyetje për krahina të veçanta. Pyetësori i dytë ndryshon nga i pari, sepse nuk e sheh fjalën të veçuar, por e sheh dialektin si një sistem me të gjitha nënsistemet e tij.

Një anë tjetër të veprës së tij e përbëjnë shumë punime, të cilat nuk janë të mirëfillta dialektologjike, por të dedikuara për historinë e gjuhës, për historinë e fonetikës

4 "Presidenti Federzoni, pasi bisedoi me senatorin Kruja dhe me Tagliavinin thotë: *Me sa duket prof. Çabej është me të vërtetë pothuajse i pazëvendësueshëm në punën e organizimit të Atlasit, sepse në Shqipëri ka vetëm një glotolog tjetër, i cili nuk e ka përgatitjen shkencore të Çabejt, dhe është edhe ai i domosdoshëm, në një periudhë të mëvonshme, për mbledhjen dhe sistemimin e zërave të Atlasit.*"

historike dhe për etimologjinë. Pavarësisht kësaj, ato kanë vlerë për dialektologjinë shqiptare, sepse në to jepen të dhëna faktike për veçoritë dalluese të mbledhura nga vetë ky shkencëtar, madje herë-herë edhe duke pyetur njerëz e gjuhëtarë nga krahina të ndryshme, jepen të dhëna nga tekste burimore dialektore të shqipes. Për historinë e tipareve dialektore të shqipes ai ka një varg punimesh që i gjejmë te studimi i *Mesharit* të Gj. Buzukut, te punimet për historinë e zanores *ë* (E. Çabej, BShSh 1956, I) për gjatësinë e zanoreve (Çabej BUShT 1957, II), për historinë e konsonantizmit (Çabej BUShT 1958 I), për diftongjet e grupet e zanoreve (Çabej BUShT 1958 III), për hundorësinë (Çabej 1977 VII) etj. Të gjitha këto dukuri të shqipes, ai i ka vendosur në arealin përkatës e duke dhënë edhe kronologjinë e jetës së tyre. Gjuhët e dëshmuara vonë me shkrim, si shqipja, i dhurojnë gjuhëtarit të dhëna dialektologjike më të hershme se gjuhët me traditë shkrimore të konsoliduar prej shekujsh, prandaj në veprën madhore *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, ky dijetar ia ka nënshtruar analizën një numri të madh fjalësh me karakter dialektor, një pasuri e inventarizuar e dialektologjisë shqiptare. "Nuk besojmë se e teprojmë po të themi se me këto fjalë dialektore, mund të hartohet lehtë një atlas dialektologjik leksikor [...] që jep një orientim qoftë dhe për përhapjen e një varianti dialektor leksikor në hapësirën e gjuhë shqipe, në hapësirën e trungut dhe të diasporës" (Gjinari 1988/3, 95).

Për veprën e autorëve të vjetër

Shqipja është gjuhë e dokumentuar vonë me shkrim prandaj gjuhëtarit të historisë së gjuhës shqipe i duhet të shfrytëzojë si burim të dhënash dokumentet dhe tekstet e para të kësaj gjuhe të shek. XV–XVII. Çabej u kushtoi vëmendje të veçantë këtyre burimeve duke i shfrytëzuar në mënyrë racionale për të parë evolucionin fonetik, gramatikor e leksikor të gjuhës shqipe, çka i dha dorë për t'u shtyrë edhe më në errësirën e shekujve të padokumentuar. Në të gjitha studimet historike të këtij gjuhëtari të dhënat gjuhësore nga veprat e autorëve të vjetër dhe nga të folmet arkaike të shqipes luajnë një rol të pazëvendësueshëm argumentimi, madje në shumë raste, sidomos në *Studimet etimologjike të gjuhës shqipe* ato përbëjnë burimin kryesor për një argument shkencor të paqortueshëm.

Gjuhës së autorëve të vjetër Çabej i kushtoi një varg artikujsh. Dokumenti i parë i gjuhës shqipe është i vitit 1462 *Formula e Pagëzimit* e cila ka si sfond historik Kuvendin e Matit të po këtij viti, një moment i rëndësishëm për historinë e Shqipërisë, e sidomos për historinë e shqipes së shkruar, por dhe asaj kombëtare e kishtare, i mbledhur nga arqipeshkvi Pal Engjëlli, i cili është dhe shkruesi i këtij dokumenti njëfjali. Duke e analizuar kontekstin historik të saj, kushtet dhe vendin ku u mblodh ky kuvend, Çabej arriti në një hipotezë, që pas Kuvendit të Matit ka të ngjarë të qëndronte vetë Skënderbeu. Përsa i përket gjuhës, me Formulën kemi një dëshmi të gjuhës shqipe të shek. XV ashtu siç flitej ajo në krahinat veriore të Shqipërisë e kjo e ka shtyrë Çabejn të mendojë që shkruesi i parë i kësaj formule të ketë qenë ndonjë prift i atyre anëve (Çabej 2008, 116). Çabej vuri re elementet e përbashkëta të grafisë së Formulës me atë të Gjon Buzu-

kut, afro një shekull më vonë, që flasin për ekzistencën e një tradite shkrimore në Shqipëri të ndikuar nga bota veneciane, që vazhdon deri në shekullin XVI, por jo më te shkrimtarët e shekullit XVII (Çabej 1968, 59).

Pjesë e rëndësishme e punës së tij përgatitore për veprën madhore të etimologjisë së shqipes, si dhe për njohjen në themel të gjuhës amtare që do të ndërmerrte më vonë Çabej, ishte dhe transkriptimi dhe transliterimi i *Mesharit* të Gjon Buzukut, që mund të konsiderohet si kryevepra filologjike e tij, të cilin ai e përfundoi në vitin 1958, por, për shkak të rrethanave (veshtirësitë e shtypit) botimi i kësaj vepre të rëndësishme për gjuhësinë dhe kulturën shqiptare u vonua dhjetë vjet, deri më vitin 1968. Botimi ishte pajisur me një hyrje dhe me një studim kritik, thellësisht shkencor për gjuhën dhe vlerat e librit dhe të autorit. Ky studim për historinë dhe dialektologjinë historike të shqipes, do t'i shërbente atij si pikë e shpeshtë referimi në përpjekjet për të rindërtuar format më të hershme të fjalëve shqipe. Të dhënat për autorin e *Mesharit*, vendin dhe rrethanat e botimit të kësaj vepre paraqesin vështirësi, sepse kopjes së vetme të tij i mungojnë fletët e para ku mund të gjendeshin të dhëna për sqarimin e këtyre çështjeve. Duke e studiuar gjuhën e Buzukut, dijetari ynë arriti në përfundimin se megjithëse gjuha e Buzukut është e ngritur me vetëdije në një gjuhë mbidialektore, por më anë tjetër vihen re në librin e tij disa tipare flasin qartë për një komponente verilindore e lindore në gjuhë. (Çabej 1968, 22) Ka qenë çështje e diskutuar edhe nga gjuhëtarë të tjerë (N. Jokl, M. la Piana etj.) nëse ky libër është i pari i shkruar në gjuhën shqipe apo ka pasur një traditë më të vjetër shkrimi. Çabej, duke përmbledhur mendimet e tij mbi një analizë të hollësishme të gjuhës së autorit të parë, ariti në përfundimin: "Duke e shikuar me një vështrim objektiv këtë tekst nga gjuha e rrjedhshme që e përshkon fund e majë atë, dhe nga mënyra me gjithë lëkundjet e shpeshta, mjaft konsekuente e shkrimit, arrin të bindet njeriu se në Shqipëri ka qenë formuar më parë, se paku që në mesjetën e vonë, një traditë letrare me shkrime liturgjike e me një ortografi gjer diku të caktuar" (Çabej 1968, 25). Libri i Buzukut sipas tij "nuk është një arë e papërpunuar". Ai kishte idenë se autorët e vjetër të shqipes shkruan në "një farë koineje". Këtë ide e përforcoi dhe në studimin "Pjetër Budi dhe gjuha e tij" (Çabej 1966/4, 145) ku thotë se dialekti regjional, prej të cilit rrjedhin, përbën bazën nga ata u ngritën në një gjuhë shkrimi mbidialektore. Transliterimi dhe transkriptimi i veprës së Buzukut nuk ka qenë i lehtë për të. Rindërtimi i një teksti të vjetër me anë të kodit të sotëm alfabetik nënkupton interpretimin fonologjik të sistemit të tij grafik dhe riprodhimin sa më me besnikëri që të jetë e mundur të mënyrës se si autori e ka shqiptuar apo si ka dashur të shqiptohej gjuha që ai shkruante. (Çabej 1968, 2) Me përgatitjen e tij të shkëlqyer filologjike ai i kapërceu vështirësitë. Buzuku përdori disa shenja të veçanta jolatine, të cilat u gjykuan nga studiuesit si përshtatje të grafemave sllave-cirilike për nevojat e shkrimit të shqipes. Vlerat fonematike të këtyre shenjave u interpretuan në fillim nga Jokl-i, më pas nga Justin Rrota (Rrota1936, 7–10) e nga Martin Camaj (Camaj 1960, 12) për t'u zbërthyer më me hollësi nga Çabej në botimin e tij kritik të "Mesharit". Ai në studimin e tij për Buzukun arriti nëpërmjet arsyetimit logjik te shkrimet sllave jugore si model i drejtpërdrejtë i librit të Buzukut, pasi i bëri një shqyrtim krahasues tekstit të Buzukut me ato tekste që kishte në dispozicion dhe vuri re largime nga teksti latin e italian e përkime me tekstet

greke, qoftë të Dhiatës së Vjetër qoftë të ungjillit bizantin. Ndikimet greke te Buzuku nuk mund të vinin veçse indirekt, nëpërmjet teksteve sllave, që edhe pse të ritit latin, vijonin traditën bizantine të sllavishtes së vjetër kishtare e kjo shfaqej në këtë tekst qoftë në mënyrën e përkthimit, qoftë në grafi. Për tingullin *h* që gjen tek ky autor në fillim, në fund e në mes të fjalës atë e mundoi pyetja nësë kemi të bëjmë me një shqiptim real apo një shenjë konvencionale me vlerë thjesht grafike pa ndonjë funksion shqiptimi. Ai pranoi se një kategori rastesh ku *h*-ja, e gjendur si në fillim të fjalës, ashtu dhe në fund të saj, ka shërbyer për zhdukje të hiatit e për ndarje të fjalëve nga njëratjetra. Në mbështetje të kësaj përmend edhe faktin se *h*-ja ka shërbyer për ndarjen, ilustruar edhe me shembuj. (Çabej 1968, 56) Çabej dalloi disa lloje përdorimi të *h*-së, që kanë natyra e burime të ndryshme. Kështu vijoi me shpjegimin fonetik të grupeve nistore *en, er, el* para një bashkëtingëlloreje apo zanoreve dyfishe, dukuri kjo edhe te autorët e tjerë, duke dalë në përfundime të sakta që qëndrojnë deri në ditët tona. Po kështu bëri vërejtje për grupet e formuara me mbylltoret *b, d, g* të cilat, ashtu si në përgjithësi në shqipen e teksteve të vjetra, ruhen mirë. Çabej e ka studiuar këtë dukuri shumë më të përhapur te Buzuku, duke gjetur paralele te autorët e tjerë të vjetër e në dialekte të ndryshme të Veriut e të Jugut, dhe i ka gjykuar ato si forma popullore me shqiptim të dobët të bashkëtingëllores hundore, që u përdorën edhe në shkrim. Edhe për gramatikën historike kanë vlerë konstatimet e Çabejt që dalin nga shqyrtimi i veprave të autorëve të vjetër. Kështu, ai ishte i pari që trajtoi asnjanësin tek autorët e vjetër duke filluar me Mesharin e Gjon Buzukut krahasuar edhe me autorët e tjerë pasardhës. Me studimin e gjuhës së Buzukut, Çabej vërtetoi mendimin e Pedersenit se asnjanësit e vjetër të shqipes nuk kufizohen vetëm në emrat që shënojnë lëndë, të përdorur si kolektivë, por shtrihen edhe në emra të tjerë, mjaft prej të cilëve me burim latin (Çabej 1977 IV, 58). Duke analizuar çështjen e nyjës në gjuhën shqipe, Çabej arriti në përfundimin se nyja ka ardhur duke u shtrirë gjithmonë e më shumë në përdorim, nga autori në autor dhe kjo vihet re sidomos te pjesorja, zhvillim që vijon edhe sot e gjithë ditën. (Çabej 1963 BUShT 3, 82–83, 88–89)

Nga ky shkencëtar u vu re edhe përshtatja në gjini, numër, edhe në rasë e mbiemrit me emrin (biflektivizmi), një tipar i gjuhës së teksteve të vjetra, pas gjase ruajtje e një gjendjeje më të vjetër. (Çabej 1977 IV, 76–77) Për gjuhën e Buzukut dhe të autorëve pas tij, Çabej shprehej se shqipja ishte atëhere – siç është gjer diku dhe sot e gjithë ditën – esencialisht një gjuhë me një fjalor të pasur me elemente që i përkasin jetës materiale, e të varfër me fjalë nga të sferës abstrakte të ideve" (Çabej 1977 IV, 35)

Çabej për shqipen e sotme

Eqrem Çabej njihet kryesisht si historian i gjuhës shqipe, por ai ka qenë gjithnjë i lidhur edhe me ecurinë e zhvillimit të shqipes letrare. E. Çabej dha një kontribut të rëndësishëm në përcaktimin e rregullave të drejtshkrimit të shqipes (projektet e viteve 1948, 1951, 1956, 1967), një ndihmesë e cilësuar në përgatitjen dhe mbarëvajtjen e punimeve të Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe (1972) dhe në vijim, gjatë gjithë

vitit 1973, mori pjesë rregullisht dhe, me vetëdijen e një detyre të lartë shkencore e kombëtare, në mbledhjet e komisionit për hartimin e "Drejtshkrimit të gjuhës shqipe". Ai punoi me bindjen se "me rrethanat e reja që u krijuan u desh të plotësoheshin nevojat e gjuhës së administratës e të fushave të tjera të veprimtarisë shtetërore, të ekonomisë, të teknikës, të arsimit e të kulturës, të sferës ushtarake etj." (Çabej 1975, V 223)

Në këtë proces ai do të ketë rolin e vet të padiskutueshëm, sepse pjesëmarrja e tij në këtë proces nuk lidhet vetëm me kërkesat e mëdha të kohës në fushën e arsimit, të kulturës dhe të shkencës shqiptare, as edhe për faktin se studimet gjuhësore në këtë fushë ishin shumë të munguara, po lidhet me faktin se ai ishte njohësi më i mirë i shqipes historike e i shqipes së re dhe puna e donte të ishte aty. Eqrem Çabej i ka njohur mirë teoritë mbi formimin e gjuhëve letrare e duke i njohur mirë këto s'kishte si të mos pajtohej edhe me mënyrën e krijimit të shqipes letrare, sepse "Gjuhët e përbashkëta të shkrimit e të literaturës zakonisht ndërtohen mbi një bazë dialektore të caktuar." Në Kongresin e Drejtshkrimit ai paraqiti kumtesën "Mbi disa çështje të traditës së shkrimit dhe të drejtshkrimit të shqipes." (Çabej 1973/1, 97–107) Në këtë kumtesë ai theksoi se zgjidhjet që po jepte ai kongres për krijimin e shqipes letrare ishin në përputhje dhe me traditën e hershme të shkrimit e të drejtshkrimit të gjuhës shqipe. (Demiraj 1990, 31)

Në shkrimin me titull "Detyra e gjuhësisë shqiptare në lidhje me gjuhën letrare kombëtare e probleme të tjera" (Çabej 1952 BUShT/4, 114–119) E. Çabej do të përcaktojë shumë qartë çka duhet të bëjë gjuhësia shqiptare për të shkurtuar rrugën e krijimit të një gjuhe të përbashkët për të gjithë shqiptarët. Në mbledhjen e Asamblesë së Akademisë së Shkencave në shkurt 1979, E. Çabej mbajti referatin "Për pastërtinë e gjuhës" (Çabej *Gjuha jonë*, viti I, nr. 1, f. 36–47) ku ngriti si çështje madhore institucionalizimin e kujdesit të shtetit për mbarëvajtjen e gjuhës. Në përfundim të këtij referati ai arriti në një përfundim të rëndësishëm "Gjuha e shkrimit dhe e bisedës që përdorim ne sot i ka rrënjët në gjuhën popullore të përpunuar gjatë kohëve. Ajo është rezultat edhe i përdorimit të fjalëve të gojës së popullit, edhe i punës së madhe të brezave të mëparshëm." Ai ngriti problemin e punës për pasurimin dhe pastrimin e gjuhës shqipe por "asnjë purizëm i tepruar, asnjë ksenofili e tepër...shqipja jo vetëm në leksikun e lëmit material, por dhe në atë të fushës abstrakte-mendore është më e pasur sa mund të kujtohet, ka mundësi në të ardhmen të pasurohet me mjetet e lëndës vetjake dhe në degët e disiplinave shkencore". Me urtësinë e moshës dhe përvojën e punës në komisionin e terminologjisë E. Çabej e shikon me sy objektiv e të matur veprimtarinë për pastërtinë e gjuhës, duke pranuar qëndrime të diferencuara, p.sh. për një pjesë të madhe të terminologjisë së shkencave natyrore e mjekësore, që përdoret përbrenda specialitetit, shqipërimi i termave do te jetë më i kufizuar. Një rëndësi të madhe merr pastrimi i termave të leksikut. (Lafe 2024, 39)

E. Çabej është bashkautor i *Fjalori të gjuhës shqipe* (1954). Ai dha një ndihmesë të çmuar në fushën e terminologjisë duke kontribuar në terminologjinë e disa fushave, si: botanikë, gjuhësi, matematikë, fizikë, kimi, arkitekturë, elektronikë, duke qenë bashkautor i fjalorëve terminologjikë të këtyre fushave.

Ai e vlerësonte shumë punën në grup e këtu duhen përmendur dy nga punimet më të mira e gati shteruese që hartoi bashkë me Aleksandër Xhuvanin*: Parashtesat e gjuhës shqipe* (1956) dhe *Prapashtesat e gjuhës shqipe* (1962)

Studime për letërsinë

Kontributi i prof. Çabejt nuk do të ishte i plotë po të mos vihet në dukje dhe punimet e tij për letërsinë shqipe. Ky kontribut erdhi në kulturën shqiptare kur kjo fushë e dijes së Albanologjisë pothuajse ishte djerrë. Qysh në hapat e parë shkencorë ai solli studime me vlerë: "Elemente të gjuhësisë dhe të literaturës shqipe (1936), "Për gjenezën e literaturës shqipe (1939) dhe "Romantizmi në Europë Lindore e Juglindore dhe në literaturën shqiptare" (1945). E. Çabej është ndër të parët studiues që u mor me romantizmin. Duke analizuar romantizmin e Europës Perëndimore me atë të Europës Lindore ai vërejti se tek e dyta kjo rymë letrare ishte në agimin e saj dhe pati ndyshime të shumta, madje edhe humbje të disa tipareve perëndimore si rrjedhojë e trajtës së ndryshme të menduarit. Kjo duket "në mungesën e themelit filozofik të poezisë…mungesa e kultit të individit në kontrastin e tij me mjedisin, mungon largimi i poetit nga realiteti, fluturimi i tij pegasik në kohë e vise të largëta, lumturia në ndjenjë, jeta në ëndërr…" (Çabej, 1994, 79) Interesi në fushën e historisë së gjuhës shqipe e çoi edhe në studimin e letërsisë së vjetër shqipe, në shkrimet e vjetra e letërsinë arbëreshe. Gjykime me vlerë ka dhënë për romantizmin e Naimit, De Radës (Çabej, 1964, f.1–2) e Serembes, duke vënë në dukje të përbashkëtën dhe të veçantën e poezisë së tyre romantike. Çabej tregoi një interesim të veçantë për folklorin i cili luajti një rol ngjizës, njësues në letërsinë artistike shqiptare. "Poetët kanë dalë prej tokës së natyrshme të poezisë popullore" vërente ai. (Çabej, S. Gj., V, 1975, 133). Folklorin Çabej e pa jo vetëm si një nga tiparet e letërsisë së romantizmit, por dhe si pjesë përbërëse e kulturës së kombit shqiptar.

Vlera e jashtëzakonshme e E. Çabejt si interpretues i letërsisë dhe krijimtarisë popullore qëndron në faktin se qasja e tij nuk ka karakter thjesht përshkrues, por ka shtruar mjaft çështje të cilat janë aktuale për studiuesit e letërsisë dhe sot.

I vlerësuar si gjeni i gjuhësisë shqiptare, E. Çabej duhet njohur edhe si një teoricien i jashtëzakonshëm i letërsisë dhe krijimtarisë popullore. Vetëm në pak studime ai vendosi piketa thelbësore, la teza që meritojnë të merren e rimerren

Çabej mbetet shembulli i intelektualit dinjitoz e të pakompromet ueshem, që në krijimtarinë e tij nuk bëri lëshime metodike ndaj trysnisë ideologjike. Ai u shqua edhe për kujdesin e madh që tregonte për përgatitjen e brezit të ri të studiuesve në fushën e albanologjisë, për çdo të ri që tregonte prirje dhe talent në fushën e albanologjisë dhe shkencës në përgjithësi. I matur në shkencë, po ashtu si dhe në jetë, ai edhe pasi jepte argumentat shtrënguese për të mbështetur pikëpamjen e tij, linte hapët mundësinë e një interpretimi alternativ. Vepra e këtij dijetari të shquar është një enciklopedi e gjuhës shqipe, e botës dhe jetës shqiptare. Ai mbetet përfaqësuesi i vetëm i kohës së tij që e europianizoi dijen shqiptare. Jetoi e punoi me etikë të lartë në shkencë e në jetë.

Bibliografia

Beci, B. (2013) "Vendi i pyetësorit dialektologjik të Spiro Floqit në historinë e dialektologjisë shqiptare", Studime Filologjike, nr. 2–3, f. 25–35.
Camaj, M. (1960) Il "Messale", Roma.
Çabej, E. (1952) "Detyra e gjuhësisë shqiptare në lidhje me gjuhën letrare kombëtare e probleme të tjera", *BSHSH* nr. 4, Tiranë 1, f. 114–119.
Çabej, E. (1956) "Për historinë e zanores ë në gjuhën shqipe", në B.Sh. Sh., I, Tiranë, f. 123–143.
Çabej, E. (1957) "Kuantiteti i zanoreve të theksuara" në B. U.Sh.T, nr. 2, Tiranë, f.207–214.
E. Çabej, (1958) "Për historinë e konsonantizmit në gjuhën shqipe", në BUShT, Tiranë, I, Tiranë, f. 31–80.
Çabej, E. (1958) " Diftongje e grupe zanoresh të shqipes", BUSHT, SShSh, viti XII, nr. 3, Tiranë, f. 71–88.
E. Çabej, (1959) Unele probleme ale istoriei limbii albaneze, në Studii şi cercetări ling vistice, 4, X, Bucureşti, f. 531.
Çabej, E. (1960) "Disa aspekte të fonetikës historike të shqipes në dritën e gjuhës së Gj. Buzukut", BUShT, SShSh,Tiranë, I. f. 253.
Çabej, E. (1960) 1. Hyrje në historinë e gjuhës shqipe 2. Fonetika historike, Tiranë; Studime etimologjike në fushë të shqipes, v. I, Tiranë, 1982; v. II, 1976; v. III, 1987; v. IV, 1997;
E. Çabej, (1963) "Rreth disa çështjeve të historisë së gjuhës shqipe", *BUShT SShSh*, nr. 3, f. 82–83, 88–89.
Çabej, E. (1964) "Disa faza më të moçme të shqipes në dritën e gjuhëve fqinje", BSHSH, Tiranë, nr.1, Shkodër, f. 5–27.
Çabej, E (1964) "Disa karaktere të poezisë së De Radës", "Drita", viti IV, nr. 49 (206), Tiranë, f.1–2,
Çabej, E. (1965) "Për gjenezën e literaturës shqipe", *Studime Gjuhësore*, V, Prishtinë, 101–135
Çabej, E. (1966) "Pjetër Budi dhe gjuha e tij", në *Studime Filologjike*, nr. 4, f.139–151.
Çabej, E. (1967) *Shumësi i singularizuar*, Tiranë, f. 9–215.
Çabej, E. (1968) *Meshari i Gjon Buzukut* 1555, pjesa e parë, Hyrje. F Çabej, f. 299.
Çabej, E. (1969) "Ilirishtja dhe shqipja" në *Ilirët dhe gjeneza e shqiptarëve*, Tiranë, f. 41–52.
Çabej, E. (1970) "Kontributi i shqipes në lidhjen gjuhësore ballkanike", *Studime filologjike*, nr. 4, f. 3–21.
Çabej, E. (1972) "Problemi i vendit të formimit të gjuhës shqipe" në *Studime filologjike*, nr. 4. f. 3–29.
Çabej, E. (1973) "Mbi disa çështje të traditës së shkrimit dhe të drejtshkrimit të shqipes", në Studime Filologjike, nr. 1, f. 97–107.
Çabej, E. (1974) "Mbi disa dukuri të historisë së gjuhës shqipe të para në lidhje me gjuhët e tjera ballkanike", *Studime filologjike*, nr. 4, f. 80–81.
Çabej, E. (1974) "Problemi i vendit të formimit të gjuhës shqipe", Kuvendi i studimeve ilire, Tiranë, f. 9–27.

Çabej, E (1974) “Karakteristikat e huazimeve latine në gjuhën shqipe”, *Studime filologjike*, nr. 2, f. 15–53.
Çabej, E. (1975) “Histori gjuhësore dhe strukturë dialektore e arbërishtes së Italisë” në *Studime Filologjike* nr. 2, f. 51–68.
Çabej, E. (1975) “Disa mendime mbi marrëdhëniet gjuhësore rumune-shqiptare”, *Studime filologjike*, nr. 1, f. 49–67.
Çabej, E. (1976) “Mbi disa izoglosa të shqipes me sllavishtes”, *Studime filologjike*, nr. 2. f. 63–74.
Çabej, E. (1976) “Histori fjalësh të sllavishtes e të shqipes” në *Studime filologjike,* viti XXX, nr.1, f.123–135.
Çabej, E. (1977) “Dy çështje gjuhësore”, në *Gjurmime albanologjie. Seria shkencat filologjike, VII*, Prishtinë, 1978, f. 27–35.
Çabej, E. (1977) “Gjon Buzuku”, *Studime Gjuhësore* VI, Prishtinë, f. 58.
Çabej, E. (1977) “Për historinë e strukturës dialektore të shqipes” në *Studime Gjuhësore* IV Prishtinë, f.188–194.
Çabej, E. (1977) “Kontributi i shqipes në formimin e lidhjes gjuhësore ballkanike”, *Studime gjuhëso*re, Rilindja, Prishtinë, IV, 335–346.
Çabej, E. (1979) “Për pastërtinë e gjuhës shqipe”, “Rilindja”, Prishtinë, 12 maj, f. 14; 13 maj 1979, f. 11; 14 maj 1979, f. 15.
Çabej, E. (1982) *Studime etimologjike në fushë të shqipes I*, Tiranë.
Çabej, E. (1986) “Laringalet”, në *Studime gjuhësore VII*, Prishtinë, f. 74–78.
Çabej, E. (1986) “Sintaksa”, *Studime gjuhësore VII*, Rilindja, Prishtinë, 125–130.
Çabej, E. (1986*)* “Sistemi emëror” *Studime gjuhësore VII*, Rilindja, Prishtinë, f. 93–100.
Çabej, E. (1994) *Shqiptarët midis Perëndimit dhe Lindjes*, Tiranë, MÇM.
Çabej, E. (2008) “Pesëqind vjetori i shkrimit shqip – Kuvendi kishtar i Matit i vitit 1462 dhe Formula e Pagëzimit”, në përmbledhjen *Formula e Pagëzimit*, Muzeu Historik Kombëtar, f. 116.
Demiraj, B. (2014) “Eqrem Çabej: Studime etimologjike në fushë të shqipes, Bleu V (K-M)”, SHB Çabej, Tiranë.
Demiraj, B. (2016) “Mbi ndryshimin e paradigmës në studimin diakronik të shqipes për nga perspektiva e indoeuropianistikës – teoria e laringaleve ie. dhe zbatimi i saj si rast studimi”, Prishtinë, f.141–163, në *Studimet albanistike në Amerikë*.
Demiraj, Sh. (1990): *Eqrem Çabej: një jetë kushtuar shkencës*, Tiranë.
Dodi, A. (1988) “Vendi i shqipes në rrethin e gjuhëve indoeuropiane në studimet e prof. E. Çabejt në fushën e fonetikës historike”, *Studime Filologjike*, nr. 3, f. 69–77.
Domi, M. (1988) “Prof. Çabej për prejardhjen e gjuhës shqipe dhe për autoktoninë e popullit shqiptar”, *Studime Filologjike*, nr. 3, f. 57–65.
Gjinari, J. (1988) “Ndihmesa e prof. Eqrem Çabejt në fushën e dialektologjisë shqiptare”, *Studime filologjike*, nr.3, f. 93–99.
Kore, M. (2024) “Qëmtime në “Studime etimologjike në fushë të shqipes të Eqrem Çabejt” në *Prof. E. Çabej përmes letërkëmbimit me kolege dhe kolegë të gjuhës gjermane*,Tiranë, f. 218–226.

Lafe, E. (2024) "Shteti dhe gjuha amtare në vështrimin e prof. Eqrem Çabejt" në *Prof. E. Çabej përmes letërkëmbimit me kolege dhe kolegë të gjuhës gjermane*, Tiranë, f. 36–47.

Lafe, G. (2024) "Hyrje në studimin krahasues të gjuhëve indoeuropiane, një vepër e rëndësishme dhe pak e njohur e Çabejt", në Prof. E. Çabej përmes letërkëmbimit me kolege dhe kolegë të gjuhës gjermane, Tiranë, f. 231–241.

Likaj, E., Avrami, A. (2024) "Çabej – zot i thellësive të historisë së gjuhës shqipe", në *Prof. E. Çabej përmes letërkëmbimit me kolege dhe kolegë të gjuhës gjermane,* Tiranë, f.68–74.

Mandalà, M. (2024) "Arbëreshët vunë një gur themeltar në ndërtesën e kulturës shqiptare*" në Prof. E. Çabej përmes letërkëmbimit me kolege dhe kolegë të gjuhës gjermane*, Tiranë, f.16–36.

Mansaku, S. (2018) "Vepra e Eqrem Çabejt – sintezë e shkencës gjuhësore europiane dhe e traditës shqiptare" në *Studime për historinë e gjuhës shqipe, Vepra I*, f.217–229.

Mansaku, S. "Studimet etimologjike në fushë të shqipes nga Gustav Meyer-i te Eqrem Çabej" në *Studime për historinë e gjuhës shqipe* Vëllimi I, Tiranë, 1, f. 281–293.

Martucci, D. (2016)"Përpjekja e parë për të hartuar një atlas gjuhësor të shqipes (1940–1944)" përkthyer nga G. Lafe në *Studime Filologjike*, nr. /3–4, f. 83–117.

Omari, A., (2008) "Gjendja e botimeve të teksteve të vjetra shqipe dhe kontributi i Çabejt", *Studime Albanologjike I Gjuh*ësi, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Tiranë, f. 86–93.

Papahagi, P. (1908) "Parallele Ausdrücke und Redensarten im Rumänischen, *Albanesischen, Neugriechischen und Bulgarischen*„ Leipzig, f.1–170.

Pedersen, H. (2003) "Gjinia asnjanëse në gjuhën shqipe", në Studime për gjuhën shqipe, ASHAK, Prishtinë, f. 47–54

Rrota, J. (1930) *Monumenti mâ i vjetri i giûhës shqype. D. Gjon Buzuku* (1555), Shkodër.

Rrota, J. (1936), *Për historin e Alfabetit Shqyp*, Shkodër, f. 7–10.

Schramm, G. (1981), *Eroberer und Eingesessene*, Stuttgart;

Schramm, G. (1994), Anfänge des albanischen Christentums. Die frühe Bekehrung der Bessen und ihre langen Folgen, Freiburg/ Br.

Topalli, K. (2008) "Vlera e studimeve etimologjike të prof. Çabejt për shkencat albanologjike" *Studime filologjike*, nr. 3–4, Tiranë, f. 79–87.

Witczak, K. T. (1994) "Proto-Albanian and the Problem of the Ethnogenesis of the Albanian Nation", in *Biuletyn Polskiego Towarzystwa Jezykoznawczego 50*, f. 21–26.

Witczak, K. T. (1995) "Were the Bessans Ancestors of the Albanians? A new opinion on the ethnogenesis of the Albanian nation in Thraco-Dacica" 16, 1–2, f. 309–312.

Hermann Ölberg, indoeuropianisti i përkushtuar ndaj gjuhës shqipe dhe parahistorisë së saj

Hermann Maria Ölberg (14 tetor 1922–25 shkurt 2017) ishte një gjuhëtar austriak, profesor në Universitetin e Innsbruck-ut (Austri), indoeuropianist dhe albanolog. Ai studioi gjuhësi të përgjithshme në Universitetin e Innsbruck-ut që nga viti 1948 pranë profesorëve të shquar Friedrich Stolz, Alois Walde, Hermann Ammann, Johann Knobloch dhe Wolfgang P. Schmied (Canaj 2018, 781) dhe më pas punoi gjithë jetën, deri sa doli në pension, në Institutin e Gjuhësisë të këtij Universiteti. Në vitin 1962 mbrojti doktoraturën me një tezë mbi toponomastikën pararomake të Tirolit verior: "Das vorrömische Ortsnamengut Nordtirols. Ein Beitrag zur Illyrierfrage", që hulumtonte rrethanat gjuhësore të lashtësisë përmes shqyrtimit të emërvendeve të vjetra dhe shprehte interesin e tij për historinë e hershme të vendlindjes së tij Tirolit si një trevë e banuar nga popullsi ilire. Në vitin 1972 u habilitua me një tezë në fushë të albanologjisë. Në universitetin e Innsbruck-ut ai filloi veprimtarinë në vitin 1953 si lektor i gjuhës esperanto, më pas, në 1963, si docent i sllavishtes së vjetër kishtare[5] dhe nga vitet 1975 deri 1987 ai ishte profesor universitar për gjuhësinë e përgjithshme dhe të aplikuar. Interesat studimore e pedagogjike të tij përfshinin një numër mbresëlënës fushash gjuhësore, si onomastika, gjuhësia historike-krahasuese indoeuropiane, albanologjia, fonetika akustike, interlinguistika dhe gjuhët e planifikuara me fokus esperanton, lëndë të cilën e ofroi për vite me radhë në këtë universitet[6], etj.. Hermann Ölberg-u ishte një nga studiuesit e paktë, i cili jo vetëm e shkruante por edhe e fliste esperanton. Ai e kishte mësuar këtë gjuhë që në vitin 1948 nga Leo Blaas, presidenti i Klubit Esperanto të Innsbruck-ut[7], u apasionua pas saj dhe gjatë viteve u bë një nga specialistët më të njohur të kësaj gjuhe.

Për gjuhën shqipe ai filloi të interesohej në vitet '50 kur studionte gjuhësi indoeuropiane dhe profesori i tij Hermann Ammann i drejtoi studentët në të fshehtat e shqipes (Ölberg 1982a, 147). Tradita e zhvilluar albanologjike në vendet gjermanishtfolëse që nga themeluesit e saj Hahn, Schuchardt, Miklosich, Meyer e më tej Lambertz, Jokl etj. la gjurmë të qëndrueshme edhe në Innsbruck, i vetmi universitet në Austri ku mësohej gjuha shqipe edhe mbas vdekjes tragjike të Norbert Joklit në vitin 1942 (Canaj 2018, 782). Por nxitja për t'u thelluar në studimet albanologjike i erdhi mbas takimit me studiuesit shqiptarë Eqrem Çabej dhe Androkli Kostallari në Kongresin Ndërkombëtar

5 Vorlesungsverzeichnis 1963–1964, Universität Innsbruck, Universitäts- und Landesbibliothek Tirol, f. 112: https://diglib.uibk.ac.at/download/pdf/3318742.pdf

6 Psh. në fushën e Interlinguistikës në vitin 1963 jepte lëndët: Esperanto für Fortgeschrittene: Der Beginn literarischer Tätigkeit (mit Texten); Wesen und Ziel der Plansprachen und ihre Forschungsgeschichte, në: Vorlesungsverzeichnis 1963–1964, Universität Innsbruck, Universitäts- und Landesbibliothek Tirol, f. 112: https://diglib.uibk.ac.at/download/pdf/3318742.pdf

7 https://de.wikipedia.org/wiki/Hermann_%C3%96lberg

të Studimeve Onomastike që u mbajt në Amsterdam në vitin 1963. Letërkëmbimi i ngjeshur që lindi dhe u zhvillua mbas kësaj me profesorët shqiptarë, veçanërisht me Eqrem Çabejn e që vijoi deri në vdekjen e gjuhëtarit të shquar shqiptar më 1980, flet për interesimin e tij në rritje për gjuhën shqipe dhe historinë e saj.

Që nga njohja dhe vendosja e marrëdhënieve miqësore e profesionale me profesor Eqrem Çabejn, Ölberg-u i zgjeroi dhe thelloi gjithnjë e më shumë njohuritë e tij për shqipen dhe e drejtoi vëmendjen dhe interesin shkencor drejt kësaj gjuhe dhe historisë së hershme të saj. Në këtë drejtim e ndihmoi shumë njohja nga afër me studimet etimologjike të Çabejt, për të cilat shprehte vlerësimin më të lartë. Mjaft frytdhënëse për punën e tij kërkimore ishte dhe vizita e tij e parë në Shqipëri në vitin 1970. Përmes studimit të literaturës që merrte nga Çabej, Ölberg-u tërhiqej gjithnjë e më shumë nga veçoritë e gjuhës shqipe në rrethin e gjuhëve indoeuropiane dhe rindërtimi i fazave parahistorike të saj përmes krahasimit me gjuhë të tjera simotra I. E. dhe analizës së fjalëve me burim nga greqishtja e vjetër e nga latinishtja. Frytet e para të studimit të shqipes dhe të të kuptuarit të veçorive të zhvillimit historik të saj ishin disa artikuj për çështje të fonetikës historike të shqipes, si "Albanica I. Rreth shndërrimit r/l në gjuhën shqipe" (Ölberg 1967); "I.-e. *k* para *u* në gjuhën shqipe" (Ölberg 1968); "Çështje të historisë së gjuhës shqipe. Parime themelore të hundorësisë", (Ölberg 1971), të cilat u pasuan nga studime më të thelluara në fonetikën historike të shqipes në lidhje me proto-indoeuropianishten, siç ishte artikulli "Disa mendime për teorinë e laringaleve zbatuar në shqipen" (Ölberg 1972a), ku polemizon me albanologun amerikan Eric Hamp lidhur me disa hipoteza të tij për reflekset e laringaleve në shqipen, mbasi ka studiuar dhe gjetur të drejta etimologjitë e Çabejt që u bien ndesh konkluzioneve të Hampit. Punimi tjetër i të njëjtit vit 1972 ishte një artikull i gjerë mbi marrëdhëniet gjuhësore të shqipes me greqishten (Ölberg 1972b), në të cilin rimerr në vështrim studimet e deri-atëhershme mbi këto marrëdhënie dhe pohimet e gabuara të atyre studiuesve që i kishin mohuar huazimet greke të vjetra në shqipen, duke u mbështetur në studimin fondamental të A. Thumb-it dhe në prurjet e reja të Çabejt nga studimet etimologjike të tij të viteve 1960–1968. Çështja e pranisë së huazimeve të vjetra greke në shqipen është thelbësore për vërtetimin e autoktonisë së shqiptarëve në trojet e tyre aktuale, pasi mungesa e tyre ishte një nga pikat e ngritura nga romanisti Gustav Weigand që e lidhte prejardhjen e shqipes me trakishten dhe jo me ilirishten, pra nga një vendbanim më në verilindje të trojeve aktuale. Duke u nisur nga parimet e shprehura nga Thumbi për huazimet greke të vjetra të shqipes, Ölberg-u jep një klasifikim të tyre, duke përcaktuar 34 njësi leksikore si huazime të sigurta, 7 njësi leksikore si të mundshme dhe 43 njësi të hyra përmes latinishtes.

Kjo punë e nisur me pasion dhe e thelluar në historinë e gjuhës shqipe e nxiti studiuesin që edhe habilitimin ta kryente në këtë fushë, dhe më 1972 ai mbrojti me sukses provimin e habilitimit me punimin "Hulumtime për leksikun indoeuropian të shqipes dhe për fonologjinë diakronike në bazë të sistemit të zanoreve", punim që u botua vetëm në vitin 2013 nën kujdesin e Bardhyl Demirajt (Ölberg 2013). Po atë vit Ölberg-u hapi lektoratin e gjuhës shqipe në universitetin e Innsbrukut, duke e bërë atë një qendër të studimeve shqiptare të njohur në të gjithë Europën. Ai ndihmoi studiue-

sit e rinj shqiptarë për specializime të mëtejshme dhe qëndrime pasuniversitare në Republikën e Austrisë.

Një arritje madhore e Ölberg-ut në promovimin e albanologjisë në Perëndim ishte organizimi i Kolokuiumit albanologjik ndërkombëtar kushtuar Norbert Jokl-it në vitin 1972. Ky ishte i pari tubim në botën e jashtme i realizuar me përmasa e nivel të lartë shkencor dhe që mbeti më i rëndësishmi për shumë dekada të tjera. Në këtë tubim morën pjesë albanologë e indoeuropianistë të shquar, si A. Desnickaja, E. Hamp, M. Gabinsky, G. Bevington, G. Klingenschmitt, W. Fiedler, O. Buchholz etj., personalitete të gjuhësisë shqiptare nga Shqipëria, si E. Çabej, M. Domi, Sh. Demiraj, J. Gjinari e J. Kole, ndërsa A. Kostallari, B. Beci, E. Lafe, Xh. Lloshi, J. Thomai dërguan kumtesat që u përfshinë në botimin e Akteve, dhe nga Kosova, si I. Ajeti, H. Kaleshi, A. Hadri, L. Mulaku, Sh. Pllana, Z. Mirdita. Kolokuiumi kushtuar Jokl-it qe një sukses dhe ngjarje e shënuar në historinë e albanologjisë dhe vëllimi i akteve që doli prej tij shënoi një kontribut të rëndësishëm në studimet albanologjike të shekullit XX (Omari 2024). Në këtë tubim Ölberg-u mbajti kumtesën "Disa mendime rreth autoktonisë së shqiptarëve në gadishullin e Ballkanit" (Ölberg 1977), në të cilën mbështeste përfundimet e Çabejt vecanërisht nga analiza e emrave të lashtë të vendeve, të cilët tregojnë një vazhdimësi të drejtpërdrejtë në gjuhën shqipe, gjë që flet për praninë e hershme të shqiptarëve në brigjet e Adriatikut që nga shekujt e fundit para Krishtit. Meqenëse shqipja tregon afërsi më të madhe me gjuhët indoeuropiane veriore, ai mendon se shqiptarët, gjatë lëvizjes së popujve indoeuropianë janë zhvendosur nga Europa qendrore ose juglindore, ashtu si fise të tjera të hapësirës ilire, gjatë mijëvjeçarit të parë para Krishtit dhe që nga shekujt e fundit të këtij mijëvjeçari kanë qenë të pranishëm në bregun perëndimor. Për marrëdhëniet e shqipes me shtresën pararomake të rumanishtes, ai ka mendimin se (proto)shqipja dhe dakishtja nuk janë e njëjta gjuhë, por kanë qenë gjuhë motra.

Ölberg-u erdhi për herë të dytë në Shqipëri me rastin e Konferencës Kombëtare për Formimin e Popullit shqiptar, të Gjuhës dhe të Kulturës së tij, organizuar nga Akademia e Shkencave, më 2–5 korrik 1982. Në këtë konferencë prof. H. Ölberg-u mbajti kumtesën "Kontributi i gjuhësisë për çështjen e atdheut ballkanik të Shqiptarëve" (Ölberg 1982b). Në kumtesën e tij ai solli argumente gjuhësore që provojnë lashtësinë e shqipes dhe të shqiptarëve në trojet aktuale në Ballkan dhe për këtë mbështetej në disa karakteristika të huazimeve latine të shqipes. Meqenëse ruajtja e *k*-së latine para *e*-së dhe *i*-së nuk tregon shumë për lashtësi, pasi studimet e fundit kanë përcaktuar se ajo ka zgjatur në latinishte deri nga shek. V-VI (Mihăescu), ai sjell në vëmendje një numër argumentesh fonetike e morfologjike që i konsideron më të rëndësishme për vjetërsinë e huazimeve latine të shqipes e për pasojë edhe autoktoninë e hershme të shqiptarëve në vendbanimet e tyre.

Gjuhëtari austriak botoi dhe studime të tjera me vlerë për albanologjinë. Një kontribut origjinal për historinë e albanologjisë është artikulli "Zhvillimi i një paradigme. Rreth lindjes së albanologjisë" (Ölberg 1982a), në të cilin ai paraqet një panoramë të lindjes dhe zhvillimit të kësaj fushe ndërdisiplinore studimi, me fokus gjuhën dhe prejardhjen e shqiptarëve, duke e parë jo thjesht si një vijimësi grumbullimi në rritje të njohurive të reja, por duke e ndarë në periudha kohore e epistemologjike. Kontributet

shkencore të albanologëve që shënuan gurët kilometrikë të albanologjisë, Ölberg-u nuk i analizon e vlerëson në mënyrë të izoluar, por i vendos në një kuadër teorik të ndarjes në periudha sipas koncepteve shkencore të "paradigmës" dhe të "ndërrimit të paradigmës" të përhapura në atë kohë. Ai mbështetej në teorinë e Thomas Kuhn, "Struktura e revolucioneve shkencore", 1962 (Kuhn 1978[3]), sipas të cilit fushat e shkencës nuk përparojnë në mënyrë lineare por kalojnë periudha revolucioni, të quajtura "ndërrime paradigme", në të cilat natyra e kërkimit shkencor pëson shndërrime të befta, ndërsa zhvillimin e shkencës e sheh të ndarë në tre stade: parashkenca, tek e cila mungon një paradigmë qendrore; shkenca normale, në të cilën shkencëtarët përpiqen të zgjerojnë paradigmën qendrore duke zgjidhur enigmat, dhe kur në këtë periudhë fillojnë të dalin rezultate të parregullta, që nuk përputhen me paradigmën, atëhere shkenca hyn në krizë dhe pranohet një paradigmë e re, revolucionare[8].

Mbi këtë bazë ai dallon fazën parashkencore, kur për prejardhjen e shqiptarëve ekzistonin teza të ndryshme të pambështetura shkencërisht, dhe fazën shkencore, e cila shënon momentin e kthesës me J. Thunmann-in 1774, i cili qe i pari që shqyrtoi dhe interpretoi burimet historike të disponueshme dhe përfundoi se në historinë e shqiptarëve ai nuk shihte asnjë gjurmë emigrimi të vonë, ndërsa gjuha e tyre jep dëshmi se ata janë fqinjët e stërlashtë të grekëve dhe nënshtetasit e Romës së lashtë: të dyja këto fakte flasin për ilirët e lashtë. Faza parashkencore shuhet vetëm pas botimit të librit të Xylander-it "Gjuha e Shqiptarëve" (Xylander 1835), ku autori, ndonëse jo me formim indoeuropianistik, me mprehtësi të madhe dhe intuitë gjuhësore vuri re afërsitë e shqipes me gjuhë të tjera indoeuropiane, duke shënuar një hop të ndjeshëm përpara në albanologji. Studiuesi vlerëson më tej si të një rëndësie vendimtare për albanologjinë në rritje, veprën e Hahn-it, "Studime shqiptare" (Hahn 1854), për të cilën citon vlerësimin e lartë të historianit Jakob Philipp Fallmerayer sidomos për faktin se Hahn-i ishte i pari europian i shkolluar që udhëtoi në gjithë Shqipërinë dhe hulumtoi edhe skajet më të thella të saj, zakonet, mentalitetin, psikologjinë, mënyrën e jetesës, gjuhën e folur shqipe me dy dialektet e saj (Ölberg 1982a, 141–142). Në shumë pikëpamje mendimet dhe përfundimet e tij mbeten të qëndrueshme edhe në kohën e sotme.

Studimi i Franz Bopp-it "Mbi gjuhën shqipe në marrëdhëniet e saj të afërisë" (Bopp 1855), i cili trajtoi gjerësisht morfologjinë e shqipes në mënyrë krahasuese me gjuhët e tjera indoeuropiane, vërtetoi përfundimisht përkatësinë e shqipes në trungun gjuhësor indoeuropian dhe njëkohësisht i dha fund hipotezës pellazge dhe tezave të tjera parashkencore. Megjithatë në këtë periudhë, që nga Xylander-i, Bopp-i, Stier-i, Schuchardt-i, Camarda, Hahn-i etj. deri në vitin 1883, albanologjia nuk përbënte një kërkim shkencor që formonte vijimësi; këta studiues kishin punuar pavarësisht nga njëri-tjetri dhe në mënyrë jo sistematike, disa prej tyre nuk ishin specialistë të gjuhësisë indoeuropiane, prandaj autori, në bazë të karakteristikave që paraqet kjo fazë sipas konceptit të studiuesit të sociologjisë së shkencave Mullins, (Nicholas Mullins, në Minerva X, 1, 1972), e përfshin atë në grupin paradigmatik A që është stadi fillestar i formimit të një grupi shkencor. Me daljen në skenën albanologjike të Gustav Meyer-it si indoeuropianist i mirëfilltë në vitin 1883 me "Studimet shqiptare" (Meyer 1883–1897)

8 https://en.wikipedia.org/wiki/Thomas_Kuhn

dhe me Fjalorin e tij etimologjik të shqipes (Meyer 1891), situata ndryshoi dhe studimet për shqipen hynë në stadin B të normalitetit (stadi normal i studimit sipas Mullins), me vendosjen e "rrjetit të komunikimit" mes studiuesve të fushës dhe zhvillimin e studimeve tashmë nga personalitete të formuara në indoeuropianistikë. Kjo fazë e studimeve albanologjike e përcaktuar në mënyrë shkencore përkon edhe me pohimin e Çabejt, të shprehur në mënyrë intuitive, që "Gustav Meyer-i, [...] në shumë pikëpamje duhet konsideruar si themeluesi i mirëfilltë i studimeve gjuhësore shqiptare" (Çabej 1971–1973, 366; Ölberg 1982a, 136), nga i cili autori u nis për të hulumtuar dhe vërtetuar me të dhëna empirike për albanologjinë teorinë e zhvillimit të specialiteteve shkencore. Në vijim të linjës së tij të arsyetimit, Ölberg-u përfshin në stadin C të grupit shkencor (cluster) fazën mbas luftës II Botërore, me organizimin më të fuqizuar të kërkimit shkencor në Shqipëri, me themelimin e një instituti studimor dhe bashkangjitjen e tij Akademisë së Shkencave të sapothemeluar, dhe me krijimin e një instituti të tillë albanologjik edhe në Prishtinë.

Në fushën e fonologjisë indoeuropiane të shqipes, një kontribut i rëndësishëm është studimi "Kontakti gjuhësor dhe kronologjia e fonemave" (Ölberg 1987). Në këtë punim zbatohen parimet e gjuhësisë diakronike bashkëkohore, e cila tashmë ka bërë hapa përpara në krahasim me periudhën e Gramatikanëve të Rinj, veçanërisht në aspektin e studimit të fazave të ndërmjetme të një zhvillimi fonetik të caktuar. Ai parashtron që në fillim parimet metodike që e kanë udhëhequr në studimin diakronik të shqipes: "Rindërtimi i zhvillimit fonetik të një gjuhe me traditë jo të hershme shkrimore, duhet të kryhet para së gjithash duke përcaktuar kronologjinë e brendshme dhe duke vëzhguar zëvendësimin e tingujve gjatë huazimit të fjalëve të huaja." (Ölberg 1987, 135). Për gjurmimin e sistemit fonetik të shqipes së vjetër na ndihmojnë sidomos huazimet latine e sllave, kontaktet gjuhësore shqiptaro-rumune dhe huazimet greke të vjetra, mirëpo përpara kësaj kohe e deri në protogjuhën indoeuropiane ka një periudhë të errët që vështirë të ndriçohet. Ai vëren se, megjithëkëtë, në rindërtimet protoindoeuropiane nuk duhet të krijohet përshtypja sikur zhvillimi ka qenë i njëtrajtshëm, por duhen bërë përpjekje për të zbuluar shkallët e ndërmjetme të evolucionit. Për shembull, sipas G. Meyer-it (1892), I. E. *ḱ* ka dhënë shq. *s* (sot konsiderohet e gabuar), por zhvillimi fonetik ka kaluar nëpër disa faza, të cilat së pari i ka vënë në dukje Pedersen-i në veprën e tij themelore "Guturalet e shqipes" (Die gutturale im Albanesischen, 1900), dhe i ka saktësuar më vonë Jokl-i. Autori në artikullin e tij rimerr çështjen e rindërtimit të kronologjisë së brendshme dhe relative të zhvillimit fonetik të sibilanteve dhe afrikateve të shqipes, duke e saktësuar më tej në bazë të etimologjive të Çabejt, të botuara në përmbledhjet e Prishtinës (Çabej1976–1977).

Këtë premisë metodike Ölberg-u e ka ndjekur e zbatuar që më herët në punimin e tij të habilitimit, botuar vetëm në vitin 2013 (Ölberg 2013), të cilin botuesi i tij prof. Bardhyl Demiraj e introdukton kështu: " [...] Është pikërisht zbatimi i kësaj premise që e integron natyrshëm veprën në vargun e veprave dhe në gjithë pasurinë e studimeve shqiptare që kanë dalë deri tani në hapësirën kulturore gjermanofolëse, ku mori formë dhe u shpalos debati shkencor albanologjik dhe luan rolin e pionierit edhe sot. Prandaj nuk mund të jetë rastësi që në këtë vepër shqipja konsiderohet në zhvillimin e saj në

hapësirë dhe në kohë si gjuhë indoeuropiane, ashtu edhe si gjuhë ballkanike, pa vënë në pikëpyetje pavarësinë e saj si gjuhë e gjallë bashkëkohore, e cila shfaqet në një formë të njësuar, por edhe në varietete, në varësi të peizazhit përkatës gjuhësor apo mjedisit shoqëror ku jetojnë folësit e saj. Kështu mund të përmblidhen shkurtimisht objekti, synimet dhe perspektivat e këtij studimi, me të cilin autori i tij, Profesor Dr. Hermann Ölberg, kreu habilitimin në vitin 1972 në Universitetin e Innsbruck-ut. Megjithëse disa nga çështjet e trajtuara në këtë punim janë rimarrë në studime të mëvonshme të autorit, kjo monografi nuk ishte botuar asnjëherë më parë si e tillë. Prandaj duhet shpresuar, se ky botim do të mbushë një zbrazëti të ndjeshme në studimet albanologjike dhe në ato të gjuhësisë historike-krahasuese."

Botimi i këtij punimi u vlerësua në një recension nga indoeuropianisti dhe albanologu austriak Joachim Matzinger, në të njëjtin vit të daljes së tij (Matzinger 2013). Autori paraqet kapitujt e punimit dhe shkurtimisht përmbajtjen e tyre: 1. Kronologjia e historisë së gjuhës shqipe; 2. Hundorësia dhe humbja e hundorësisë. Situata e gegërishtes dhe e toskërishtes; 3. Zanoret e shkurtra të indoeuropianishtes; 4. Zanoret e gjata të indoeuropianishtes; 5. Diftongjet indoeuropiane; 7. Miscellanea ose konkluzionet, duke shënuar dhe vërejtjet përkatëse nga këndvështrimi i sotëm i albanologjisë. Meriton të vihet në dukje sidomos përshkrimi i kreut 2. për hundorësinë dhe mungesën e hundorësisë në një nga kryedialektet e shqipes, i cili kishte dalë në dritë si artikull më vete i përpunuar për shtyp që në vitin 1973 (Ölberg 1973), si "trajtimi më gjithëpërfshirës deri tani i hundorësisë së gegërishtes, një dukuri komplekse, e cila në të folmet e sotme të gegërishtes mund të hulumtohet fare mirë në format e shfaqjes së saj (hundorësia sekondare dhe çhundorëzimi sekondar), ndërsa faza më e vjetër e saj është e vështirë për t'u kuptuar. Por duhet thënë se gegërishtja e vjetër si dhe dialekte të sotme konservative të gegërishte e kanë një hundorësi kuptimdalluese, edhe pse monumentet e vjetra gege nuk e shënojnë [...]" (Matzinger 2013, 283). Recensioni i Matzinger-it 41 vjet pas përpilimit të punimit ka vlera të veçanta pasi vë në dukje përditësimet e përparimet që janë bërë ndërkohë në studimin historik të shqipes, si në periodizimin e saj, në rindërtimin diakronik indoeuropian të shqipes, në historinë e gjuhës shqipe e në përpunimin filologjik të teksteve të vjetra shqipe, në bazë të studimeve të albanologëve bashkëkohorë.

Hermann Ölberg-u si dashamirës i gjuhës shqipe dhe i shqiptarëve u interesua edhe për një çështje madhore të kombit shqiptar, siç është gjuha e njësuar letrare. Në vitin 1993, mbas kthesës demokratike të vendit, kur u ngritën zëra për rivlerësimin e rolit të gegërishtes së shkruar, ai shkroi një artikull si përgjigje ndaj Deklaratës së gjuhëtarëve të Shkodrës të vitit 1992, në të cilën shihej me sy kritik vendosja e gjuhës së njësuar letrare mbi bazën e dialektit toskë dhe Kongresi i Drejtshkrimit i vitit 1972 që sanksiononte këtë gjuhë standarde dhe kërkohej njohja dhe përdorimi i gegërishtes letrare si dhe rishikimi i gjuhës standarde për ta bërë më të pranueshme për të gjithë. Në artikullin e tij, botuar në antologjinë "Quo vadis Shqipëri?", përgatitur nga ish-studenti i tij, dr. Ardian Klosi (Klosi 1993), Ölberg-u e pranon dhe e quan të realizueshme idenë që tradita e gegërishtes letrare të njihet dhe gegërishtja të lëvrohet në letërsi. Nga ana tjetër ai përqendrohet në kërkesën për rishikimin e standardit si gjuha zyrtare e

administratës, e shkollës, shtypit, radios etj. për ta bërë më të pranueshëm, një kërkesë e cila i duket e paqartë, pasi në fund të fundit çështja përmblidhet në pyetjen nëse do vazhdojë të jetë toskërishtja baza e standardit apo do të rishikohet dhe do ta zërë këtë vend gegërishtja. Një bashkëjetesë të të dy varianteve standarde në një shtet modern ai e sheh të pamundur, ndërsa standardi tashmë sipas tij ka zënë vend në mendjet e shqiptarëve dhe është pranuar si normë. Për situatën gjuhësore gjuhë amtare/bisedore – gjuhë letrare, ai sjell rastin e Austrisë, ku bavarishtja, gjuha e Monarkisë Austriake, që pritej të bëhej gjuhë letrare e Austrisë, në të vërtetë mbeti jashtë standardit dhe përdoret si gjuhë e folur amtare, ndërsa gjuhë letrare u bë gjermanishtja e Luterit (Lafe 2022). Duke qenë i formuar si gjuhëtar i mirëfilltë që e njeh gjuhën në funksionet, përdorimet dhe historinë e saj, kërkesa normativizuese për "rishikim" të standardit atij i duket e paqartë pasi as nuk e mendon që ajo të ketë në bazë idenë e përzierjes dialektore si eksperiment "tavoline", siç është kërkuar shpeshherë tek ne në raste konferencash apo forume gjuhëtarësh.

Me këtë artikull, të cilin e kishte shkruar në shqipe të pastër, Ölberg-u dëshmonte jo vetëm njohjen e tij të thellë të gjuhës shqipe, por edhe të zhvillimeve politike e shoqërore të Shqipërisë, të cilat i kishte ndjekur nga afër gjatë tri dekadave përmes leximit të rregullt të shtypit shqiptar.

Ai ndiqte me interes dhe i njihte mirë edhe rrethanat shoqërore-politike në Kosovë dhe përkrahte të drejtat e kosovarëve për liri, siç dëshmohet nga një letër drejtuar autorit të librit "Azem Bejtë Galica" në vitin 1996 (Mehmeti 2024).

Në vitin 2005 prof. H. Ölberg-ut iu dha titulli "Doctor honoris causa" nga Universiteti i Tiranës për kontributin e tij të vyer në ndriçimin e problemeve themelore të historisë së gjuhës shqipe, të burimit të saj e të marrëdhënieve me gjuhët e tjera. Në dëshminë zyrtare të këtij titulli prof. Hermann Ölberg-u vlerësohet si një indoeuropianist dhe albanolog i shquar, vijues i traditës së madhe austriake në fushën e albanologjisë, organizues i veprimtarive të rëndësishme për albanologjinë, dhe vihet në dukje pritja dhe mbështetja bujare e tij për studiuesit e rinj nga Shqipëria, që kryenin kualifikimin pasuniversitar në Universitetin "Leopold Franzes" të Innsbrukut, ndër të cilët Ardian Klosi, Kristaq Jorgo, Petrit Kotrri (Lafe 2022, 157).

Prof. Hermann Ölberg-u pati një jetë të gjatë e të mbushur me veprimtari shkencore e mësimdhënëse, ndër të cilat ndoshta vendin më të rëndësishëm e zinte albanologjia me studimet diakronike për gjuhën shqipe dhe seminari albanologjik që themeloi dhe drejtoi për 20 vjet në Universitetin e Innsbruck-ut. Ai vdiq në vitin 2017 në moshën 95-vjeçare, mbasi përjetoi edhe kënaqësinë e botimit të monografisë së tij të habilitimit, nga një koleg dhe mik më i ri albanolog shqiptar, prof. B. Demiraj, që i bëri një nder të merituar në emër të shqiptarëve profesorit të shquar. Me rastin e largimit të tij nga jeta, shteti shqiptar, nëpërmjet Ambasadës së tij në Austri, dha këtë njoftim në faqen e saj, të cilin po e riprodhojmë në vend të mbylljes së këtij profili biobibliografik të prof. Hermann M. Ölberg-ut:

"Më datën 27 shkurt 2017 është ndarë nga jeta në moshën 94-vjecare indoeuropianisti dhe albanologu i shquar, Prof. Dr.Hermann Ölberg. Profesor Ölberg ka dhënë një kontribut të çmuar në fushën e studimeve albanologjike. Punimet e tij hapën një epokë

të re në sqarimin e problemeve themelore të historisë së gjuhës shqipe. Profesor Ölberg vazhdoi më tej traditën e shkollës austro-gjermane në fushën e albanologjisë, duke e çuar më përpara e duke e thelluar më shumë dijen shkencore për gjuhën shqipe dhe historinë e saj dhe raportet e saj me gjuhët e tjera ballkanike. Që nga viti 1972 ai drejtoi për rreth 20 vite degën e albanologjisë, duke e rritur cilesinë e studimit dhe mësimdhënies së gjuhës shqipe në Universitetin e Innsbruck-ut. Falë punës së palodhshme të Profesor Ölberg-ut, Universiteti i Innsbrukut u bë një nga qendrat më të rëndësishme të albanologjisë në Europë. Ai ka organizuar veprimtari të rëndësishme ndërkombëtare për Albanologjinë dhe ka mbështetur bujarisht kualifikimet pasuniversitare të studentëve dhe të shkencëtarëve të rinj shqiptarë në Universitetin e Leopold-Franzens të Innsbruck-ut. Janë të shumtë artikujt, punimet e botimet shkencore për gjuhën dhe kulturën shqiptare të Profesor Ölberg-ut. Në vlerësim të kontributit të tij Universiteti i Tiranës i dha Profesor Hermann Ölberg-ut në vitin 2005 titullin e nderit "Doctor honoris causa ". Me vdekjen e Profesor Hermann Ölberg gjuha shqipe dhe kultura jonë kombëtare humbën një albanolog të shquar dhe populli shqiptar një mik të çmuar. Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Vjenë i shpreh ngushëllimet e saj më të thella familjes së Profesorit Ölberg dhe kolegëve e bashkëpunëtorëve të tij. I paharruar qoftë kujtimi i Profesor Ölberg-ut dhe mirënjohje e përjetshme veprës së tij!"[9]

Bibliografia

Bopp, Franz. (1855). *Über das Albanesische in seiner verwandtschaftlichen Beziehungen*. Berlin.

Canaj, Kimete. (2018). "Roli i profesorit austriak Hermann M. Ölberg në studimin dhe promovimin e gjuhës dhe të kulturës shqipe". Në: *Studimet albanistike në vendet ku flitet gjermanisht,*. Prishtinë: ASHAK.

Çabej, Eqrem. (1971–1973). "Albanische Beiträge zur Kenntnis der lateinischen Wortschatzes". Në: *Bollettino dell'Atlante linguistico mediterraneo*, 13–15, f. 365–377.

Çabej, Eqrem. (1976–77). *Studime Gjuhësore I-II*. Prishtinë: Rilindja.

Hahn, J. Georg von. (1854). *Albanesische Studien*. Jena.

https://de.wikipedia.org/wiki/Hermann_%C3%96lberg

Klosi, Ardian (ed.). (1993). *Quo vadis, Shqipëri?* Antologji e përgatitur nga Ardian Klosi. München: Botime Albania,.

Kuhn, Thomas. (1978). *Die Struktur wissenschaftlicher Revolutionen,* bot. 3. gjerm., Frankfurt. https://en.wikipedia.org/wiki/Thomas_Kuhn

Lafe, Emil. (2022). "Hermann Ölberg – albanolog i shquar dhe mik i shqiptarëve". Në: *Gjurmime Albanologjike – Seria e shkencave filologjike*, nr. 52, f. 153–158, online në ht tps://gazetadita.al/hermann-olberg-albanolog-i-shquar-dhe-mik-i-perzemert-i-popu llit-shqiptar/

9 Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Austri, Ndahet nga jeta albanologu i shquar Prof.Dr. Hermann Ölberg. https://arkiva.ambasadat.gov.al/austria/sq/article/ndahet_nga_jeta_albanologu_i_shquar_profdr_hermann_%C3%B6lberg

Matzinger, Joachim. (2013). "Hermann M. Ölberg: *Untersuchungen zum indogermanischen Wortschatz des Albanischen und zur diachronen Phonologie aufgrund des Vokalsystems*. Herausgegeben von Bardhyl Demiraj (= Albanische Forschungen 35). Wiesbaden: Harrassowitz 2013. 180 S. ISBN 978-3-447-06959-5". *Zeitschrift für Balkanologie* 49, nr. 2, f. 281–285.

Mehmeti, Hazir. (2024). "Albanologu austriak Hermann M. Ölberg, mik i madh i shqiptarëve", Gazeta Dielli, 3 shkurt 2024, online në https://gazetadielli.com/albanologu-austriak-hermann-m-olberg-mik-i-madh-i-shqiptareve/

Meyer, Gustav. (1883–1897). *Albanesische Studien I. Die Pluralbindung der albanesischen Nomina*, Wien; *Albanesische Studien II. Die albanesischen Zahlwörter*, Wien, 1884; *Albanesische Studien III. Lautlehre der indogermanischen Bestandteile des Albanesischen*. Wien, 1892; *Albanesische Studien IV. Das griechisch-südrumänisch-albanesische Wörterverzeichnis des Kavalliotis,* Wien, 1895; *Albanesische Studien V. Beiträge zur Kenntnis der in Griechenland gesprochenen albanesischen Mundarten*, Wien, 1896; *Albanesische Studien VI. Beiträge zur Kenntnis verschiedener albanesischen Mundarten*, Wien, 1897.

Meyer, Gustav. (1891). Etymologisches Wörterbuch der albanesischen Sprache. Strassburg: K. J. Trübner.

Ölberg, Hermann. (1967). "Albanica I. Zum r/l Wechsel". *Innsbrucker Beiträge zur Indogermanistik und Keltologie: Julius Pokorny zum 80. Geburtstag gewidmet*. Innsbruck, f. 57–71.

Ölberg, Hermann. (1968). "Indogermanisches *k* vor *u* im Albanischen". Në: *Studien zur Sprachwissenschaft und Kulturkunde. Gedenkschrift für W. Brandenstein*. Innsbruck, f. 109–118.

Ölberg, Hermann. (1971). "Fragen der albanischen Sprachgeschichte. Grundsätzliches zur Nasalierung". Në: *Dissertationes Albanicae*. München, f. 176–206.

Ölberg, Hermann. (1972a). "Uberlegungen zur Laryngaltheorie: An Hand des Albanischen". Në: *Zeitschrift für vergleichende Sprachforschung*, nr. 1. Göttingen, f. 121–136.

Ölberg, Hermann. (1972b). "Griechisch-albanische Sprachbeziehungen". Në: *Serta Philologica Aenipontana II*. Innsbruck, f. 33–64.

Ölberg, Hermann. (1973). "Fragen der albanischen Sprachgeschichte. Grundsätzliches zur Nasalisierung". Në: *Dissertationes Albanicae in honorem Josephi Valentini et Ernesti Koliqi septuagenariorum*. München, 176–206.

Ölberg, Hermann. (1977). "Einige Überlegungen zur Autochtonie der Albaner auf der Balkanhalbinsel". Në: Ölberg, Hermann M. (ed.). *Akten der internationalen albanologischen Kolloquiums, Innsbruck, 1972, zum Gedächtnis an Norbert Jokl*. Innsbruck: Institut für Sprachwissenschaft der Universität Innsbruck, f. 625–629.

Ölberg, Hermann. (1982a). "Die Entwicklung eines Paradigmas. Zur Entstehung der Albanologie". Në: W. Meid, H. Ölberg, H. Schmeja (eds.), *Sprachwissenschaft in Innsbruck*. Arbeiten von Mitgliedern und Freunden des Instituts für Sprachwissenschaft der Universität Innsbruck aus Anlass des fünfzigjährigen Bestehens des Instituts im Jahre 1978 und zum Gedenken an die 25. Wiederkehr des Todestages von Hermann Ammann am 12. September 1981. Innsbruck, f. 147.

Ölberg, Hermann. (1982b). "Kontributi i gjuhësisë për çështjen e atdheut ballkanik të shqiptarëve". *Studime Filologjike*, nr. 3, f. 35–40.

Ölberg, Hermann. (1987). "Sprachlicher Kontakt und Lautchronologie". Në: *Dona Slavica Aenipontana* in honorem Herbert Schelesniker. München: R. Trofenik, f. 135–145.

Ölberg, Hermann. (2013). *Untersuchungen zum indogermanischen Wortschatz des Albanischen und zur diachronen Phonologie aufgrund des Vokalsystems*, Herausgegeben von Bardhyl Demiraj (= Albanische Forschungen 35). Wiesbaden: Harrassowitz Verlag.

Omari, Anila. (2024). "Letërkëmbimi i Hermann Ölberg-ut me Çabejn, një model bashkëpunimi miqësor dhe kontributi të frytshëm në albanologji". Në: *Prof. E. Çabej përmes letërkëmbimit me kolegë të gjuhës gjermane*, punime të konferencës shkencore, UT, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Tiranë, 91–99.

Vorlesungsverzeichnis 1963–1964, Universität Innsbruck, Universitäts- und Landesbibliothek Tirol, f. 112: https://diglib.uibk.ac.at/download/pdf/3318742.pdf

Xylander, J. Ritter von. (1835). *Die Sprache der Albanesen oder Schkipetaren*. Frankfurt am Main.

Bibliografi e punimeve kryesore të Hermann Ölberg:

1. Illyrisch, Alteuropäisch, Breonisch. in: Wolfgang Meid, Hermann M. Ölberg, Hans Schmeja (Hrsg.): Studien zur Namenkunde und Sprachgeographie. Festschrift für Karl Finsterwalder zum 70. Geburtstag [= Innsbrucker Beiträge zur Kulturwissenschaft 16]. Innsbruck 1971, S. 47–59.
2. Akten des Internationalen Albanologischen Kolloquiums zum Gedächtnis an Univ.-Prof. Dr. Norbert Jokl: Innsbruck, 28.9.–3.10.1972.
3. mit Kunigunde Müller: Grundlagen der Sprachschallanalyse (Sonagraphie). Innsbruck 1976.
4. Zur Grundlegung der Interlinguistik. in: Plansprachen. Darmstadt 1976, S. 243–254.
5. Die Weltsprachenfrage im wissenschaftlichen Werk Hugo Schuchardts. Sonderdruck aus: Sitzungsbericht der philosophisch-historischen Klasse. Österreichische Akademie der Wissenschaften, Wien 1978.
6. Interlinguistik – Teil der Linguistik? in: Terminologie als angewandte Sprachwissenschaft. München 1979, S. 239–246.
7. mit Wolfgang Meid, Hans Schmeja (Hrsg.): Sprachwissenschaft in Innsbruck. Arbeiten von Mitgliedern und Freunden des Instituts für Sprachwissenschaft der Universität Innsbruck aus Anlass des fünfzigjährigen Bestehens des Instituts im Jahre 1978 und zum Gedenken an die 25. Wiederkehr des Todestages von Hermann Ammann am 12. September 1981. Innsbruck 1982.
8. Universität Innsbruck. Institut für Sprachwissenschaft: Dokumente zur Geschichte der indogermanischen und allgemeinen Sprachwissenschaft sowie der altindischen Geschichte (Philologie) und Altertumskunde an der Universität Innsbruck von den Anfängen (1861) bis 1945. Innsbruck 1984.
9. La lektorato Esperanto je la universitato de Innsbruck. Innsbruck 1986.

10. Untersuchungen zum indogermanischen Wortschatz des Albanischen und zur diachronen Phonologie aufgrund des Vokalsystems (= Albanische Forschungen Nr. 35). Harrassowitz 2013, ISBN 3–447069597.
11. Aufsätze zur Interlinguistik und Esperantologie. Edition Iltis, Bad Bellingen 2015,

Vëllim kushtues për nder të Hermann Ölberg me rastin e 65- vjetorit të lindjes:

Hanspeter Ortner, Barbara Stefan, Manfred Kienpointner, Hans Schmeja (Hrsg.): Sprache, Sprachen, Sprechen: Festschrift für Hermann M. Ölberg zum 65. Geburtstag am 14. Oktober 1987 (= Innsbrucker Beiträge zur Kulturwissenschaft. Germanistische Reihe). Innsbruck 1987.

Letërkëmbimi i Ölberg-ut me Çabejn në shqip

6 dhjetor 1964 Innsbruck

Instituti për Gjuhësi të Krahasuar
Universiteti Innsbruck

Zotit
Prof. Dr. Eqrem Çabej
Tiranë

I nderuar Profesor,

rrallëherë marr letra që më gëzojnë aq shumë sa e juaja dhe për këtë ju falënderoj në mënyrë të veçantë dhe për fjalët tuaja të datës 9 nëntor.

Jo më pak më ka lënë përshtypje bibliografia juaj madhështore, në të cilën jam thelluar krejtësisht; një pjesë të saj për fat të mirë e kam marrë, pjesën tjetër shpresoj ta marr përmes Vjenës për ta fotokopjuar këtu, dhe ndoshta buletini do të arrijë pjesërisht edhe nga biblioteka juaj.

Në fakt, nga biblioteka është fotokopjuar puna juaj mbi fjalët e huaja latine. Me këtë punim po merrem tashmë prej shumë orësh, është aq gjithëpërfshirës sa që më duhet ta lexoj fjali për fjali. Do të kthehem patjetër te kjo temë. Lokalizimi i vendbanimeve romake të lashta më duket bindës, për aq sa kam të drejtë të shpreh një mendim. Mbi të gjitha, do të ishte me rëndësi të gjendej një përpunim përmbledhës i toponomastikës. A është ndërmarrë një gjë e tillë në Institutin tuaj?

Do të ishte interesante edhe mënyra e formimit të emrave të lumenjve shqiptarë, ajo mënyrë e vërtetë e formimit. A ekzistojnë të tillë dhe a mund të përcaktohet ndonjë hapësirë gjeografike përkatëse?

Çështja iliro-shqiptare duket se duhet të mbetet e hapur. Argumentimi juaj është pa dyshim më i drejtpërdrejti dhe më i thjeshti, dhe e gjithë kjo çështje do të mbetet pezull derisa të zbulohet ndonjë pikë referimi kronologjike për zhvillimin *kentum* apo *satem* të shqipes.

Përfaqësimet e ndryshme në shqipe më janë të pashpjegueshme, më së shumti duket se kemi të bëjmë me shtresa kronologjike. Përfaqësimet fillestare *satem* në gjuhët indoeuropiane janë në thelb spontane dhe të pavarura nga tingujt pasues, gjë që për mua është një kundërshtim vendimtar ndaj krahasimit me zhvillimet përkatëse në gjuhët romane nga latinishtja, që varen nga zanoret pasuese.

Veçanërisht mirënjohës jam për premtimin tuaj se do të më dërgoni, herë pas here, ndonjë botim të marrë nga punimet tuaja të ardhshme. Kjo është me vlerë të dyfishtë për ne këtu, për shkak të izolimit tonë. Por do të isha mirënjohës edhe vetëm për njoftimin se ku dhe kur është botuar ndonjë punim i ri, publikimin ndoshta mund ta gjejmë diku.

Në përgjithësi, ka kaluar kohë e gjatë që nuk ka dalë ndonjë punim i juaj në "*Indogermanische Forschungen*". A nuk është për të ardhur keq kjo?!

Tani që shefi im, prof. Schmid, po e redakton këtë revistë bashkë me Krahe, nuk do të ishte shumë e vështirë të realizohej botimi i ndonjë kontributit tuaj pa shumë vonesa.

Jam i habitur që ka kaq pak nga botimet tuaja të paraqitura në "*Bibliographie linguistique*". A nuk mund të gjendet ndonjë zgjidhje për këtë?

Përveç *Studime rreth etimologjisë* që për momentin nuk i kam, u gëzova shumë kur pashë *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe*, më në fund gjeta atë që kërkoja prej kohësh. A po del kjo vepër në formë fletësh të ndara (dispenca) si botim i veçantë dhe a është në shitje në librari? Punën e ngjashme të Barić-it ende nuk e kam marrë dhe, sipas mendimit të docentit Solta, nuk qenka ndonjë vepër e veçantë.

A janë bërë ndonjëherë studime më të thelluara mbi *Cuneus* të Bogdanit? Fjalorë, komente, analiza gjuhësore? Kam kërkuar një kopje të vjetër nga Biblioteka Kombëtare e Vjenës për ta fotokopjuar këtu, kopja doli e shkëlqyer, si e re, ndërsa origjinali ishte shumë i dëmtuar. Do të kisha dashur të thellohesha në të dhe do të isha mirënjohës për ndonjë udhëzim. A trajtohet tek ju në program edhe diçka si "shqipja e vjetër"? A do të mund të merrja një herë një plan mësimor apo një orar leksionesh?

Për vitin e ardhshëm kam shënuar në agjendë Kongresin në Marburg, shpresoj që do të delegoheni si përfaqësues i Shqipërisë atje dhe nuk kam dëshirë më të madhe sesa të takohemi atje. Po mbaj të kryqëzuara të dy gishtat!

Pas pak kohe do të mbërrijë prej meje një urim i vogël për Krishtlindje, shpresoj që do t'ju sjellë gëzim. Kjo është dëshira ime.

Ndërkohë, mbetem me shpresën që do të gjeni ndonjëherë ndonjë çast për mua,

Me nderimet më të përzemërta, i juaji shumë i përkushtuar

Ölberg

NB.: Nëse ndonjë artikull që ju nevojitet, nuk do ta gjeni, më shkruani, ju lutem. Ndoshta mund t´jua fotokopjoj disa prej tyre.

Innsbruck, më 10–01. 1964

Hermann Ölberg Innsbruck

Për zotin
Prof. dr. Eqrem Çabej
Rruga B. Curri, shk. 7, ap. 15
Tiranë

I nderuar Profesor,

me rastin e ndërrimit të viteve dëshiroj t'ju shpreh, i nderuar Profesor, urimet e mia të përzemërta për këtë vit që sapo ka filluar, me shpresën që t'ju sjellë shumë gjëra të bukura dhe të gëzueshme!

Prej kohësh kam dashur t'ju shkruaj dhe t'ju falenderoj për takimin e këndshëm në Amsterdam gjatë kongresit. Shpresoj që të keni pasur një udhëtim të mbarë dhe një kthim të mirë në shtëpi. Pikërisht, gjatë ditëve të qëndrimit tuaj në Vjenë, docent Solta ndodhej në Innsbruck dhe kur i tregova për ju, u mërzit shumë, gjë që është e kuptueshme, pasi nuk ju kishte njohur më parë!

A patët një qëndrim të këndshëm dhe sukses në kërkimet tuaja për trashëgiminë e Joklit? Sipas asaj që më tha Solta, ajo ndodhet në Bibliotekën Kombëtare. Do të kisha interes të madh, të dija më shumë për këtë çështje.

Shpesh mendoj: A bëtë fotografi të bukura? A ju janë dërguar filma të rinj për aparatin fotografik? Do të më jepte kënaqësi nëse do të mund t´ju ndihmoja në ndonjë mënyrë tjetër.

Kam kërkuar pak në revista shkencore, veçanërisht për punimet tuaja dhe me kënaqësi kam parë që ekziston një sasi e konsiderueshme e tyre. Fatkeqësisht, punimet më të reja që janë botuar në revista të vendeve lindore (Rumani etj.), nuk ndodhen këtu dhe do t´ju isha shumë mirënjohës, nëse do të mund të më dërgonit disa kopje të veçanta. Edhe artikullin "De quelques problèmes fondamentaux de l'histoire ancienne de l'albanais", të cilin falë prof. Knobloch e pashë shkurt.

E di që ju mbroni tezën e autoktonisë së shqiptarëve, dhe pikërisht për këtë arsye kjo punë më është dukur veçanërisht me vlerë. Gjithashtu Popović është shprehur kundër kësaj teze në "Zeitschrift für slawische Philologie", vëllimi 26, 1957, faqet 301 e më tej. Jam i sigurt se argumentet tuaja janë trajtuar edhe diku tjetër.

Për fjalën *truall* që ma përmendët, gjeta në IF 36, f. 137 një referencë për *terriola*, ose më saktë sipas Jokl-it *terra-ola*, pra një formë latine? Ju lutem më jepni disa detaje për këtë, për shkak të punës sime.

Jam lidhur me bibliotekën e universitetit tuaj dhe kam marrë një përgjigje shumë miqësore dhe pozitive. Paketa ime e parë duket se ka humbur, ndërsa paketa që jam njoftuar nga biblioteka, ende nuk ka mbërritur. Megjithatë, pas këtyre vështirësive fillestare,

shpresoj që të kemi një bashkëpunim të mirë. Paketën e parë nuk e kam dërguar rekomande, ndoshta kjo ka qenë një gabim.

Sot po dërgoj një letër tjetër. A keni marrë një kopje të thjeshtë të ndonjë punimi të botuar?

Ju lutem, përcillini përshëndetjet e mia më të përzemërta edhe kolegut tuaj që ishte me ju në Amsterdam.

Për sot, po e mbyll këtu dhe mbetem

Me shumë respekt, i juaji i përkushtuar!

H. Ölberg

Innsbruck, më 4.5.1964

Shumë i nderuar zoti Profesor,

me një gëzim të jashtëzakonshëm mora letrën tuaj të datës 22.03. dhe ju falenderoj shumë për të. Nga ajo mësova se jeni mirë dhe se i keni marrë letrat e mia.

Ju falenderoj gjithashtu për dy kopjet e veçanta të botimeve. Njërin e kemi tashmë këtu, pasi revista "Lingua Posnaniens" gjendet në bibliotekën tonë, por botimi tjetër rreth konferencës suaj është jashtëzakonisht i vlefshëm. Atë, dikur, e kisha parë shkurt, huajtur nga prof. Knobloch. Argumentimi juaj është i shpjeguar aq mirë, saqë është vështirë të mos pranohet përfundimi i tij. Prandaj më intereson shumë që të ndjek më në detaje botimet tuaja, gjë që është mjaft e vështirë këtu.

Nëse do të më lejohej të tregohem pak i pasjellshëm, do të isha shumë i lumtur nëse mund të më dërgonit edhe disa kopje të tjera të veçanta të botimeve tuaja, që këtu janë tërësisht të paarritshme, për shembull nga "Studi e cer. X" ose "Revue de linguistique VII".

Si fillim i shkëmbimit me Bibliotekën tuaj universitare, kam marrë numrat e *Buletinit* për vitet 1962 dhe 1963 dhe në përgjigjen time u jam lutur që të më dërgojnë veçanërisht numrat më të vjetër, të cilat përmbajnë artikujt tuaj. Deri tani nuk kam marrë asnjë përgjigje dhe as ndonjë dërgesë, por shpresoj që kërkesa ime të merret parasysh, nëse këta numra ende gjenden. Do t'ju isha shumë mirënjohës edhe për një bibliografi të plotë të shkrimeve tuaja, veçanërisht të botimeve pas Luftës, që t'i porosis nga Vjena dhe t'i fotokopjoj. Sepse çdo kërkim albanologjik duhet, në fund të fundit, të nisë nga puna juaj.

Prof. Kola më tha se ka porositur për mua revistën e re shqiptare. Natyrisht që dua t´ia kthej mirësinë në të njëjtën mënyrë.

Më gëzoi shumë lajmi që keni qenë për një kohë të gjatë në Vjenë me prof. Kostallarin. Me habi lexova se ai është Drejtor i Institutit dhe jam i bindur që keni gjetur ndonjë thesar nga trashëgimia e Jokl-it në Bibliotekën Kombëtare. A mund të presim diçka tjetër prej jush? A ju pëlqeu qëndrimi atje?

Më gëzon gjithashtu shumë që arritët të takoheni edhe me docentin Solta në Vjenë. Fatkeqësisht ai e refuzoi thirrjen për në Innsbruck, gjë që i ka sjellë dëme, siç shihet tani nga zgjedhja e pasardhësit për Vjenën. Ai me siguri ka menduar për këtë pas largimit të prof. Kronasser. Tani duket se edhe këtu është rregulluar çështja e pasardhësit, me shumë gjasë do të emërohet docent Schmid nga Tübingen (nxënës i Krahe-s dhe bashkë-redaktor i "Indogermanische Forschungen"). Kjo do të ishte një zgjedhje e mirë.

Do të gëzohesha shumë nëse do të mund të merrja nga ju një version në gjermanisht të "*Problèmes fondamentaux*". A mendoni se ky zhvillim i tipit të zanoreve është një dukuri e vonë e shqipes, në mënyrë që të mund të bashkohet me ilirishten kentum si një gjuhë *kentum*? A duhet domosdoshmërisht që gjuha shqipe, edhe nëse ka qenë prej kohësh në hapësirën ilire, të jetë patjetër një pasardhëse direkte e ilirishtes?

Kam ndërmend të shkoj në Kongresin e Fonetikës në Münster, a do të vini edhe ju? Do të më gëzonte shumë të takoheshim përsëri, me kushtin tjetër që të ndaloni patjetër në Innsbruck! Së fundi ju falënderoj edhe një herë shumë përzemërsisht dhe ndërkohë mbetem

me shumë respekt, i juaji i përkushtuar

H. Ölberg

Innsbruck, 12.12.1965

I nderuari zoti Profesor,

më lejoni t'ju falenderoj përzemërsisht për letrën tuaj, e cila më ka gëzuar pa masë.

Shpresoj të jeni mirë dhe se ju dhe familja juaj gëzoni shëndet të plotë.

Me mendje jam shpesh e shumë herë me ju dhe qindra herë kam dashur t'ju shkruaj, por shpesh gjithçka bëhet aq konfuze, saqë mezi arrin njeriu të marrë veten dhe të gjejë pak qetësi.

Edhe vera jonë ka qenë e keqe, si nga ana meteorologjike, familjare, ashtu edhe në universitet, i cili u rindërtua tërësisht, gjithçka ishte rrënojë. Me pak fjalë: një vit pa shumë suksese. Kështu që nuk pata as dëshirë të merrja pjesë në ndonjë kongres, edhe pse gjithmonë pyesja veten: A do të jeni vallë edhe ju atje?

Tani të tre fëmijët i ka zënë Lija e Dhenve, vajza e vogël e kaloi më rëndë dhe prej një muaji jemi të ngarkuar deri në maksimum. Kështu që po e mbyll këtë pjesë me shpresën që Krishtlindjet ose Viti i Ri do të jenë më mirë.

Një përshëndetje e vogël për ditët e ardhshme të paqes do të vijë veçan dhe shpresoj që do t'ju sjellë pak gëzim. Ndoshta një ditë do të mund të vini këtu.

Për vitin e ardhshëm do të doja shumë të shkoja në Sofje për Kongresin e Parë Ballkanik, dhe shpresoj shumë që edhe ju të merrni pjesë. Do të më interesonin shumë gjëra: A do të ishte e mundur të udhëtohej përmes Tiranës? Do të kisha dëshirë të shihja Universitetin, Institutin tuaj dhe nivelin e albanologjisë. Por kjo mbetet për tani vetëm një shpresë e heshtur.

Siç ndoshta e dini, prof. Schmid është kthyer prej kohësh në Göttingen dhe pas një pushimi të gjatë është emëruar këtu prof. Meid nga Würzburg-u. Ai është ndoshta i vetmi keltolog që ekziston në hapësirën gjermanishtfolëse, ndaj mendoj se nuk do të qëndrojë gjatë këtu, por shpresoj që të qëndrojë aq gjatë sa të mbarojë profesurën time.

Deri tani kam publikuar studimin më të madh për keltët në hapësirën tonë, i cili do të botohet në pranverë si pjesë e një botimi festiv për prof. Franz, historianin tonë të lashtësisë. Prof. Schmid është tani redaktor i vetëm i revistës "Indogermanische Forschungen" dhe do të gëzohej shumë po të publikonit përsëri në revistën e tij. Shpresoj që t'jua kem shkruar këtë më herët.

Në Gjermani ka tani disa të rinj në Albanologji, në Bonn dhe Mynih, shumë inkurajues.

Vetë do të doja të analizoja më në hollësi kronologjinë relative të ndryshimeve fonetike, pra të përshkruaja historikisht metodën pa kohë të shkollës së re gjuhësore.

A mund t'ju lutem të më tregoni nëse është kryer ndonjë studim i plotë i dialekteve shqipe në Greqi ose për dialektin e Salamisit? Kjo lidhet me punimin për profesurë të Haebler-it, i cili ka dalë së fundmi tek Harrassowitz.

Jam shumë i emocionuar për botimet tuaja të paralajmëruara dhe do t'ju isha mirënjohës nëse do të mund të më dërgonit ndonjë përmbledhje të botimeve tuaja për vitet 1964 dhe 1965, nëse kjo nuk është shumë e guximshme nga ana ime. Kjo do të më ndihmonte për plotësimin e listës që më keni dërguar dikur.

Nga biblioteka juaj universitare kemi marrë "Studime filologjike dhe historike", ndërsa "Studia Albanica" duket se nuk është më e disponueshme. Nuk e di nëse pjesët e mbetura do t'i marrim. Fatkeqësisht edhe Buletini është shumë i paplotë dhe z. Kolë Luka, me të cilin në përgjithësi kam një shkëmbim të mirë, është përpjekur shumë të më sigurojë disa numra.

Po ju jap më poshtë një listë të ekzemplarëve që kemi këtu dhe do t'ju lutesha të mendonit për ne nëse ndoshta keni mundësi të na siguroni ndonjë kopje:

- Studia Albanica mungon.
- Buletini 1962 komplet, 1963 mungon nr. 2 (pavarësisht kërkesave të përsëritura drejtuar bibliotekës suaj nuk është marrë); 1957, nr. 1 dhe 2. Nëse do të mund të gjeni ndonjë kopje të kësaj serie, sigurisht veçanërisht kontributet tuaja!

- Etnografia shqiptare nr. 2 (mungon nr. 1)
- Studime filologjike 18/1964 komplet, 19/1 – shpresoj të vazhdojnë të vijnë rregullisht.

Nëse mund të na dërgoni ndonjë nga këto, do t'ju isha shumë mirënjohës. Do të doja shumë t'ju dërgoja diçka në këmbim, për të treguar falenderimin tim me vepra. Nuk e di se si janë mundësitë tuaja për shkëmbime nga jashtë për ju apo për Institutin tuaj. Mund t´ju fotokopjoj me lehtësi edhe artikuj të veçantë nga revista të këtejshme.

Botimin festiv për Petrovici, që edhe ju më keni dërguar, me siguri nuk e keni në shumë kopje, ishte një sakrificë e madhe ta jepnit atë. Tani që edhe Instituti ynë e ka atë, falë Zotit edhe me kontributin tuaj, më lejoni, pa dashur t'ju fyej, t'ju propozoj që ta përdorni atë ekzemplar për ta shkëmbyer me ndonjë partner tjetër në Perëndim. Merreni ju vendimin. Nëse doni, unë do ta mbaj këtu dhe, me kërkesën tuaj, do ta dërgoj në adresën përkatëse. Mjafton që kontributi juaj të jetë në Innsbruck dhe kështu është. Shpresoj të më kuptoni drejt.

Dhe tani po e përfundoj dhe ju falenderoj edhe një herë për gjithçka që bëni për mua.

Juve dhe familjes suaj ju uroj Krishtlindje të bukura dhe gjithçka të mirë për Vitin e Ri 1966!

Mbi të gjitha, mirupafshim!

Me përshëndetje të përzemërta, i juaji me shumë respekt!

H. Ölberg

Innsbruck, 12.7.1966

Instituti për Gjuhësi Krahasuese pranë Universitetit të Innsbruck-ut

Zotit Prof. Dr. Eqrem Çabej

I nderuari Profesor,

sapo jam kthyer nga Kongresi për Toponimet në Londër dhe më vjen jashtëzakonisht keq që nuk pata mundësinë t'ju takoja atje. Në përgjithësi, më duket e pakuptueshme mungesa e një delegacioni zyrtar shqiptar në këtë ngjarje.

Kalova një javë shumë të bukur atje, që më dha përshtypjet e para mbi këtë qytet gjigand. Thesaret që ndodhen atje, janë aq të pamatshme, sa do të duhej të punoje me vite për t'i përfshirë. Vizitova edhe Institutin për Studime të Evropës Lindore, ku kishte një bibliotekë të vogël shqiptare (shumë modeste!). Duket se zoti Mann (të cilin fatkeqësisht nuk e takova) ka bibliotekën e tij personale. U përpoqa të siguroj edhe një kopje tjetër të përmbledhjes së përmbajtjeve (summaries) dhe, nëse e marr, do t´ua dërgoj menjëherë.

Tema e përgjithshme "Shtresëzimi kronologjik i emrave të vendeve" më duket se nuk u trajtua mjaftueshëm nga pikëpamja metodologjike, edhe pse pati studime të veçanta shumë të mira. Aktet e Kongresit të Amsterdamit u shpërndanë më në fund në mënyrë solemne, kështu që do të dalin së shpejti.

Faleminderit shumë për letrën tuaj të datës 03.04., të cilën fatkeqësisht po e konfirmoj kaq vonë, po ashtu edhe për punimin mbi marrëdhëniet gjuhësore rumuno-shqipe, që është veçanërisht i vlefshëm për mua pasi nuk e kemi atë revistë këtu. Shihet qartë se sa shpejt mund të nxirren përfundime kronologjike në bazë të fjalëve të huazuara.

Gjatë Kongresit dëgjova se Reichenkron ka ndërruar jetë para pak kohësh si pasojë e një aksidenti automobilistik në Berlin. Ai kishte për qëllim të botonte një Gramatikë Historike të Gjuhës Shqipe dhe një Fjalor Etimologjik te shtëpia botuese Winter në Heidelberg. Vallë a e dini nëse do të vazhdohet me këto projekte dhe si?

Në separatin tuaj ju përmendni në lidhje me çështjen e infinitivit Bogrea-n dhe Ilie Bacinschi-n. A mund të më tregoni se ku ka shkruar Bogrea për këtë temë dhe nëse është ende e mundur të gjendet punimi i Bacinschi-t?

Lidhur me fjalën *mal*, do të më interesonte nëse ajo ka marrë edhe kuptimin "fund", ashtu siç *caput vallis* do të thotë "fundi i luginës". Ne kemi gjithashtu *mal-úsinus* (Lisenstal) dhe *burg-úsinus* (Bergisel) me një prapashtesë krejtësisht joromane. A e keni hasur ndonjëherë këtë prapashtesë?

Shpesh jam ndeshur me emrin e Pekmezit. Nga sa kam mundur të zbuloj, ai ka qenë dikur konsull në Vjenë. Më intereson shumë personaliteti i tij. A mund të më thoni nëse ekziston ndonjë shkrim për jetën e tij apo ndonjë bibliografi e veprave të tij? Dhe kur ka vdekur? Së fundmi kam bërë kopje të botimit të tij të "Bletës..." së Mitkos.

Nga Biblioteka juaj dhe nga z. Kolë Luka kam marrë të gjithë radhën e Buletinit. Fatkeqësisht, ende nuk kam marrë asnjë kopje të "Studia Albanica", dhe frikësohem se numrat e vëllimit të parë tashmë janë ezauruar. A do të mund të më ndihmonit për sigurimin e kësaj radhe?

Jam gjithmonë i gatshëm për këmbime, siç e dini, tashmë. Fatkeqësisht nuk do të mund të vij në Kongresin e Parë të Ballkanologjisë në Sofje, megjithëse do të kisha dashur shumë. Nëse do të mund të siguroja disa *summaries*, do të ishte shumë e vlefshme. Do të ishte e mundur të më regjistronit për aktet e Kongresit? Kam frikë se këtë vit nuk do të kem mundësinë t'ju takoj. Por në rast se bëni ndonjë udhëtim zyrtar drejt Veriut, a do të ishte e mundur të koordinohej një ligjëratë këtu në Innsbruck? Duhet ta dimë disa muaj përpara, në mënyrë që të bëjmë kërkesat përkatëse. E konsideroj për të ardhur keq nëse lidhjet nuk arrijnë deri në Innsbruck.

Tani më duhet të përfundoj dhe jam shpesh me mendje te ju.

I juaji me respekt të thellë

H. Ölberg

Edhe një pyetje tjetër, ju lutem: Në bibliografinë tuaj, në nr. 61 është dhënë: *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe*. Si mund të bëj për ta siguruar këtë?

A ekziston ndonjë etimologji për fjalën *arsim* (arsimim, mësimdhënie)? Deri tani nuk kam gjetur asgjë mbi këtë.

Innsbruck, 15.12.1966

Instituti për Gjuhësi Krahasuese
pranë Universitetit të Innsbruck-ut

Për
Prof. Dr. Eqrem Çabej
Rruga B. Curri 260, shk. 7, ap. 15, Tiranë

I nderuari Profesor!

Tashmë ka kaluar edhe një vit dhe po afrohemi sërish te festa e Krishtlindjes. Me këtë rast, për Krishtlindje dhe për Vitin e Ri, ju uroj nga zemra juve dhe familjes suaj çdo të mirë! Shpresoj që të jeni të gjithë mirë me shëndet dhe të keni pasur një vit të mbarë.

Më habiti shumë mungesa e një delegacioni nga Shqipëria në Kongresin për emrat e vendeve që u mbajt në Londër. Londrën e pashë për herë të parë dhe më pëlqeu shumë, por fatkeqësisht nuk e takova S. E. Mann, që do të kisha shumë qejf ta njihja.

Niveli shkencor i kongresit nuk ishte i lartë, dhe prandaj mbeta shumë i zhgënjyer që nuk ju takova, por kam shpresë se do të takohemi vitin e ardhshëm në Bukuresht. Do të kisha dashur të paraqes një referat mbi gjuhën shqipe dhe marrëdhëniet e saj me gjuhët alpine, pra një përballje me studimin që ka bërë Jokl dikur në Vox Romanica. Meqenëse ju i njihni mirë rrethanat e Europës Lindore, do të doja të dija nëse do të ishte më mirë që këtë referat ta mbaja në frëngjisht?

Marrëdhëniet e mia me bibliotekën e Tiranës, dhe në veçanti me z. Kolë Luka, janë shumë të mira dhe tashmë kam krijuar një seksion të konsiderueshëm me literaturë shqiptare. Më dërgoi së fundmi edhe përmbledhjet e referateve të delegacionit shqiptar në Kongresin e Parë Ballkanologjik në Sofje, që ishin jashtëzakonisht përmbajtësore, por mungonte pikërisht referati juaj. A nuk morët pjesë atje?

Arritjet e Institutit tuaj, sa kam mundur t'i ndjek që pas luftës, janë vërtet të jashtëzakonshme, dhe gjithnjë e më shumë kam dëshirë ta vizitoj një ditë. A nuk do të publikohen këto studime dialektologjike në një atlas gjuhësor ose të bëhen ndryshe të aksesueshme për kërkimin shkencor?

A është e mundur ta gjej diku për kopjim librin tuaj Hyrje në historinë e gjuhës shqipe, botuar më 1959? Po ashtu, do t'ju isha shumë mirënjohës nëse do të mund të më shkruanit cilat janë botimet tuaja për vitin 1966, që të mund ta mbaj listën time të përditësuar.

A i merrni rregullisht botimet albanologjike të huaja? Nëse jo, jam gjithmonë i gatshëm t'ju ndihmoj, këtë e dini tashmë.

Bashkë me këtë letër po ju dërgoj një shtesë të vogël për fëmijët tuaj dhe një herë tjetër ju uroj çdo të mirë për vitin e ardhshëm!

I juaji me përulësi dhe respekt të thellë!

H. Ölberg

Innsbruck, 26.3.1967

Instituti për Gjuhësi Krahasuese
pranë Universitetit të Innsbruck-ut

Për
Prof. Dr. Eqrem Çabej
Rruga B. Curri 260 Tiranë

I nderuar Profesor!

Ju falënderoj shumë për letrën tuaj të datës 05.02. Ju lutem më ndjeni për vonesën e përgjigjes sime, e cila erdhi si pasojë e një sëmundjeje të gjatë. Në fund të muajit shkova me grip në Vjenë për ditën e parë të sllavistëve austriakë, përpiqesha ta shtypja me gjithfarë mjetesh, por kur u ktheva në shtëpi, pësova një përkeqësim të rëndë, me infeksion të dhimbshëm në të dy anët e sinuseve të nofullës dhe të ballit, prej nga po rimëkëmbem vetëm tani.

Ndërkohë, nga Instituti më sollën disa libra në shtëpi, për të cilët sekretarja tha se të githë kishin ardhur prej jush, përkatësisht: "Texte istroromine", "Jeronim de Rada", "Revue roumaine de linguistique" (3 numra), "Lulëzo Shqipëri". Nëse vërtet janë prej jush, nuk di si t'ju falënderoj! Ju kam ofruar edhe më parë ndihmë për libra apo kopje Xerox, dhe më lejoni ta përsëris këtë ofertë.

Me zotin Kolë Luka kjo mënyrë bashkëpunimi po funksionon shumë mirë. Por meqë kemi edhe marrëveshje shkëmbimi me Rumaninë, mund të ndodhë që ndonjë nga librat e përmendur të ketë ardhur prej andej dhe do të ishte e rëndësishme ta dija këtë. Ju lutem më njoftoni në një rast të përshtatshëm.

Në Vjenë vizitova Institutin e Gjuhësisë Indoeuropiane, tani nën drejtimin e prof. Mayrhofer, që ndoshta e njihni më herët. Ai po përgatit gjithçka që revista "Sprache" të

pajiset me një pjesë kronike të gjerë, në stilin e Indogermanisches Jahrbuch, gjë shumë e mirë, shpresoj, që do të realizohet siç është planifikuar. U takova shkurtimisht edhe me zotin docent Solta, emërimi i të cilit si profesor i asociuar tani duket se është siguruar.

Më ka lënë shumë përshtypje leximi i *Historisë së Shqipërisë*, Tiranë 1964, veçanërisht pjesa mbi shek. XIX dhe përpjekjet e vazhdueshme të asaj periudhe, ku mbetet e pakuptueshme nga buronin forcat, qoftë njerëzore apo ekonomike. Vështirë të gjesh një popull që ka luftuar aq shumë i vetëm dhe i mbyllur në vetvete.

A është B. Curri, emri i rrugës suaj, Bajram Curri, ai që u vra në vitin 1925? Do të dëshiroja shumë të ekzistonte një botim kritik me burime dhe literaturë për këtë figurë.

Tani më në fund po i kthehem letrës suaj, të cilën e kam lexuar me vëmendje dhe kam mbledhur të gjitha të dhënat përkatëse.

Vjena është shumë e pasur me literaturë. Buletini është i plotë prej vitit 1957, por vitet më të hershme vështirë se mund të gjenden. Po ashtu "Studia Albanica" e kam të plotë, pra vitet I dhe II, por për vitin 1966 nuk jam i sigurt që e kam.

Sapo lexova në letrën tuaj se do të më dërgoni albumin dhe vëllimin për De Radën, kështu që pyetja ime më sipër bëhet e pavlefshme. Vlerën më të madhe do ta kishte për *mua Hyrje në historinë e gjuhës shqipe*, të cilën do të doja ta kopjoja këtu, nëse nuk mund të më dërgoni ekzemplarin. Kjo mund të bëhet për disa ditë.

Jam shumë i gëzuar për botimin tuaj të Mesharit të Buzukut, besoj se përfshin edhe indeksat përkatës. Botimin "Prapashtesat..." nga Xhuvani-Çabej e kam marrë prej jush.

Ende nuk di nëse do të mund të vij në Bukuresht. Vera e këtij viti është shumë e pafavorshme për mua. Për *Internationale Textbibliothek* kam marrë për shqyrtim punimin e habilitimit të Camajt dhe shpresoj t'i bëj recensë këtij libri të pasur me përmbajtje. A mund t'jua dërgoj për shqyrtim recensionin kur ta kem përfunduar?

Ju falënderoj shumë për botimin tuaj të veçantë nga Amsterdami. Ishte një kongres i bukur, më i bukuri për shkak të pranisë së delegacionit shqiptar.

Ndërkohë po ju dërgoj një kontribut të vogël mbi keltët në Tirol, që sapo ka dalë nga shtypi.

Përshëndetjen që doja t'jua dërgoja për Pashkë, nuk arrita ta bëj në kohë, megjithatë, ju uroj gjithë të mirat!

I juaji me respekt të përzemërt!

H. Ölberg

P.S. Studimin "Parashtesat..„ fatkeqësisht, nuk e kam. A është fjala për artikullin nga Buletini, viti 1956, nr. 4? Këtë nuk e kemi ende. Ju lutem, nëse është e mundur, më dërgoni një kopje.

Innsbruck, 6.9.1967

Instituti për Gjuhësi Krahasuese
pranë Universitetit të Innsbruck-ut

Për
Prof. Dr. Eqrem Çabej
Universiteti i Tiranës

I nderuar Profesor!

Ka kaluar sërish një kohë e gjatë që kur kam marrë lajme nga ju dhe shpresoj që ju dhe familja juaj të keni kaluar një verë të mirë.

Profesor Knobloch ishte në Bukuresht, por fatkeqësisht nuk mundi të më thoshte nëse edhe ju ishit atje, gjë kjo që kuptohet për shkak të numrit të madh të pjesëmarrësve. Vetë nuk mora pjesë në asnjë kongres këtë vit, pasi pata shumë punë dhe më duhej t'i anuloja të gjitha udhëtimet.

Në letrën tuaj të datës 12.04. lexova me habi se keni vetëm një botim shumë të vjetër të fjalorit të Kluge-s, prandaj ju dërgova menjëherë botimin më të fundit. Librin e nisa me postë rekomande dhe shpresoj që ta keni marrë.

Me keqardhje lexova gjithashtu që nuk e dispononi fjalorin greqisht të Frisk-ut. Edhe këtë mund t'jua dërgoj, aktualisht do ta keni në dispozicion deri tek nr. 17 (*sakos*). Ju lutem më shkruani nëse e dëshironi ende.

Megjithëse më keni kthyer një përgjigje të sjellshme lidhur me recensionin e librit të Camaj-t, megjithatë po e bashkëngjis. Nga ky shkrim do të mund të kuptoni edhe një herë sa i domosdoshëm është përfundimi i redaktimit të fjalorit tuaj etimologjik, dhe me kënaqësi do të ndihmoja me libra për këtë. Në botimet e deritanishme në *Buletin*, S*tudime* etj., nuk mund të gjenden të gjitha për shkak të mungesës së referencave të ndërsjella. Shpresoj që fjalori të mund të përpilohet dygjuhësor, pasi disa shpjegime vetëm në shqip nuk mund t'i kuptoj qartë, kjo natyrisht për shkak të njohurive të mia të kufizuara.

Nuk e kam menduar kurrë se libri i Camaj-t do të rezultonte një zhgënjim i tillë. Kam punuar për gjashtë muaj mbi të dhe nuk mund ta kuptoj si ka qenë e mundur që një botim i tillë të lejohej në Mynih në vitin 1964. Megjithatë u përpoqa të qëndroj sa më neutral në recension (për *Indogermanische Forschungen*), por do t'ju isha shumë mirënjohës nëse do të mund të gjenit pak kohë për ta lexuar dhe për të më thënë me sinqeritet nëse i kam bërë recensë librit apo jo. Sigurisht që kisha shumë vërejtje të tjera, por për hir të mirësjelljes i lashë jashtë, sepse kushdo që lexon mes rreshtave, do ta kuptojë që me këtë metodë "mediterraniste" apo "alarodike" të shkencës, nuk mund të pajtohesh. Më vjen veçanërisht keq, sepse nga ky libër kisha pritur një vazhdim të punës së Jokl-it.

Më mungon gjithashtu shumë punimi juaj mbi Parafjalët shqipe, si dhe hyrja e shumëfishuar (për përdorim të brendshëm). A mund t'ju lutem të më dërgoni nga një kopje të secilës? Nuk është nevoja t'i fotografoni, unë do të bëj një kopje me Xerox këtu dhe do t'jua kthej menjëherë ekzemplarin tuaj. Kjo është mënyra më e thjeshtë dhe, nëse dërgesa bëhet me rekomande, nuk do të humbasë.

Nëse nuk e keni fletushkën nga Göschen për formimin e fjalëve në gjermanisht (*Krahe-Meid: Germanische Sprachwissenschaft III, 1967*), mund t'jua dërgoj edhe atë. Profesori im më ka dhënë disa kopje.

Kur do të vini sërish në Austri? Kam edhe një pyetje tjetër: A do të ishte e mundur të merrej nga Instituti juaj ose nga Radio Tirana një regjistrim magnetofoni me shqipen e sotme letrare? Për shembull, ndonjë lajm apo emision i ngjashëm? Radio Tiranën nuk mund ta dëgjoj këtu, dhe as Moska me emisionin në shqip nuk dëgjohet mirë. A transmeton Tirana edhe në valë të shkurtra? Do të isha shumë i lumtur nëse do të mund të merrja një regjistrim. Dëshiroj që semestrin e ardhshëm të shpall lëndën e Hyrje në Gjuhën Shqipe, dhe ky material do të më nevojitej për këtë qëllim.

Ju falënderoj shumë dhe ju lutem të më njoftoni në lidhje me pyetjet e mësipërme.
Gjithë të mirat!

I juaji me përulësi dhe respekt të thellë!

H. Ölberg

Innsbruck, 16.11.1967

Instituti për Gjuhësi Krahasuese
pranë Universitetit të Innsbruck-ut

Për
Prof. Dr. Eqrem Çabej, Tiranë

I nderuar Profesor!

Për letrën tuaj aq të pasur me përmbajtje të datës 24.09. ju falënderoj përzemërsisht dhe më vjen keq që ju mora kaq shumë kohë për punët e mia personale. I kam shënuar me kujdes të gjitha pikat e përmendura nga ju. Supn- në vend të súpno- është, natyrisht, një marrëzi. Po të kisha pasur më herët studimet tuaja për Parashtesat, shumë gjëra do të kishin dalë ndryshe dhe më mirë.

Më duhet t'ju them se një mik në Vjenë është duke më përgatitur një kopje të artikullit tuaj në numrin përkatës të "Buletinit", për të cilin e kam lutur prej kohësh, kështu që ju

lutem të mos shqetësoni bibliotekën tuaj për këtë, nëse nuk e keni porositur ende. Nganjëherë ndodh që gjërat përplasen në kohë, ndaj ju lutem të mos më mbani inat për këtë.

Gjatë dy viteve të fundit kam krijuar një seksion të veçantë për shqipen, i cili nga një fond fillestar prej 4–5 librash (fjalori i Meyer-it, gramatika e Weigand-it, disa gjëra nga Lambertz-i) sot përfshin pothuajse gjithçka të nevojshme në fushën e gjuhësisë, duke përfshirë edhe libra si të Makusov-it, si dhe thesare të vërteta si disertacioni juaj.

Të gjitha monumentet e vjetra tani i kam të kopjuara në Xerox, si dhe një sërë fjalorësh. Sa shumë më ka ndihmuar biblioteka juaj (dhe z. Kolë Luka), nuk është nevoja ta theksoj më tej. "Buletinin" e kemi të plotë që nga viti 1957 dhe dëshira ime më e madhe është të siguroj edhe vitet para kësaj. Por duket se kjo nuk është më e mundur.

Kam përfituar shumë nga studimet tuaja etimologjike, dhe nuk është nevoja t'ju them se për mua ato janë si një zbulesë dhe themeli përfundimtar i kërkimeve. Së bashku me skriptin, për të cilin ju falënderoj shumë, ato përbëjnë një bazë të fortë për punën time. A pritet së shpejti të botohet edhe një morfologji dhe sintaksë? Jam i gëzuar që studimet etimologjike po përmbyllen dhe më lejoni t'ju lutem për një indeks të detajuar në fund, qoftë edhe nëse më pas do të botohet si libër. Shpesh jam munduar për të gjetur ndonjë fjalë që nuk është në listën kryesore, por që gjendet në ndonjë vend tjetër nën një fjalë të së njëjtës familje leksikore. Kur i marr bashkë skriptin, fjalorin etimologjik dhe studimin mbi parashtesat, bindem edhe më shumë sa e dobët është puna e Camajt, madje edhe më shumë sesa më dukej më parë. Që në Mynih të miratohej një punë e tillë mediterraniste-alarodike si punim habilitimi, për mua është e pabesueshme. Puna është një mashtrim i pastër dhe thelbësisht johoneste, dhe kjo është ajo që më zemëron më shumë.

Si shenjë falënderimi të thellë për gjithçka që keni bërë për mua, ju kam dërguar me 3 dërgesa këto:

1. Frisk, vëllimi i parë i lidhur,
2. Frisk, fletët e mëvonshme deri në dorëzimin nr. 17, të cilat do t'i merrni automatikisht më tej,
3. Krahe, *Gjuhësia gjermanike*, vëllimi II, dhe Krahe-Meid, vëllimi III,
4. Diçka të vogël për ëmbëlsim,
5. Lista e leksioneve (Vorlesungsverzeichnis).

Shpresoj që gjithçka ka arritur në rregull.

Nëse keni nevojë për ndonjë material të veçantë, më shkruani ju lutem!

Më pas po ju dërgoj edhe disa foto nga z. Deutscher. U gëzova shumë që ju pashë kaq të freskët dhe të shëndetshëm dhe që njoha edhe bashkëshorten tuaj. Ishte për mua një surprizë e madhe të dëgjoja më vonë për takimin me z. Deutscher. Ai mendoi se ju ishit germanist, dhe kur ia shpjegova se me çfarë autoriteti shkencor kishte pasur nderin të takohej, "ai nuk u besoi veshëve". Nëse dëshironi ndonjë botim të ri apo zmadhim të fotove, më shkruani mua ose atij.

Meqë më pyetët me dashamirësi, nëse më nevojitet diçka, po ju përmend vetëm këto:

Buletini para vitit 1957, edhe nëse janë numra të veçantë – do t'i kopjoja unë këtu.

Nga *Studime filologjike*, më mungon numri 2 i vitit 1966. I kam shkruar Bibliotekës suaj për këtë, por ju lutem edhe ju të shikoni për këtë (sidomos për punimin tuaj etimologjik). Me këtë numër, viti 1966 do të ishte i plotë.

Nga *Historia e Shqipërisë*, kam marrë një herë vëllimin II, të vitit 1965. A është ende i mundur të merret edhe vëllimi I?

Nga *Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë* kam marrë vëllimin I, të vitit 1965. A ka ndonjë vazhdim?

Dhe një pyetje tjetër: Një shqiptar i Kosovës, z. Ethem Fasliu, i cili pas luftës ka studiuar këtu dhe tani dëshiron të bëjë doktoraturën (për të përparuar më mirë në Amerikë), ka marrë përsipër një punim doktorature në Romanistikë për fjalët huazime romanike në shqipen e sotme (Jo latinishten. Kjo është tepër e vështirë). A është botuar ndonjë gjë nga ana juaj mbi këtë temë, që mund të sigurohet? Mund t´ju lus gjithashtu që, për mbledhjen e materialit, të dërgoni ndonjë tufë gazetash ose revista kulturore, nga të cilat ai të mund të nxjerrë materiale? Nuk duhet të jenë ndonjë gjë e rrallë apo me vlerë të madhe. Do t'ju lutesha vetëm që t'i dërgoni, në vend që të përfundojnë në kosh. Do të ishte një ndihmë e madhe.

Tani, ndoshta ju jam bërë mjaftueshëm i bezdisshëm, por nëse mund të mbani mend edhe pyetjen për një regjistrim zanor, do t'ju isha shumë mirënjohës. Ndoshta mund të merrni diçka nga Radio Tirana?

Z. Kolë Luka më kishte shkruar dikur se universiteti juaj po planifikonte të nxirrte një listë leksionesh të shumëfishuara. A është bërë kjo ndërkohë? Mund ta imagjinoni sa shumë do të më interesonte të shihja një të tillë. Njëherë, kam marrë rastësisht, *Bibliografinë Kombëtare*, viti 6, nr. 3. A mund të sigurohet ajo rregullisht?

Tani po e përfundoj. Më falni që ju kam shqetësuar kaq shumë, por meqë ju keni ndikuar në mënyrë kaq vendimtare rrugën time shkencore me kërkimet tuaja, më lejohet ndoshta ndonjëherë të hap gojën, apo jo? Ndoshta do të ketë një takim vitin tjetër?

Me përulësi dhe mirënjohje të thellë, i juaji

H. Ölberg

Innsbruck, 14.12.1967

Për
Prof. Univ. Dr. Eqrem Çabej
Rruga "Bajram Curri" 260, Tiranë

I nderuar Profesor!

Me gëzim të madh mora para disa ditësh dërgesën tuaj me tre fjalorët dhe ju falënderoj veçanërisht për to. Shpresoj që edhe dërgesat e mia të kenë mbërritur në rregull. Me të njëjtën postë po ju dërgoj një përshëndetje të vogël, një separatum të kopjuar nga vepra për nder të Mossé-së, me autor de Vries, për *r*-në emfatike në gjuhët gjermanike. Këtë kontribut ndoshta nuk e keni njohur më parë dhe është metodologjikisht shumë nxitës.

Sapo mora gjithashtu një kopje të punimit të Stuart E. Mann, "The reduced prefixes ḱs- and đe/d, and the metathesis in Greek", botuar në *Transactions of the Philological Society* më 1942. Etimologjitë greke të paraqitura aty, me të drejtë nuk janë marrë shumë seriozisht në literaturën shkencore, por si dëshmi historike mund t'ju interesojë. Nëse dëshironi, mund t'ju përgatis një kopje prej katër faqesh.

Javën e kaluar, prof. Brandenstein vdiq papritur nga një emboli pulmonare në Graz, një humbje e madhe që të gjithë e ndjemë me keqardhje. A e keni njohur personalisht? Ne po përgatisnim një libër (Festschrift) për të si vëllimi XIV i serisë IBK, pasi vitin tjetër do të mbushte 70 vjeç; tani do të jetë, me shumë gjasë, një libër përkujtimor.

Po afron Krishtlindja dhe më lejoni t'ju uroj juve dhe familjes suaj çdo të mirë për këtë rast! Në veçanti, ju falënderoj për ndihmën dhe përkrahjen tuaj gjatë këtij viti dhe shpresoj që ndoshta do të kemi mundësi të takohemi vitin që vjen.

Pak kohë më parë, prof. Mihaescu mbajti disa ligjërata si i ftuar këtu. Kam folur edhe me të për ju dhe shkëmbyem disa kujtime.

Edhe një pyetje: Tek Jokl-i lexoj vazhdimisht për shënime dorëshkrimore të baron Fr. Nopcsa, të cilat ai i kishte përdorur, duket se bëhej fjalë për lista fjalësh që i kishte mbledhur në Shqipërinë e Veriut. A janë botuar këto shënime të Nopcsës ndonjëherë? Apo janë përdorur vetëm në librin e tij "Ndërtesa, kostume tradicionale, pajisje" (*Bauten, Trachten, Geräte*, 1925)? Apo ndodhen ende të papublikuara në Bibliotekën Kombëtare? A keni pasur rast për t'i parë?

Edhe një herë ju falënderoj përzemërsisht dhe mbetem me urimet më të mira për ju dhe për familjen tuaj të nderuar.

Me mirënjohje të thellë, i juaji shumë falenderues!

H. Ölberg

Innsbruck, 04.01.1968

H. Ölberg
Zotit Prof. Dr. E. Çabej
Rruga B. Curri 260
Tiranë

Shumë i nderuar zoti profesor!

Me gëzim të madh mund t'ju konfirmoj që dërgesa me "Dorsa" dhe "Guys" ka mbërritur në rregull. Lavdi zotit! Sepse do të ishte vërtet për të ardhur keq, nëse këta libra kaq të vyer do të kishin humbur. Ju falenderoj shumë përzemërsisht për këtë pasurim kaq të rëndësishëm të fondit tonë të librave. A mund të bëni pa to? Përndryshe mund të porosis që ata të fotokopjohen.

Ndërkohë shpresoj që edhe ju ta keni marrë letrën time si edhe pakon e vogël me Frisk-un.

Për botimin përkujtimor për Brandenstein-in po punoj momentalisht për një artikull rreth gërmës "k" përpara "u"- së në gjuhën shqipe, ku sipas mendimit tim, supozimi i vjetër i Pedersen-it (KZ 36) që ajo është kthyer në "su", nuk është i drejtë. Por tani po më mungon revista në të cilën ju ka gjasa të keni trajtuar "thuprë – ŝufrë". A më lejoni t'ju kërkoj informacion, se cila do të ishte qasja etimologjike në lidhje me këtë sipas opinionit tuaj aktual? Për trajtimin e kësaj çështjeje natyrisht që kam gërmuar me zell në artikujt tuaj të botuar te Buletini; gjatë këtij procesi më kanë rënë në sy disa gjëra që dua t'jua vë në dispozicion për informacion:

Në lidhje me "grunë", (Buletini 1962,. Nr. 3, 58) nëse e kuptoj drejt pikëpamjen tuaj, Kretschmer 86 në botimin për nder të Jokl-it duhet të ketë mbrojtur tezën "n > un". Por aty vetë nuk thuhet asgjë në lidhje me këtë.

Në lidhje me "curr" (Buletini 1961, nr. 1, 70) kombinimi "acervus – irlandishte e vjetër → carn" është ndoshta vërtet i guximshëm. Ndoshta është më mirë opinioni i Walde-Hofmann LEW 1 te zëri "acervus". Edhe Pokorny IEW i ndan këto të dyja, f. 22 dhe f. 532. E dhëna bibliografike (Tagliavini, Riv. d'Albania I 184 e në vazhdim) mund të mos jetë e saktë. Unë vërtetë kam vetëm disa kopje të pjesshme të kësaj reviste, por Tagliavini e fillon raportin e tij përmbledhës rreth faqes 200. Por aty nuk gjeta dot asgjë. Por megjithatë pikërisht për shkak të mangësive në faqet përkatëse nuk mund të pretendoj asgjë me saktësi.

Në lidhje me "dhunë" (Buletini 1961, nr. 4, 110) ju shkruani se tek Hahn-i 26 gjendet forma me rotacizëm "dhurë". Por unë aty gjeta vetëm "dhunë" turp dhe disa rreshta më poshtë (dhurë) në qejf.

Në lidhje me "bij" (Buletini 1960, nr. 4, 56) duhet Jokl-i te Walde-Hofmann LEW I 504.

Gjej që St. Mann është cituar pak, por shumë shpesh citohet La Piana që nuk ka shumë baza. A e njihni Mann-in, "Indoeuropean vowels in Albanian", Language 26? Mann-i

duket të jetë shumë i ngjashëm me Camajn, edhe atij nuk i interesojnë shumë opinioni dhe hulumtimet e të tjerëve.

Si shqiptohet saktë mbiemri "Camaj", me c- apo me ç-?

Tani dua t'ju falenderoj edhe një herë shumë përzemërsisht. A më lejoni të bashkëngjis edhe një kërkesë të paturp: nëse do t'ju ndodhen dubleta ose separate të dyfishta, që nuk ju duhen më, a mund ta regjistroja institutin tonë si të interesuar? P.sh. sa u takon punimeve të La Piana-s apo shkrime të ngjashme?

Tashmë kemi hyrë në vitin e ri, unë shpresoj që ju ta keni filluar më së miri së bashku me familjen tuaj dhe ju uroj gjithë të mirat për këtë vit! Ju përshëndes edhe nga zoti Deutscher, i cili u gëzua shumë që fotografitë patën jehonë pozitive tek ju.

Ju falenderoj nga zemra për gjithçka dhe më shkruani për çdo gjë që ju duhet!

Me nderime

Hermann Ölberg

Më lejoni t'ju bëj me dije edhe sa më poshtë:

Nga revista "Studime Filologjike" kemi marrë të fundit numrin 4 të vitit 1966. Nuk është botuar asgjë në vitin 1967? Artikujt tuaj rreth gërmës "thu-" do të më duheshin shumë. Numri 2 i këtij viti, siç ju informova, mungon.

Studia Albanica 1966, numri 2. Nga viti 1967 asgjë?

Studime Historike: na mungon numri 2 i vititi 1965. Nga viti 1966 kemi marrë vetëm numrin 1. Që atëherë asgjë tjetër.

Nga revista "Etnografija shqiptare" vetëm numrin 1 dhe 2.

Më falni nëse ju bie gjithmonë më qafë, por ndoshta kur të shkoni në bibliotekë mund ta diskutoni edhe këtë temë.

Vëllimi 13 i IBK (Pokorny) [IBK=Studime të Universitetit të Innsbruck-ut për shkencat kulturore] është nisur për në Bibliotekën e Universitetit të Tiranës. Nëse juve ju intereson i gjithë vëllimi (aty ka shumë shkrime rreth keltologjisë), ndoshta mund të siguroj një ekzemplar për ju.

Edhe një herë shumë falemnderit!

H. Ölberg

A – 6020 Innsbruck, 28.10.1968

Instituti për
Gjuhësi Krahasuese
Universiteti i Innsbruck-ut

Zotit Prof. Dr. E. Çabej
Tiranë

Shumë i nderurar, zoti Profesor!

Ja edhe vera iku sërish dhe unë shpresoj se ju dhe familja juaj e keni kaluar bukur. Në ditët në vijim do t'ju dërgohen separatet e artikullit tuaj të vyer për Brandenstein-in. Gjithashtu edhe një vëllim të cilin e kishit porositur. Ndërkohë sapo ka arritur këtu edhe vazhdimi i Frisk-ut.

Më lejoni t'ju falenderoj edhe një herë shumë përzemërsisht për bashkëpunimin tuaj në serinë tonë. Shpresoj që ky botim përkujtimor të jetë i denjë për studiuesin në fjalë dhe të ketë jehonë pozitive.

Siç konstatova, juve ju është dërguar vëllimi nr. 13 (Pokorny), së bashku me faturën me çmimin që kemi për bashkëpunëtorët. Nëse çështja e devizave ju paraqet vështirësi, ju lutem ma shkruani.

Nga zoti prof. Mihaescu kam dëgjuar që vëllimi juaj mbi Buzukun, për të cilin dhe më keni shkruar, po i afrohet fundit. Ky publikim do të jetë një ndihmë e madhe për kërkimin shkencor, kur të jetë në dispozicion.

Unë kam vazhduar të punoj me intensitet për një fonetikë historike të gjuhës shqipe dhe nuk mund të shpreh veçse admirim për punën tuaj. Ky themelim i bazave shkencore për herë të parë është kaq i shkëlqyer, saqë çdo lemë hap horizonte të reja. A do të botohet ndonjëherë fjalori etimologjik edhe në gjuhën gjermane? Në fakt, për hir të traditës, do duhej të ndodhte! Dëshira ime e fshehtë do të ishte që këtë vëllim ta botonim te revista jonë IBK, sepse ky do të ishte kurorëzimi i kolanës sonë (Por natyrisht jam i ndërgjegjshëm, që kjo është veçse një ëndërr). Mos ma merrni për keq, ju lutem, nëse më poshtë po parashtroj disa pyetje:

dre (1961, 3, 56) nga vjen "darn" e irlandishtes? Nuk kam mundur ta gjej askund. Si është raporti i apofonisë te fjala "dre"?

diel (1961, 2, 59): baza "dhel-" Pokorny 246.
sulem (1961, 4, 60): LKU 59 Jokl.
ehull (1961, 4, 115): Cinochowski LP 5, 192.
sup: Pisani Saggi 132, Solta IF 70, 279.
lehtë (1964, 2, 17): Pokorny IEW 660? Apo 681?
lesh (1964, 2, 23): Meyer Alb. St. 3, 38?
shlligë (1966, 1, 31): Lambertz, Alb. Märchen, kollona 9, shënimi 2.

mund (1964, 3, 45): në vend të *mēghno duhet "māghno".
gjû (stadet më të hershme te Revista „Zeitschrift für Balkanologie" 2, 12): në irlandishten e vjetër fjala "glūn" ka zanore të gjatë, qjë që nuk mund të thuhet për gjuhën shqipe.
lyen: a mos janë përzier bashkë në qasjen etimologjike "lei- 3" (Pokorny 662) dhe "lei- 4" (Pokorny 664)?
ditë (1961, 2, 60) ndoshta ende Jokli, Arch.roman,14, 119.
lenj (1964, 2, 18 vazhdim): për këtë Jokli vendos edhe l'art leudhro- LKU 228.
cep (1961, 1, 63): Jokl, Balkangerm. ... 126.

Nuk po guxoj të trajtoj aspektin përmbajtësor të etimologjive, sepse askush tjetër nuk do të mund t'ju tejkalonte juve. Më vonë, pasi të kem përpunuar gjithçka, do doja t'u rikthehem disa gjërave bazike. A keni ndoshta në plan të trajtoni në një të ardhme të afërt teorinë laringale dhe konsekuencat e saj për gjuhën shqipe, ashtu si e ka iniciuar Hamp-i te "Evidence for Laryngeals"? Mua nuk më duket e diskutueshme gërma "h" në fillim të fjalës, por "shurrë", por momentalisht më mungon ky numër i revistës, kështu që nuk i njoh qasjet tuaja. A mund të ma thoni ju lutem qasjen tuaj?

Tashmë mjaft ju bezdisa dhe më falni që guxova të komentoj diçka në lidhje me këtë kryevepër. Për fat të keq ajo është shumë pak e njohur në rang ndërkombëtar, Hamp-i nuk i citon fare etimologjitë tuaja, çka i anulon që në krye të herës propozimet e tij. Sa keq, a nuk ka ai kontakte me ju? Me shpresën se do ta merrni të padëmtuar dërgesën (ndoshta të ndarë në 2 pjesë), mbetem si përherë

me shumë respekt

H. Ölberg

A – 6020 Innsbruck, 15.12.1968

Instituti për
Gjuhësi Krahasuese
Universiteti i Innsbruck-ut

Zotit Prof. Dr. E. Çabej
Tiranë

Shumë i nderuar zoti Profesor!

Dhe ja ku festat po afrojnë sërish dhe viti po shkon drejt fundit. Më lejoni që me këtë rast t'ju uroj gjithë të mirat juve, bashkëshortes suaj dhe familjes! Nëse fëmijët tuaj koleksionojnë pulla poste, le të gëzohen sadopak me shtojcën e kësaj letre. Qoftë viti i ardhshëm po kaq i suksesshëm sa ky që po lëmë pas. Më vjen shumë keq që nuk pata mundësinë

t'ju takoja askund. E kaluat verën në shtëpi dhe buzë detit? Do të isha gëzuar shumë që pas gjithë këtyre viteve që nga koha e Amsterdamit të takohesha sërish me ju.

Po punoj shumë intensivisht me etimologjitë tuaja dhe mund të them bindshëm që punimi juaj është vepra më e madhe shkencore në fushën e indogjermanistikës në këto dekadat e fundit. Është për të ardhur keq që ky botim momentalisht ende nuk është shqyrtuar në kërkimin shkencor të të tjerëve. Por nëse kjo do të ndodhë në vitet e ardhshme, do të kemi një modifikim të madh në fjalorët etimologjikë. Shpresoj që së shpejti të mund ta botoni këtë vepër si një vëllim më vete. Komentin tim, që libri juaj do të paraqiste pikën kulmore të kolanës IBK (Innsbrucker Beiträge zur Kulturwissenschaft), mos e konsideroni si të pacipë, sepse ishte thjesht një dëshirë sekrete dhe natyrisht e parealizueshme, edhe pse edhe Walde-Pokorny pikënisjen e kishte në Innsbruck dhe unë nuk do të përfytyroja dot diçka më të bukur, sesa të mund t'ju ndihmoja. Por nëse një publikim përmbledhës nuk është planifikuar për të ardhmen e afërt, do të gëzohesha, nëse në përfundim do të botonit në një numër reviste një regjistër (fjalësh). Unë për vete e kam hartuar një regjistër me fjalët kyçe më të rëndësishme, për t'i rigjetur prapë ato "kokrrizat e florinjta" që janë fshehur në shumë paragrafë. Kam sërish një radhë komentesh të vogla, që do t'jua dërgoja nëse ju nuk ofendoheni prej tyre. Në të shumtën e rasteve natyrisht që bëhet fjalë për gabime shtypi të radhitësit të tipografisë, për disa prej etimologjive do të diskutoja me kënaqësi me ju një herë tjetër, pasi të kem përpunuar gjithçka, si p.sh. "djep" dhe greqisht "δέπας" , që është e dokumentuar në gjuhën mikene "di-pa".

Për fat të keq ende nuk i kam marrë numrat e vitit 1968, edhe pse i kam kërkuar me urgjencë te biblioteka e universitetit, kështu që nuk i posedoj hulumtimet tuaja duke filluar nga gërma "th" e më tutje. Mos ndoshta ende nuk janë botuar? U mundova t'i gjej edhe në Vjenë, Salzburg dhe Graz, por pa sukses. Ende nuk ka biblioteka juaj një pajisje Xerox, apo makineri fotokopjeje në të thatë, që do të punonte më shpejt se sa të filmosh me mikrofilm dhe pastaj të zmadhosh sërish? A më lejoni të shpreh dhe një kërkesë të rëndësishme? Ju më keni dërguar para disa vitesh bibliografinë tuaj deri në vitin 1963, publikimet pas këtij viti sigurisht që i kam regjistruar, por çfarë mund të jetë botuar në vende të rralla, për fat të keq, është e panjohur për mua. A do të mund të më dërgonit një listë të këtyre botimeve kur t'ju jepet rasti? Do t'ju isha shumë mirënjohës për këtë. Në tryezën time të punës kam pothuajse çdo studim tuajin, që mund ta siguroja nga bibliotekat e tjera përveç Innsbruck-ut dhe që ka lidhje me punën time aktuale.

Më lejoni edhe një herë t'ju uroj juve dhe familjes suaj të shtrenjtë gjithë të mirat për ditët e festave dhe para së gjithash shëndet dhe suksese për vitin e ardhshëm!

Me shumë falenderime dhe me respekt

H. Ölberg

Diçka e vogël do ju vijë me postë veçmas.

A – 6020 Innsbruck, 06.08.1969

Instituti për
Gjuhësi Krahasuese
Universiteti i Innsbruck-ut

Zotit Prof. Dr. E. Çabej
Rruga Q. Stafa 395/12
Tiranë

Shumë i nderuar zoti Profesor!

I sapokthyer nga Zvicra gjeta letrën tuaj të datës 21.07. Për fat të keq ka mbërritur me vonesë, përndryshe do ta kisha blerë medikamentin menjëherë kur isha në Bernë. Por gjithsesi nuk ka problem, sepse tashmë e bleva dhe sot e dërgova me postë ajrore si mostër produkti. Shpresoj ta merrni në rregull. Dërgesa zyrtarisht do kishte qenë shumë e komplikuar, sepse rregullat e postës sa u takon medikamenteve, janë shumë të rrepta dhe pothuajse aspak të zbatueshme. Ju lutem të më shkruani menjëherë sapo ta keni marrë medikamentin. Nëse sërish do ju duhet diçka, do të gëzohesha, nëse do të më jepej mundësia t'ju ndihmoja të gjithëve. Gjithashtu u gëzova kur lexova se djali juaj është pak më mirë. Nëse do mund të vinit në vjeshtë, ndoshta si zëvendësues i prof. Mayrhofer-it, do të ishte shumë mirë dhe sigurisht që duhet ta lemë për t'u takuar.

Ju falenderoj shumë për propozimin tuaj për të ardhur një herë në vendin tuaj të bukur. Jam i gëzuar për këtë mundësi.

Kongresi në Bernë ishte shumë interesant, edhe pse çështjet e gjuhësisë historike dhe ato të gjuhësisë së përgjithshme gjenerative u trajtuan paralelisht pa lidhje me njëratjetrën. U fol edhe që indogjermanistika qenka e rrezikuar etj. Në kryesinë e re u zgjodhën prof. Mayrhofer, Rix dhe dr. Reichert. Redaktorit për revistën Kratylos, prof. Redard, iu caktua edhe një redaktor i dytë, me qëllim që puna të ecë përpara edhe më mirë. Do përpiqem të siguroj edhe një volum të përmbledhjeve të kongresit, të cilin do jua dërgoj juve.

Tani po vazhdoj përsëri me punën. Kam dëgjuar që Schmidt-Brandt ka përgatitur tashmë një raport kërkimor mbi gjuhën shqipe për një prej numrave të ardhshëm të revistës Kratylos.

Bashkëshortes dhe fëmijëve tuaj u dërgoj përshëndetje dhe urime shumë të përzemërta. Zoti Deutscher më dha negativët që bëri atëherë dhe unë po ia bashkëngjis kësaj letre.

Ju lutem më shkruani sërish, dhe nëse ju duhen medikamente të tjera, më njoftoni.

Përshëndetje të përzemërta.

Me nderime.

H. Ölberg

NB: Sa i takon festës jubilare për 300-vjetorin, senati vendosi që të ftohet respektivisht vetëm një i ftuar. Besoj se në këto rrethana ftesa për ju për fat të keq nuk do të jetë e mundur. Detajet e tjera ende nuk i di.

A – 6020 Innsbruck, 14 dhjetor 1969

Instituti për
Gjuhësi Krahasuese
Universiteti i Innsbruck-ut

Zotit Prof. Dr. E. Çabej
Rruga Q. Stafa 395/12
Tiranë

Shumë i nderuar, zoti Profesor!

Ju falenderoj shumë përzemërsisht për letrën tuaj të datës 9.11. Për fat të keq vetëm tani e pata të mundur t'ju përgjigjem dhe ju lutem të më falni për vonesën, por kam shumë presion pune në institut.

Sa i takon Kongresit të Onomastikës të Vjenës, rastësisht mora vesh pas kongresit që ju dhe zoti prof. Kostallari kishit qenë atje. Mund ta përfytyroni se sa u suprizova. Po ta kisha ditur, do të isha përjekur të paktën t'ju merrja në telefon! Unë nuk mund të largohesha nga puna, sepse gjatë verës pata bërë shumë lëvizje/udhëtime dhe më duhej të punoja. Kështu që ndiej vërtet keqardhje të jashtëzakonshme, që e humba këtë mundësi! Megjithatë shpresoj që për Shqipërinë të ketë qenë sërish një sukses si asokohe në Amsterdam, ku ju njoha për herë të parë, a e mbani mend?

Ndërkohë të gjitha dërgesat tuaja postare kanë arritur në rregull dhe besoj se Buzukun dhe Pellegrini-Prosdocimi-n i kam konfirmuar. Separatet ende nuk kanë mbërritur. Sa për mua, jam i kënaqur që e keni marrë Frisk-un dhe të tjerat, vetëm do më interesonte të dija, nëse i keni marrë edhe ilaçet. Dërgesa e tyre është gjithmonë e vështirë. Nga ana tjetër jam i lumtur që biri juaj është më mirë, nëse ju duhet diçka, më shkruani, sepse do t'jua siguroj me kënaqësi. Ndoshta do ta keni mundësinë më vonë ta përsërisni trajtimin në Vjenë?

Punimi juaj mbi Buzukun është tejet i vlefshëm, natyrisht që edhe ju vetë e dini këtë. Ndërkohë kam lexuar diku që në institutin tuaj është regjistruar/përpiluar leksiku jo vetëm i Buzukut, por edhe i dokumenteve të tjera monumentale të shqipes së vjetër, a do të dalin në shtyp edhe këto? Sa i takon Georgacas-it, para pak kohësh mora edhe prej atij vetë librin e tij mbi toponimet e Peloponezit. Nëse librin që më dërguat ju, do ta donit edhe për dikë tjetër, do ta dërgoja më tej atje ku duhet.

Tani po ju dërgoj disa nga përmbledhjet e Kongresit të Bernës, madje edhe diçka nga firma Leroy[10], kjo më shumë për të futur edhe gjëra të tjera brenda. Nëse këto janë të duhurat, më shkruani, ju lutem, që të blej edhe të tjera. I kam rezervuar, sepse nuk është e lehtë të gjesh gjithmonë të njëjtin model. Nuk më kujtohet me saktësi se si ishte mbulesa e tavolinës asokohe, por shpresoj që p[ecetat] t'i përshtaten.[11] Do të gëzohesha, nëse do t'i pëlqente bashkëshortes suaj.

Ekspozita për Shqipërinë ishte faktikisht në Innsbruck. Rastësisht lexova për të në gazetë dhe bëra plan për ta vizituar në fundjavë. Për fat të keq kisha kaq shumë presion për të përgatitur leksionet, saqë nuk munda të shkoja atje menjëherë. Por edhe në fundjavë më dolën gjëra të paparashikuara, kështu që për keqardhjen time të madhe nuk e shfrytëzova dot këtë mundësi. Sinqerisht që nuk e kuptoj, përse ekspozita nuk u përgatit më mirë. Emri im njihet në Vjenë dhe unë mund t'i kisha ndihmuar. Edhe shtypin nuk e afruan pothuajse fare, pra me pak fjalë, ekspozita mund të kishte pasur një jehonë më të gjerë. Por siç dëgjova, ajo kishte qenë goxha informuese dhe domethënëse. Sa i takon portretit të Skënderbeut në Amras, do të kujdesem për këtë kur të takohem me restauratorin. Asokohe i kisha dërguar bibliotekës suaj një kopje të një pjese teatrale jezuite mbi Skënderbeun dhe me siguri që edhe juve ju kisha shkruar për këtë; një reportazh për këtë e shkroi edhe docenti Hölzl për gazetën e këtushme, ai është kritik teatri, e ky reportazh është botuar edhe te "Shejzat". Kjo pjesë teatrale gjendet në muzeun Ferdinandeum.

A e keni vizituar kështjellën Amras gjatë semestrit të studimeve tuaja këtu? Ajo është restauruar sërishmi dhe është kthyer në një qendër të madhe kulturore. Në verë shpesh mbahen koncerte në parkun e saj, vërtet shumë romantike.

Për festat që po afrojnë, ju dërgoj juve dhe familjes suaj përshëndetje dhe urime shumë të përzemërta. Shpresoj që viti i ardhshëm të jetë i mbarë për të gjithë ju. Shtojca e letrës është për djalin tuaj, nëse koleksionon.

Me nderime

H. Ölberg

P.S. Më shkruani ndonjëherë, çfarë i pëlqen vajzës suaj dhe t'i dërgoj diçka pastaj.

10 Leroy – kompani që tregton produkte për dekorimin e shtëpisë. [shënim i përkthyesit]

11 Nga përmbajtja e këtij paragrafi duket që profesori rezervohet në të shkruar, sepse fjalën "pecetë„ e shkruan me inicialе "S„ (Serviette) dhe nuk e shpreh hapur që po dërgon diçka në formë dhurate. [shënim i përkthyesit]

A – 6020 Innsbruck, 16 janar 1970

Instituti për
Gjuhësi Krahasuese
Universiteti i Innsbruck-ut

Zotit Prof. Dr. E. Çabej
Rruga Q. Stafa 395/12
Tiranë

Shumë i nderuar zoti Profesor!

Para së gjithash, ju falenderoj shumë përzemërsisht për surprizën e madhe që më bëtë me ato dy gjërat e bukura. Njëra do të admirohet prej të gjithëve mbi skrivaninë time, kurse pikturën e vara në dhomën time të punës. Edhe një herë shumë falemnderit! Shpresoj që dërgesa ime e mëparshme të ketë mbërritur mirë, dhe do t'ju siguroja edhe ekzemplarë të tjerë.

Tani do të kisha një kërkesë të rëndësishme. Në numrin e këtij viti të revistës sonë 16/1970 po përgatisim një botim festiv për nder të Karl Finsterwalder-it, studiuesit tonë të onomastikës, i cili ka hulumtuar Tirolin që nga kohërat e lashta e deri te dialektet bavareze dhe mbi materialet e të cilit bazohej disertacioni im i atëhershëm mbi emrat pararomakë. Ftesat unë i kam dërguar që vitin e kaluar, por po shoh që me sa duket, juve nuk ju paskam shkruar. Por me këtë rast një punim i juaji do të ishte tejet i vlefshëm. A mund t'ju pyes dhe t'ju kërkoj në mënyrë të paturpshme, nëse do ta kishit të mundur të hartonit edhe një artikull për ne, duke pasur parasysh që tematika e këtij vëllimi titullohet "Studime për Alpet" dhe unë marr guximin t'ju pyes nëse ju mund të vazhdoni të trajtoni onomastikën e alpeve shqiptare ashtu siç e kishte trajtuar Jokl-i, (Vox romanica 8, 1945–1946)? Nuk do të kishte kënaqësi më të madhe për mua se sa të botoja në revistën tonë një punim të tillë tuajin. Natyrisht që tani do të fillojmë me faqosjen dhe do të ishte e nevojshme që ta shkruanit së shpejti studimin, në mënyrë që ne të mund ta kemi deri për Pashkë. E di që këto janë kërkesa të paturpshme, por meqenëse ju keni qenë gjithmonë dashamirës ndaj meje, po i lejoj vetes t'jua kërkoj me ngulm këtë. Gjatësia e artikullit të jetë si zakonisht, dhe pjesa tjetër është krejtësisht në dorën tuaj.

Po ju bashkëngjis edhe një ftesë, siç i kemi dërguar fillimisht.

Uroj ta keni filluar mbarë vitin e ri së bashku me familjen. Nëse ju duhet diçka, më shkruani ju lutem. A e dispononi ndërkohë artikullin e Barić-it "Albanisch, Romanisch und Rumänisch!", botuar në Godišnjak 1, Sarajevë 1957 (për të cilin në një punim ju shkruanit që ai nuk ishte në dispozicion)?

Ky vëllim përmban edhe më shumë punime albanologjike, por ndërkaq do të ketë mbërritur në bibliotekën tuaj. Pëndryshe do t'ju dërgoj një fotokopje.

Me urimet më të mira dhe me respekt

H. Ölberg

Ftesa e lartpërmendur:

Shumë i nderuar zoti koleg!

Në datën 14 prill 1970 Profesor Doktor Karl Finsterwalder do të mbushë moshën 70 vjeç. Meritat e tij të mëdha për studimin shkencor të hapësirës së Alpeve në aspektin gjuhësor, gjeografik dhe historik, janë të njohura në nivel ndërkombëtar dhe na japin shkas ta nderojmë me rastin e jubileut me një botim festiv të denjë. Gjuhëtarë, gjeografë dhe historianë të universitetit kanë në plan që këtë vëllim ta botojnë si volumin e 16-të të revistës "Studimet e Universitetit të Innsbruck-ut për Shkencat Kulturore".

Do t'ju ishim shumë mirënjohës nëse do donit të kontribuonit për hartimin e këtij botimi festiv nëpërmjet një artikulli shkencor dhe nëse do të mundnit t'i dërgonit redaksisë deri në korrik 1969 një dorëshkrim prej maksimumi 15 faqesh daktilografike. Temat duhet të pasqyrojnë fushën e gjerë të interesit të profesorit të nderuar dhe të trajtojnë p.sh. çështje të gjuhësisë, studimeve toponimike, studimeve të ngulimeve dhe çështje të ngjashme duke marrë në konsideratë veçanërisht hapësirën e Alpeve.

Do t'ju ishim shumë mirënjohës për një përgjigje të shpejtë; karshi profesorit të nderuar do t'ju luteshim të ruanit sekretin.

Prof. Dr. W. Meid

Adresa e redaksisë:
"Innsbrucker Beiträge zur Kulturwissenschaft"
Institut für vergleichende Sprachwissenschaft
Innrain 30
A 6020 Innsbruck

A – 6020 Innsbruck, 03.07.1970

Instituti për
Gjuhësi Krahasuese
Universiteti i Innsbruck-ut

Zotit Prof. Dr. E. Çabej
Rruga Q. Stafa 395/12
Tiranë

Shumë i nderuar, zoti Profesor!

Ju falenderoj përzemërsisht për letrën tuaj të datës 15.06. dhe gëzohem që jeni shëndoshë e mirë. Ajo letër ka kaq shumë informacione, saqë po ju përgjigjem sipas radhës:

Botimi festiv për Finsterwalder-in: Më vjen jashtëzakonisht keq që nuk jeni në gjendje të bashkëpunoni. Natyrisht që i kuptoj shumë mirë arsyet tuaja, por a më lejoni t'ju kërkoj edhe një herë se mos vallë të paktën mund të shkruanit një artikull të shkurtër, ndoshta për marrëdhëniet/lidhjet alpine? Ju keni pasur aspekte të ndryshme në artikujt tuaj etimologjikë, a mund t'i përmblidhni ato? Janë edhe 7 bashkëpunëtorë që ende nuk i kanë dorëzuar artikujt, kështu që do të zgjasë edhe 2 muaj deri sa unë ta përfundoj këtë vëllim, madje edhe atëherë do të duhet kohë për radhitjen në shtypshkronjë dhe do të kemi mundësi për të futur diçka shtesë. Nuk besoj se do ta kemi gati faqosjen para shtatorit. Në të vërtetë nuk e përfytyroj dot këtë botim festiv pa artikullin tuaj dhe madje do të prisja për faqosjen, nëse do ta dija se do të na vinte edhe një shkrim i juaji! Ju lutem mos m'u zemëroni, por ndoshta megjithatë mund të bëni diçka??

Nga rreshtat tuaja kuptoj që, mesa duket, do të më vijë një ftesë dhe që ne ndoshta do të shihemi në Tiranë? Kjo natyrisht që do të më gëzonte shumë, por unë do t'ju isha shumë mirënjohës nëse ju ndoshta mund të më bëni të ditur edhe periudhën. Në fillim të semestrit të dimrit synoj të dorëzoj punimin për habilitimin (për marrjen e titullit profesor) dhe kolokuiumi mund të jetë para Krishtlindjeve. Në këtë rast do të isha nën trysni të madhe, siç mund ta kuptoni, saqë për mua më mirë do të ishte një datë në pranverë. Por ende nuk di se sa duhet të zgjasë kjo vizitë dhe a kam detyrime ndaj kolegëve, apo do të jetë vetëm një vizitë e thjeshtë? Ju lutem më shkruani shkurtimisht, sepse ju e njihni situatën dhe e dini ç'duhet bërë. Më tej ju keni shprehur dëshira shumë modeste, ndërsa unë do kisha kënaqësinë t'u sillja diçka bashkëshortes dhe vajzës suaj dhe do preferoja që të m'i shkruani dëshirat e tyre, me qëllim që të gjej gjënë e duhur. Sa vjeç është vajza dhe çfarë i pëlqen veçanërisht?

Në fund të marsit ju kam dërguar pjesën nr. 21 të Frisk-ut dhe shpresoj që e keni marrë, përndryshe ju lutem të më shkruani!

Përgjatë dy semestrave kam mbajtur lëndën e Hyrjes në Gjuhën Shqipe, bazuar te Camaj, sepse këtu nuk ka gramatikë tjetër. Për fat të keq një zhgënjim i madh, jo vetëm shkel e shko, por edhe me gabime të drejtpërdrejta. Dëgjuesit e mi nuk ishin entuziastë

dhe brenda mundësive e kompensova këtë. Ka ardhur koha që të ndodhë diçka në këtë fushë. Në semestrin e dimrit do vazhdoj të bëj një orë gramatikë me tekste, veçanërisht lakime dhe zgjedhime, në këtë aspekt paraqiten vështirësi të pabesueshme, e megjithatë edhe mua m'u desh një kohë e gjatë deri sa e kuptova! Pastaj do të bëj edhe 2 orë gramatikë historike dhe më duhet të nxjerr ekstraktet për indogjermanistin.

Momentalisht po përgatis një artikull për teorinë laringale të Hamp-it për revistën KZ, i cili njëkohësisht është edhe një kapitull i punimit tim të habilitimit "Fonetikë historike dhe kronologji relative". Gjatë gjithë verës do të jem i zënë me hartimin përfundimtar të këtij punimi.

Gëzohem që hulumtimet tuaja etimologjike tashmë do të botohen në formë libri, është një vepër gjeniale. Pikëpamjet tuaja mbi "ha" – "gjerm. Essen", "harr" – "gjerm. Jäten", "hut" – "gjerm. leer", "hyp" – "gjerm. steigen" dhe kryesisht për h-në përpara i-së "hi" – "gjerm. Asche" do të më interesonin për këtë artikull. Kam mbledhur edhe një radhë komentesh në lidhje me fjalë kyçe të veçanta të punimit tuaj. Sapo të më jepet mundësia, do t'i përmbledh të gjitha dhe do t'jua dërgoj.

Sa i takon fjalorit të ri të gjuhës së shkruar, për çdo folje duhet të jepet patjetër klasa e zgjedhimit. Gjatë kursit këtë e perceptova si një mangësi të madhe, sepse asnjë fjalor përveç atij të Weigand-it nuk i përmban këto të dhëna. Tek emrat ishte dhënë rregullisht shumësi i tyre, kështu që edhe foljet do duhet të përcaktoheshin. Më tej do duhet të jepeshin edhe sasitë. Atëherë po ju falenderoj dhe ju lutem të më shkruani shkurtimisht.

Me respekt

H. Ölberg

A – 6020 Innsbruck, 18 gusht 1970

Instituti për
Gjuhësi Krahasuese
Universiteti i Innsbruck-ut

Zotit Prof. Dr. E. Çabej
Rruga Q. Stafa 395/12
Tiranë

Shumë i nderuar, zoti Profesor!

Me gëzim të madh mora letrën tuaj të datës 26.07. dhe ju falenderoj nga zemra. Nga Ambasada Shqiptare në Vjenë m'u përcoll me të vërtetë ftesa, çka më gëzoi shumë, por më shumë ndiehem edhe i nderuar. Në këtë frymë u përgjigja që në datën 7 tetor do të mund të nisesha me avion nga Budapesti. Në datën 5 tetor do të isha në Vjenë për të kryer të gjitha formalitetet. Kështu po realizohet një dëshirë e vjetër dhe jam i gëzuar që

do të njihem me ju, bashkëshorten tuaj dhe fëmijët. Për fat të keq, ju sërish nuk më keni shkruar dëshirat konkrete të familjes suaj. Për mua do të ishte më e lehtë, po ta dija me përafërsi me se t'ua bëja qejfin. Sa vjeç është vajza? Nëse ju duhen medikamente ose gjëra të ngjashme, ju lutem më njoftoni, sepse ende jemi në kohë.

Atë faqen nga KZ 34 në lidhje me "bir" e kopjova dhe po ia atashoj letrës. Ajo çka thotë Treimer-i në lidhje me "brez", RRPH 38, 391, është thjesht një pohim që ajo është një fjalë e vjetër autoktone që përdoret për veshje, me fjalën rumune "briu". Përndryshme fjala "brez" nuk shfaqet më në të gjithë artikullin e Treimer-it. Prandaj edhe nuk e kopjova këtë pjesë të tekstit.

Citimin e Alessio-s mbi fjalën "buf" në "Annali dell Univ. Bari 1, 1954" nuk mundem ta verifikoj, por shpresoj të marr së shpejti të dhëna më të sakta, të cilat do t'jua përcjell më tej.

Bashkëngjitur edhe një listë e vogël me komente/vërejtje.

Kënaqësi të madhe më solli edhe lajmi juaj, që do të jeni në gjendje të dorëzoni një artikull për botimin festiv për nder të Finsterwalder-it. Ju falenderoj nga zemra dhe ju lutem të më falni për kokëfortësinë me të cilën ju bie herë pas here në qafë!

Ju lutem më shkruani për dëshirat konkrete. Ndërkaq ju dërgoj shumë të fala edhe për bashkëshorten tuaj.

Me nderime

H. Ölberg

Innsbruck, 7.9.1970

Shumë i ndershmi, zoti profesor,

në lidhje me krahasimin si të barabarta nga ana juaj të fjalëve "i zi", "juodas" dhe "irlandisht: adaig" – natë (në shkrimin "Mbi disa fjalë që fillojnë me -z", faqja 209 ff) dua t'i referohem thënies së profesor W. Meid-it në shkrimin Die Romanze von Froich (Táin Bó Froich), botuar në numrin special 30 të revistës IBK [IBK = Studimet e Universitetit të Innsbruck-ut për Shkencat Kulturore], ku ai hedh poshtë etimologjitë e deritanishme të fjalës "adaig" (ky numër i revistës i është dëguar bibliotekës suaj).

"Juodas" e lituanishtes është gjithashtu e pazgjidhur sipas Fraenkel-it, Fjalori Etimologjik i Lituanishtes. – A e posedoni ju ose Biblioteka juaj universitare fjalorin e ri krahasues të gjuhëve sllave të autorëve Sadnik-Aitzemüller, Wiesbaden, Harrassowitz, deri tani me 5 pjesë? – Para disa ditësh ju është dërguar pjesa e 22-të e Frisk-ut me gjithë kopjen e Papanti-t. – Nga Ambasada Shqiptare në Vjenë kam kërkuar një ftesë zyrtare, por deri tani nuk ka ardhur, e megjithatë shpresoj që gjithçka të shkojë mirë!

Me nderime

H. Ölberg

A – 6020 Innsbruck, 29.09.1970

Instituti për
Gjuhësi Krahasuese
Universiteti i Innsbruck-ut

Zotit Prof. Dr. E. Çabej
Rruga Q. Stafa 395/12
Tiranë

Shumë i nderuar zoti Profesor!

Më lejoni t'ju njoftoj shkurtimisht që si datë përfundimtare e nisjes së udhëtimit tim me Ambasadën Shqiptare në Vjenë u dakordësua 14 tetori. Jam shumë i gëzuar për këtë udhëtim interesant dhe sidomos që do të kem mundësinë t'ju takoj juve pas kaq shumë vitesh si edhe zotin profesor Kostallarin. Gjithashtu do të njoh familjen tuaj të dashur.

Kam prerë nga faqja e gazetës artikullin që shkruan për konkursin e atëhershëm në Innsbruck, por sot insbrukasit kanë ardhur te ju!

Shpresoj të marr edhe një lajm nga ju dhe gjithashtu një listë me dëshira.

Me respekt

H. Ölberg

A – 6020 Innsbruck, 11.11.1970

Instituti për
Gjuhësi Krahasuese
Universiteti i Innsbruck-ut

Zotit Prof. Dr. E. Çabej
Rruga Q. Stafa 395/12
Tiranë

Shumë i nderuar zoti Profesor!

Menjëherë pas kthimit tim më duhet t'ju njoftoj që kam mbërritur mirë. Por në Budapest m'u desh të flija një natë, sepse treni i mbrëmjes nuk udhëtonte më në sezonin e dimrit. E kështu kalova një mbrëmje shumë interesante bashkë me profesor Erdödi-n në kodrën Gellertberg!

Tri javët që kalova në vendin tuaj ishin të bukura dhe interesante, si edhe tejet të rëndësishme edhe për punën time. Kështu ju falenderoj juve dhe të gjithë zotërinjtë që u angazhuan për të ma mundësuar këtë vizitë studimore.

Në Vjenë fola shkurtimisht me profesor Mayrhofer-in dhe Solta-n dhe u përcolla të dyve të falat tuaja. Me sa duket, artikujt e revistës "Die Sprache" për vitin 1971 tashmë janë radhitur pjesërisht në shtypshkronjë, por ata do të shohin nëse mund të afrojnë në kohë edhe botimin e artikullit tuaj, megjithatë premtime nuk mund të bëhen.

Tani dua të bisedoj me ju si më poshtë:

Si biblioteka juaj, profesor Domi, ashtu edhe në Shkodër më kërkojnë që t'u dërgoj revistën "Die Sprache". Prandaj në Vjenë e preka këtë temë me Dr. Pfeiffer-in dhe ai më tha që ata nga ana e institutit në këmbim të "Studime filologjike" dhe "Studia albanica" jua dërgojnë juve rregullisht revistën "Die Sprache", gjë që më habiti shumë (megjithatë unë nuk fola me ju për këtë në Tiranë). Por përpara se t'i shkruaj bibliotekës dhe të trajtoj kërkesën e saj, dua t'ju pyes si të veproj.

Sa i takon anëtarësimit në Shoqatën e Indogjermanistikës, i kam shkruar profesor Mayrhofer-it. Ose ju ose Instituti juaj do të merrni njoftim. Numrat e viteve të deritanishme të botimit do ia dërgoj Bibliotekës suaj nga fondi im me kërkesën për t'ia përcjellë institutit tuaj (janë rreth 5 vite botim). Nëse anëtarësimi kryhet me sukses dhe pastaj numrat e revistës do ju dërgohen automatikisht nga shtëpia botuese, ju lutem të më njoftoni.

Sa i takon një anëtarësimi të mundshëm në shoqatën Societas linguistica Europaea, i kam shkruar prof. Werner Winter-it, me adresë D 23 Kiel, Olshausenstr. 40–60. Shpresoj që edhe ata t'ju dërgojnë njoftim juve ose institutit tuaj. Revista në fjalë do të ishte: Folia linguistica, Mouton Den Haag.

Fotokopjet me Xerox do t'i bëj në ditët në vijim, kështu që javës tjetër mund t'jua rikthej librat me postë.

Sa i takon fjalës gote "andeis" – "Ende" (shqip: fund), unë kam verifikuar te bibla e Streitberg-ut të gjitha pasazhet ku ajo shfaqet, dhe i kam ekstraktuar, shih shtojcën. Në të gjitha rastet fjala "andeis" ka kuptimin "fund, kufi, synim/destinacion".

Separati rreth fjalës "mal-" i profesor Finsterwalder-it do t'ju dërgohet menjëherë.

Në lidhje me artikullin tuaj për Finsterwalder-in do t'ju isha shumë mirënjohës, nëse do ta kishim këtu sa më shpejt të jetë e mundur, sepse po radhiten edhe shkrimet e fundit. Por unë dua të pres padiskutim edhe për ju!

Me zonjën, prof. Hornung nuk arrita dot të flas, sepse për fat të keq arrita në Vjenë një ditë më vonë, por do t'i shkruaj tani në lidhje me artikullin tuaj. Me këtë rast më vjen ndër mend, që profesor Kostallari më kërkoi të interesohesha në Vjenë, se përse dy vëllimet e kongresit të onomastikës së Vjenës nuk i kanë shkuar ende. Nëse nuk gaboj, ju më keni thënë që i keni dy vëllime, a janë këto ato që kanë porositur institucionet, apo janë ekzemplarë privatë tuajt? Nuk po e pyes ende zonjën Hornung, deri sa të më çoni ju njoftim.

E sërish më ka përfshirë vrulli i punëve në Institut, tri javët e bukura për fat të keq kaluan shpejt, këtu moti është i ftohtë, por i thatë, nëpër male ka dëborë e mua do të më bënte mirë sërish pak diell nga Shqipëria. Edhe një herë shumë falemnderit dhe të fala bashkëshortes dhe familjes suaj.

Me respekt

H. Ölberg

P.S. Në Institutin tonë kemi si dubleta vëllimin 1 dhe 7 të revistës "Die Sprache". Mund t'ju vinim juve në dispozicion.

Letër e shkurtër e Prof. Ölberg e datës 17.01.1971 e shkruar në shqip.
(me makinë shkrimi)

Shumë i nderuari Profesor,

Shpresoj që keni filluar mirë vitin e ri e jua dërgoj akoma urimet më të mira për ju e familjes suaj [sic!]. Në lidhje me Festschrift Finsterwalder morëm gjithë dorëshkrimet e ju lutem nga zemra ime të më dërgoni edhe kontributin tuaj.

Ju e dini sa e vlefshme është vepra juaj!

Sa i përket fonologjisë shqipe mund t'ju them që do ta mbaroj në dy ose tre muaj. Shpresoj që do të qëndroj në kritikën tuaj!

Me nderime

H. Ölberg

Letër me shkrim dore, gjermanisht, e marsit 1971, në të cilën Prof. Ölberg ngushëllon me fjalë të ndjera Prof. Çabejn për ndarjen e parakohshme nga jeta të të birit. Për fat të keq nuk janë të lexueshme qartë të gjitha fjalët e letrës, kështu që nuk mund ta riprodhojmë të plotë në shqip.

A – 6020 Innsbruck, 07.04.1971

Instituti për
Gjuhësi Krahasuese
Universiteti i Innsbruck-ut

Zotit Prof. Dr. E. Çabej
Rruga Q. Stafa 395/12
Tiranë

Shumë i nderuar zoti Profesor!

Pas ngjarjeve të rënda me të cilat u sprovuat, shpresoj që gjendja juaj dhe e bashkësortes suaj të jetë disi e mirë, uroj të njëjtën gjë edhe për vajzën tuaj! Mund të përfytyroj se çfarë boshllëku është krijuar në jetën tuaj. Më vjen mirë që përkujtimi im ishte i përshtatshëm dhe falenderoj gjithashtu bashkëshorten tuaj për fjalët që më shkroi. Gjithashtu edhe gruaja ime ju falenderon përzemërsisht!

Sot dua thjesht t'ju bëj me dije, se i kisha ofruar bibliotekës suaj (Bibliotekës universitare) revistën e shkencave të antikitetit që botohet këtu te ne nga Instituti i Filologjisë Klasike, dhe duke plotësuar kërkesën e bibliotekës, i kam dërguar vitet e botimit 17–22, vitet në vazhdim do të vijnë pastaj me radhë rregullisht. Revista përmban raporte kërkimore-shkencore dhe recensione, si edhe shumë njoftime personale. Unë nuk e di se ku do të përcillet më tej revista, por besoj se vendi më i përshtatshëm për të do të ishte instituti juaj.

Në ditët në vijim do ju dërgoj një leksion nga fondi i trashëguar i profesor Krahe, të cilin e kemi botuar në kolanën tonë të re IBS Innsbrucker Beiträge zur Sprachwissenschaft (shqip: Studimet e Universitetit të Innsbruck-ut për Shkencat Gjuhësore). Më pas, një manuskript mbi çështjen e nazalizimit dhe ju lutem të jepni gjykimin tuaj kompetent. Unë thjesht nuk mund ta besoja që rrokjet e vjetra "an" dhe "en" të jenë njesuar në gegërisht në "ën", për t'u ndarë më pas sërish nga njëra-tjetra në mënyrë të paqartë. Edhe barazimet tuaja *arena* > *ranë*, por *frenu-* > *frêni* nuk më lanë të qetë. Vërtet edhe unë vetë nuk kam gjetur ende një zgjidhje për këtë, por këta shembuj tipikë idealë duke filluar që nga Jokli, sipas mendimit tim, janë përjashtime, prej të cilave nuk mund të nisemi. Jam kureshtar se çfarë do të thoni ju për këtë. Do t'ju dërgoj pastaj edhe një bateri për vajzën.

Më lejoni t'ju shkruaj edhe diçka nga muajt e kaluar. Në fund të shkurtit, ju kam dërguar kapakun e kopertinës së Frisk-ut, për vëllimin e dytë. Shpresoj ta keni marrë, gjithashtu edhe librat e ndryshëm që m'i dhatë hua në Tiranë dhe që sapo përfundova fotokopjet e tyre, menjëherë jua dërgova mbrapsht sërish me rekomandé. Vëllimi i regjistrit të Frisk-ut do të botohet kompakt këtë vit, por ende nuk e di se kur me saktësi, por ju natyrisht që do ta merrni.

Në lidhje me botimin festiv për Finsterwalder-in kuptohet që nuk shpresojmë më artikull nga ana juaj. Gjithashtu ju kisha dërguar kopje të artikullit të vetë Finsterwalder-it, të

cilin duhet ta keni marrë. Por në rast se fuqitë tuaja gjithsesi ju kanë lejuar ta vazhdoni temën që kishit planifikuar për botimin festiv, unë edhe tani do të mund ta fusja për botim artikullin tuaj, sepse procesi i botimit po ecën me hapa jashtëzakonisht të ngadalta. Por gjithsesi dorëshkrimi juaj do duhej të na vinte shumë shpejt. Gjithsesi e kuptoj që nuk mund t'ju bezdisim me këtë çështje. Shpresoj që gjithsesi të keni pasur mundësinë të përfundoni kumtesën tuaj për kongresin e onomastikës dhe t'ia keni dërguar redaksisë së Vjenës. Më lejoni t'i rikthehem letrës sime të datës 11.11.1970, ku ju kisha shkruar për përpjekjet e mia në lidhje me Shoqatën e Indogjermanistikës. Siç më ka bërë me dije profesor Mayrhofer-i, çështja është rregulluar në mënyrë të tillë që ju do të merrni të paktën njoftimet dhe komunikimet e rregullta të shoqatës, ndërkohë që unë do t'ju dërgoj revistën Kratylos. Shpresoj pra që të ketë funksionuar që ose ju ose instituti juaj të merrni njoftimet në fjalë. Revista Kratylos do t'i dërgohet bibliotekës suaj universitare. Ju kisha pyetur më tej edhe për revistën "Die Sprache", se çfarë duhej të bëja, dhe do t'ju isha mirënjohës, nëse do të më shkruanit në lidhje me këtë.

Së fundmi dua gjithashtu t'ju bëj me dije që para pak kohësh i kam dërguar institutit tuaj shiritin magnetik me incizimin e Joklit mbi dialektin e Rapshishtit. Shpresoj të mbërrijë në rregull. Është dërguar së bashku me një paketë ku ndodheshin vëllimet e enciklopedisë. Do të isha mirënjohës nëse do të merrja një konfirmim në lidhje me shiritin magnetik, sepse do të njoftoj në lidhje me të edhe Arkivin e Fonogrameve të Vjenës. Cilësia natyrisht që është shumë modeste, por diçka mund të kuptohet. Ky mund të ishte incizimi më i vjetër që disponojnë shiqiptarët, apo jo? Është një kënaqësi për mua që përpjekjet e mia shumëvjeçare tanimë patën sukses. Dhe ky incizim duhet të jetë më në fund në institutin tuaj! A e dini se ku ndodhen shënimet/regjistrimet që ka bërë Jokli asokohe me informantët, mos vallë janë ruajtur në Bibliotekën Kombëtare? Ai ka punuar shumë intensivisht me ta dhe aty duhet të ketë një material shumë interesant. – Sa i takon enciklopedisë, kini mirësinë ju lutem, t'i thoni profesor Kostallarit, që vëllimet e fundit janë nisur sot. Ai do duhej të ketë vëllimet 1–30, indeksin e 30-ës dhe një vëllim plotësues (suplement). Për fat të keq vëllimi 5 dhe 19 më humbën, por i shkrova redaksisë dhe shpresoj që do t'i marr edhe ato. Do të gëzohesha nëse kjo enciklopedi do të ishte e dobishme për institutin. Çdo ditë për disa çaste ju mendoj ju dhe vendin tuaj të bukur. juve, bashkëshortes dhe vajzës suaj ju uroj gjithë të mirat. Jemi thjesht njerëz dhe kështu nuk mund ta dimë se çfarë na ka caktuar fati çdo ditë e me se duhet të përballemi.

Shumë të fala!

Me respekt

H. Ölberg

A – 6020 Innsbruck, 27.06.1971

Instituti për
Gjuhësi Krahasuese
Universiteti i Innsbruck-ut

Zotit Prof. Dr. E. Çabej
Rruga Q. Stafa 395/12
Tiranë

Shumë i nderuar zoti Profesor!

Me gëzim të madh mora dërgesën tuaj, në të cilën ndodheshin shtypshkrimi i bukur e i pastër i Hyrjes suaj si edhe një vëllim i "Gjurmime Albanologjike". Ju falenderoj shumë dhe që tani kam filluar t'i lexoj. Vërtet prej jush ende nuk kam marrë lajm dhe as kritikë të mprehtë në lidhje me doreshkrimin tim, por paraprakisht dëshiroj t'ju bëj një surprizë të vogël. Para pak kohësh më ra ndër mend, që në maj të vitit 1972 do të jetë 30-vjetori i vdekjes së Joklit dhe që duhet të ndërmarrim diçka, nëqoftëse në Vjenë nuk do të organizojnë gjë. Po mendoja për një konferencë shkencore albanologjike në Innsbruck dhe më saktësisht fund shtatori – fillim tetori 1972. E biseduam këtë me profesor Mayrhofer-in, si kryetar të Shoqatës së Indogjermanistikës dhe kur para pak kohësh u zhvillua në Köln një kolokuium i indogjermanistikës, ai ia parashtroi këtë plan Shoqatës dhe plani u vendos. Kështu pra momentalisht kemi një kolokuium në lidhje me Shoqatën e Indogjermanistikës. Kjo tani na vendos përpara problemeve të ndryshme, të cilat do t'i parashtroj menjëherë, por para së gjithash hëpërhë dëshiroj t'ju informoj në rreth të mbyllur ju dhe miqtë e mi dashamirës në Shqipëri dhe kam shumë shpresë që shumë prej atyre që i njoha atje si edhe të tjerë t'i ritakoj këtu në Innsbruck! Bashkëngjitur gjendet edhe një program paraprak i kësaj konference. Por: nga njëra anë synojmë një konferencë gjithëpërfshirëse, ku të diskutohet shumë për problemet gjuhësore të albanologjisë, nga ana tjetër, indogjermanistët që nuk dinë shumë rreth shqipes, natyrisht kanë dëshirën të dëgjojnë referate gjithëpërfshirëse, pa kaluar në çështje specifike. Këto dy fusha interesi të papajtueshme jam përpjekur t'i bashkoj në mënyrë të tillë që pjesa e parë, p.sh. nga e enjtja deri të shtunën, t'i kushtohet indogjermanistikës, pjesa e dytë çështjeve specifike të albanologjisë dhe ballkanologjisë.

Ju lutem të na komunikoni sa më shpejt të gjitha idetë që keni në lidhje me këtë. Nga pikëpamjet e ndryshme më pas do të formohej një program përfundimtar dhe besojmë se nga vjeshta do të jemi në gjendje të dërgojmë ftesat zyrtare. Atëherë: sa i takon një date të favorshme, a mund të fillojë konferenca që të enjten, në cilat ditë fluturojnë avionët? Si do ta strukturonit ju pjesën kushtuar indogjermanistikës? Të planifikojmë shumë referate të veçanta, apo të mbledhim më parë qëndrimet e studiuesve të ndryshëm për çështje të caktuara, në mënyrë që më pas të referohet përmbledhtazi dhe të diskutohet? Cilat tema të indogjermanistikës propozoni ju? A mund të përpiloni një listë të tillë tematike? U shtrua edhe pyetja, nëse duhet apo mund të organizohet një kurs intensiv 2-ditor për

indogjermanistët e interesuar. Strukturimi/mbrujtja i/e temave për pjesën e dytë nuk besoj të jetë dhe aq i komplikuar, pasi këtu specialistët do jenë brenda rrethit të tyre. E megjithatë edhe për këtë ju lutemi të na dërgoni propozime.

Supozojmë se nga vendi juaj do të krijohet një delegacion për fushat specifike të diskutimit, për të cilin tani natyrisht që ende nuk mund të thuhet gjë, por ju e dini mirë se si procedohet në raste të tilla te ju.

Dhe tani më lejoni t'ju raportoj se para pak kohësh isha në kështjellën Amras për t'u interesuar për tablonë e Skënderbeut, për të cilën më keni shkruar një herë. Në të vërtetë ajo ekziston ende, por momentalisht ndodhet në Vjenë për t'u restauruar. Arrita të shoh vetëm një fotografi, goxha e mirë dhe porosita të më bëjnë një negativ të saj. Pas pak kohësh do të më dërgojnë ekzemplarët e zmadhuar dhe një prej tyre do t'jua dërgoj juve. Për nder të kongresit do donim të organizonim në kështjellën Amras një ekspozitë të vogël në Sallën e Armëve, gjithashtu edhe me materiale nga Muzeu Ferdinandeum.

Shpresoj që kjo letër t'ju gëzojë, sepse në Tiranë u ndamë me fjalën "Mirupafshim" dhe shpresoj se do të rishihemi në Innsbruck. Merrni me vete edhe bashkëshorten tuaj!

Para pak kohësh përfundova hartimin e një artikulli mbi teorinë laringale dhe gjuhën shqipe (kundra Hamp-it) për KZ. Jeni të interesuar të merrni një kopje?

Për stinën e verës ju uroj juve dhe familjes suaj pushime të mbara dhe shlodhje të mjaftueshme. Ju lutem të na shkruani së shpejti.

Deri atëherë ju shpreh si përherë

nderimet e mia.

H. Ölberg

A – 6020 Innsbruck, 21 dhjetor 1971

Instituti për
Gjuhësi Krahasuese
Universiteti i Innsbruck-ut

Zotit Prof. Dr. E. Çabej
Rruga Q. Stafa 395/12
Tiranë

Shumë i nderuar, zoti Profesor!

Javën e fundit me mendje kam qenë shpesh te ju dhe familja juaj dhe e di që disa plagë nuk mund të shërohen, por megjithatë shpresoj që ju të gjithë të jeni mirë dhe po ashtu të vazhdoni të jeni mirë edhe vitin e ardhshëm.

Për fat të keq nuk kam pasur mundësi t'i përgjigjem menjëherë letrës suaj të detajuar, së pari sepse unë vetë që nga pushimet verore po vuaj nga mbifunksionimi i gjendrës tiroide, prej të cilit tani po e marr veten sërish, së dyti sepse edhe bashkëshortja ime ka pasur probleme, për shkak se pas heqjes së një dhëmbi ajo pati sinusit maksilar dhe u operua para pak kohësh. Për shkak të kësaj situate unë kam qenë mjaft i zënë me punë gjithashtu edhe në shtëpi dhe mezi gjeja qetësi për të menduar e për të shkruar. Kështu edhe urimet e mia fatkeqësisht do t'ju vinë me vonesë, por siç e dini, ato burojnë nga zemra. Para pak kohësh ju kam dërguar një kalendar për vitin 1972 dhe shpresoj që të mbërrijë në rregull dhe t'ju sjellë kënaqësi gjatë gjithë vitit.

Të më falni që ende nuk mund të trajtoj pikëpamjen tuaj, ju jeni munduar shumë me artikullin tim, gjë për të cilën ju jam veçanërisht mirënjohës dhe kritikës suaj i kam hyrë me themel. Disa gjëra arrita t'i shtoj te korrektura e fundit. Meqenëse pata përshtypjen që titulli im fillestar ishte shumë i përgjithshëm në disa pika dhe nuk dërgova përgjigje rreth tij, unë e ndryshova kështu "Çështje bazike mbi nazalizimin" dhe te shtojca theksova më tej që shtrohej vetëm pyetja nëse "en" dhe "an" të gjuhëve indogjermanike janë ruajtur të ndara veçmas në gegërisht. Për këtë duhej të mbështetesha te etimologjitë indogjermanike, që ju i keni sjellë kaq mjeshtërisht. Prej jush mësova edhe shqyrtimin më të mprehtë e rigoroz të marrëdhënieve fonetikore të shqipes, në bazë të të cilit ju hidhni poshtë shumë etimologji dhe i zëvendësoni ato me etimologjitë përkatëse. Kam futur aty edhe fjalët e huazuara nga latinishtja, bazuar në të cilat ka evoluar parimisht pikëpamja ime përgjatë rrjedhës së kohës dhe duke u nisur nga to për të kaluar te leksiku i trashëguar. Ndoshta te ju është krijuar përshtypja se këndvështrimi im është i ngurtë për shkak të trajtimit të parapëlqyer të qasjeve indogjermanike, pa trajtuar format e ndryshme dialektore të gegërishtes. Por edhe ju, nuk keni mundur të vërtetoni në punimet tuaja që në gegërishte ka pasur një bashkim të "en" dhe "an". Nëse do të ishte kështu, ju mund të më qortonit për mosmarrjen në konsideratë të kësaj faze të ndërmjetme. Kështu, nisur nga qasjet indogjermanike m'u desh të tregoja që kjo shtresë e ndërmjetme nuk ekziston. Por natyrisht, nëse mjeshtri i kësaj fushe e kundërshton këtë, unë marr edhe më shumë shkas të reflektoj për këtë dhe në fakt këtë po bëj vazhdimisht. Natyrisht që llogaritja nuk funksionon pa probleme, por sipas mendimit tim kundrashembujt janë më të pakët në numër dhe me peshë më të vogël sesa provat e mia. Ju lutem të më jepni ndihmë e mbështetje të mëtejshme.

Sa i takon kolokuiumit tonë albanologjik, programi po fillon të skicohet ngadalë. Ju falenderoj për konfirmimin tuaj, nga ju varet suksesi apo dështimi i të gjithë eventit dhe prandaj mbaj shpresa që mund t'ju angazhojmë me disa kumtesa.

Në lidhje me ditën e parë po mendoja që ju do duhej të mbanit fjalimin kryesor mbi personalitetin e Jokl-it, mbi kontributin dhe arritjet e tij, dhe ndoshta mund të sillnit edhe materiale të papublikuara nga arkivat e Tiranës, ndërkohë që pas jush do duhej ndoshta të fliste Solta në përgjithësi për kontributin dhe arritjet e albanologëve austriakë. Me kaq, sipas mendimit tim, programi i paradites do të ishte mëse i plotë. Fatkeqësisht Solta po vjen rrotull e nuk po do të angazhohet, megjithëse ai si austriak dhe nxënës i Joklit mund ta mbante këtë fjalim si askush tjetër. E megjithatë shpresoj që ta nxisim e motivojmë për këtë. Ai përgjithësisht nuk i ka qejf fjalimet zyrtare dhe nuk i frekuenton

kongreset. Kë tjetër mund të rekrutonim për këtë punë? Ai është i mendimit që duhej ta bëja unë, por unë nga përjetimet e mia nuk do mund të flas dot kurrë si Solta, i cili e ka jetuar vetë atë kohë.

Se si do të zhvillohen punimet e së premtes, për fat të keq ende nuk mund ta themi me detaje, disa propozime i kemi tashmë, por sigurisht që jemi të detyruar të presim përgjigjet për ftesat që i kemi dërguar Shoqatës së Indogjermanistikës. Por një gjë është e sigurtë, që edhe këtu nuk do të mund të bëjmë dot pa praninë tuaj!

Sa i takon së hënës dhe të martës, shpresojmë dhe jemi të sigurtë që shumë zotërinj nga Tirana do të ideojnë temat e këtyre ditëve. Në lidhje me përhapjen e shqiptarëve, Camaj do të mund të referonte mbi diasporën në Itali (sapo është botuar libri i tij mbi dialektin e Greci-t te shtëpia botuese Olschki në Firence), për shqiptarët e Greqisë do të kishim menduar për Hamp-in (por ai ende nuk është përgjigjur), për shqiptarët e Ukrainës – Desnickaja, ose dikush i ngjashëm me të, dhe për shqiptarët e Bullgarisë mund të referojë një studiues i atjeshëm. Klasifikimi i dialekteve, stadi i sotëm i dialektologjisë, brenda mëmëdheut, pyetësorët, atlaset gjuhësore etj. mund të ishin një temë për profesor Gjinarin, profesor Dodin e të tjerë të kësaj fushe. Ndërsa zhvillimi i gjuhës së shkruar shqipe me siguri që do të merret përsipër nga zoti, profesor Kostallari. Do të ishte një dëshirë e imja e veçantë të përshëndesja dhe të dëgjoja tek referonte këtu shoqëruesin tim të palodhur Ali Dh., duke mundur kështu t'i shprehja falenderimet e mia.

Vërtet jam i ndërgjegjshëm që ende nuk janë dërguar ftesat zyrtare për në Tiranë, por ndoshta do të ishte e mundur që brenda për brenda Institutit të diskutohej një herë çështja e temave dhe të më shkruanit në lidhje me to, me qëllim që të vazhdojmë planifikimin e detajuar të kolokuiumit. Sepse gjithçka duhet koordinuar me Qendrën, kjo do të ishte dëshira ime. Dhe shumë shpejt do të kemi më shumë kohë në dispozicion. Ju ishit të mendimit që datën e kolokuimit ta sillnim më përpara në kohë që të përkonte me mbarimin e Kongresit të Linguistikës, por patëm disa vota kundra. Gjithashtu në gjysmën e dytë të shtatorit 1972 do të zhvillohet një kurs për Gjuhësinë e Aplikuar, ku jemi thirrur drejtpërsëdrejti për të marrë pjesë. Duke marrë në konsideratë këto rrethana, konferenca jonë do të mbetet për datat e enjte 28.09. deri të martë 03.10.1972. Por nëse nga ana e Institutit tuaj do të kishte ndonjë kundërshtim vendimtar, do ju lutesha të më informoni sa më parë. Ah sa do t'ju isha mirënjohës, nëse do të më shkruanit sa më parë për ide të tjera në lidhje me konferencën.

Ju uroj edhe një herë gjithë të mirat për vitin 1972 dhe ju falenderoj përzemërsisht për ndihmën tuaj të vazhdueshme!

Me respekt

H. Ölberg

A – 6020 Innsbruck, 13.03.1972

Instituti për
Gjuhësi Krahasuese
Universiteti i Innsbruck-ut

Zotit Prof. Dr. E. Çabej
Rruga Q. Stafa 395/12
Tiranë

Shumë i nderuar zoti Profesor!

Vërtet po ju shkruaj me shumë vonesë dhe ende nuk i jam përgjigjur letrës suaj të datës 23.01., por tani sapo mbërriti edhe letra juaj e datës 27.02. dhe patjetër që më në fund duhet t'ju përgjigjem menjëherë. Pjesët e gazetave kanë mbërritur në rregull, gjithashtu Gjurmime Albanologjike 1969/2, dhe sot Fjalë të Urta të Dançetoviç-it. Gjithashtu edhe "Probleme të historisë së gjuhës shqipe". Shpresoj te mos kem harruar asgjë. Gjithçka është tejet e vyer për mua! Sot do të nisen me postë për ju dy separate.

Ju falenderoj për përpjekjet tuaja për konferencën tonë. Por jam dhe shumë i surprizuar për njoftimin tuaj në lidhje me kolokuiumin tuaj mbi ilirët, nga njëra anë sa i takon ftesës së planifikuar, nga ana tjetër sa i takon datës. Të parën, sipas gjasave, nuk do të kem mundësi ta pranoj për shkak të përgatitjeve tona, sado që me shumë kënaqësi do doja të vija në "atdheun tuaj e kopshtin e lulëzuar"[12]! E dyta, nënkupton që ne duhet të shtyjme datën e konferencës sonë, sepse pa një përfaqësi nga Tirana nuk do doja të organizoja asgjë këtu. Me sa duket, konferenca juaj zgjat 2 javë? Që do të thotë se ne këtu do të mund të fillonim jo para së hënës datë 9 tetor? Edhe për ne vete pak vonë, pasi edhe semestri do të fillojë rreth datës 15 tetor. Nëse konfernca juaj do të zhvillohej nga 22.09. deri më 01.10., mund t'ju prisnim këtu rreth datës 5 tetor, e enjte, apo jo? Kjo do të përkonte ekzaktësisht me një shtyrje prej një jave. Ju lutem të më njoftoni sa më shpejt si e keni agjendën e angazhimeve dhe datat, në mënyrë që këtu të mund të riorganizohemi. Si është situata me kongresin e linguistëve në Bolonja? A do të shkoni atje, e pastaj do ktheheni shpejt në Tiranë për kongresin tuaj e më pas do udhëtoni sërish për këtu te ne? Tani shpresoj që të mos sakrifikohet Innsbruck-u! Ju lutem më lajmëroni sa më parë, e gjitha kjo ka konsekuenca për ne, dhe na duhet gjithashtu të bëjmë sa më parë njoftimet tona. Ndërkohë rektorit të Universitetit të Tiranës i është dërguar një shkresë zyrtare, kështu që së shpejti ndoshta do të keni një bisedë apo diskutim.

Ne kemi ftuar albanologë nga të gjitha vendet socialiste, edhe nga Prishtina, Sofja etj. dhe shpresojmë që këtu do të mblidhet një rreth ekspertësh kompetentë. Për fat të keq unë nuk mund të vij në Sofje, ku shpresoja që t'ju takoja, por do t'ju isha mirënjohës nëse mund të mblidhnit e të më dërgonit sa më shumë referate të fotokopjuara.

12 Në letrën origjinale ky togfjalësh është shkruar në shqip nga Ölberg-u. [Shënim i përkthyesit]

Sa i takon kërkesës suaj për literaturë, në ditët në vijim do të bëhen fotokopjet. Në lidhje me Porzig (Gliederung) dhe Hirt (Idg. Gr. II) i kam shkruar një antikuari, meqë Hirt-i ende ofrohet shpesh. Nëse nuk do t'i sigurojmë dot librat, do t'ju dërgohen kopjet. Është një kënaqësi për mua të mundem t'ju falenderoj paksa për punimet tuaja të pakrahasueshme.

Dua gjithashtu t'ju njoftoj që profesor Borgeaud Willi nga Otava (i njëjti që në vitin 1943 botoi tezën e tij "Les Illyriens en Grèce et en Italie", të cilën ai sot nuk e vlerëson edhe aq shumë) ishte për dy muaj te ne dhe u stërvit fort në departamentin tonë të albanologjisë. Mendja e tij është plot ide dhe etimologji dhe sa për qartësim i mundësova të lexonte njëherë punimet tuaja, çka solli rezultate të mira. Kopjova për të edhe disa vepra, meqë në Otava ai, natyrisht, që ndodhet shumë larg studimeve shkencore, megjithëse me sa duket tani ata po marrin "Studimet" etj. Nëse do të kishit për të edhe një ekzemplar të punimeve tuaja "Hyrje" ose "Shumësi", do t'ju isha shumë mirënjohës. Këto dhe të tjera si këto mund t'i dërgoni në adresën time. Edhe ai po pret me shumë interes vëllimin e parë të "Studimeve etimologjike" dhe unë gjithsesi i thashë që libri së shpejti do të dalë nga shtypi, apo jo? Nëse do t'ju teprojë për të ndonjë ekzemplar i punimeve tuaja të tjera, do t'ju isha shumë mirënjohës.

Muajt e fundit kam pasur shumë trysni në punë, saqë nuk besoja se do ia dilja të mbijetoja, por tani që kanë filluar pushimet semestrale, situata është më e mirë.

Edhe diçka për konferencën: Për ekspozitën e planifikuar të librave mund t'ju them se nga biblioteka e Unviersitetit tuaj dhe nga ju vetë jam furnizuar vazhdimisht me botimet më të reja, që do t'i ekspozoj atje, kështu që nuk është nevoja të bëj kërkesë për të më dërguar ekzemplarë të tjerë. Edhe sa i takon letërsisë artistike, kohët e fundit na kanë ardhur dërgesa të mëdha postare. Për fat të keq ende nuk kam pasur mundësi t'i shpreh falenderimet e mia drejtorit, zotit Hanxhari, por do t'ju isha mirënjohës nëse do t'ia përmendnit këtë në ndonjë nga bisedat tuaja. Për fat të keq lidhja me Shkodrën nuk po funksionon dhe vëllimet e atjeshme, që m'u premtuan, nuk po vinë. Profesor Bala më tha asokohe që ata po planifikonin 2 kolana dhe që ne do të merrnim atë me përmbajtje filologjike e historike. Gjithashtu nuk kemi pasur me ta as letërkëmbim. Gjithashtu, për fat të keq, as me drejtorin në Durrës, zotin Toçi. Por nëse do të jetë botuar ndonjë material arkeologjik prej aty (veçmas, jo te "Studime..." apo te "Studia..."), neve do të na interesonte për konferencën. Natyrisht edhe materiale për vendet e tjera arkeologjike. Vëllimin e mrekullueshëm "Shqipëria arkeologjike" sapo e mora për Krishtlindje nga biblioteka e universitetit tuaj.

Para pak kohësh më ra në dorë disertacioni i Bevington-it "Albanian Phonology" sipas një qasjeje të analizës gjenerative dhe gjatë letërkëmbimit me të ai më tha se i kishte dërguar një ekzemplar edhe institutit tuaj, por nuk ka marrë asnjë vërtetim që ekzemplari ka mbërritur. A ka ardhur te ju ky vëllim?

Nuk jam treguar i sjellshëm dhe ende nuk e kam falenderuar bijën tuaj për urimet e Vitit të Ri në gjuhën angleze. Përshëndeteni nga unë dhe gjithashtu përcillini të falat e mia edhe bashkëshortes suaj. Shpresoj që të jeni mirë që të gjithë.

Në pritje të disa (apo shumë) rreshtave nga ana juaj mbetem si përherë

me respekt,

H. Ölberg

A – 6020 Innsbruck, 12.05.1972

Instituti për
Gjuhësi Krahasuese
Universiteti i Innsbruck-ut

Zotit Prof. Dr. E. Çabej
Rruga Q. Stafa 352/12
Tiranë

Shumë i nderuar zoti Profesor!

Një falenderim shumë të përzemërt për lajmet e mira të datës 1 prill dhe 11 prill. Jam i gëzuar që munda t'ju ndihmoj. Ndërkohë ju janë dërguar me postë rekomandé Hirt 2 dhe "Mitologjia shqipe" e Lambertz-it. Të fundit fatkeqësisht ende nuk e njihja, përndryshe do ta kisha marrë në konsideratë.

E tani t'u kthehm pyetjeve të tjera të letrës suaj të datës 27.02.:

Sa i takon Porzig-ut, vepra e tij "Die Gliederung des indogermanischen Sprachgebiets" nuk gjendet në treg, jam ende duke kërkuar.

Sa i takon Kretschmer-it, veprës së tij "Dialekti i sotëm i Lesbosit", faqja 410: "ἀμόντε (në gjuhën kretase edhe „ἀμόντες") 'i humbur' χαμένως, ματαίως'. M. 10: italisht andare a monte".

"M. 10" do të thotë Meyer, Neugriechische Studien IV, faqja 10:

„ἀμόντε Adv. να πάη ἀμόντε τόσος κόσμος ,që do duhej të vdisnin/ të zhdukeshin kaq shumë njerëz". Naxos, Ανάλ. II 66. Italisht: andare a monte".

Më tej në faqen 434 të veprës së Kretschmer-it gjeta edhe një përmbledhje të huazimeve shqipe dhe po ju bashkëngjis dhe një kopje.

Angelos I: Aty brenda ndodhet artikulli i Dieterich-it "Hellenistische Volksreligion und byzantinisch-neugriechischer Volksglaube" (Leksioni i parë pas emërimit si profesor në Leipzig, 1923). Ju kam bërë një kopje, që po ju dërgohet menjëherë.

Dhe me këtë, me sa po shoh, them se të gjitha pyetjet tuaja kanë marrë përgjigje.

Po ju bashkëngjis edhe një kopje të artikullit *irlandisht: súil* – sy nga studimi "Tàin Bó Froích" të Meid-it, nga i cili rezulton se **suli-* nuk ekziston, gjë që mund të ketë pasoja për pikëpamjen tuaj rreth "sy". Mua nuk më ka bindur argumentimi juaj **sun-* me gjithë cilësinë e mënyrës së argumentimit. Veçanërisht numri special 30 i revistës IBK duhet të ishte i aksesueshëm për ju nëpërmjet bibliotekës suaj universitare, së cilës ia kemi dërguar që prej shumë kohësh. Aty ka shumë etimologji irlandeze.

Prej jush më kanë ardhur "Nga historia e gjuhës shqipe", në Zëri i Popullit, Nr. 19, 23 janar, si edhe "Te burimet e gjuhës shqipe" nga gazeta Drita XI, 51, 19 dhjetor 1971. Ndërsa artikullin mbi emrin kombëtar të shqiptarëve në revistën "Albanie Nouvelle" si edhe po aty artikullin mbi prejardhjen e shqipes nuk i kam marrë. Nëse këta dy artikuj janë botuar edhe te revista "Shqipëria e Re", do ju lutesha për të dhënat e sakta bibliografike, pasi këtë revistë e marrim nga ambasada juaj në Vjenë.

Dhe tani një lutje të madhe nga ana ime: Sa u takon publikimeve tuaja deri në vitin 1965, disponoj një bibliografi të besueshme nga vetë ju, por që nga viti 1966 kam mbajtur shënimet e mia për çka gjeja dhe çfarë më është dërguar, por do t'ju isha shumë mirënjohës nëse do të më dërgonit sërish një listë të përpiluar që nga viti 1966.

Sa i takon konferencës: po na vinë shumë kërkesa për regjistrim pjesëmarrjeje, por pak njoftime për mbajtje kumtesash. Klingenschmitt (asistent shkencor në Erlangen) është regjistruar me një kumtesë në lidhje me bazat indogjermanike (indo-evropiane) të foljes në gjuhën shqipe. Po mbi këtë temë edhe Fiedler-i (Berlin), por ai dhe zonja Dr. Buchholz me shumë gjasa nuk do të jenë prezent personalisht. Na mungojnë kumtesa për fleksionin nominal, fjalëformimin dhe përemrat.

Më tej dëshiroj t'ju pyes, nëse ka ndonjë përpilim të ri të leksikut të trashëguar bazuar në klasifikim/grupim tematik (pjesë të trupit, leksik bazë).

Disa studiues si Desnickaja, Hamp, Gabinsky, Bevington etj. kanë konfirmuar, deri tani janë rreth 40 veta. Ende nuk mund të thuhet gjë për pjesën e dytë ballkanologjike, pasi vërtetë janë regjistruar disa referate, por kjo pjesë do të duhej të mbulohej në radhë të parë prej shkencëtarëve nga Tirana. Organizimi konkret varet, pra, nga një konfirmim nga Tirana, në të cilin do duhej të përcaktoheshin njëkohësisht edhe temat dhe referentët.

Më lejoni t'ju kërkoj, që në lidhje me pjesën e parë të aktivitetit të angazhoheshit rast pas rasti, siç u përmend më lart, rreth fleksionit, zanafillës së nyjes së paravendosur dhe asaj të prapavendosur dhe për specialitete të ngjashme. Dhe meqë ju i keni tashmë disa ide në mendje, shpresoj që nuk po tregohem i paturpshëm me kërkesat e mia, apo jo?

Meqë së shpejti do të udhëtoni drejt Sofies (dhe unë nuk vij dot atje), do t'ju isha shumë mirënjohës nëse do të flisnit atje në favor të konferencës sonë. Nga profesor Georgievi p.sh. ende nuk kam një konfirmim përfundimtar, megjithëse ai me siguri që do të vijë dhe do të regjistrohet me një kumtesë mbi pikëpamjet e tij sa u takon Dakëve. Zonja Sokolova është regjistruar me një referat mbi Mandricën, por nuk kemi askënd tjetër nga Bullgaria. Do t'i dërgoj edhe një herë disa fletëpalosje zotit prof. Georgiev me lutjen për t'i shpërndarë më tej.

Profesor Solta-n nuk do ta kemi të pranishëm, me sa duket ai vuan në përgjithësi nga një fobi ndaj kongreseve, siç po dëgjoj të flitet. Eventualisht referatin e tij do ta marrë përsipër profesor Haas-i.

Ju lutem të më dërgoni sa më shpejt të jetë e mundur njoftim në lidhje me gjithë sa më sipër.

E mora ftesën nderuese për në kongresin tuaj mbi Ilirët, por ende nuk jam përgjigjur. Me gjithë dëshirën e madhe për të qenë sërish në vendin tuaj, nuk besoj ta kem të mundur të largohem një javë të tërë për shkak të disa arsyeve personale, por jo më pak edhe për shkak të pregatitjeve të konferencës sonë.

Tani po e mbyll. Nëse ju nevojitet diçka, ju lutem thjesht më shkruani! – Sa u takon akteve të konferencës, unë e kam me qejf ta botoj një vëllim të tillë, ndërkohë që aty temat mund të trajtohen sigurisht më të detajuara, madje edhe prej personave që nuk mund të marrin pjesë personalisht. Shpresoj pra që edhe disa zotërinj të tjerë të institutit tuaj të kenë dëshirë të bashkëpunojnë.

Përshëndetje të përzemërta e me përulje për familjen tuaj!

Si gjithmonë me nderime,

H. Ölberg

A – 6020 Innsbruck, 24.05.1972

Instituti për
Gjuhësi Krahasuese
Universiteti i Innsbruck-ut

Shumë i nderuar zoti Profesor!

Dje mbërriti letra juaj e datës 6 maj dhe unë menjëherë bëra kopjen që i kam bashkëngjitur kësaj letre. Bëhet fjalë në të vërtetë për një artikull të Puscariu-t, në të cilin citohet Pàrvan-i. Gëzohem gjithmonë sa herë kam mundësi t'ju ndihmoj, ndaj mos ngurroni. Dërgesa me Hirt-in, Lambertz-in etj., duhet të ketë arritur tashmë te ju, ashtu si edhe letra ime e datës 12 maj mbi Kretschmer-in, amonte.

Sot u habita mjaft kur nga ambasada shqiptare e Pekinit mora revistën "New Albania" nr.1, 1972, në të cilën gjendet edhe artikulli juaj mbi temën "National name by which the Albanians have been known". Bota po bëhet edhe më e vogël!

Në lidhje me bibliotekën e universitetit tuaj: Po na vijnë vazhdimisht paketa me literaturë shkencore. Supozoj që kjo ka lidhje me konferencën tonë. Ju lutem t'i shprehni falenderimet e mia të sinqerta zotit drejtor, unë në fakt ende nuk i kam shkruar atij dhe

kërkoj falje. Sapo na ka ardhur një numër i revistës Kratylos (viti 1961!!) dhe një nga katalogët e studimeve të Antikitetit, shumë shpejt do t'i përcjell më tej për në Tiranë. I lexoni ju këto dërgesa?

Gjithashtu në lidhje me konferencën, sapo na erdhën 6 regjistrime nga disa zotërinj nga Prishtina: Ajeti, Kaleshi, Hadri, Mulaku, Pllana, Mirdita. Ah sikur të kishte ardhur tashmë edhe njoftimi zyrtar i universitetit tuaj! Sepse pa temat konkrete të delegacionit tuaj ne nuk mundemi të dërgojmë qarkoren e dytë të konferencës, por gjithsesi, para se të mbarojë semestri (fillim korriku), ajo duhet bërë gati dhe dërguar. Për këtë i shkrova dje zotit drejtor Kostallari.

Me situatën e tanishme nuk do ta kem të mundur të vij në Tiranë për konferencën tuaj. Më vjen shumë keq. Por jam aq i mbytur me punë, sa nuk kam kohë për të tjera gjëra. Dy javë duhet të shkoj me familjen buzë detit në Itali, menjëherë sa përfundon shkolla, dhe më shumë kohë të lirë se kaq nuk gjej dot.

Pres me gëzim letrën tuaj të radhës, ku mund të shkruani dëshirat tuaja.

Shumë të fala familjes suaj.

Me respekt

H. Ölberg

A – 6020 Innsbruck, 04.08.1972

Instituti për
Gjuhësi Krahasuese
Universiteti i Innsbruck-ut

Profesorit Dr. E. Çabej
Rruga Q. Stafa 395/12
Tiranë

Shumë i nderuar zoti Profesor!

Ju falenderoj shumë përzemërsisht për letrën tuaj të datës 14.07., edhe për letrën nga Budapesti. Jam i gëzuar që i keni marrë dërgesat e mia, vetëm studimi i Porzig-ut "Gliederung....." nuk ka më ekzemplarë në treg dhe nuk mund të gjendet. Në rast nevoje do të merrni një kopje. Gëzohem kur mundem t'ju ndihmoj. Lochner-i më shkroi rreth Sofjes dhe për ju, unë vetë nuk munda të vija, pjesërisht për shkak të konferencës, por kryesisht për shkak të detyrimeve të mia të këtushme dhe më datën 05.07. kisha edhe mbrojtjen e habilitacionit për titullin profesor, gjithçka vajti në rregull. Mund ta merrni me mend sa i rraskapitur kam qenë. Profesor Knobloch-u gjithashtu më ka thënë që ai po

bën pushimet këtu (dmth. po punon për fjalorin e tij të linguistikës). Sa i takon Shoqatës së Indogjermanistikës, ma merr mendja se ju figuroni si anëtar. Si do që të jetë, ju jeni në listën e anëtarëve të shoqatës, që më erdhi këtë vit. Në lidhje me këtë i shkrova sot edhe Dr. Reichert-it në Wiesbaden. Gjatë konferencës sonë nuk do të zhvillohet ndonjë mbledhje e Shoqatës së Indogjermanistikës, meqë konferenca nuk organizohet prej saj, por do të zhvillohet vetëm një mbledhje e kryesisë (Mayrhofer, Rix, Reichert, ndoshta Meid dhe të tjerë). Me aq sa di unë, vitin e ardhshëm do ketë sërish një konferencë të Shoqatës së Indogjermanistikës. Mbledhja e kryesisë do të zhvillohet në njërën prej mbrëmjeve të konferencës sonë dhe me shumë gjasa nuk do të përmbajë ndonjë gjë të rëndësishme. Nëse do të kishit ndonjë dëshirë apo plan, do ju propozoja t'i diskutonit me Mayrhoferin. Për konferencën tonë janë regjistruar pothuajse të gjithë albanologët, mungon vetëm Italia dhe Haebler-i (fatkeqësisht edhe Solta, kongresofobi, ju kam shkruar për këtë). Pra shpresoj se do të ketë sukses. Bashkëngjitur qarkorja e dytë, e cila fatkeqësisht nuk është e plotë, sepse mungojnë ende pjesëmarrësit kryesorë, pra Tirana. Pra, do na duhet ta improvizojme renditjen e referateve shumë pak para konferencës, por meqë konferenca është në rreth të vogël, nuk do të kemi ngatërresa. Për fat të keq, nga radhët e studentëve ka pasur pak të interesuar, ndërkohë që ne prisnim më shumë. Me sa duket, kjo lidhet me kushtet e vështira në universitetet gjermane. Profesor Tagliavini ishte para pak kohësh në Innsbruck, na vizitoi edhe ne, gjë për të cilën u gëzova, e natyrisht tregoi për të shkuarën e tij dhe do kish mundur të sillte një kumtesë për Joklin. Por para pak kohësh dëgjova se ka pësuar një goditje në tru; nëse kjo është e vërtetë, nuk mund ta llogarisim më për pjesëmarrje, ai ishte plakur shumë kur ishte te ne dhe nuk ishte dhe aq mirë me shëndet.

Siç mund ta shihni nga programi, te pjesa e indogjermanistikës, mungon veçanërisht morfologjia. Do të ishte detyra juaj të mbyllet ky boshllëk, gjë për të cilën do t'ju luteshim shumë. Pra: lakimi, përemrat. Unë vetë, nëse do duhet patjetër, ndoshta do të kontribuoja me një kumtesë për numërorët dhe fonetikën. Edhe për nyjet ju do duhet të flisnit shkurtimisht. Edhe për gjëra të tjera që ju duken të domosdoshme. Nëse do të ishte e mundur, do të dëshironim një njoftim prej jush me tema konkrete, në mënyrë që të kemi një program përfundimtar që në shtator, me ndarje kohore. Deri atëherë shpresojmë për komunikimin zyrtar nga Universiteti i Tiranës. I kam shkruar gjithmonë edhe zotit drejtor, profesor Kostallarit, dhe ndonëse ende nuk ka kthyer përgjigje, besoj se ai do të ketë marrë masat e nevojshme.

I shkrova edhe një herë drejtorit që nga ana e institutit tuaj mund të paraqiten sigurisht tema të tjera nga studiues që nuk munden të marrin pjesë personalisht. Ne këto do t'i përfshinim në aktet pasuese të kongresit, në mënyrë që ky botim të jetë më i plotë. Shpresoj që ky sugjerim të jetë marrë në konsideratë dhe të japë fryte. Tek e fundit ky sugjerim vlen edhe për Shkodrën. (A ju kam shkruar që menjëherë pas letrës suaj në të cilën më njoftonit se kishit folur me Shkodrën, na erdhën të gjitha vëllimet e atjeshme?)

Nga biblioteka juaj po vinë vazhdimisht pako me botime letrare. Ekspozita jonë e librave pra do të jetë shumë e bukur. A do t'i shprehnit zotit drejtor Hanxharit falenderimet e mia të sinqerta? Nëse deri në ditën e konferencës do të kompletonit edhe listën e botimeve tuaja, ekspozita jonë do të ishte vendi i duhur për të.

Shpresoj që të keni pasur pushime të bukura dhe që familja juaj të jetë mirë. Të fala bashkëshortes dhe vajzës.

Shumë të fala!

Me respekt

H. Ölberg

P.S. A nuk më thatë njëherë në Tiranë, që në arkivin e shtetit kishte materiale të pashtypura nga Reinhold-i? A nuk mund të bëhet një kopje ose një mikrofilm nga këto materiale dhe të paraqiteshin në konferencë? Këtu do të krijohej edhe mundësia e publikimit.

A – 6020 Innsbruck, 21.08.1972

Instituti për
Gjuhësi Krahasuese
Universiteti i Innsbruck-ut

Zotit Prof. Dr. E. Çabej
Rruga Q. Stafa 395/12
Tiranë

Shumë i nderuar, zoti Profesor!

Para disa ditësh erdhi një telegram nga drejtori i institutit tuaj me njoftimin që në konferencë do të marrë pjesë një delegacion. Tani po pres me kureshtje të mbërrijë letra me detajet dhe jam i gëzuar që me siguri do të ritakohem me miq të vjetër.

Në lidhje me kumtesat tuaja do t'ju luteshim shumë të kishim mundësinë të dëgjonim edhe një referat mbi Progresin etimologjik në fushën e gjuhës shqipe, dhe unë, madje, ushqej një shpresë të fshehtë që vëllimi i parë i veprës suaj tashmë të jetë i përfunduar, apo jo? Gjithsesi ju duhet të flisni për punën tuaj, në rast se vjen edhe Polák-u dhe raporton gjëra të ngjashme rreth punës së tij.

Më tej do të doja të diskutoja njëherë edhe çështjen e përpunimit të dokumenteve të vjetra të gjuhës shqipe, deri ku është arritur, p.sh. sa i takon përpunimit të leksikut, siç e ka bërë Ashta për Buzukun. Me sa më kujtohet, ai ka hedhur nëpër skeda edhe "Kuvendin", por nuk e ka publikuar. A nuk mund ta sillnim këtë manuskript këtu në konferencë? A ekzistojnë regjistra të tillë edhe për dokumente të tjera të gjuhës shqipe, apo mos vallë ata janë në fazë përgatitore në Shqipëri dhe a do mund të bëhej një plan që regjistra të tillë të botoheshin sipas radhës?

Dëshira ime, që portreti i Skënderbeut nga Amras-i të sillej këtu, për fat të keq nuk mund të realizohet. Me sa më thanë, ai gjendet së bashku me shumë vepra të tjera që prej 20 vjetësh në Muzeun e Historisë së Artit në Vjenë dhe ende nuk është restauruar. Për

momentin është në një gjendje të tillë që nuk mund ta lejojë transportin e tij mbrapsht këtu te ne. Sa keq! Por gjithsesi informacioni juaj shërbeu për diçka, dhe pikërisht që vjenezët të mos e përvetësojnë në heshtje!

Me gëzimin e ritakimit tonë të ardhshëm, ju shpreh

nderimet e mia.

H. Ölberg

A – 6020 Innsbruck, 25.08.1972

Instituti për
Gjuhësi Krahasuese
Universiteti i Innsbruck-ut

Zotit Prof. Dr. E. Çabej
Rruga Q. Stafa 395/12
Tiranë

Shumë i nderuar, zoti Profesor!

Ju falenderoj përzemërsisht për letrën tuaj të datës 6 gusht. Sapo porosita librin "Grundwortschatz Deutsch" (Leksiku bazë i gjermanishtes) dhe me ta marrë, do ta dërgoj me postë, sepse ju me siguri që do të keni shumë për të transportuar.

Unë vetë në të vërtetë nuk kam asnjë dëshirë, thjesht gëzohem që do t'ju shoh (për fat të keq pa familjen) dhe që do të kemi mundësi të rrimë së bashku.

Do të më interesonte një hartë e re e Shqipërisë 1:200.000 ose më e madhe, me sa më shumë emra vendesh dhe me emërtimet e qarqeve politike. A është botuar diçka e tillë te ju?

Shpresoj të më lejoni t'ju kërkoj edhe 2 ekzemplarë të guidës gjuhësore gjermanisht-shqip, që është botuar te Albturisti. Një ekzemplar e bleva atëherë te Dajti, botim i vitit 1969, dhe prej tij kam edhe një shirit të incizuar që e përdor në kurset e mia.

Bashkëngjitur po dërgoj edhe një kopje të qëndrimit juridik të Shoqatës së Indogjermanistikës, detajet e të cilit as unë nuk i dija.

Me gëzimin e ritakimit ju shpreh

nderimet e mia

H. Ölberg

Bonfante-n e ftova edhe një herë.

Ismajli reagoi pozitivisht dhe do të vijë.

21 gusht 1972

Zotit
Dr. Hermann Ölberg
Instituti për Gjuhësi Krahasuese
i Universitetit të Innsbruck-ut

A – 6020 Innsbruck
Innrain 30

Shumë i nderuari zoti, Dr. Ölberg,

Ju falenderojmë për interesimin tuaj të datës 4 gusht 1972 në lidhje me profesor Çabejn, Tiranë.

Bazuar në të dhënat që na keni përcjellë, zoti, profesor Çabej posedonte anëtarësinë e shoqatës së vjetër. Megjithatë shoqata e re e Indogjermanistikës nuk i ka marrë përsipër automatikisht të drejtat dhe detyrimet e shoqatës së vjetër dhe si rrjedhojë zoti, profesor Çabej deri më tani nuk është anëtar i saj. Zoti profesor Mayrhofer, të cilit gjithashtu po i dërgojmë një kopje të këtyre radhëve, e kishte cekur një herë temën e këtij anëtarësimi. Ne i kishim parashtruar se një anëtarësim, pa paguar kuotën e anëtarësisë, sjell me vete aspekte nga më të ndryshmet, ndër të tjera edhe dërgesën pa pagesë të revistës KRATYLOS, e cila pastaj do duhej të financohej nga anëtarët e tjerë. Këtu bëhet fjalë për një precedent dhe nuk kemi as kohë në dispozicion sot për të diskutuar sërish qëndrimet pro dhe kundra.

E kështu, me zotin profesor Mayrhofer e lamë që zotit, profesor Çabej t'i dërgojmë qarkoret dhe gjëra të tjera të shoqatës, por të mos ta kemi në listën e anëtarëve të plotë, deri sa të sqarohet, se në ç'mënyrë mund të paguhet kuota e tij.

Konferenca shkencore e radhës do të zhvillohet në shtator 1973 në Regensburg dhe në kuadrin e saj do të planifikohet edhe mbledhja e zakonshme e anëtarësisë së shoqatës.

Përshendetje miqësore

Me respekt

Dr. L. Reichert

Përgjegjës i thesarit i Shoqatës së Indogjermanistikës

30.09. – 05.10.1972

Kolokuium albanologjik ndërkombëtar
Në kujtim të Norbert Jokl-it

në bashkëpunim me Shoqatën e Indogjermanistikës –

i organizuar nga Instituti për Gjuhësinë Krahasuese, Universiteti i Innsbruck-ut, parashikuar për periudhën fund shtatori – fillim tetori 1972.

Tema: Situata aktuale e albanologjisë.

Planifikim paraprak:

E enjte paradite: ceremoni përkujtimore për Jokl-in (organizuar veçanërisht nga ishnxënësit

e tij).

Si edhe: Albanologjia austriake, roli i saj në themelimin dhe zhvillimin e kësaj disipline.

E enjte pasdite: Albanologjia në ditët e sotme: qendrat kërkimore në Shqipëri dhe jashtë saj, veprimtaritë, projektet, studiuesit.

E premte paradite: Çështje të gramatikës indogjermanike (indo-europiane) në lidhje me gjuhën shqipe.

E premte pasdite: .....

E shtunë paradite: .....

Si edhe: Mbledhja e Shoqatës së Indogjermanistikës? Ndoshta edhe diskutimi i çështjes së rolit të gjuhës shqipe në procesin e mësimdhënies në fushën e indo-europianistikës.

E hënë paradite: Tema: Dialektologjia e gjuhës shqipe: Përhapja e shqiptarëve në gadishullin e Ballkanit dhe përtej kufijve të tij (Itali, diasporë), klasifikimi i dialekteve, situata aktuale e dialektologjisë.

Pasdite: (Vazhdimi)

E martë paradite: Tema: Atdheu ballkanik i shqiptarëve: Çështjet e substratit. Marrëdheniet me rumanishten. Gjuha dako-miziane. Toponimia.

pasdite: Tema: Gjuha e shkruar e ditëve të sotme: Zhvillimet dhe tendencat. Kodifikimi.

Seanca përmbyllëse.

Është planifikuar një ekspozitë librash me literaturë shkencore nga fusha e albanologjisë dhe ballkanologjisë.

Publikimet e konferencës do të bëhen në kuadrin e revistës IBK.

A – 6020 Innsbruck, 03.12.1972

Instituti për
Gjuhësi Krahasuese
Universiteti i Innsbruck-ut

Zotit Prof. Dr. E. Çabej
Rruga Q. Stafa 395/12
Tiranë

Shumë i nderuar zoti Profesor!

Të më falni që nuk ju kam shkruar më parë. Para së gjithash dua t'ju falenderoj ju dhe të gjithë anëtarët e delegacionit tuaj, që me praninë e tyre kontribuan në mbarëvajtjen dhe suksesin e konferencës sonë. Isha shumë i gëzuar që pata rastin t'ju përshëndesja këtu në Innsbruck dhe shpresoj që vendi ynë të ketë lënë një përshtypje të mirë dhe të qëndrueshme te të gjithë.

Siç edhe pata frikë, fatkeqësisht nuk e pata të mundur të vija te konferenca e drejtshkrimit. Detyrimet profesionale kishin prioritet kësaj radhe dhe unë jua kam sqaruar rrethanat. Shpresoj që gjithçka të përfundojë deri për Krishtlindje. Do isha gëzuar shumë të vija sërish në vendin tuaj e të takoja miqtë e vjetër dhe të njihesha me miq të rinj, por me gjithë këto aktivitete të institutit tuaj me siguri do të jepet sërish rasti vitin e ardhshëm për të organizuar një konferencë dhe ndoshta do të më dërgohet sërish një ftesë. Sa herë që takoj rektorin tonë, më pyet gjithmonë si jeni ju të gjithë dhe a ju pëlqeu këtu te ne. Ai pa dyshim që u kënaq shumë gjatë konferencës dhe me siguri do të gëzohej nëse ndonjëri nga ju do t'i dërgonte një raport të shkurtër.

Ju falenderoj, gjithashtu, edhe për letrën tuaj të datës 8 tetor, si edhe për fotografinë e Joklit që në të vërtetë duket të jetë e njëjta me fotografinë tonë nga vëllimi IJb (Innsbrucker Jahrbuch), veçse është pak më e errët. A duhet t'jua kthej sërish mbrapsht, apo keni edhe një foto tjetër?

Sa i takon Hornung, unë u kam shkruar atyre dhe shpresoj që ndërkohë dërgesa të jetë nisur tashmë për te ju. Vështirësia qëndronte te pagesa e vëllimit të 3-të, sepse për ju ishin përgatitur vetëm separatet. Por supozoj që dhe kjo çështje të jetë rregulluar, mua ende nuk më ka ardhur ndonjë përgjigje. Meqë nuk arrita të vija në Shqipëri, nuk munda as të përmbush dëshirën tuaj dhe kështu nuk ju solla dot gjë. Asokohe i shkrova menjëherë edhe Dr. Cara-s për ta pyetur se kur do të udhëtonte dhe m'u përgjigj që as ai nuk do të vijë dot në Shqipëri përpara verës së vitit të ardhshëm. Më vjen keq që në këto rrethana nuk e plotësova dot kërkesën tuaj, por ju lutem më shkruani nëse çështja do të jetë e vlefshme edhe për vitin tjetër, në rast se do të më vijë sërish një ftesë.

Para disa ditësh ju kam dërguar për vajzën librin e Schulz-Griesbach, nivelin e avancuar (Oberstufe), si edhe fjalorin bazik të gjermanishtes. Jam ende në pritje të nivelit fillestar

të Schulz-Griesbach. Dje mbërriti edhe vëllimi i regjistrit të Frisk-ut dhe shumë shpejt do t'jua dërgoj. Me këtë vëllim e gjithë vepra quhet më në fund e përfunduar.

Kur të merrni këtë letër, ju dhe gruaja juaj do të jeni duke përjetuar ditë dhimbjeje. Ju siguroj që unë dhe bashkëshortja do të jemi me mendje pranë jush. Fakti që e përtejmja mund të jetë në të vërtetë më e mirë se bota e këtushme, na bën ndoshta ta durojmë më me lehtësi fatin.

Dje iu dërgua profesor Domit një regjistrim zanor me diskutimet dhe me kumtesën tuaj mbi zhvillimet në fushën e etimologjisë. Nuk patëm mundësi t'i rishkruanim tekstet këtu dhe kështu, që të mos ketë më vonesa të mëtejshme, unë e kopjova kasetën.

Tani edhe një kërkesë në lidhje me këtë: Ne vërtetë e kishim inçizuar fjalën tuaj të hapjes mbi Joklin, por fatkeqësisht ky inçizim është fshirë (përveç minutave të fundit) nga një referat tjetër. Ishte gabimi im, pasi nuk kam shumë përvojë me pajisjet me 4 pista dhe e bëra shumë vonë ndërrimin. Përveç kësaj isha kaq i ngarkuar, saqë thjesht nuk u tregova i vëmendshëm sa duhet.

Do t'ju luteshim që ta regjistronit edhe një herë me zërin tuaj këtë kumtesë në kasetën që sapo ju dërgova, me qëllim që ta kemi të inçizuar të gjithë konferencën. Ndoshta mund t'i rregullonit punët në mënyrë të tillë që kasetën, pasi të mos ju duhet më, ta dërgoni ndoshta mbrapsht në rrugë zyrtare nëpërmjet ambasadës ose dhe drejtpërdrejt.

Një pjesë e fotografive kanë dalë shumë bukur, kësaj radhe po ju dërgoj disa, të tjerat do të vijnë në vazhdim.

Guntrami u gëzua shumë për takimin, por edhe për kartolinën e vajzës suaj. Ajo duhet të shkruajë vetëm gjermanisht!

Momentalisht jemi duke përgatitur aktet e konferencës dhe i lutemi delegacionit tuaj të na dërgojë referatet. Në lidhje me prononcimet kritike gjatë diskutimeve doja t'ju pyesja nëse i keni përpunuar plotësisht, apo keni ndër mend t'i shtoni në formën e fjalëve kyçe? Kjo vlen natyrisht edhe për profesorët Domi dhe Demiraj. Ju lutem, të na dërgoni gjithsesi manuskriptet përkatëse sa më pastër dhe me distancë të madhe mes rreshtave, të shkruara vetëm nga njëra anë e fletës.

Gjithashtu i kam thënë profesor Domit që do të pranojmë me kënaqësi manuskripte të tjera nga zotërinj, të cilët nuk patën mundësi të merrnin pjesë personalisht. Oferta vazhdon të jetë e vlefshme, ndoshta zoti Kolë Luka mund të na dërgojë një shkrim rreth çështjes së shfaqjes për herë të parë të emrit "Albaner" dhe "Shqipëtarë".

Më lejoni t'ju referoj edhe fjalët e mia në krye të diskutimit përfundimtar të ditës së martë, kur delegacioni juaj ende nuk kishte hyrë në sallë, besoj, dhe ku unë përmenda që do të ishte e favorshme nëse do të kishim një panoramë të përgjithshme se për cilat dokumente të shqipes së vjetër gjenden studime të shpërndara nëpër skeda. Buzuku – përveç punimit të Ashtës. Kam dëgjuar gjithashtu, që i njëjti zotëri ka punuar në skeda rreth Koncilit. A do të ishte e mundur që në kuadër të akteve të konferencës, instituti juaj të na pajiste me një listë të skedave të paprintuara të kartotekës që lidhet me autorët e vjetër? Me qëllim që të kemi një panoramë të përgjithshme.

Dje dërgova dy libra për në Shkodër. Në rast se do jepet mundësia t'i takoni zotërinjtë e atjeshëm, ju lutem t'u përcillni nderimet dhe konsideratat e mia.

Viti i Ri po afron, uroj t'ju sjellë juve dhe familjes gjithë të mirat!

Përshëndetje të përzemërta,

I juaji

H. Ölberg

P.S. Në datën 12 tetor ju kam dërguar huazimet greke të Vasmer-it. Studimet e Miklosich-it mbi turqishten do të fotokopjohen së shpejti.

A – 6020 Innsbruck, 19.01.1973

Instituti për
Gjuhësi Krahasuese
Universiteti i Innsbruck-ut

Zotit Prof. Dr. E. Çabej
Rruga Q. Stafa 359/12
Tiranë

Shumë i nderuar zoti Profesor!

Shumë falemnderit për letrën tuaj të datës 5 janar si edhe për dërgesën me arkivin e Baric-it, Kontinuitetet e Qoses dhe 2 herë Mësuesin. Para tyre mbërriti edhe artikulli mbi rregullat fonetikore. Shpresoj që i kam konfirmuar kështu të gjitha dhe njëkohësisht gëzohem që Frisk-u ka mbërritur në rregull te ju. Kështu këtë vepër e keni të plotë.

Shumë falemnderit për dërgesat tuaja, dhe i vlerësoj shumë këto dhurata, kështu që po i dorëzoj në bibliotekën tonë, e cila po pasurohet edhe më shumë në këtë mënyrë. Me këtë rast, a mund t'ju pyes, mos vallë keni marrë me vete vëllimin model të Polák-ut, gërmën C, sepse nuk po e gjej më këtu? Mund ta mbani, përveç rastit nëse Polák-u do ta kërkonte mbrapsht shprehimisht.

Nuk po gjendet as libri i Haarmann-it mbi elementet latine, por këtë do ta marr edhe një herë nga autori.

Libri i Schulz-Griesbach, niveli fillestar, ende nuk ka mbërritur, por pa merak, se do t'ia dërgoj vajzës suaj. Guntrami u gëzua shumë për përshëndetjet e vajzës suaj dhe ai do t'i përgjigjet gjermanisht, por kur?

Revista "Mësuesi" më pëlqen shumë, a mund të bëja një abonim për vitin 1973, apo nuk dërgohet jashtë shtetit? Do t'ju isha shumë mirënjohës, nëse do të më dërgonit edhe artikujt tuaj që botohen në gazeta të tilla.

Jam gjithashtu i qetë, që mbërriti mirë edhe kaseta e incizuar dhe ju falenderoj që artikujt e delegacionit tuaj tashmë po bëhen gati. Nëse do të inçizonit edhe fjalimin tuaj hyrës, do të isha krejt i kënaqur, pasi më vjen shumë keq, që në sajë të gabimit tim, mbi të u regjistrua një fjalim tjetër. Por në gjithë atë rrëmujë nuk mund të isha i kudondodhur.

I përcolla të falat tuaja profesor Menghin-it dhe ai arriti të gjente edhe një separat të artikullit të të atit që ju e kishit cituar dhe që ai do t'jua dërgojë së bashku me materiale të tjera. Do të gëzohej shumë, nëse do t'i shkruanit disa rreshta. Adresa e tij: Prof. Dr. Osmund Menghin, Universität, Institut für Vor- und Frühgeschichte, Innrain 52, A 6020 Innsbruck.

Sa i takon emrit "Birgitz" (f. 37), krahasimi i vjetër me fjalët pararomake *Burgusium-Burgeis* në Vintschgau ose *Burgúsinus – Bergisel* nuk është i qëndrueshëm, "Birgitz", forma e vjetër "Burgitz" dhe të tjera forma të ngjashme, mund të përmbajë vetëm prapashtesën "-itium" dhe është me prejardhje romane. Në të kundërt, emrat e tjerë të listuar si p.sh. Patsch, saktë /pōts/ < *potsi ose pod-si (në rrëzë/këmbë të malit?), ose Perfuss, saktë Perfess, *péruenes (vau i lumit?) janë emra të vjetër të bukur ((ilirë)). A ju kujtohet, që pasi patëm vizituar Urën e Europës (Europabrücke), ne udhëtuam malit përpjetë duke kaluar nga Patsch-i për të vajtur në Igls dhe pastaj u kthyem mbrapsht. Igls, ndoshta *iclu, krahso me Yculum! Duhet ta planfikoj që të merrem prapë me përpunimin e studimit tim mbi emërtimet pararomake, me qëllim që ta publikoj së shpejti.

Përveç listës së publikimeve të Jok-lit, do doja që vëllimit t'i shtoja edhe lista të tjera. Për Lochner-Hüttenbach-un, listën e ka përpiluar G. Meyer, do doja të shtoja edhe listën e publikimeve tuaja, gjithashtu edhe ato të Pisani-t, Tagliavini-t, Hamp-it, për sa kohë më vihen në dispozicion. Doja të merrja edhe një këshillë nga ju, në mënyrë që askush të mos ndiehet i diskriminuar. Do të pranonim me kënaqësi listat e Gjinarit, Domit, Kostallarit etj.

Pas nisjes së delegacionit u kujova që, kur u dorëzova kasetat me regjistrimet zanore të Rapshishtit profesor Domit dhe profesor Kaleshit, ka të ngjarë që të kem ngatërruar me njëra-tjetrën kasetat. Në fakt kasetat kanë të njëjtin material të regjistruar, vetëm parathënia është e ndryshme. Do të ishte e sikletshme për mua, nëse te ju ka mbërritur në të vërtetë kaseta që ishte paracaktuar për Prishtinën. Për këtë i kam shkruar tashmë edhe profesor Kaleshit dhe iu luta që, nëse e sjell rasti, në ndonjë prej udhëtimeve mes Prishtinës dhe Tiranës të merreshin kasetat me vete e të shkëmbeheshin. Për fat të mirë kontaktet sa vjen e po bëhen më intensive.

Bashkëshortja ime ju përshëndet përzemërsisht dhe ne shpresojmë që ky vit të jetë i mbarë për familjen tuaj. Gjithashtu ushqej shpresa që edhe këtë vit të zhvillohet një kongres tjetër në Tiranë. Dhe meqë gjithçka u përmbyll me sukses, mundem të marr frymë lirisht dhe të planifikoj kohën e ardhshme.

Ju uroj gjithë të mirat.

Me nderime.

H. Ölberg

Ç'mendim keni për incizimin mjeshtëror të zonjës, profesor Meid, që po ia bashkëngjis kësaj letre?

A – 6020 Innsbruck, 27.02.1973

Instituti për
Gjuhësi Krahasuese
Universiteti i Innsbruck-ut

Zotit Prof. Dr. E. Çabej
Rruga Q. Stafa 395/12
Tiranë

Shumë i nderuar zoti Profesor!

Ju falenderoj përzemërsisht për letrën tuaj të datës 20 shkurt dhe për manuskriptin e fjalimit tuaj solemn. Falemnderit edhe për njoftimin e dërgimit të kumtesave të tjera së shpejti. Shpresoj që edhe kumtesat e anëtarëve të tjerë të delegacionit të mbërrijnë pa vonesë. Puna për vëllimin po ecën mirë. Pisani dhe disa të tjerë kanë dërguar kumtesa shtesë, kështu që shpresoj që do të dalë në dritë një vepër e mirë në shërbim të studimeve albanologjike. Rekomandimin tuaj në lidhje me përfshirjen e listave të publikimeve e kemi mbajtur shënim. Në varësi të rrethanave, se cila fotografi e Joklit mund të kopjohet/printohet më bukur, do të marrim ose foton e IJb-së ose tuajën. A e keni lexuar ndërkohë versionin e vdekjes së tij te Shejzat? Nga mund të burojë kjo pikëpamje?

Haarmann-i u bë prapë i gjallë. Sot i shkrova nëse mundet t'ju dërgojë edhe një vëllim. Polák-u ende nuk e ka kërkuar mbrapsht projekt-modelin e tij, kështu që ju lutem ta mbani ekzemplarin që keni.

Gjithashtu ju falenderoj shumëfish për premtimin për të më dërguar revistën "Mësuesi".

Nga punimi i Miklosich-it "Türkische Elemente" tani po bëhet gati pjesa e parë dhe unë më pas do jua dërgoj radhazi të tria pjesët. Te botimi AslPh 8 dhe 9 Korsch-i ka bërë disa plotësime, po ashtu Kraelitz-i ka bërë plotësime te "Sitzungsberichte Wien". A i keni në dispozicion këto?

Kohët e fundit kanë mbërritur disa dërgesa nga ju, separati i revistës "Gjuha"; problemi i tri serive guturale qëndron dhe bie me faktin nëse gjendet një dokumentim i q-së për-

para një zanoreje të përparme, i cili të jetë i sigurt. Nëse po, dhe nëse ky kombinim na jep "qj", atëherë të tria seritë janë të sigurta. Ju nuk sillni asnjë dëshmi. Ç'mund të themi për korrë < qērn- ?

A keni mundur ta incizoni referatin tuaj në kasetë? Fotografitë kanë dalë mirë, sidomos ajo me T. është mjeshtërore.

Tani, pas krishtlindjeve të gjelbra, po kalojmë një dimër të mrekullueshëm me shumë dëborë. Për fat të keq kolegu ynë Schmeja theu këmbën duke bërë ski e tani po çalon prapë. I kanë këto gjëra Tiroli dhe sportet dimërore. Në klinikë janë shtruar, me sa po dëgjoj, 180 persona që kanë thyer këmbën nga skijimi.

Librin për vajzën tuaj, pjesën e parë, ende nuk e kam marrë, por porosia nuk është harruar.

Përcilluni të falat e mia me nderime bashkëshortes dhe vajzës suaj dhe shumë falemnderit për gjithçka.

Gjithë të mirat!

I juaji

H. Ölberg

8.9.1973

Zotit Prof. Dr. E. Çabej

Rruga Q. Stafa 395/12

Tiranë

Shumë i nderuar zoti Profesor!

Me gëzim të madh dhe falenderime të përzemërta konfirmoj që kam marrë sot dërgesën tuaj me manuskriptin mbi studimet e reja etimologjike, si dhe kam marrë para pak kohësh të dy vëllimet e Koneskit. Manuskripti juaj, të cilit tashmë ia hodha një sy, është i shkëlqyer. Le të shpresojmë që fjalori juaj etimologjik të shkojë së shpejti në shtypshkronjë dhe që brenda vitit 1973 të shohë dritën e botimit pjesa e parë!

Një pjesë e madhe e manuskripteve të konferencës kanë mbërritur tashmë, por për fat të keq ende mungojnë kumtesat e anëtarëve të tjerë të delegacionit. Nga profesor Gjinari kemi një version në frëngjisht të referatit të tij, por nuk di nëse ky mund të konsiderohet i gatshëm për shtyp. Do t'ju isha mirënjohës nëse do t'ia matnit pulsin. Zoti, profesor Domi më premtoi se materiali i plotë i të gjithë pjesëmarrësve do të vijë si një trup i vetëm dhe unë së shpejti do t'i shkruaj sërish, sepse kemi ndërmend që të fillojmë me radhitjen brenda këtij viti.

Siç kuptoj nga letra juaj, jeni mirë dhe po tregoheni i zellshëm e punëtor edhe gjatë pushimeve. Do ishte mirë edhe të shlodheshit pakëz. Guntrami i shkroi para pak kohësh një kartolinë vajzës suaj, zgjati shumë deri sa u përgjigj, të na falni. Momentalisht është ende në Spanjë me një grup të rinjsh, Hermann-i është në Itali, por javës tjetër fillon sërish shkolla dhe ky do të jetë një ndryshim i vështirë! Këtë vit e kaluam verën në malësi, 30 km larg Insbruck-ut, pranë komunës Telfs, ku patëm një mot fantastik. Unë vetë natyrisht shumicën e kohës isha në institut, për të punuar më tej me temën e konsonantizmit. Teoria laringale dhe çështja e guturaleve janë mbyllur (sipas mendimit tim, mbetemi te tri guturale). Shpresoj ta kem gati manuskriptin deri për Krishtlindje, vetëm atëherë mund të them që kam hequr një barrë të madhe.

Para rreth 3 javësh, ju dërgova kopjet e studimeve mbi gjuhën turke të Miklosich-it së bashku me plotësimet. Ishte një pako e madhe dhe shpresoj që gjithçka të jetë në rregull. Dhe kështu them se e kam mbajtur premtimin!

Nga autori Emanuele Banfi më erdhi para ca kohësh një separat me titullin "Aree latinizzate nei Balcani e una terza area latino-balcanica (area della Via Egnazia)" nga seria Rendiconti Istituto Lombardo di Scienze e Lettere, Milano, 106, 1972. Një punim interesant në të cilin ai, duke u bazuar te huazimet latine në gjuhën shqipe dhe greke, përpiqet të rikonstruktojë një latinitet të veçantë karakteristik përgjatë rrugës Egnatia. Megjithatë ai përdor shpesh disa etimologji të vjetëruara si p.sh. *glande- > lënde*, ose *latinisht ō > shqip u* bazuar te *cōrte > kurt*. Këtë rajon të tretë ai e konsideron si një "area di mezzo tra le due restanti aree della latinità balcanica e l'area italo-meridionale". Ai krahason *sagitta > shqip sajetë* drejtpërdrejt me fjalën italojugore, siçiliane *sagitta > sajitta*. I shkrova Banfit që do ishte mirë t'ju dërgonte një ekzemplar.

Javën e ardhshme zhvillohet konferenca shkencore e indogjermanistikës në Regensburg, ku, po pata mundësi, kam dëshirë të shkoj. Do t'ju raportoj pastaj rreth saj.

Me përshëndetje shumë të përzemërta për familjen tuaj dhe si gjithmonë

Me respekt

H. Ölberg

Innsbruck, 24.02.1974

Instituti për
Gjuhësi Krahasuese
Universiteti i Innsbruck-ut

Zotit Prof. Dr. E. Çabej
Rruga Q. Stafa 395/12
Tiranë

Shumë i nderuar zoti Profesor!

Para disa ditësh ju kam dërguar shtojcën që kish mbetur nga vepra e Miklosich-it, Türkische Studien, dhe shpresoj që ta merrni të gjithën në rregull. Kjo pjesë vërtetë më kishte shpëtuar pa e parë dhe nuk e kisha fotokopjuar asokohe. Shpresoj që vitin e ri ta keni filluar mirë së bashku me familjen. Këto dy muajt e fundit më shumë kam qenë në lëvizje se sa këtu, sepse kemi pasur disa konferenca si në Vjenë ashtu edhe në Salzburg, pasi gjuhëtarët austriakë janë bashkuar (në shoqatë) dhe si rrjedhojë po organizojnë shpesh diskutime të karakterit shkencor. Së fundmi, javën e kaluar, isha në Bonn te profesor Knobloch-u, i cili këtë semestër mbante një seminar rreth gjuhëve të vogla indo-europiane, dhe në kuadrin e të cilit referoi një herë profesor Duridanovi mbi gjuhën trake dhe ku së fundmi mua më ftuan në lidhje me çështjen e atdheut ballkanik të shqipëtarëve. Me këtë rast pashë universitetin dhe institutin e profesor Knobloch-ut. Atje më pëlqeu jashtëzakonisht shumë, qyteti ishte madhështor, megjithëse pikërisht gjatë atyre ditëve po zhvilloheshin greva dhe disa muzeume ishin të mbylluara. Ne ju dërguam një kartolinë dhe ju kujtuam.

A mund t'ju pyes mos vallë rastësisht mund të gjendet në një mënyrë Buletini i vitit 1957, Nr. 1 dhe 2? Më tej ju falenderoj që keni porositur revistën "Mësuesi". E megjithatë deri tani nuk na ka ardhur gjë, mos ndoshta është destinuar për rrethe më të ngushta? Mos ndoshta mund të merret më me lehtësi gazeta "Drita"?

Prej shumë kohësh kam krijuar prapë një koleksion me skeda si komentar për studimet tuaja etimologjike dhe po jua bashkëngjis të gjitha këtu, siç i kam mbajtur shënimet, pasi detajet nuk i mbaj më mend. Kur pritet të dalë vëllimi i parë i fjalorit etimologjik?

Edhe një herë ju urojmë juve, bashkëshortes dhe vajzës suaj gjithë të mirat!

Të fala dhe me nderime!

H. Ölberg

Kartolinë e dërguar nga Bonn-i dhe e nënshkruar nga Hermann Ölberg, T. Ölberg dhe Johann Knobloch:

Shumë i nderuar, zoti Profesor!

Ju përshëndes përzemërsisht nga Bonn-i ku kam mbajtur nga një referat mbi shqiptarët dhe ilirët.

Me nderime Hermann Ölberg

Edhe nga unë urimet më të mira dhe përshëndetje të përzemërta!

T. Ölberg

Ju përshëndes plot nderime!

I juaji, Joh. Knobloch

Innsbruck, 12.06.1974

Instituti i Gjuhësisë i Universitetit të Innsbruck-ut
Kryetari: Prof. Dr. Wolfgang Meid
A-6020 Innsbruck, Innrain 30, Telefon (05222) 227 01 / 961

Prof. Dr. E. Çabej
Rr. Q. Stafa 395/12
Tirana

Shumë i nderuar zoti Profesor,

Më në fund po i përgjigjem letrës suaj të detajuar të datës 21 mars, pasi i kemi diskutuar disa herë pyetjet tuaja (Prof. Meid dhe unë). Por para së gjithash ju kërkoj të falur që ende nuk kam konfirmuar marrjen e teksteve tuaja në lidhje me konferencën si dhe marrjen e asaj surprize të bukur për Krishtlindje. Gjithçka mbërriti në rregull dhe dhurata e vajzës suaj më gëzoi shumë. Shishja e vogël është vendosur mbi tavolinën e punës dhe zbukuron dhomën, por nuk kam guxuar ta mbush me gjësend. Nëse dërgesa e pakove, përveç librave, nuk do të ishte kaq e komplikuar, do t'ju dërgoja shpeshherë ndonjë gjë!

Më tej ju falenderoj për dërgesat e vazhdueshme të "Mësuesi"-t si edhe për fjalorin e Scerba-s, të cilin ua dorëzova sllavistëve që momentalisht kanë nevojë për të.

Tani t'i kthehem çështjes thelbësore: më pëlqen shumë që synoni të botoni edhe në gjuhën gjermane hyrjen e librit për Buzukun. Me siguri zoti Dr. Fiedler do të ishte shumë i përshtatshëm për këtë. Por të gjitha publikimet tona janë pa shpërblim, përndryshe do të hynim në konflikt me institucionet e tatimeve. Edhe në rastin konkret ne nuk

mund të japim honorar, e shumta në mënyrë indirekte, duke e deklaruar shumën për diçka tjetër. Por edhe kjo nuk do të ishte ndonjë shumë e madhe dhe në çfarë vlerash mund të mendohej? Sa i takon publikimit, IBK (Studimet e Universitetit të Innsbruck-ut për shkencat kulturore) nuk është i përshtatshëm për shkak të karakterit shumë specifik të publikimit. Më shumë përshtatet IBS (Studimet e Universitetit të Innsbruck-ut për shkencat gjuhësore), por edhe këtu zoti, profesor M. momenatlisht nuk sheh ndonjë perspektivë të madhe për shkak të arsyeve financiare. Por do të duhet kohë deri sa edhe përkthimi të jetë gati, kështu që siç thotë edhe shprehja: koha është kështilltari më i mirë e, deri atëherë, ndoshta gjenden dhe financat. Kostot e shtypit kanë arritur shifra irreale saqë jemi të detyruar të heqim dorë nga shtypshkrimi në plumb dhe duhet të përdorim një procedurë më të thjeshtuar, të shkruajmë me makinë shkrimi të mirë pa barazim të marxhinave dhe pa shtyp të tipit offset. Pak a shumë siç u veprua me botimin e referateve. Profesori M. dhe unë vetë, mendojmë se thjesht publikimi i hyrjes është pak, dhe unë mendova se ndoshta ju mund ta plotësoni hyrjen me anë të një regjistri të plotë rreth veprës së Buzukut, sepse vetëm kështu, për herë të parë, Buzuku do të zbërthehej e deshifrohej saktësisht. Ju me siguri keni plotësuar studimet e Ashtës, ose paralelisht me të, në mënyrë të pavarur, keni përpiluar një regjistër të tillë të leksikut të Buzukut. E gjitha kjo do të rezultonte në një vepër standarde për botimin e së cilës mund të bënim për vete edhe Këshillin e Kërkimit Shkencor, sepse kështu do të kishim në dispozicion gjithçka që ka lidhje me Buzukun. Se si do të publikohej kjo te ne, natyrisht që e kemi ende të paqartë për momentin, por për këtë çështje ndoshta mund të bëhet diçka në Vjenë.

Unë kam menduar edhe për një mundësi tjetër, dhe konkretisht: të hapim një kolanë të veçantë me studimet ballkanologjike. Por nga ana organizative kjo është ende problematike. Jemi menduar e kemi reflektuar gjatë për këtë çështje kaq komplekse, pikërisht për arsyen se propozimi juaj na nderon shumë dhe do të ishte shumë bukur, nëse botimi juaj do të realizohej në Austri.

Pra, për ta përmbledhur, do të thosha se ne kemi interes të madh për publikimin dhe do t'ju luteshim të vazhdojmë ta mendojmë së bashku çështjen edhe sa i takon Fiedler-it. A mund të caktohet një afat se kur mund ta ketë gati përkthimin Fiedler-i?

Kumtesat për konferencën albanologjike janë të gjitha këtu, për fat të keq, nuk po arrijmë të kontaktojmë me Fiedler-in, a do të mund ta kujtonit ju për kumtesën e tij? Po ashtu Uhlisch dhe të tjerë që fillimisht kishin konfirmuar kumtesa.

Për fat të keq nuk vij dot në Bukuresht, sepse më duhet të përfundoj kapitujt e fundit rreth konsonantizmit. Gjatë semestrit, për shkak të leksioneve, mezi gjej kohë për të punuar me përqendrim për manuskriptin. Me rastin e botimit festiv për nder të Bonfante-s kam shkruar një artikull rreth dy ose tre tingujve guturalë, pra kam mbërritur sërish deri te tre, ndërsa argumentimi juaj nuk më duket të jetë i plotë. Po ju dërgoj një kopje të bocave dhe jam kureshtar (për opinionin tuaj).

Është për të ardhur keq, që fjalori juaj etimologjik ende nuk është në shtypshkronjë. Komentet që po ju dërgoj në lidhje me të, janë në shumicën e rasteve thjesht të një natyre

teknike, sa i takon përmbajtjes, me të merrem e përballem më shumë në punën time të përditshme. Por nuk ka kurrfarë dyshimi që zërat e fjalorit tuaj janë krejt gjenialë.

A mund t'ju kërkoj diçka: A do të mund të më dërgonit një ekzemplar të "Dialektologjia shqiptare" të Gjinarit? Për të m'u lut një student në Bonn, kur isha atje për të mbajtur referat. Më tej, a do të ishte e mundur të pajisesha me vëllimin e tretë të "Foklor shqiptar"? Nga biblioteka juaj mbërriti dje një dërgesë, mes të tjerash ishte edhe përkthimi i Mayani-t "Das Ende des etruskischen Rätsels" (Fundi i misterit etrusk). Sikur më goditi rrufeja, kur pashë që është përkthyer një *nonsens* i tillë. Asokohe, kur ambasada juaj e Vjenës ma dërgoi si dhuratë këtë libër në gjuhën franceze, unë i dërgova një letër mjaft negative ambasadës. Ç'të bësh, letra dihet që i duron të gjitha[13].

Si jeni ju dhe familja? Shpresoj që mirë. A do të shihemi sërish ndokund? Kaluam ditë shumë të bukura atëherë këtu te ne.

Përshëndetje të përzemërta dhe urimet më të mira për stinën e verës!

Si gjithmonë me respekt,

H. Ölberg

A- 6020 Innsbruck, 26.08.1974

Instituti për
Gjuhësi Krahasuese
Universiteti i Innsbruck-ut

Zotit Prof. Dr. E. Çabej
Rruga Q. Stafa 395/12
Tiranë

Shumë i nderuar, zoti Profesor!

Ju falenderoj përzemërsisht për letrën tuaj të datës 11 gusht. Me siguri së shpejti edhe lejen do ta keni mbaruar dhe do të filloni punën. Ju me shumë gjasa do të keni qenë edhe në Bukuresht, apo jo?

Sa i takon Buzukut, së bashku me profesor Meid-in jemi munduar të gjejmë një zgjidhje pozitive. Prandaj do t'ju isha vërtet mirënjohës nëse këtë çështje nuk do ta linit në dorë të kohës, por të na thoshit mendimin tuaj dhe mundësitë e një publikimi. A e takuat Fi-

13 Papier ist geduldig – shprehje gjermane që do të thotë, në letër mund të shkruash gjithçka, edhe pse mund të mos ketë lidhje me realitetin. Një shprehje e ngjashme në shqip do të ishte: Letra s'ka gojë të ankohet. Ölberg nënkupton që libri i Mayani-t nuk përputhet me realitetin. [Shënim i përkthyesit]

edler-in? Vërtet nuk posedoni regjistër (të Buzukut), çka nuk mundem ta besoj, dhe a nuk do të ishte ky regjistër gati për publikim?

Dërgesat me "Mësuesi" dhe "Drita" i marr në rregull dhe ju falenderoj vërtetë përzemërsisht. Ato më mundësojnë një pasqyrë e panoramë interesante. Do t'ju ishim shumë mirënjohës nëse në vjeshtë do të kujtoheshit për Dialektologjinë e Gjinarit dhe për "Folklor shqiptar 3".

Porzig ndërkohë nuk gjendej dhe do të kujdesem që t'ju siguroj një kopje të punimit.

Gjatë gushtit familja ime është në mal dhe në shtator do të jemi sërish të gjithë bashkë. Për fat të keq kanë ndodhur disa ngjarje, që nuk më lejojnë të vij sërish në vendin tuaj të bukur në shtator e të ndjek ftesën e profesor Kostallarit. Vëllai im, për fat të keq, ka ndërruar jetë në Vjenë dhe kanë dalë shumë vështirësi me mbylljen e biznesit dhe me trashëgiminë, kështu që për momentin nuk largohem dot. Prandaj fatkeqësisht u detyrova të heq dorë dhe të kërkoj një shtyrje afati. Do të gëzohesha shumë t'ju ritakoja dhe ndoshta mund ta realizonim nga pranvera, nëse është e mundur.

Është mirë dhe bukur kur fëmijët udhëtojnë larg si vajza juaj. Po shishja, ka zënë vendin e saj të nderit mbi skrivaninë time në institut. A ka ndonjë dëshirë vajza juaj? Si po ecën me gjermanishten?

Aktet e kolokuiumit albanologjik tani janë duke u redaktuar e përgatitur për botim, më në fund. Por pastaj çdo gjë do të eci me hapa të shpejtë. Ju do të merrni edhe korrekturat.

I dërgoj rregullisht revistën Kratylos dhe katalogun e shkencave të antikitetit bibliotekës universitare, po ju, a i lexoni rregullisht ato?

E tani, si gjithmonë, ju uroj juve dhe familjes suaj gjithë të mirat dhe shpresoj që së shpejti të marr sërish një letër nga ju. Ju e dini se sa më gëzojnë letrat tuaja. A do të mund të më dërgonit një apo dy ekzemplarë të guidës gjuhësore shqip-gjermanisht të Albturistit?

Me shumë respekt,

H. Ölberg

A-6020 Innsbruck, 11.11.1974

Instituti për
Gjuhësi Krahasuese
Universiteti i Innsbruck-ut

Zotit Prof. Dr. E. Çabej
Rruga Q. Stafa 395/12
Tiranë

Shumë i nderuar zoti Profesor!

Para së gjithash dëshiroj t'ju falenderoj shumë përzemërsisht për ngushëllimet që më shprehët ju dhe bashkëshortja juaj. Im vëlla ishte i sëmurë prej një kohe të gjatë, por askujt nga ne nuk ia merrte mendja që Perëndia do ta merrte kaq shpejt. Këtë vit kalova një verë aspak të mirë dhe ju do ta mirëkuptoni që m'u desh ta anuloja udhëtimin për në atdheun tuaj të bukur, sado që më erdhi keq. Por besoj se do të shfaqet prapë ndonjë rast.

Pas disa javësh do të përkujtohet sërish dita, kur djali juaj u largua përgjithmonë prej jush dhe unë si çdo vit me mendje do të jem pranë jush, ashtu si herën e parë.

Sa i takon letrës suaj të datës 11 gusht, unë kisha ndër mend të fotokopjoja librin e Porzig-ut, por meqë ju tashmë e keni, kjo nuk është më e nevojshme. Për Gjinarin dhe "Folklor shqiptar 3" do t'ju isha shumë mirënjohës. Në shumë dërgesa kam marrë prej jush "Mësuesi" dhe "Drita", shumë falemnderit. I lexoj me qejf shkrimet e tyre.

Zonjusha Heller ishte në kongresin e Bukureshtit dhe raportoi edhe për delegacionin tuaj si edhe për përshëndetjet dhe cigaret, falemnderit përzemërsisht! Nëse ka një version frëngjisht të botimeve paraprake të delegacionit tuaj, do të më interesonte.

Si po shkon puna juaj në Akademi? Shpresoj që atje të keni një fushë profesionale të mirë. A vajti tashmë për shtyp libri juaj?

Nëpërmjet Schwanke-s kam marrë nga Biblioteka Kombëtare e Austrisë ekzemplarin e Studimeve Etimologjike (1911) të Joklit, të cilin ai e kishte ndërfletëzuar dhe e kishte pajisur me shënime e plotësime. E njihni këtë ekzemplar? Por ky nuk mund të jetë libri për të cilin më folët, pra ekzemplari i ndërfletëzuar i Fjalorit etimologjik të Meyer-it. Ai duket se ka humbur me të vërtetë. Para pak kohësh pata një bisedë të gjatë këtu me zotin Gangale, i cili më dha një listë të manuskripteve albanologjike që ndodhen në Kopenhagë dhe që i kishte blerë të gjitha Hjelmslevi. Kjo listë do të botohet te aktet e kolokuiumit albanologjik. Gangale është një njohës i shkëlqyer i Kalabrisë dhe i historisë së shqipëtarëve! Ai posedon një thesar të pabesueshëm dorëshkrimesh, të cilat për shkak të mungesës së bashkëpunëtorëve nuk mundet t'i përgatisë për shtyp.

E tani ju uroj juve, bashkëshortes dhe vajzës suaj gjithë të mirat!

Si gjithmonë me respekt,

H. Ölberg

Innsbruck, 26.11.1974

Instituti i Gjuhësisë i Universitetit të Innsbruck-ut
Kryetari: Prof. Dr. Wolfgang Meid
A-6020 Innsbruck, Innrain 30, Telefon (05222) 227 01 / 961

Prof. Dr. E. Çabej
Rr. Q. Stafa 395/12
Tirana

Shumë i nderuar, zoti Profesor,

Me shpresën se ju dhe familja juaj jeni mirë, dua t'ju bëj të ditur që këto ditë profesor Meid-i do t'ju dërgojë një letër me anë të së cilës do t'ju kërkohet një raport vlerësimi profesional mbi veprimtarinë time shkencore. Kjo lidhet me kërkesën time për një post si profesor i asociuar. Do t'jua dija shumë për nder, nëse do ta hartonit një raport të tillë. Nuk është nevoja që të jetë i gjatë, por do të ishte mirë nëse do të mund ta hartonit së shpejti, sepse në përputhje me këtë caktohen edhe mbledhjet e komisionit që nga ana e tyre duhet të raportojnë prapë para komisionit të fakultetit, i cili nuk mblidhet dhe aq shpesh. Ju i njihni pengesat e burokracisë së tepërt. Ju falenderoj që tani për mundimin tuaj!

Ditë të vështira po ju afrohen sërish dhe ju lutem të jeni të sigurt që bashkëshortja ime dhe unë me mendje do të jemi pranë jush. Sa më shumë kalon mosha dhe sa më shumë të afërm e miq na i rrëmben vdekja, aq më mirë mund ta kuptojmë situatën tuaj. E vetmja shpresë tani është që të ketë gjetur paqen e përjetshme.

Ende po mendohemi për çështjen e përkthimit të hyrjes së botimit tuaj të Buzukut dhe nuk duam ta lëmë pa e sqaruar. Ç'mendim keni nëse do të fusnim aty edhe artikullin e Joklit nga vëllimi HD 6, 1930, në gjuhën gjermane? A dini gjë, nëse gjendet ende varianti gjermanisht? Në lidhje me këtë do t'i shkruaj edhe zotit Dr. Schwanke. A ka filluar ta-shmë puna për përkthimin e hyrjes suaj në gjermanisht? A mundët të flisnit për këtë në Bukuresht? Më erdhi shumë keq që nuk pata mundësi të shkoja atje, por i gjithë ky vit nuk më eci mbarë, siç dhe e dini, dhe thjesht mund të shpresojmë që viti i ardhshëm të jetë më i mirë.

Kështu pra ju uroj juve dhe familjes suaj edhe një herë gjithë të mirat!

Ju përshëndes si gjithmonë me shumë respekt,

H. Ölberg

Innsbruck, 10.01.1975

Instituti i Gjuhësisë i Universitetit të Innsbruck-ut
Kryetari: Prof. Dr. Wolfgang Meid
A-6020 Innsbruck, Innrain 30, Telefon (05222) 227 01 / 961

Zotit
Prof. Dr. E. Çabej
Rr. Q. Stafa 395/12
Tirana

Shumë i nderuar zoti Profesor,

Letra juaj e datës 29.12. më gëzoi shumë dhe ju falenderoj shumë përzemërsisht për të. Ju urojmë të gjithëve një vit të mbarë 1975!

Dhurata e mrekullueshme e vajzës suaj na gëzoi shumë, ju falemnderit përzemërsisht edhe në emër të gruas sime. Edhe ne donim t'ju dërgonim diçka para Krishtlindjeve, por ka pasur kaq shumë rrëmujë, saqë pritëm të zgjidhnim diçka me qetësi dhe po jua dërgojmë tani. Shpresojmë ta pëlqeni e ta gëzoni!

Çështjen e Buzukut do ta mendoj edhe një herë në këndvështrimin e aspekteve të reja dhe do t'i shkruaj një herë Boretzky-t. Sikur të isha më i lirshëm, do ta bëja vetë përkthimin. Por leksionet mbi gjuhësinë e përgjithshme, gramatikën gjenerative etj. të cilat i kam detyrim, më marrin aq shumë kohë, saqë nuk arrij dot të merrem me diçka tjetër. Ndoshta mund të realizohej një vëllim i vogël përmbledhës mbi Buzukun me disa punime rreth tij, të cilat janë botuar edhe më parë. Eventualisht edhe një listë bibliografike me literaturë sekondare mbi Buzukun? Ju lutem, më thoni mendimin tuaj.

Artikujt tuaj për kolokuiumin albanologjik janë përgatitur (në IBM) dhe do t'ju dërgohen për korrigjim në ditët e ardhshme. Korrigjimet janë të komplikuara veçanërisht kur tejkalojnë rreshtin. Ndaj, nëse do të keni ndryshime të mëdha, do të ishte mirë nëse do t'i sillnit në formën e një shtojce. Pas kësaj do të përgatiten artikujt e zotërinjve të tjerë të delegacionit shqiptar dhe do t'u dërgohen me radhë autorëve. Ndoshta mund t'i informoni edhe këta zotërinj, që mundësisht të mos bëjnë korrigjime që do të zhvendosnin rreshtat.

Pastaj do t'ju lutesha edhe t'i kërkonit zotit, prof. Domi të na e dërgojë sa më shpejt manuskriptin e tij (edhe fjalimin e hapjes).

Ne do t'ju dërgojmë juve (dhe zotërinjve të tjerë) dy kopje prove dhe manuskriptin dhe ju lutemi për korrigjimin si edhe për të na kthyer mbrapsht manuskriptin.

Unë kam paraqitur kërkesën për profesor i asociuar (konform përcaktimeve të reja ligjore), gjë për të cilën kërkohen disa raporte vlerësimi. Ju falenderoj që e pranuat kërkesën e profesor Meid-it dhe që e hartuat një raport të tillë i cili do të vijë së shpejti. Gjith-

sesi, bazuar në përvojën e deritanishme, do të zgjasë mesatarisht 2 vjet, derisa ministria të lëshojë vendimin e emërimit.

Edhe një herë urimet më të mira për këtë vit për ju dhe familjen tuaj!

Përzemërsisht dhe me respekt,

H. Ölberg

P.S. Ne kemi një shkruese shumë të mirë, të saktë dhe të përpiktë në detaje (është studente e sllavistikës), e cila po kopjon manuskriptet. Në një apo dy vende në dokumentet tuaja ajo diskutoi gjatë për shkak të përdorimit të një fjale ("kulmi i mesjetës" në vend të "mesjetë e plotë" dhe të tjera të ngjashme) dhe ne i lejuam asaj një farë lirie. Por në rast se ju nuk jeni dakord me këtë, ju lutem ta korrigjoni sërish.

Innsbruck, 04.03.1975

Instituti i Gjuhësisë i Universitetit të Innsbruck-ut
Kryetari: Prof. Dr. Wolfgang Meid
A-6020 Innsbruck, Innrain 30, Telefon (05222) 227 01 / 961

Zotit
Prof. Dr. E. Çabej
Rr. Q. Stafa 395/12
Tirana

Shumë i nderuar, zoti Profesor,

Herë pas here vijnë dërgesat tuaja me gazetën "Drita" dhe ju falenderoj vërtet nga zemra për këtë, gjithashtu edhe për separatet që ishin dërguar herën e fundit. Shpresoj që të jeni mirë. Në fund të gushtit do të zhvillohet në Bernë Kongresi i 12-të i Onomastikës. A do të vijë ndonjë delegacion shqiptar atje? Ende e ruaj në kujtesë Amsterdamin, i cili për mua rezultoi vendimtar.

Para rreth 10 ditësh ju janë dërguar kumtesat tuaja të kolokuiumit albanologjik së bashku me manuskriptet. Nuk e di nëse janë transportuar me postë ajrore, sepse pakoja ishte shumë e rëndë. Normalisht do duhej të mbërrinte së shpejti te ju. Ju lutem na dërgoni mbrapsht një kopje të korrigjuar dhe manuskriptet. Teksti është shkruar në platformën e IBM-së, ndaj ju lutemi që plotësimet voluminoze të shtohen në fund të kumtesës në formën e një shtojce.

Edhe një pyetje: te aktet do të botohet edhe dorëshkrimi gjermanisht i artikullit të Joklit "Die europäische Wissenschaft und die albanische Sprache" (Shkencat europiane dhe

gjuha shqipe), i cili ishte botuar vetëm në gjuhën shqipe në revistën "Cirka". Shënimi me shkrim dore i Jokl-it përmbi kopjen daktilografike ishte 28.11. (me siguri e vitit 1937) dhe ne po hamendësojmë që kjo datë nënkupton ditën kur artikulli i është dërguar revistës. Punonjësi i arkivit i Institutit të Europës Lindore dhe Juglindore në Vjenë po më bën të vëmendshëm ndaj faktit që, sipas shënimit tuaj në "Studia Albanica" (1964, 1, 51), Jokli gjatë qëndrimit të tij në Shqipëri ka lexuar para audiencës dorëshkrimin me titull "Albanische Wörter als Zeugen albanischer Kulturgeschichte" (Fjalët shqipe si dëshmitare të historisë së kulturës shqiptare) – do të na interesonte të dinim nëse Jokli ka pasur me vete edhe manuskriptin "Shkencat europiane dhe gjuha shqipe" dhe mos vallë e ka referuar edhe atë? Natyrisht që këtë fakt do ta shënonim me kënaqësi te artikulli i tij.

Më tej do doja të dija nëse është e vërtetë, që Jokl-i ka qenë vetëm një herë të vetme në Shqipëri, pra në kohën për të cilën po flasim. Sepse Schw. ka vendosur një pikëpyetje te shënimi i bërë në hyrjen e dorëshkrimit. Dmth. ai nuk është i sigurt, dhe në fakt ai do duhej ta dinte.

A ka mbërritur në rregull pakoja e Krishtlindjeve që ju dërguam me vonesë? Për momentin jemi të gjithë mirë. Guntrami në maj ka provimin me shkrim dhe në qershor provimin me gojë të maturës. Shpresojmë për më të mirën.

Më lejoni t'ju falenderoj shumë përzemërsisht për raportin tuaj vlerësues, që siç mora vesh, paska mbërritur. Ndoshta do të kem mundësinë t'ju falenderoj në Vjenë, ku do të kishim edhe shumë gjëra për të biseduar.

Me urimet më të mira dhe si gjithmonë me shumë nderime

I juaji

H. Ölberg

Innsbruck, 11.07.1975

Instituti i Gjuhësisë i Universitetit të Innsbruck-ut
Kryetari: Prof. Dr. Wolfgang Meid
A-6020 Innsbruck, Innrain 30, Telefon (05222) 227 01 / 961

Zotit
Prof. Dr. E. Çabej
Rr. Q. Stafa 395/12
Tirana

Shumë i nderuar zoti Profesor,

Ka kaluar sërish shumë kohë, qëkur erdhi letra juaj e fundit e datës 24 prill. Ju kërkoj ndjesë që kam heshtur kaq gjatë, por ky semestër ishte jashtëzakonisht i mundimshëm

për mua, pasi leksionet mbi tipologjinë e gjuhëve më kanë ezauruar plotësisht. Përveç kësaj edhe profesor Meid-i ka marrë një vit sabatik. U gëzuam që pakoja mbërriti mirë dhe ju ka pëlqyer. Kështu mund të dërgoj sërish ndonjë gjë.

Dërgesat tuaja me gazetën "Drita" vazhdojnë të vijnë rregullisht, por unë nuk jam në gjendje të lexoj me detaje të gjithë atë volum përmbajtjesh. Por të paktën jam në korrent të gjërave.

Në lidhje me ekzemplarin e ndërfletëzuar të studimeve të Jokl-it unë do të bëj një kopje. Në të vërtetë nuk përmban shumë gjëra, më së shumti korrigjime dhe plotësime të bazuara te njohuritë e përftuara nga leximet, të cilat ai i mbante shënim. Nuk ka propozime të reja etimologjike.

Jam i gëzuar që patët mundësinë të kalonit ca kohë në Italinë e Jugut. Me siguri ju janë ripërtërirë kujtime të vjetra. Disertacionin tuaj e kam këtu të kopjuar.

Po gëzohem shumë që do të ritakohemi në Bernë, ku do të mund të diskutojmë për gjëra të ndryshme. Më lejoni t'ju parashtroj edhe një kërkesë: Profesor Demiraj më dedikoi një ekzemplar të librit të tij "Morfologjia historike" (1973). Një mik i mirë m'u lut t'i siguroj edhe atij një ekzemplar. A do të mund të më dërgonit një ekzemplar, ju lutem? Ndoshta edhe një ekzemplar të "Çështje të sistemit emëror".

U kam dhuruar disa zyrave/institucioneve atë guidën gjuhësore shqip-gjermanisht të Albturistit dhe tani nuk më ka mbetur asnjë për vete. A mund të merrni edhe një ose dy copë për mua nga ky botim?

Te ne, provimet e maturës vajtën mirë, shpresojmë të njëjtën gjë edhe për Brikenën! Gjithë të mirat për udhën e saj të mëtejshme!

Deri në ritakimin e ardhshëm ju përshëndes me respekt.

I juaji

H. Ölberg

Kartolinë e datës 12.09.1975 e dërguar nga Berna (Zvicër)

Shumë i nderuar, zoti profesor,

Me keqardhje të madhe konstatova që këtu nuk ka ardhur asnjë delegacion nga Shqipëria, gjë të cilën e prisja. Shpresoj të jeni mirë.

Përshëndetje të përzemërta,

I juaji

Hermann Ölberg

Innsbruck, 13.12.1975

Instituti i Gjuhësisë i Universitetit të Innsbruck-ut
Kryetari: Prof. Dr. Wolfgang Meid
A-6020 Innsbruck, Innrain 30, Telefon (05222) 227 01 / 961

Zotit
Prof. Dr. E. Çabej
Rr. Q. Stafa 395/12
Tirana

Shumë i nderuar, zoti Profesor,

Ja ku përfundoi sërish edhe një vit dhe ju këto ditë keni pasur kujtime të rënda – ne si gjithmonë kemi qenë me mendje pranë jush dhe familjes suaj. Shpresojmë që të jeni të gjithë mirë dhe që vajza juaj tashmë të ketë filluar studimet. Guntramit i duhet të shkojë në ushtri në janar. Kështu fluturon koha, djali ynë i dytë shkon tashmë në klasën e shtatë dhe së shpejti do të largohet edhe ai. Për vitin e ardhshëm ju urojmë para së gjithash shëndet, gjithë të mirat dhe shumë energji për të punuar. Ishte për të ardhur keq, që nuk erdhi asnjë delegacion shqiptar në kongresin e Bernës, unë e kisha pritur me shumë gëzim. A do të kemi ndonjë takim në vitin 1976?

Ju falenderoj shumë për dërgesat e "Dritës", herën e fundit mbërriti një pako e madhe, kështu që kam shumë material për të lexuar! Këtë semestër zhvilloj sërish një kurs hyrës për gjuhën shqipe, sepse kemi disa studentë gjermanë që kishin interes të madh për këtë. Kësaj radhe u bazova te libri i Solano-s, por nga ana didaktike është krejt i papërshtatshëm, ushtrimet nuk korrespondojnë me gramatikën, nuk ka leksik. Është për të ardhur keq që nuk ekziston asnjë libër mësimor i denjë. Gramatika e gjuhës shqipe C. nuk gjendet më në treg, ndoshta do të publikohet një ribotim i ripunuar me themel konform standardit të sotëm të gjuhës së shkruar.

Artikullin mbi "daks-", pas shumë kërkimesh jashtë shtetit, e gjeta më në fund në Institutin e Historisë së Universitetit tonë!! Të më falni për vonesën, por nuk ma kish marrë mendja që kjo revistë mund të gjendej në Innsbruck. Nëse ju duhet edhe ndonjë gjë tjetër, mos nguroni të më shkruani. A e morët kopjen e Studimeve Etimologjike të Joklit?

Këtu gjërat po shkojnë mirë. Si profesor i asociuar më janë ngarkuar të paktën 6 orë leksione dhe madje nga fusha e gjuhësisë së përgjithshme, çka kërkon aq shumë përgatitje, saqë duhej të lija pas dore shqipen. Dhe kështu ende më mungojnë disa kapituj mbi konsonantizmin te fonetika ime historike, dhe si rrjedhojë nuk kam pasur mundësi ta dorëzoj për shtyp. Dita do duhej të kishte 60 orë!

Pak para kongresit të Bernës më erdhi sërish një ftesë shumë nderuese nga drejtori i Institutit tuaj për të ardhur në Tiranë, por e kisha krejt të pamundur ta planifikoja edhe këtë udhëtim, sepse për shkak të olimpiadës semestri këtu filloi më herët dhe po përfun-

don që tani në fund të janarit. Mund ta përfytyroni gjithë rrëmujën e këtushme. Ndoshta olimpiada po transmetohet në televizion dhe ju mund ta shihni sërish prej së largu Innsbruck-un?!

Edhe një herë ju falenderoj për të gjithë ndihmën tuaj gjatë këtij viti dhe ju uroj edhe nga bashkëshortja ime gjithë të mirat për të ardhmen! Kur te posta të ketë prapë qetësi, do ju dërojmë sërish diçka për vajzën.

Me urimet më të mira.

I juaji

H. Ölberg

1.1.1977

Shumë i nderuar, zoti profesor!

Me kënaqësi të madhe mora letrën tuaj të datës 8 gusht dhe u gëzova shumë kur pashë, që jeni mirë. Me të njëjtën postë më erdhën atëherë edhe vëllimi i dytë i fjalorit tuaj etimologjik, dispensa juaj si edhe disa separate dhe revista "Nëndori". Një falenderim të përzemërt për gjithçka. Një urim të veçantë për fjalorin etimologjik, më së fundi vepra e shumëpritur, pika kulmore e albanologjisë! Gëzohem bashkë me ju. Që gjithë forcat dhe mundimin ia keni dedikuar kësaj vepre, është e kuptueshme, sidomos duke pasur parasysh që me gjithë këtë punë voluminoze pritet të dalin rreth 8 vëllime. Shpresoj që procesi i shtypit të eci shpejt. Nëse do të kishit mundësi të na dërgonit edhe neve një ekzemplar, do t'ju isha shumë mirënjohës.

Shpresoj që ditët e festave t'i keni kaluar bukur në rrethin familjar dhe ju uroj, edhe pse me vonesë, gjithë të mirat për këtë vit!

Të më falni që nuk jam përgjigjur më herët, edhe pse në mendje e kam pasur shpesh, por aktivitetet dhe rrëmuja para Krishtlindjeve krahas ngarkesave në institut nuk më kanë lënë kohë të lirë. E tani, letra e parë në këtë vit të ri është për ju. Falenderoj shumë përzemërsisht edhe Brikenën për përshëndetjet dhe urimet e saj, të cilave u përgjigjem me urimet e mia për suksese e mbarëvajtje. Shpresoj ta keni marrë në rregull pakon. Meqë Shqipëria dhe Austria ngjasojnë në shumë aspekte, mendojmë që edhe mbulesa do t'i shkojë mirë dhomës së saj! Por ne kemi kujtuar edhe birin tuaj të dashur, që nuk mundet të jetë më mes jush dhe kemi ndjerë dhimbjen tuaj.

Pushimet e Krishlindjeve po i kaloj me redaktimin përfundimtar të vëllimit të kolokuiumit, i cili tashmë ka arritur 750 faqe dhe këto ditë, më në fund, vërtet do të shkojë për shtyp. Dhe kështu botimi i vëllimit përkon me 100-vjetorin e lindjes së Jokl-it (20 shkurt 1877). Fillimisht na vonuan me premtime, pastaj mungonin paratë. Por tanimë të gjitha pengesat janë eliminuar dhe unë preferoj më mirë të mos flas për to. E megjithatë, besoj

se botimi do të jetë një vëllim i denjë reprezentativ. Që disa zotërinj na lanë në baltë, megjithë premtimet e përsëritura, këtë mund ta vërejmë vetëm me keqardhje.

Tani e ka radhën vëllimi im mbi fonetikën historike. Të shpresojmë që ta përfundoj së shpejti temën e konsonantizmit. Për shkak të detyrimit tim për 6 orë mësim në fushën e gjuhësisë së përgjithshme, për fat të keq, m'u desh ta lija pas dore shqipen dhe kam qenë krejtësisht i zënë deri në grykë me përgatitjet e leksioneve. E tani po futem sërish ngadalë në shina. Megjithatë, tani ka më shumë mbledhje e punë administrative se më parë, çka të rrëmben shumë kohë. Koha e bukur e të qenit docent ka përfunduar. Shpesh do kisha shumë qejf të vija në Shqipëri dhe të lija pas gjithçka për 2–3 javë. Që nuk iu përgjigja dot ftesave miqësore e të përsëritura këto vitet e fundit, më ka ardhur shumë keq, por kemi pasur aq shumë punë si unë edhe bashkëshortja ime, saqë thjesht nuk ka qenë e mundur.

Në institut jemi mirë të gjithë. Profesor Schmeja ka marrë përsipër drejtimin e indogjermanistikës, unë më shumë gjuhësinë e përgjithshme, profesor Meid-i është gjithashtu më shumë aktiv në fushën e indo-gjermanistikës. Vetëm ne të tre ofrojmë sëbashku 18 orë. Profesor Menghin-i është shëndoshë e mirë dhe gërmon me zell në tokën e Tirolit. Edhe prej tij keni shumë të fala.

Në vjeshtë Guntrami filloi studimet në Graz, elktroteknikë, degë shumë e vështirë. Por meqenëse ai interesohet shumë për gjithçka që ka lidhje me televizionin dhe gjëra të ngjashme me të, shpresojmë që do t'ia dalë. Hermanni është në klasën e shtatë dhe Gertruda, fiks para Krishtlindjeve, mbushi 12 vjet. Nga këto mund të llogarisja edhe moshën time, por më mirë po e lë.

Me rastin e 100-vjetorit të lindjes së Jokl-it shpresoja që profesor Solta do të organizonte ndoshta diçka në Vjenë, por me sa duket, s'është bërë gjë. Mos vallë nuk mund të organizoheshin disa leksione të hapura me folës të ftuar? Duket se po përpiqet në këtë drejtim.

A nuk ka ndonjë raport mbi themelimin e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë? Do të më interesonte të dija se si është e organizuar ajo. A nuk ka ndonjë lloj buletini?

Do t'ju isha shumë mirënjohës, nëse do të angazhoheshit në lidhje me numrat që mungojnë të revistave "Studime filologjike" dhe "Studia albanica". Neve do të na duheshin me patjetër.

Edhe unë i kujtoj me kënaqësi ditët e bukura që kaluam me rastin e kolokuiumit albanologjik. Shpresoj që vitin tjetër të vijë në Vjenë një delegacion shqiptar në kongresin e gjuhëtarëve dhe që ne të mund të takohemi sërish.

Sa i takon qëndrimit tim në lidhje me guturalet, ai do të provokonte një punim voluminoz nga ana juaj! Bëhet fjalë për çështjen e vokalizmit pas guturaleve. Nëse ju doni t'ia dilnin me 2, si në gjuhët sllave, do duhej të ishin shfaqur ndryshime fonetikore përkatëse në vokalizmin pasues, si në sllavishte. Tek e fundit ju e dini, që jeni absolutisht fantastik (siç thuhet bukur në gjuhën e sotme të fëmijëve të mi).

Dhe në fund më lejoni t'ju falenderoj edhe një herë shumë fort për të gjithë ndihmën dhe mbështetjen që më keni dhënë edhe vitin e kaluar. juve dhe të dashurve tuaj ju uroj edhe një herë gjithë të mirat dhe shëndet për vitin e ardhshëm, i cili sapo ka filluar.

Përshendetje të përzemërta edhe nga gruaja ime.

Me nderime

H. Ölberg

P.S. Meqenëse Brikena po studion edhe anglisht, po ju dërgoj diçka nga letërsia.

Innsbruck, 10.12.1977

Instituti i Gjuhësisë i Universitetit të Innsbruck-ut
Kryetari: Prof. Dr. Wolfgang Meid
A-6020 Innsbruck, Innrain 30, Telefon (05222) 227 01 / 961

Zotit
Prof. Dr. E. Çabej
Tirana

Shumë i nderuar, zoti Profesor,

Është vërtetë një turp që prej shumë kohësh nuk i jam përgjigjur letrës suaj të datës 30.07. dhe ju kërkoj shumë ndjesë. Por ju e dini që megjithatë ju mendoj shpesh. Ndërkohë ju më keni dërguar jo vetëm vëllimin e dytë vërtetë mjeshtëror të veprës suaj, por edhe artikuj e revista të shumta, si edhe "Gramatika II". Të gjitha kanë mbërritur në rregull e unë ju falenderoj nga zemra. Shpresoj që tani që vepra filloi të botohet, do të procedohet shpejt edhe me shtypin e vëllimeve të tjera. Ju e dini që ky kontribut është i papërsëritshëm, kështu që edhe duhet ta çoni deri në fund. Gëzohem që do t'ju takoj në Vjenë vitin e ardhshëm. Kanë kaluar shumë vite që nga takimi ynë i fundit. Para pak kohësh na erdhi një shkresë nga ministria, që me gjasa vitin tjetër dy austriakë do të mund të shkonin në Shqipëri në kuadrin e një shkëmbimi. Unë për vete kam aplikuar për vjeshtën 1978 dhe do të isha shumë i lumtur po të kisha mundësi të vija për disa javë në vendin tuaj të mrekullueshëm.

Me që ra fjala, të gjithë atyre që ishin të pranishëm në Innsbruck asokohe, u kam dërguar një vëllim të kolokuiumit dhe separatet, po ashtu edhe akademisë, por deri tani nuk kam marrë konfirmim. Shpresoj të mos ketë ndodhur gjë me dërgesat. Më lejoni t'ju kërkoj edhe diçka dhe konkretisht në lidhje me shkëmbimin që ka instituti ynë me universitetin tuaj. Kohët e fundit publikimet shqiptare na kanë ardhur nga Akademia, ndërkohë që dikur vinin nga biblioteka e universitetit. Unë tani nuk di kujt t'ia drejtojmë dërgesat tona dhe as nëse në Tiranë ka ndodhur ndonjë riorganizim. Për këtë u kam shkruar tashmë dy herë akademisë dhe bibliotekës së universitetit, por nuk kam marrë asnjëherë përgjigje. A do të mund të interesoheshit njëherë?

Para një jave patëm një konferencë interesante në Graz me rastin e 50-vjetorit të vdekjes së Schuchardt-it. Biblioteka e universitetit ka hartuar një katalog për këtë dhe unë mora një ekzemplar për ju, të cilin do t'jua dërgoj së shpejti. A keni arritur ta njihni Schuchardt-in? Ndërkohë me shumë mundësi do të keni marrë dërgesën me kopjet e ndryshme që kërkuat. Të dhënat mbi Joklin në ekzemplarët e Brockhaus-it janë aq të pamjaftueshme, saqë asokohe munda t'i anashkaloj.

Vera e këtij viti nuk shkoi edhe aq mirë, sepse në gusht, kur ne sërish ishim me leje, ranë shira pothuajse çdo ditë, kështu që nuk patëm fare mundësi të shkonim për t'u larë. Në shtator filluam me ndërtimin e karabinasë dhe tani, pikërisht para reshjeve të dëborës, arritëm të vendosnim edhe çatinë. Një shtëpizë e vogël buzë pyllit. Në pranverë do të vazhdojmë me ndërtimin derisa të mbarojnë paratë, pastaj do bëjmë pauzë.

Këtu vazhdon puna dhe ia kam marrë dorën aq mirë leksioneve për gjuhësinë e përgjithshme, saqë mund t'i kthehem sërish shqipes me intensitet. Për semestrin e ardhshëm kam shpallur që do të ofroj sërish një kurs hyrës (në gjuhën shqipe).

Ditët e ardhshme do të jemi sërish me mendjen te ju. Ju urojmë juve dhe familjes suaj të dashur gjithë të mirat dhe forcën e duhur e mbarësi për vitin e ri!

Përshëndetje të përzemërta edhe nga gruaja ime.

Me nderime

H. Ölberg

Innsbruck, 25.12.1978

Instituti i Gjuhësisë i Universitetit të Innsbruck-ut
Kryetari: Prof. Dr. Wolfgang Meid
A-6020 Innsbruck, Innrain 30, Telefon (05222) 33601–9961

Zotit
Prof. Dr. E. Çabej
Tirana

Shumë i nderuar, zoti Profesor!

Dhe ja ku viti po i afrohet sërish fundit dhe unë me mendje jam pranë jush dhe ju uroj juve dhe familjes suaj të dashur gjithë të mirat! Të shpresojmë që të jetë një vit i mbarë. Dhjetori sjell ditë të vështira për familjen tuaj të dashur dhe ne si gjithmonë ju kemi menduar shumë. Për Krishtlindje na erdhi përshëndetja juaj në formën e një "kutize", që na gëzoi shumë e për të cilën dhe bashkëshortja ime ju falenderon shumë. Ajo shkon më së miri me kutitë e argjendta që solla asokohe si suvenir nga Shqipëria dhe që zbuku-

rojnë dhomën. Si jeni? Siç dëgjova nga kolegët, në Vjenë keni qenë në formë shumë të mirë dhe gjithashtu edhe kumtesat tuaja kanë qenë të shkëlqyera. U përpoqa të paktën t'ju arrija në hotel, por ishte e kotë. Më erdhi shumë keq që nuk munda të vija në Vjenë. Sado që e kisha planifikuar, ashtu si dhe udhëtimin në vendin tuaj të bukur, me gjithë dëshirën e mirë, nuk funksionoi. Me siguri do ju kenë treguar që po ndërtojmë një shtëpizë jashtë Innsbruck-ut (pranë Telfs-it në një pllajë si Hungerburg-u). Kush ndërmerr diçka të tillë, e ka punën keq dhe i heq ca gjëra në kurriz. Pa folur fare për oraret e takimet, të gjithëve dhe gjithçkaje duhet t'u shkosh nga mbrapa dhe nëse nuk je vetë prezent aty, gjërat nuk ecin. Kësaj radhe pra patëm një verë vërtetë plot punë dhe pasi gjithçka u shty e u stërzgjat, nuk mund ta lija time shoqe vetëm, por m'u desh të qëndroja këtu. Shpresoj shumë që në Tiranë të mos ma kenë marrë për keq, pasi isha unë vetë që e kërkova një qëndrim atje dhe profesor Kostallari më shkroi plot mirësi. Shpresoj që do të kem mundësi vjeshtën e ardhshme? Punimet kanë ecur mirë, sepse patëm një vjeshtë të gjatë e të favorshme. Me shumë gjasa në pranverë do arrijmë të vendosim mobiljet atje, për të pasur mundësi për të shkuar fundjavave në mal.

Sapo dëgjova nga profesor Knobloch-u, që ju ka ftuar në Bonn për kolegjin e gjuhës shqipe dhe që ai shpreson se kjo do të realizohet gjatë këtij viti. Ju lutem, të planifikoni patjetër edhe Innsbruck-un në këtë udhëtim dhe na vini në dijeni në kohë që të mund të përgatitemi. A e morët asokohe katalogun e bibliotekës së Schuchardt-it që jua dërgova pas konferencës së Grazit? Edhe Ali Dhrimos i kam dërguar disa herë ndonjë gjë, por nuk kam marrë asnjëherë përgjigje, mos ka ndonjë adresë të re? Do t'i kishim dërguar me kënaqësi ndonjë gjë vajzës suaj për të përmirësuar njohuritë e gjermanishtes, a ka vazhduar të mësojë me zell dhe çfarë do t'i duhej?

Më lejoni t'ju pyes si më poshtë: Në dokumentet veneciane shfaqet shpesh fjala "gordena", që sipas kontekstit duhet të ketë kuptimin "dhuratë". A e njihni këtë fjalë apo mund të jepni një opinion për të? A është fjalë e njohur në sferën mediterrane?

Si po shkon puna me vëllimet e tjera të fjalorit etimologjik? Ne po e presim me padurim. Me ngarkesën mësimore aktuale (kësaj radhe 8 orë) më është dashur ta lë pak pas dore punën me gjuhën shqipe, për fat të keq. Por gjithsesi nuk e ndërpres fare, në mënyrë që të mbetem i përditësuar.

E tani dua t'ju uroj juve dhe familjes suaj edhe një herë gjithë të mirat për vitin 1979 duke shpresuar shumë që të kemi mundësi të ritakohemi!

Me respekt.

I juaji

H. Ölberg

Innsbruck, 03.08.1978

Instituti i Gjuhësisë i Universitetit të Innsbruck-ut
Kryetari: Prof. Dr. Wolfgang Meid
A-6020 Innsbruck, Innrain 30, Telefon (05222) 33601–9961

Zotit
Prof. Dr. E. Çabej
Rr. Q. Stafa 395/12
Tirana

I dashur zoti Profesor!

Do mendoni që jam bërë dembel në të shkruar, meqë prej kohësh nuk ju kam shkruar më. Ju lutem më falni për këtë neglizhencë dhe të jeni i sigurtë që ju mendoj shpesh. Dëshiroj t'ju bëj të ditur që do të vij sërish në atdheun tuaj të bukur, madje kam në plan të fluturoj nga Budapesti drejt Tiranës në datën 18 shtator (e hënë). Them të qëndroj 14 ditë atje.

Por sipas gjasave ju do të vini në Vjenë në kongresin e indo-gjermanistikës. E megjithatë shpresoj t'ju takoj e të flas me ju për disa ditë para nisjes suaj.

A e keni marrë ndërkohë katalogun e Schuchardt-it? Jua kisha dërguar së bashku me letrën dhe shpresoj që të mos ketë humbur.

Po gëzohem që tani që do e shoh sërish Shqipërinë pas kaq shumë vitesh dhe që do njihem me zhvillimet që kanë ndodhur ndërkohë.

Nëse keni ndonjë dëshirë, më shkruani sa jemi në kohë. Sa për të tjerat këtu, gjithçka është në rregull. Mirupafshim!

Me shumë respekt

H. Ölberg

Innsbruck, 26.08.1978

Instituti i Gjuhësisë i Universitetit të Innsbruck-ut
Kryetari: Prof. Dr. Wolfgang Meid
A-6020 Innsbruck, Innrain 30, Telefon (05222) 33601–9961

Zotit
Prof. Dr. E. Çabej
Rruga Q. Stafa 395/12
Tirana

Shumë i nderuar zoti Profesor!

Para ca kohësh ju shkrova se isha i gëzuar t'ju takoja sërish në Tiranë. Por për fat të keq kemi pasur ca vështirësi të cilat nuk do të më lejojnë të largohem në mes të shtatorit. Mund të realizohej më së hershmi në fillim të tetorit. Por meqë në atë periudhë te ne fillon prapë semestri, vështirë të marr dot leje për t'u larguar në tetor. Sa i takon kësaj, do të më duhet të informohem.

E tani shpresoj që të paktën ju të mund të vini në Vjenë. Do të përpiqem të marr pjesë një apo dy ditë në konferencë, për të qëndruar pak me ju. Kanë kaluar sërish gjithë ato vite, që kur u takuam për herë të fundit. Pengesa për udhëtimin tim është krejtësisht e një natyre personale, ishte bërë gati gjithçka. Më vjen jashtëzakonisht keq, sepse isha gëzuar shumë të ndodhesha pak në atë vend të mrekullueshëm.

Me shpresën se do të shihemi në Vjenë ju dërgoj përshëndetje të përzemërta për familjen dhe urimet më të mira!

I juaji

H. Ölberg

Innsbruck, 07.08.1979

Instituti i Gjuhësisë i Universitetit të Innsbruck-ut
Kryetari: Prof. Dr. Wolfgang Meid
A-6020 Innsbruck, Innrain 30, Telefon (05222) 33601–9961

Shumë i nderuar, zoti Profesor,

Shpresoj që ju dhe familja juaj po i kaloni bukur dhe këndshëm pushimet verore. Siç më bëri të ditur profesor Solta, ekzistoka shpresa që ju të vini në Vjenë për disa javë gjatë

semestrit të dimrit. Dëshirojmë t'ju lutemi që ta përfshini edhe Innsbruck-un këtu. Edhe profesor Knobloch-u shpreson që të mund të vini për të mbajtur referate si profesor i ftuar, kjo punë rregullohet lehtësisht nga Vjena.

Te "Studime filologjike" sapo lexova që 70-vjetori juaj është festuar si duhet. Më vjen keq që nuk e dija më parë këtë datë, ndaj më lejoni t'ju paraqes me vonesë urimet dhe nderimet e mia. Ju keni dhënë një kontribut kolosal. Prej vitesh isha përpjekur tashmë të merrja vesh datën e saktë të ditëlindjes suaj dhe mora përgjigje të ndryshme. E mësova vetëm tani që është tepër vonë! Më në fund mora nga Prishtina edhe botimin me gjashtë vëllime të studimeve tuaja, një koleksion madhështor. Përse nuk më keni treguar asnjëherë për këtë? Këtu janë të aksesueshme, në një mënyrë krejt tjetër, edhe hulumtimet tuaja etimologjike.

Gjej rastin t'ju njoftoj që kam ndër mend të vij sërish ne vendin tuaj të bukur në mes të shtatorit dhe kam shpresën të arrij t'ju takoj në kohën e duhur, sepse ma marr mendja që nuk do të niseni për Vjenë aq herët. Nëse deri atëherë do të ketë ende benzinë për avionët[14], unë do të nisja fluturimin për Tiranë të martën, në datën 18 shtator, ose ka të ngjarë të premten pasuese, me sa më kanë informuar këtu. Jam shumë i gëzuar për ritakimin. Nëse keni ndonjë dëshirë, më shkruani ju lutem.

Përshëndetje shumë të përzemërta.

Me nderime.

I juaji

H. Ölberg

Kartolinë me shkrim dore:

Shumë i nderuar zoti profesor!

Për ditët e festave që po afrojnë, dua t'ju bëj qejfin me një surprizë të vogël.

Gjithë të mirat juve dhe familjes suaj!

Me respekt

I juaji

H. Ölberg

14 Ölberg duket se i referohet krizës së naftës dhe benzinës të viteve '70, kur në 1979 çmimet e benzinës pësuan sërish një rritje të lartë, pas krizës së parë të vitit 1973. [shënim i përkthyesit]

Kartolinë me shkrim dore nga Salzburg-u:

M'u kujtua Gjirokastra, kur javën e kaluar patëm një takim të gjuhëtarëve austriakë në Salzburg!

Përshëndetje të përzemërta,

H. Ölberg

**Qyteti i Salzburg-ut ka një kala që është atraksion turistik. Ndoshta për këtë arsye Ölberg bën lidhjen me Gjirokastrën. [shënim i përkthyesit]*

Kartolinë me shkrim dore:

Shumë i nderuar zoti Profesor!

Krishtlindje të bekuara dhe gjithë të mirat për vitin e ardhshëm për ju dhe familjen tuaj!

Me shumë respekt

I juaji

H. Ölberg

Gerhard Rohlfs: Rrugëtimi biografik dhe shkencor

Gerhard Rohlfs-i mbahet si një nga figurat më të shquara të Romanistikës në shekullin XX. Hulumtimet e tij mbi zhvillimin historik të gjuhëve romane dhe veçanërisht punimet e tij mbi dialektologjinë në lidhje me dialektet italiane, të Zvicrës Jugore e më gjerë, e bënë atë një figurë të shquar në komunitetin shkencor.

Në botën e shkencës njihet si simbol i lidhjes së kërkimeve teorike me qasjen empirike. Kështu nëpërmjet kërkimeve në terren në Itali, Francë dhe Spanjë, dha ndihmesë në mënyrë vendimtare në kuptimin e zhvillimit të gjuhëve romane.

Rohlfs-i është nderuar nga komuniteti ndërkombëtar i shkencës gjuhësore si "patriarca dei linguisti" (Weidner 1987, 259), duke u vlerësuar kështu rëndësia e jashtëzakonshme e punës së tij.

Jeta dhe arsimimi

Gerhard Rohlfs-i lindi më 14 korrik 1892 në Berlin. Mjedisi familjar i tij ishte i karakterizuar nga një nivel i lartë arsimor. Interesi i tij për gjuhët u zhvillua relativisht vonë, pasi fillimisht ishte i pasionuar pas botanikës dhe zoologjisë (Rohlfs 1981, 151).

Pas përfundimit të gjimnazit humanist në Coburg, në vitin 1913 filloi studimet në Universitetin e Berlinit për Romanistikë, Filologji Klasike dhe Gjuhësi Krahasuese, ku u përqendrua kryesisht në diversitetin e gjuhëve dhe të dialekteve europiane.

Përvoja e tij në front, duke përfshirë plagosjen në vitin 1916, ndikoi në perspektivën e tij të mëvonshme profesionale mbi gjuhën dhe kulturën, duke i dhënë një kuptim më të thellë kushteve njerëzore dhe sociale në të cilat gjuha mbetet e gjallë.

Karriera akademike

Pas luftës Rohlfs-i vazhdoi karrierën e tij akademike, duke iu përkushtuar me intensitet çështjeve gjuhësore. Në vitin 1919 mori titullin "Doktor" me disertacionin me temë: *"Ager, Area, Atrium. Një studim mbi historinë leksikore të gjuhëve romane"* (Rohlfs 1920, 3–10).

Punimi i tij trajtoi çështje gjuhësore dhe etimologjike të gjuhëve romane dhe tregoi qartë përkrahjen e tij për kërkimin empirik. Ai u bë i njohur për metodologjinë, e cila do të kishte një ndikim të rëndësishëm në kërkimin e tij të mëvonshëm dhe studiuesit e rinj.

Dy vite më vonë bëri profesurën mbi "Habeo-Futurumin dhe Kondicionalin në gjuhët romane" (Rohlfs 1922, 15–22). Ky punim, mbi ishujt dialektorë grekë në Jug të Italisë, përfshinte aspekte teorike dhe praktike të kërkimit gjuhësor, në të cilin paraqiti jo vetëm karakteristikat gjuhësore, por gjithashtu ndërmori kërkime të gjera në terren, duke e përforcuar kështu njohurinë e tij me shembuj të gjallë. Kjo metodë u karakterizua nga një bashkëpunim i ngushtë me folësit e dialekteve përkatëse dhe ishte në kundërshtim me kërkimet akademike të asaj kohe.

Në vitin 1936 Rohlfs u emërua Profesor i rregullt për filologjinë romane në Universitetin e Tübingen-it. Ky post e ndihmoi për të zgjeruar kërkimin, thelluar mësimdhënien dhe të formonte një brez të ri gjuhëtarësh.

Dy vjet më vonë, mori postin e Vossler-it në Universitetin e München, ku mundi të thellonte interesat e tij në dialektologji dhe në letërsinë italiane dhe të krijonte një mjedis kërkimor ndërdisiplinor.

Në vitin 1944, Rohls-i u përball me një situatë të vështirë politike, u përndoq për shkak të denoncimeve, gjë që e çoi në pezullimin e tij nga detyra. Fatmirësisht, procedura ndaj tij u mbyll pas pagesës së një gjobe dhe e lejoji të vazhdonte karrierën shkencore. Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, mundi të rifillonte mësimdhënien dhe t'i kthehej hulumtimit.

Gjatë karrierës akademike Rohlfs-i arriti statusin "Profesor" në Tübingen (1926–1938) dhe në München (1938–1957), ku, pas rënies së regjimit nazist, u rikthye në detyrë në vitin 1945. Pas daljes në pension në Tübingen, u emërua Profesor Nderi. Megjithëse u tërhoq nga jeta akademike, vazhdoi kërkimet shkencore me përkushtim, duke botuar një sërë veprash të rëndësishme (Rohlfs 1977, 50–55).

Kontributet kërkimore dhe ndihmesa në Dialektologji

Kontributi më i rëndësishëm i Gerhard Rohlfs-it në gjuhësi ishte pjesëmarrja e tij në krijimin e Atlasit të Gjuhës dhe të Çështjeve të Italisë dhe të Zvicrës Jugore (AIS) që njihet si një nga projektet më të mëdha të kërkimit të dialekteve të shekullit XX. Puna e Rohlfs-it në dialektologji çoi në një bashkëpunim të ngushtë me shkencëtarë të njohur si Jaberg-u dhe Jud-i, të cilët e përfshinë atë në ekipin për Atlasin Gjuhësor Zviceran-Italian. Atlasi ofroi një mbledhje sistematike të dialekteve italiane dhe retoromane dhe hodhi themelet për shumë punime të mëvonshme në dialektologji.

Rohlfs-i nuk ishte vetëm një linguist teorik, por dha ndihmesë edhe përmes studimeve të tij të thelluara në terren dhe vëzhgimit të drejtpërdrejtë të përdorimit dhe të ndryshimit të gjuhës, duke luajtur një rol të rëndësishëm në krijimin e Atlasit. (Rautmann, Lindja e Atlasit të Gjuhës dhe Çështjeve të Italisë dhe Zvicrës Jugore, punim i papublikuar M. A. Hamburg 1993, cituar sipas (Weidner. 1987, 259)-Fussnote! Në këtë kuadër, ai dokumentoi dialektet e Jugut të Italisë dhe solli një kuptim të thellë për veçoritë gjuhësore të këtyre rajoneve. Veçanërisht të rëndësishme ishin kërkimet e tij në terren. Ai udhëtoi përmes fshatrave të izoluara për të mbledhur të dhëna gjuhësore autentike dhe për të ruajtur trashëgiminë gjuhësore të rajonit.

Metodologjia shkencore dhe punimet kryesore shkencore

Punimet shkencore të Rohlfs-it janë të një rëndësie të madhe për romanistikën dhe dialektologjinë. Kërkimet e tij u karakterizuan nga qasja empirike. Ai mblodhi materialet gjuhësore drejtpërdrejt në terren dhe i kombinoi ato me analiza historike. Analiza e tij rigoroze dhe kuptimi i thellë i dialekteve rajonale e bënë atë një figurë të rëndësishme në gjuhësi.

Kërkimi i Rohlfs-it në rajonin e Pirenejve u përqendrua në ndërveprimet midis baskishtes dhe gjuhëve romane. Ai analizoi ndikimet latine në gjuhën baske dhe studioi elementët baskë në varietetet romane rajonale. Qasjet e tij metodologjike që ndiqeshin nga parimet e Gramatikanëve të Rinj, mundësuan një studim të detajuar të fenomeneve gjuhësore komplekse në këtë kontekst multigjuhësor.

Në vitin 1957 Rohlfs-i doli në pension, por mbeti aktiv si Profesor Nderi në Universitetin e Tübingen-it, ku vazhdoi të mësojë dhe të studiojë deri sa vdiq më 12 shtator 1986 në Hirschau.

Në atë kohë ishte i angazhuar në komunitetin akademik dhe mbante kontakte me shkencëtarë ndërkombëtarë

Një aspekt tjetër i rëndësishëm i punës së tij ishte kritika ndaj pikëpamjeve dominuese të historianëve të gjuhës italiane.

Rohlfs-i kërkoi një shqyrtim të diferencuar të gjendjeve gjuhësore në Jug të Italisë dhe ishte për marrjen parasysh të konteksteve sociale dhe kulturore në të cilat përdoret gjuha.

Qasja e tij shkencore ishte ndërdisiplinore dhe përfshinte perspektiva etnologjike dhe historike, gjë që çoi në një kuptim më të plotë të gjuhëve romane.

Kërkimi për historinë e gjuhës

Studimet e Gerhard Rohlfs-it mbi historinë e gjuhës sollën një ndryshim thelbësor në mënyrën e kuptimit të zhvillimit të gjuhëve romane. Veçanërisht, hulumtimet e tij mbi ishujt gjuhësorë grekë në Italinë e Jugut ishin novatore dhe thellësisht analitike. Ai argumentonte se greqishtja e folur në këtë rajon nuk ishte thjesht një trashëgimi e kolonizimit bizantin, por një vazhdimësi e drejtpërdrejtë e Magna Graecia-s, çka shkaktoi debate të shumta në radhët e studiuesve italianë (Specchia, 1986, 10). Pavarësisht kundërshtimeve, Rohlfs-i arriti ta mbështeste tezën e tij me dëshmi të shumta gjuhësore të sakta dhe të dokumentuara (Battisti, 1955, 12–18).

Fusha që e bëri atë të njohur ndërkombëtarisht ishin studimet mbi komunitetet greke në Italinë e Jugut, të cilat përbëjnë dy "ishuj gjuhësorë", njëri pranë Otrantos në jug të Lecce-s dhe tjetri në Kalabri, në perëndim të Reggio-s. Këto ishin komunitete gjuhësisht në zhdukje. Aty Rohlfs-i realizoi regjistrime të folësve të gjeneratës së fundit, veçanërisht në Kalabri. Që nga koha e doktoraturës (1922, botuar 1924), kishte treguar se këto dialekte nuk mund të konsideroheshin, siç pretendonte historiografia italiane, thjesht si vazhdimësi e kolonive bizantine, por përfaqësonin gjuhë të vendosura

që në periudhën e hershme, të cilat, ndryshe nga shumica e dialekteve greke të sotme, nuk rrjedhin nga Koinéja.

Gjatë gjithë karrierës së tij, edhe në debate të ashpra me historianët e gjuhës italianë, Rohlfs mbajti dhe zhvilloi qëndrimin e tij përmes një sërë publikimesh, të cilat u pritën me vlerësim ndërkombëtar, veçanërisht nga studiuesit grekë e që sot janë pranuar edhe në komunitetin akademik italian. Një paraqitje sistematike ai ofroi me veprën e tij Historische Grammatik der unteritalienischen Gräzität (München: Bayerische Akademie der Wissenschaften, 1950).

Kontributi i Rohlfs-it shtrihet përtej studimeve gjuhësore: ai hapi horizonte të reja për kuptimin e rrënjëve historike dhe kulturale të bashkëjetesës gjuhësore në Itali të Jugut, duke ofruar një metodologji rigoroze dhe një qasje inovative, që ndikoi thellësisht në gjeneratat e ardhshme të studiuesve

Ndikimi në dialektologji dhe romanistikë

Rohlfs-i pati një ndikim të thellë në dialektologji, duke i trajtuar dialektet jo si devijime nga gjuha standarde, por si sisteme të pavarura gjuhësore. Hulumtimet e tij në terren mundësuan dokumentimin e detajuar të dialekteve, të cilat përndryshe mund të ishin zhdukur. Veçanërisht, *Dizionario dialettale delle Tre Calabrie* ndihmoi në sistemimin e variacioneve rajonale të gjuhës (Rohlfs 1977, 50–55). Rohlfs-i i përqendroi kërkimet e tij në jug të Italisë, veçanërisht në kolonitë greke dhe hulumtoi në Pirineje mbi marrëdhëniet gjuhësore midis Baskishtes dhe dialekteve.

Këto rajone, për shkak të kontaktit të tyre unik gjuhësor dhe veçorive historike, u bënë një pikë kyçe e punimeve të tij.

Pavarësisht përfshirjes politike në kontekstin fashist, ku u vazhduan kërkimet e tij, ai mbeti kryesisht apolitik në punën e tij shkencore (Rohlfs *Archiv Stud. Neueren Spr. 183*/1943: 61)

Kërkimet e tij mbi ishujt e dialekteve greke në Jug të Italisë, të cilët i quante "ishuj gjuhësorë që po vdesin", e bënë atë të njohur ndërkombëtarisht. Rohlfs-i vuri në dukje se këto dialekte nuk vinin, siç ishte menduar deri tani, nga kolonitë bizantine, por ishin gjuhë banimi arkaike nga periudha e hershme. Këto përfundime i prezantoi në disertacionin e tij dhe që nga viti 1922 në publikime të tjera (Hausmann 2000, 432–449).

Rohlfs-i gjithashtu hulumtoi Baskishten në Pirineje, duke studiuar si ndikimet latine në Baskisht ashtu edhe substratin bask të dialekteve romanike rajonale. Këto punime çuan në paraqitjen e "Baskolatinishtes" dhe të një studimi të detajuar të fjalëve të mbetura baske në rajonin e Pirinejve (Hausmann 2000, 432–449). Hulumtimet e tij mbi gjuhët e Pirenejve sollën gjithashtu kontribute të rëndësishme. Në *Le Gascon* analizoi ndërveprimet gjuhësore midis gaskonishtes, aragonishtes dhe gjuhës baske, duke ndihmuar në sqarimin e zhvillimeve historike të këtyre gjuhëve (Rohlfs, 1935, 80–90).

Dokumentimi i gjerë dhe metodologjikisht i saktë i hapësirave gjuhësore nga Rohlfs-i, përfshirë panoramën e tij të gjuhëve neolatine, mbetet një trashëgimi e rëndësishme shkencore (Tuaillon 1976, 5). Përmes kërkimeve të tij të detajuara dhe të pava-

rura, Rohlfs-i kontribuoi në mënyrë të rëndësishme në zhvillimin e gjeografisë moderne të gjuhës dhe të dialektologjisë.

Opinioni shkencor

Tezat e Rohlfs-it nuk u pranuan gjithmonë pa kundërshtime. Veçanërisht gjuhëtarët italianë si C. Battist-i dhe Parlangeli nuk pranuan interpretimin e tij mbi ndikimet greke në Italinë e Jugut (Battisti, 1955, 12–18). Megjithatë kërkimet e mëvonshme konfirmuan përfundimet e tij dhe sot ato konsiderohen si udhërrëfyese në fushën e gjuhësisë.

Qëndrimi i tij kritik ndaj "filologjisë së zyrës" shkaktoi përplasje, veçanërisht me Harri Meier, i cili e kritikoi për metodat e tij të kërkimit në terren. Kjo polemikë theksoi gjithashtu rëndësinë e qasjes empirike të Rohlfsit për shkencën e gjuhësisë (Meier, 1965, 30–40).

Angazhimi shoqëror dhe trashëgimia

Përveç arritjeve të tij shkencore, Rohlfs u angazhua edhe në komunitetin akademik dhe punoi për promovimin e gjuhëve romane dhe dialekteve të tyre. Ai ishte anëtar i disa organizatave shkencore ndërkombëtare dhe mori shumë nderime për punimet e tij kërkimore. Roli i tij si mentor për studentët dhe shkencëtarët e rinj ishte gjithashtu i rëndësishëm. Shumë nga nxënësit e tij kanë dhënë kontribute të rëndësishme në gjuhësi dhe kanë vazhduar trashëgiminë e Rohlfs-it.

Ndonëse karriera akademike e Rohlfs-it ishte e shquar, ai u përball gjithashtu me zëra kritikë në pasluftë, të cilët e akuzuan atë për mosangazhim të mjaftueshëm ndaj lëvizjeve politike gjatë nazizmit.

Këto polemika janë një pjesë e trashëgimisë së tij komplekse, e cila pasqyron tensionet midis shkencës dhe etikës në një botë në ndryshim.

Përfundim

Gerhard Rohlfs-i vdiq në vitin 1986 në moshën 94-vjeçare në Tübingen dhe la pas një trashëgimi të jashtëzakonshme shkencore. Me të romanistika gjermane humbi një nga mësuesit e vjetër të saj të fundit. Vepra e tij e plotë përfshin 478 libra dhe artikuj, nga të cilët gati gjysma janë shkruar pas daljes së tij në pension.

Kërkimet e tij mbi historinë e gjuhës, dialektologjinë dhe praninë e gjuhës greke në Itali kanë pasur një ndikim të qëndrueshëm në shkencën e gjuhësisë dhe mbeten një pjesë qendrore e shkencës moderne gjuhësore dhe ende citohet dhe zhvillohet në kërkime e sotme. Kombinimi i njohurive teorike, kërkimeve praktike dhe qasjes ndër-

disiplinore ka pasuruar jo vetëm dialektologjinë, por gjithashtu ka kontribuar në ruajtjen dhe vlerën e saj.

Për meritat e tij, Rohlfs-i u nderua me një numër të madh titujsh dhe çmimesh: "Doktor honoris causa" i universiteteve të Athinës (1937), Palermos (1963), Torinos (1964), Lecces (1973) dhe Cosenzas (1981). Shtatë komuna italiane i dhanë titullin "Qytetar nderi", ndërsa shtatë vepra përkujtimore (Festschriften) janë botuar në nder të tij. Ai ishte gjithashtu anëtar i një sërë akademive dhe shoqatave shkencore, si në Itali, Spanjë, Greqi, Suedi dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Për më tepër, ai u nderua me çmimin prestigjioz italian "Premio Forte dei Marmi – Galileo Galilei".

Në vitin 1940, me propozim të Karl Vofiler, Rohlfs u zgjodh anëtar i rregullt i Seksionit Filosofik-Historik të Akademisë Bavareze të Shkencave, një njohje e rëndësishme për kontributin e tij të jashtëzakonshëm në fushën e gjuhësisë dhe studimeve kulturore.

Pavarësisht diskutimeve të kundërta, metoda e tij u bë e njohur dhe sot formon një bazë për hulumtimet gjuhësore. Trashëgimia e tij shkencore mbetet e pakundërshtuar dhe vazhdon të jetë me rëndësi të lartë.

Gerhard Rohlfs-i ishte një nga romanistët më të shquar të kohës së tij. Jeta dhe vepra e tij përbëjnë një shembull të shkëlqyer të zhvillimit të romanistikës në shekullin XX.

Veprat kryesore të Rohlfs

Regjistri i veprave të Gerhard Rohlfs-it ka gjithsej 478 tituj, duke përfshirë libra dhe artikuj, përveç shumës së konsiderueshme të recensimeve që ai ka shkruar. Afërsisht gjysma e këtyre botimeve i përket periudhës pas daljes së tij në pension, çka tregon përkushtimin e tij të vazhdueshëm ndaj kërkimit shkencor.

Nga viti 1930 deri më 1954, Rohlfs-i ishte redaktor i revistës *Archiv für das Studium der neueren Sprachen*. Gjithashtu, nga viti 1925 deri në 1967, ai botoi një koleksion të teksteve ushtrimore romane, duke kontribuar në mënyrë të konsiderueshme në përhapjen dhe përvetësimin e gjuhëve romane nga studiuesit dhe studentët.

Për ditëlindjet e tij të 60-të, 65-së dhe 75-vjetorit u botuan vepra përkujtimore (Festschriften) që përfshinin një koleksion të shkrimeve të tij (52), si dhe nëntitujt *Romanica*, *Serta Romanica* dhe *Romania Cantat* (për ditëlindjen e 85-të). Veçanërisht *Romania Cantat* përmban mbi 70 këngë nga të gjitha gjuhët romane, shoqëruar me komente gjuhësore dhe muzikologjike, duke ilustruar përkushtimin e tij ndaj studimeve të gjuhës dhe kulturës.

Vepra e tij më e rëndësishme, apo *opus maximum*, mbetet *Historische Grammatik der italienischen Sprache und ihrer Mundarten*, një gramatikë historike në tri vëllime (1949–1954, riprint 1972), e cila u hartua qysh gjatë kohës së tij në Mynih. Kjo punë përbën një arritje monumentale në studimin e gjuhës italiane dhe dialekteve të saj, duke pasuruar thellësisht fushën e gjuhësisë historike.

Disa nga veprat e tij më të rëndësishme përfshijnë:

- ***Griechen und Romanen in Unteritalien (1924)***: Një studim mbi ndërveprimin gjuhësor midis dialekteve greke dhe romane në Italinë e Jugut. Në këtë vepër, ai hodhi tezën se ndikimet greke në Italinë e Jugut nuk datojnë vetëm nga periudha bizantine, por shtrihen deri në kohën e Magna Graecia-s (Rohlfs, 1924, 35–40).
- ***Historische Grammatik der italienischen Sprache und ihrer Mundarten (1949–1954)***: Një vepër standarde në tri vëllime mbi zhvillimin e gjuhës italiane, e cila mbetet e një rëndësie qendrore edhe sot. Rohlfs i kushtoi një vëmendje të veçantë sintaksës dhe studimit të dialekteve, duke u dalluar nga studimet e mëparshme si gramatika italiane e Meyer-Lübke (Rohlfs, 1949, 12–18).
- ***Etymologisches Wörterbuch der unteritalienischen Gräzität (1930, rishikuar 1964)***: Ky punim dokumentoi ato çka kishin mbetur nga gjuha greke në Italinë e Jugut dhe sistemoi prejardhjen e tyre (Rohlfs, 1964, 90–105). Ky punim mbështet tezat e tij mbi zhvillimin gjuhësor në Jug të Italisë, por gjithashtu ndikoi në diskursin shkencor mbi dialektet greke në Itali.
- ***Le Gascon (1935)***: Një analizë e gjuhës gaskone dhe marrëdhënieve të saj me gjuhët iberoromane. Në këtë studim, ai shqyrtoi veçanërisht ndikimin e gjuhës baske mbi dialektin aragonas (Rohlfs, 1935, 80–90).

Studime mbi Italinë e Jugut dhe greqishten italike
- *Griechen und Romanen in Unteritalien* (1924)
- *Dizionario dialettale delle Tre Calabrie* (1932–1939)
- *Nuovo dizionario dialettale della Calabria* (1977)
- *Vocabulario supplementare dei dialetti delle Tre Calabrie* (1966–1967)
- *Lexicon Graecanicum Italiae Inferioris* (1964)
- *Etymologisches Wörterbuch der unteritalienischen Gräzität* (1930, 1964)
- *Neue Beiträge zur Kenntnis der unteritalienischen Gräzität* (1962)
- *Scavi linguistici nella Magna Grecia* (1933)
- *Nuovi scavi linguistici nell'antica Magna Grecia* (1972)
- *Italogriechische Sprichwörter in linguistischer Konfrontation mit neugriechischen Dialekten* (1971)
- *Griechischer Sprachgeist in Süditalien* (1947)
- *Dizionario toponomastico e onomastico della Calabria* (1974)

Gjeografia gjuhësore dhe dialektologjia romanike
- *Sprachgeographische Streifzüge durch Italien* (1947)
- *Estudios sobre geografía lingüística de Italia* (1952)
- *Vocabolario dei dialetti salentini* (1956–1961)
- *Le Gascon. Études de philologie pyrénéenne* (1935)
- *Rätoromanisch* (1975)

- *Die rumänische Sprache in ihrer sprachgeographischen Beziehung zu anderen romanischen Sprachen* (1980)
- *Die lexikale Differenzierung der romanischen Sprachen* (1954)

Filologji dhe zhvillimi i gjuhëve romane
- *Romanische Philologie* (1949–1952)
- *Einführung in das Studium der romanischen Philologie* (1966)
- *Sermo vulgaris latinus* (1951, 1956)
- *An den Quellen der romanischen Sprachen* (1952)
- *Lengua y cultura* (1966)
- *Vom Vulgärlatein zum Altfranzösischen* (1960; 2. Aufl. 1963)
- *Manuel de filología hispánica*

Gjuha italiane dhe strukturat e saj *La struttura linguistica dell'Italia* (1937)
- *L'italianità della Corsica* (1941)
- *Germanisches Spracherbe in der Romania* (1947)
- *Historische Grammatik der italienischen Sprache und der italienischen Mundarten* (1949–1954)
- *Grammatica storica della lingua italiana e dei suoi dialetti* (1966–1968)

Kultura, ndërtimi dhe letërsia e vjetër
- *Primitive Kuppelbauten in Europa* (1957)
- *Studien zur romanischen Namenkunde* (1956)
- *Altfranzösisches Rolandlied* (Hg. 1942, Neuauflage 1948)

Bibliografia

Battisti, G. (2004). Gigino Battisti: dall'antifascismo all'impegno politico nel dopoguerra. Archivio trentino di storia contemporanea, 53(1), 19–30.

Hausmann, F. (2000). Die baskischen Elemente in den romanischen Dialekten der Pyrenäen.

Hausmann, F. (2000). Die griechischen Sprachinseln im Süden Italiens.

Killy, W. (Ed.). (2007). Deutsche Biographische Enzyklopädie (Vol. 8: Poethen – Schlüter, pp. 296–297). München: K. G. Saur Verlag.

Meier, H. (1965). Die methodischen Probleme der Sprachforschung.

Noyer-Weidner, A. (1987). Gerhard Rohlfs 14.7.1892–12.9.1986. In Jahrbuch der Bayerischen Akademie der Wissenschaften München (pp. 259–265).

Rautmann, W. (1993). Die Entstehung des Atlas der romanischen Sprachen und Dialekte Italiens und der Schweiz. Hamburg.

Rohlfs, G. (1920). Ager, Area, Atrium. Ein Beitrag zur lexikalischen Geschichte der romanischen Sprachen. Berlin.

Rohlfs, G. (1922). Habeo-Futurum und Konditional im romanischen Sprachgebiet.

Rohlfs, G. (1924). Griechen und Romanen in Unteritalien. Genève.
Rohlfs, G. (1935). Le Gascon. Halle.
Rohlfs, G. (1977). Dizionario dialettale delle Tre Calabrie. Milano: Niemeyer.
Rohlfs, G. (1981). Italienische Studien (Vol. 4).
Specchia, G. (1986). Gerhard Rohlfs: un linguista tedesco e la sua ricerca sul dialetto di Serrara Fontana. Quindicinale Salentino d'Informazione.

Çabej për Gerhard Rohlfs-in

Eqrem Çabej: "Për fjalorin e dialekteve shqiptare në Kalabri"

Me rastin e përvjetorit të Gerhard Rohlfs-it, prof. E. Çabej vlerëson kontributin e tij për hulumtimin e gjuhës shqipe dhe të dialekteve të saj. Ai e vlerëson Rohlfs-in për qasjen ndërdisiplinore dhe e përshkruan si hulumtues që "i lidh studimet që merren me fjalët dhe sendet me kërkimin për terrenin dhe historinë në një mënyrë model" dhe, i karakterizon studimet e tij si një shembull të humanizmit të vërtetë në hulumtimin e gjuhës. (Çabej 1962, 115)

Punimet e G. Rohlfs-it vendosen sidomos në kontekstin e historisë së gjuhës shqipe dhe marrëdhënieve të gjuhëve të gadishullit Apenin dhe Ballkanik. Përmes regjistrimeve të kujdesshme të dialekteve dhe analizës së detajuar të zhvillimeve gjuhësore, Rohlfs-i ka dhënë impulse të rëndësishme për hulumtimin e dialekteve shqiptare, impulse që shqyrtohen në kontributin e Rohlfs-it në një kontekst të gjerë historik, gjeografik dhe shkencor të kulturës.

Qasja metodologjike e Rohlfs-it dhe kontributet e tij

Perspektiva historiko-gjuhësore dhe hulumtimi i dialekteve

Interesi i Rohlfs-it për lidhjet historike dhe gjeografike midis gjuhëve të Ballkanit dhe Jugut të Italisë mund të shpjegohet përmes njohurive të tij të thella për gjuhën shqipe dhe pozicionin e saj të veçantë në hapësirën gjuhësore të Europës Juglindore. Ai e kuptoi herët se gjuha shqipe, për shkak të "karakterit të saj të lashtë" dhe vendndodhjes së saj në kufirin ndërmjet qendrave të gjuhës, është ideale për të shfaqur marrëdhëniet shumëplanëshe midis Greqisë dhe Jugut të Italisë. E. Çabej e ka formuluar këtë shkurt: "Kjo gjuhë duket në të vërtetë përmes karakterit të saj të lashtë, pozicionit të saj pothuajse në mes të dy shteteve [...] është veçanërisht e aftë për të ndriçuar marrëdhëniet e shumëfishta të dy gadishujve." (Çabej 1962,115)

E veçanta e hulumtimit të Rohlfs-it për fjalët e huazuara nga dialekti dorik-verior grek në shqipe është se ato janë pjesërisht të ngjashme në format e tyre me pasardhësit e tyre në Jug të Italisë. Kjo gjetje është "...jo e parëndësishme për pyetjen e vazhdimësisë së pasurive gjuhësore greke të lashta." (Çabej 1962, 115) Kjo mbështet qasjen e Rohlfs-it për të ndjekur në mënyrë metodologjike dhe empirike shtresat historike të gjuhës dhe lidhjet e tyre.

Dialektologjia (diaspora shqiptare) dhe ishujt gjuhësorë

Një pikë e rëndësishme e hulumtimeve të Rohlfs-it ishte dokumentimi sistematik i dialekteve shqiptare në Kalabri dhe Siçili. Shembull është studimi për ishullin gjuhësor të Acquaformosa në provincën e Cosenza-s, ku ai mblodhi të dhëna të vlefshme mbi leksikun e gjuhës shqipe dhe zhvillimin e tij nën ndikimin e mjedisit roman. Këta ishuj gjuhësorë janë të rëndësishëm, pasi ruajnë një fazë më të hershme të shqipes, kur ndarja dialektore nuk ishte ende aq e theksuar. E. Çabej e vlerëson "Mjeshtri ynë i nderuar në regjistrimet e tij për "Atlasin e Gjuhës dhe Gjërave të Italisë dhe Zvicrës Jugore" [...] ka nxjerrë një material të pasur." (Çabej 1962, 116) Më tej E. Çabej thekson se "të folmet e vendbanimeve shqiptare, të shpërndara kryesisht në shekujt XV dhe XVI [...] në Italinë e Poshtme dhe Siçili, janë me rëndësi të veçantë për historinë e shqipes" (Çabej 1962, 117).

Përmes krahasimit të elementeve shqipe të sjella dhe atyre të fituara në Itali, për shembull në fushën e emrave të të afërmve ose pjesëve të trupit, Rohlfs-i mundi të kapë kalimin dhe transformimin e fjalorit në mënyrë sistematike (Çabej 1962, 121). Ky shqyrtim i detajuar i substrateve gjuhësore jo vetëm që ofron të dhëna për kërkimin e dialekteve, por gjithashtu hap mundësi për ndryshimin social dhe kulturor të diasporës shqiptare në Jug të Italisë.

Leksiku dhe dialektet shqiptare kalabreze

Studimet e Rohlfs-it mbi leksikun e shqipes së arbëreshëve zbuluan shumë fenomene interesante gjuhësore, duke përfshirë ruajtjen e formave arkaike të gjuhës si dhe zhvillime të reja nën ndikimin e mjedisit roman. Rohlfs-i konstatoi se dialektet shqipe në Kalabri kanë ruajtur elemente nga shtresa të ndryshme historike të gjuhës, përfshirë huazime doro-veriperëndimore greke si dhe fjalë të marra nga latinishtja dhe greqishtja. "Është me rëndësi nga pikëpamja e historisë së fjalëve që elemente leksikore të kësaj natyre përsëriten në greqishten-shqipe" (Çabej 1962, 118).

Fjalori i të folmeve arbëreshe dëshmon një zhvillim të pavarur leksikor, i cili ka ardhur si pasojë e ndarjes së gjatë historike nga trualli amë. Sipas E. Çabejt, ky tip dialektor nuk ka një përkim të plotë në territoret e sotme shqiptare, për shkak të ndryshimeve që ka pësuar nën ndikimin e gjuhëve përreth, veçanërisht atyre romane (Çabej 1962, 137).

Elementë leksikorë me prejardhje shqiptare janë të pranishëm dhe shpeshherë të lidhur me nëntingëllimet e toskërishtes, për shkak të origjinës së toskëve të emigruar. Si shembull mund të përmendim shprehjen "me merr slsh", që përkthehet në italisht "mi ha dato il malocchio" (më ka marrë mësysh), si dhe fjalën "xerku", e cila nënkupton "qafa" (Çabej 1962, 137–138).

Ndikimi i gjuhës turke është gjithashtu i dukshëm në disa huazime që janë ruajtur në të folmet arbëreshe. Ndër to përmendim fjalën "manushaqe" (vjollcë) dhe "sndüqi" (sanduk, arkë), që dëshmojnë për ndërveprimet gjuhësore gjatë periudhës osmane (Çabej 1962, 147).

Nga aspekti morfologjik, të folmet arbëreshe ruajnë forma arkaike, të cilat janë zhdukur në shumicën e dialekteve të shqipes së sotme. Shembuj ilustrues janë forma

të tilla si "asht eshtrat" p dhe "mbiel" për "mbjell", që përfaqësojnë trajta të vjetra të folura në arealin shqipfolës

Vëzhgime fonologjike dhe morfologjike me rëndësi për historinë e shqipes

Një aspekt i rëndësishëm i punës së Rohlfs-it ishte analiza fonologjike dhe morfologjike e shqipes së arbëreshëve. Rohlfs-i identifikoi forma të vjetra, të cilat nuk ekzistojnë më në dialektet e sotme të shqipes. Për shembull, në Kalabri folja "lehem" (të lindesh) është ruajtur në formën e saj të vjetër mediopasive, ndërsa në shqipen moderne është zëvendësuar gjerësisht nga "lind". "Kjo fjalë shfaqet vazhdimisht si mediopasive "lehern" (lindem), "u le" (lindi) shpjegon Çabej (Çabej 1962, 119).

Kontaktet gjuhësore dhe huazimet semantike

Një aspekt tjetër i rëndësishëm i punimeve të Rohlfs-it është paraqitja e kontakteve të ndërlikuara gjuhësore që ka pasur shqipja gjatë shekujve. Ai dokumentoi ndikimet latine-greke, por edhe elemente romanike-bizantine dhe turke, të cilat kanë formësuar imazhin gjuhësor të shqipes. E. Çabej vëren: "Elementet turke që janë të pakta në numër [...] i përkasin shtresës më të vjetër të huazimeve turke të shqipes." (Çabej 1962, 117)

Rohlfs analizoi gjithashtu ndikimet e gjuhëve romane në italo-shqipen. Ai arriti të identifikojë shumë përkthime huazimesh, huazime kuptimore dhe formime hibride. Për shembull, në shqipen e arbëreshëve u zhvillua fjala "qene" si forma femërore e "qen", në mënyrë analoge me italishten "cane/cagna".

"Një krijim krejtësisht i ri është "regjethi" (mbreti i gardhit), i cili, si "mbret i vogël" (regj-th), rrjedh nga italishtja *reattino* dhe variantet e tij dialektore" (Çabej 1962, 122).

Shembuj të tillë ilustrojnë si shqipja, duke qenë në kontakt të vazhdueshëm me gjuhët e fqinjëve, jo vetëm që mori fjalë të huaja, por edhe i përshtati ato në mënyrë semantike dhe morfologjike. Këto studime dhe ndikime gjuhësore kanë një rëndësi të madhe për gjuhësinë e kontaktit dhe për studimin e komuniteteve dygjuhëshe.

Vlerësimi për Gerhard Rohlfs-in

Çabej përfundon kontributin e tij për hulumtimin e gjuhës shqipe duke theksuar se qasja metodologjike dhe empirike e Rohlfs-it jo vetëm që forcon pozitat e shqipes në gjuhësinë ballkanike, por gjithashtu "reflekton zhvillimet materiale dhe shpirtërore të gjuhës popullore" (Çabej 1962, 116). Për më tepër, theksohet fakti që fjalori shqip duhet të shihet si një dëshmi e besueshme e zhvillimit kulturor: "Zgjedhja është bërë në bindjen se [...] fjalori, si një dëshmi e besueshme e zhvillimit material dhe shpirtëror, ka një pozicion të shquar në sistemin gjuhësor." (Çabej 1962, 116)

Regjistrimet e detajuara të Rohlfs-it dhe analiza krahasuese e dialekteve të ndryshme shqipe nga format e para në Jug të Italisë deri te variacionet konservatore në Veri të Shqipërisë, kanë ofruar të dhëna thelbësore për të rindërtuar ndryshimet historike të gjuhës dhe kontaktet mes familjeve të ndryshme gjuhësore.

Përfundimisht mund të themi se Çabej e vlerëson shumë punën e Gerhard Rohlfs.

Në këtë kontribut për Rohlfs-in, Çabej thekson se si qasja e tij ndërdisiplinore, e bazuar në analiza historike, gjeografike dhe gjuhësore, ka dhënë kontribute të rëndësishme për rikonstruktimin e historisë së gjuhës shqipe dhe për hulumtimin e ishujve gjuhësorë në Jug të Italisë.

Vlerësimi i gjerë i Çabejt thekson se Rohlfs-i nuk ka lënë vetëm një ndikim të qëndrueshëm si gjuhëtar i shquar, por edhe si historian i kulturës, duke ndihmuar në kuptimin e zhvillimeve gjuhësore dhe shoqërore në këtë rajon.

Çabej e përfundon kontributin e tij me një lavdërim personal dhe i dëshiron jubilarit "pleqëri të bardhë" në mënyrën tradicionale shqiptare, duke theksuar respektin e madh dhe ndikimin e qëndrueshëm të punës së Rohlfs-it (Çabej 1962, 124).

Bibliografia

Çabej, Eqrem: "Zum Wortschatz der albanischen Mundarten in Kalabrien" serta romanica, Festschrift für Gerhard Rohlfs zum 75. Geburtstag . Im Einvernehmen mit W. Theodor Elwert und Heinrich Lausberg herausgegeben von Rudolf Baehr und Kurt Wais, Max Niemeyer Verlag Tubingen 1968.

Bashkëpunëtorët për Gerhard Rohlfs-in

Në parathënien e librit për 75-vjetorin e Gerhard Rohlfs-it *SERTA ROMANICA -FESTSCHRIFT FÜR GERHARD ROHLFS ZUM 75. GEBURTSTAG,* botuesit vlerësojnë veprën e tij si të jashtëzakonshme, ashtu edhe rolin e tij të rëndësishëm në zhvillimin e gjuhësisë romane.

Theksohet se Rohlfs-i është një personalitet shkencor që nuk i përket "vetëkënaqësisë retrospektive" pasi ai gjithmonë synon "njohuri të reja dhe më të thella". (fq. IV) Kjo reflektohet në zgjedhjen e citatit nga gjeorgjiket e Virgjilit: "ET VIBIDI IN CAMPO TEMPLUM DE MABMOKE PONAM" (Georgica III,13), që simbolikisht përfaqëson qasjen metodike dhe përparimtare të Rohlfs-it dhe nënvizon aftësinë e tij për të kapur në një fjali të vetme "dinamikën, qenien dhe veçantinë" e punës së tij (fq. IV).

Rohlfs-i përshkruhet si një pionier, i cili që në fillim e konsideroi veten si shkencëtar "romanist" dhe, që nga koha kur ishte student i ri e më pas si një bashkëpunëtor i gjatë i "AIS", nëpërmjet udhëtimeve të panumërta kërkimore e nxori gjuhësinë romane nga ekzistenca e saj e izoluar në dhomat akademike dhe e lidhi atë me realitetin e gjallë të gjuhës. Në këtë kontekst, Rohlfs-i paraqitet si një "Conquistador" që hulumtoi që nga Greqia dhe Rumania deri në Gadishullin Iberik, duke pajtuar teorinë dhe praktikën e dialektologjisë romane (fq. IV). Në një kohë kur qasja "pozitiviste" në gjuhësi konsiderohej si përparimtare, Rohlfs-i përshkruhet si ai që e zbatoi këtë qasje me "pavarësi, konsekuencë dhe rreptësi" dhe e bëri atë faktor vendimtar në zhvillimin e dialektologjisë romane të shekullit XX (fq. IV).

Parathënia gjithashtu thekson se Rohlfs-i, në një moment historikisht të rëndësishëm për shkencën, veproi si "lajmëtar i pozitivizmit të kuptuar drejt...dhe nuk hezitoi të kritikojë përfundimet e nxituara" të "filologjisë idealiste të re" (fq. IV-V).

Metoda e tij përshkruhet si vendimtare: një kombinim i njohurive të verifikuara, një metodologji e menduar mirë dhe një aftësi e jashtëzakonshme për sintezën e informacionit. Në dialektologji, ai krijoi një vepër që paraqitet si një "tempull" për gjuhësinë romane, "e përshkuar nga drita dhe ajri" që "edhe në detajin më të vogël është e lidhur në mënyrë të kuptimtë me harmoninë e tërësisë" (fq. V).

Për më tepër, theksohet njohja ndërkombëtare e Rohlfs-it që nuk pasqyrohet vetëm në karrierën e tij akademike. Ai u ngjit në katedrën e Karl Vossler-it dhe zuri vendin e Benedetto Croce-s në Akademinë Mbretërore Suedeze të Shkencave, por u vlerësua edhe me shumë dekorata, duke përfshirë doktorata nderi nga Athina, Palermo dhe Torino, si dhe anëtarësime të rëndësishme akademike dhe çmime nga shtete të ndryshme (fq. V).

Në 60-të dhe 65-vjetorin e tij u nderua me një *Tabula gratulatoria* dhe një botim jubile (fq. V).

Parathënia përfundon me një falenderim për të gjithë ata që ndihmuan në realizimin e këtij botimi për ditëlindjen e Rohlfs-it, veçanërisht për botuesin Robert Harsch-Niemeyer dhe theksohet se numri i atyre që e vlerësojnë dhe e nderojnë punën e Rohlfs-it i tejkalon "kufijtë teknikë të një botimi të tillë" (fq. V-VI). Kjo reflektohet në larminë e gjerë tematike të autorëve që nuk përfshijnë vetëm perspektiva gjuhësore, por edhe ato letrare dhe etnologjike (fq. VI).

Rohlf-i vlerësohet si më poshtë "Duke e kuptuar veten si një romanist, ju, që kur ishit një student i ri, më pas si bashkëpunëtor i gjatë i AIS dhe në udhëtime të panumërta kërkimore, e nxorët gjuhësinë romane nga një ekzistencë e thjeshtë laboratorike në dhomat akademike dhe e çuat në *viridis campus*, i cili shtrihet sipas "natyrës suaj të Conquistador-it" (Jaberg) nga Greqia dhe Rumania deri në bregun perëndimor të Gadishullit Iberik" (fq. IV).

Parathënia vlerëson angazhimin gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm të Rohlfs-it për gjuhësinë romane dhe e paraqet punën e tij si një bazë të domosdoshme për kërkimet e ardhshme në këtë fushë.

Bibliografia

SERTA ROMANICA FESTSCHRIFT FÜR GERHARD ROHLFS ZUM 75. GEBURTSTAG
Im Einvernehmen mit W. Theodor Elwert und Heinrich Lausberg herausgegeben von Rudolf Baehr und Kurt Wais, MAX NIEMEYER VERLAG TUBINGEN 1968

ET VIBIDI IN CAMPO
TEMPLUM DE MABMOKE PONAM.
Oeorgica 111,13

Letërkëmbimi i Rohlfs-it me Çabejn në shqip

momentalisht Prasa (Kalabri) 01.03.1965

Komisioni për Hulumtimin e Toponimeve
Pranë Akademisë Bavareze të Shkencave
Mynih

I dashur mik dhe koleg Çabej,

Para disa ditësh, mora në Romë ftesën telegrafike të universitetit tuaj për të vizituar vendin tuaj. U gëzova shumë për këtë dhe ju falenderoj shumë ngrohtësisht për ndërmjetësimin tuaj dashamirës. Vizën për të udhëtuar drejt Shqipërisë e mora menjëherë në Romë.

Momentalisht jam duke udhëtuar vetëm dhe do të qëndroj në Italinë jugore deri rreth datës 19 mars. Pastaj do të takohem me bashkëshorten time në Bari për të udhëtuar me makinë drejt Greqisë për katër javë (Peloponez dhe ishujt).

Mendova se ndoshta do të ishte më mirë, që ne të vimë nga Bari në Tiranë me avion në përfundim të udhëtimit tonë në Greqi (rreth datës 19 prill). Bashkëshortja ime do ta marrë vizën në Romë në datën 17.03. Duam të rrimë në Shqipëri rreth 4–5 ditë.

Nëse e konsideroni të dëshirueshme, jam i gatshëm të mbaj një referat, p.sh. mbi mbiemrat e familjeve italiane, ose mbi toponimet (në cilën gjuhë? Italisht?). Më lejoni të marr mendimin tuaj? Adresat e mia janë:

9–10 mars: Hotel Lido, Reggio Calabria
18 mars: Bari, presso Consolato di Germania Federale
Në Greqi: Athinë, Lexikon Historicum tes Akademias....

Përshëndejte miqësore

I juaji G. Rohlfs

16.05. 65

Hirschau pranë Tübingen
Hirschhalde 2

Komisioni për Hulumtimin e Toponimeve
Pranë Akademisë Bavareze të Shkencave
Mynih

I dashur koleg Çabej,

Pasi jemi kthyer sërish në shtëpi që prej datës 1 maj, nuk dua të lë pas dore për t'ju shprehur falenderimin tonë shumë të ngrohtë për gjithë mikpritjen dhe dashamirësinë që përjetuam në Shqipëri (dhe gjithçka falë ndërmjetësimit tuaj miqësor).

Në kontekstin e gjithë atyre përshtypjeve pozitive që morëm me vete nga Shqipëria, po mendoj paksa për të hartuar një reportazh udhëtimi në njërën prej gazetave tona të mëdha mbi Shqipërinë e ditëve të sotme, veçanërisht mbi përparimin e saj kulturor dhe si një vend me interes për turizmin.

Për këtë do duhej të më ndihmonit për të plotësuar disa boshllëqe. Po i formuloj ato në formën e një pyetësori të veçantë.

Ndërkaq ju kam dërguar shkrimet e mëposhtme: 1. Një botim të shkurtër të....., 2. Një nekrologji për Wagner-in, 3. "Terminologia pastorale", 4. "Neue Beiträge...".

A i keni marrë të gjitha?

Disa shkrime të tjera ia kam dërguar bibliotekës së universitetit të atjeshëm, mes tyre edhe raportet e Kongresit të Onomastikës në Mynih.

Përshëndetje të përzemërta, edhe për të gjithë miqtë tanë të mirë

I juaji

G. Rohlfs

18.01.66

Komisioni për Hulumtimin e Toponimeve
Pranë Akademisë Bavareze të Shkencave

Zotit Profesor Eqrem Çabej
Universiteti i Tiranës

I dashur zoti koleg,

Më në fund gjeta kohën e nevojshme për të bërë gati për shtyp referatin tim, të cilin keni kohë që e prisni.

Teksti kryesor është shkruar me makinë shkrimi. Sa u takon shënimeve dhe komenteve, besoj se do të jetë e mundur që teksti i tyre të konvertohet me makinë shkrimi atje te ju. – Sepse nuk dua t'ju lë më të prisni për këtë arsye.

Juve personalisht ju lutem që të verifikoni shembujt e gjuhës shqipe dhe atje ku është e nevojshme, t'i plotësoni. Edhe te shënimi nr. 3 duhen plotësuar disa të dhëna bibliografike.

Ju falenderojmë për urimet e dashura me rastin e Vitit të Ri, të cilat unë dhe bashkëshortja jua kthejmë përzemërsisht.

Ju lutem të më konfirmoni nëse e keni marrë manuskriptin me postë.

Përshëndetje të përzemërta për ju dhe zotin profesor Domi.

I juaji

G. Rohlfs

Do të ma dërgoni artikullin për ta korrigjuar?

20.02.66

Komisioni për Hulumtimin e Toponimeve
Pranë Akademisë Bavareze të Shkencave

Prof. Dr. G. Rohlfs
Hirschau pranë Tübingen

I dashu mik Çabej,

Rreth fundit të janarit kam dërguar në adresën tuaj manuskriptin e referatit tim: shpresoj që të ketë mbërritur pa probleme.

Me kënaqësi të madhe morëm përshëndetjet tuaja nga Vjena.

Një pyetje sot: vendi i banuar prej shqiptarëve Cerzeto (“querceto”) nga banorët e atjeshëm në shqip quhet Quanë. Çfarë është kjo?

San Giorgio Albanese (provinca e Kozencës) në shqip quhet Mbuzat-iz: nga vjen ky emër?

Po mendojmë që në datat 11–13 prill të marrim pjesë në Kuvendin e Atlasit Gjuhësor Mesdhetar në Venecia. Që andej kemi në plan të nisemi (nëpërmjet Brindizit) për katër javë drejt Greqisë.

Në rrugën e kthimit do kishim shumë dëshirë të udhëtonim me makinë përmes Shqipërisë, për ta njohur edhe më mirë vendin tuaj të bukur: Hyrja nga liqeni i Ohrit përmes Thanës, dalja nga Shkodra. – A do të ishte e imagjinueshme dhe e realizueshme kjo? Kësaj radhe do të donim të vinim si turistë, me shpenzimet tona.

Nëse kjo ende nuk është e mundur, atëherë jam i gatshëm të mbaj një referat në Universitetin e Tiranës, p.sh. me titullin “Probleme dhe aspekte të etnografisë së krahasuar” (me projeksion).

Nëse dëshira jonë miratohet, a do të ishte e mundur ta merrnim vizën e hyrjes në Vjenë?

Përshëndetje të përzemërta

(edhe nga gruaja ime)

I juaji

G. Rohlfs

Data: 22.03.1966

Komisioni për Hulumtimin e Toponimeve
Pranë Akademisë Bavareze të Shkencave

Mynih 22,
Marstallplatz 8

I dashur zoti Çabej,

dje morëm telegramin tuaj të dashur që na surprizoi dhe gjithashtu na gëzoi shumë.

Menjëherë u lidha me Ambasadën në Vjenë dhe shpresoj tashmë që gjithçka të ecë në rregull.

Me kënaqësi jam i gatshëm të mbaj një referat. Tema etnografike që ju kisha propozuar, mundëson edhe trajtimin e çështjes së shqiptarëve të Kalabrisë. Po e formuloj përfundimisht: Aspekte dhe probleme të etnografisë së krahasuar (ose.... mediterane), me projeksion, ashtu si një vit më parë (me epidiaskop).

Ndërkohë bashkëshortja ime do donte të dinte sa e keni masën e jakës: mos na e merrni për keq ju lutem! – Por nëse ju keni dëshira të tjera të veçanta ose nqs. ju duhet diçka me ngut, ju lutem na shkruani sa më shpejt. Mos vallë ju duhen libra?

Ne do të nisim udhëtimin në datën 7 ose 8 prill, fillimisht drejt Venecias, pastaj Kalabri dhe Greqi.

Ndërkohë ju lutem që t'i shprehni zotit rektor falenderimet e mia të përzemërta për ftesën shumë miqësore.

Për çdo rast po ju jap edhe disa adresa ku do të ndodhem në Itali:

10–12 prill: pranë Komitetit të Atlasit Gjuhësor Mesdhetar, Fondacioni Giorgio Cini, San Giorgia Maggiore, Venecia.

18 prill: pranë avokatit Annibale Brancia, Nicotera.....

28 prill: pranë Profesor Alfredo Majorano Taranto, Via Berardi 8

Kam informuar ambasadën në Vjenë që, duke ardhur nga Greqia ose Jugosllavia, do të donim të hynim në Shqipëri me makinë duke kaluar në Elbasan (ose Gjirokastër) dhe do të largoheshim nga Shqipëria nëpërmjet Shkodrës, duke qëndruar në Tiranë 1–2 ditë. Por nuk jemi të sigurtë, nëse kjo do të jetë e mundur.

Përshëndetje të përzemërta (edhe zotit Domi)

I juaji

G. Rohlfs

Crotone, 30.04.1966

Zotit Profesor Eqrem Çabej
Universiteti i Tiranës

I dashur mik Çabej,

Ndodhemi në përfundim të udhëtimit tim studimor në Kalabri dhe nesër do të nisemi nga Brindizi me tragetin "Appia" për në Greqi duke kaluar nga Korfuzi. Në Greqi planifikojmë të rrimë deri nga data 16 ose 17 maj.

Synojmë që në datën 18 ose 19 maj të hyjmë në Shqipëri (me makinën tonë) nga liqeni i Ohrit.

Kështu që referati im mund të fiksohet për datën 20 maj (apo 19?).

Nëse për të kaluar kufirin do duhet edhe ndonjë "dokument" tjetër i veçantë, ose ndonjë formalitet tjetër, do ju lutesha të më njoftonit deri në datën 12–14 maj në adresën:

Hotel Cecil

Kifissia

Athinë

Përshëndetje miqësore për ju dhe gjithë të njohurit tanë.

I juaji

G. Rohlfs

04.08.1966

Prof. Dr. Gerhard Rohlfs
Hirschau pranë Tübingen
Hirschhalde 2

Zotit Profesor Eqrem Çabej
Universiteti i Tiranës

I dashur zoti Çabej,

Vdekja e papritur e profesor Reichenkron-it në Berlin, e shkaktuar si pasojë e një aksidenti rrugor, është një humbje e madhe për filologjinë ballkanike në Gjermani. Si pasojë e drejtimit aktual të përkohshëm të Institutit të Berlinit edhe programi i referateve dhe kumtesave të planifikuara nga profesor Reichenkrohn-i nuk po funksionin si duhet.

Ndërkohë mora vesh nga përfaqësuesi i Filologjisë Sllave në Mynih (Prof. Schmaus), se Universiteti i Mynihut ju ka ftuar për një kumtesë. Për të mbuluar plotësisht kostot e udhëtimit tuaj edhe disa universitete të tjera në Gjermaninë jugore, kanë në plan t'ju kërkojnë të mbani një kumtesë. Këtë informacion e kam nga qytetet e Heidelberg-ut dhe Tübingen-it.

Për të planifikuar në mënyrë më të detajuar, ne do donim të dinim, nëse preferoni të vini në Gjermani në janar (shkurt), apo në nëntor (dhjetor), apo në maj (qershor).

Sa na takon ne personalisht, e kujtojmë me shumë kënaqësi qëndrimin tonë të fundit në Shqipëri. Ditët që kaluam në Shqipëri, janë për ne një kujtim shumë i bukur në çdo aspekt.

Duke ju uruar gjithë të mirat juve dhe bashkëshortes suaj (edhe në emër të gruas sime) dhe njëkohësisht me lutjen që të përshëndesni shumë përzemërsisht miqtë dhe të njohurit tanë të dashur në Tiranë, ju përshëndes përzemërsisht me mirënjohje!

I juaji

G. Rohlfs

Adresa jonë e pushimeve deri në fund të shtatorit: ..... Spanjë

Tübingen, 5 dhjetor 1966

Komisioni për Hulumtimin e Toponimeve
Pranë Akademisë Bavareze të Shkencave
Mynih

Zotit Profesor Eqrem Çabej
Fakulteti Filologjik i Universitetit të Tiranës

I dashur zoti Çabej,

Pasi jemi bërë me dije se Instituti Ballkanologjik i Universitetit të Berlinit si edhe Universiteti i Mynihut ju kanë ftuar për të mbajtur referate e kumtesa nga fusha juaj studimore, ne do të gëzoheshim nëse do përfshinit në udhëtimin tuaj edhe Universitetin tonë për të mbajtur një referat.

Mund t'ju them se këtu ka një interes të madh për të gjitha çështjet e Filologjisë Ballkanike. Dhe do të gëzoheshim veçanërisht shumë, nëse një përfaqësues i Universitetit të Tiranës (që aktualisht po lulëzon), do të merrte fjalën këtu te ne në lidhje me tema shkencore.

Me shpresën se dëshira jonë mund të plotësohet, Seminari i Gjuhëve Romane i universitetit tonë i ka dërguar rektorit të universitetit tuaj para disa ditësh ftesën zyrtare për ju.

Edhe Seminaret e Gjuhëve Romane të universiteteve të Heidelberg-ut (Prof. Baldinger) dhe Freiburg-ut (Prof. Lüdtke) janë shumë të interesuar për kumtesat tuaja dhe do t'i shprehin zotit Rektor të Universitetit të Tiranës ftesën zyrtare respektive.

Sapo ta keni të mundur, ju lutemi të na bëni me dije muajin në të cilin mund të zhvillohet turi juaj i kumtesave. Si një periudhë të përshtatshme po ju përmend 15 janar – 15 shkurt, ose muajt maj-qershor.

Duke ju lutur (njëkohësisht edhe në emrin e bashkëshortes sime) që t'ju transmetoni përshtypjet tona më të mira të gjithë kolegëve të dashur me të cilët u njohëm, ju përshëndes miqësisht!

I juaji

G. Rohlfs

20.02.1967

Komisioni për Hulumtimin e Toponimeve
Pranë Akademisë Bavareze të Shkencave
Mynih

Zotit Profesor Eqrem Çabej
Fakulteti Filologjik i Universitetit të Tiranës

I dashur zoti Çabej,

Nga rektori i universitetit tuaj u informuam që për fat të keq nuk mund t'i përgjigjeni ftesës për të udhëtuar drejt Republikës Federale Gjermane për një tur kumtesash, pasi ju ndërkohë keni marrë përsipër detyra të rëndësishme me rastin e përgatitjeve të Kongresit të Albanologjisë të planifikuar për fillimin e vitit 1968.

Ju urojmë shumë suksese për përgatitjet dhe mbetemi me shpresë se do të krijohet mundësia të realizoni udhëtimin tuaj për mbajtjen e kumtesave në Republikën Federale, udhëtim për të cilin shumë universitete kanë një interes serioz.

Do të doja të botoja në një revistë shqiptare një shënim të shkurtër interesant rreth furrës së pjekjes nën tokë (për qingja ose derra të egër), siç ka qenë e zakonshme në shekullin e 16-të te shqiptarët e Kalabrisë (shënimi e ka burimin te libri i Marafiotit, viti 1601).

Cila prej revistave do të ishte më e përshtatshme për këtë? Në çfarë gjuhe ta shkruaj artikullin tim (krejt të shkurtër)?

Me urimet më të mira për ju personalisht dhe punën tuaj, shumë të fala edhe nga bashkëshortja ime, njëkohësisht shumë të fala edhe të gjithë kolegëve tanë të dashur!

I juaji

G. Rohlfs

28.05.1967

Komisioni për Hulumtimin e Toponimeve
Pranë Akademisë Bavareze të Shkencave
Mynih

I dashur zoti Çabej,

Heshtja juaj e gjatë na merakosi shumë: patëm frikë se mos ndoshta nuk ishit mirë me shëndet.

Por letra juaj e fundit na qetësoi.

Ne jemi mirë. Po punoj momentalisht për vëllimin e 2-të të fjalorit tim kalabrez në formë suplementi.

Në prill ishim për disa javë në Sardenjë.

Me interes të madh lexova artikullin që patët mirësinë të më dërgonit mbi "Prejardhjen e kolonive shqiptare në Itali". Më pëlqeu shumë trajtimi i shumanshëm dhe këmbëngulës që i kishit bërë problemit. – Po ju dërgoj sot një artikullin tim me titull "Fontane e sorgenti in Calabria". Në faqen 65 ndodhet një foto e komunës shqiptare Acquaformosa (1924).

Shpresoj të mund të takohemi sërish në Kongresin e Gjuhësisë Romane në Bukuresht (prill 1968).

Me urimet më të mira,

I juaji

G. Rohlfs

Kartolinë gjermanisht:

Ju falenderojmë për të falat tuaja nga Vjena, për të cilat u gëzuam shumë!

Në disa territore të Kalabrisë shqiptarët e atjeshëm quhen brieš (briesh). – Nga e ka prejardhjen kjo fjalë?

G. Rohlfs

Letër pa datë

I dashur zoti Çabej,

Para pak kohësh mora prej jush artikullin "Shqipja dhe gjuhët fqinje të saj" (Das Albanische und seine Nachbarsprachen). E lexova artikullin që ofron një parashtrim të qartë e tërheqës, me interes dhe përfitim të shumëfishtë. Ju falenderoj shumë që patët mirësinë të ma dërgonit!

Kemi ndër mend, që pas një udhëtimi përmes Greqisë, të marrim pjesë në kongresin ndërkombëtar të romanistëve në Bukuresht (15–20 prill). Do të ishte një kënaqësi e madhe për ne të takonim atje ju ose ndonjë prej kolegëve tuaj.

Ja edhe disa pyetje shkencore:

1. A dallon shqipja mes këtyre dy formave:
   ich verheirate mich (Mann) – (unë martohem, burrë)
   dhe
   ich verheirate mich (Frau) – (unë martohem, grua)? – Dhe si është shprehja në të dyja rastet?
2. A përdoret për "ich habe gegessen" (*unë kam ngrënë*) dhe "ich habe einen Bruder" (*unë kam një vëlla*), "ich habe Fieber" (*unë kam temperaturë/ethe*) e njëjta folje? (Në Italinë e jugut thuhet "ho mangiato", por "tengo un frate.)
3. Bashkëngjitur një listë me mbiemra familjesh që janë të zakonshëm në Kalabri në zonat ku ka vendbanime të ngulimeve shqiptare.

Letrën tuaj të datës 19 nëntor e kam marrë.

Ju uroj gjithë të mirat dhe ju çoj të fala juve, bashkëshortes suaj dhe kolegëve tuaj!

I juaji

G. Rohlfs

Mbiemrat e familjeve në Kalabri

Cilët nga emrat (mbiemrat) e mëposhtëm mund të dëshmohen si shqiptarë?

Dramis
Damis
Remis
Frega
Borrescio
Lasdica
Nesci
Pisarro
Viterriti
Bloise
Azzinnari
Baffa
Busciacci
Camodeca
Candreva
Viteritti
Vituitti
Rebecchi
Dorsa
Chiurco
Zuddio
Nemojanni
[Cadicamo
Chidichimo]
Braile
Accoti
Assi
Miniaci
Cetta
Indrei
Sceba
Marcojale
Ggilo
Mázzica

16 qershor 1968

Komisioni për Hulumtimin e Toponimeve
Pranë Akademisë Bavareze të Shkencave
Mynih

I dashur mik Çabej,

ajo ç'ka na informuat (më 19 maj) për ecurinë e sëmundjes së djalit tuaj, na ka tronditur shumë si mua ashtu edhe bashkëshorten time. Po mendonim nëse do të ishte mirë të kontaktonim me një psikiatër këtu, duke i bërë me dije të gjithë indikatorët që keni përmendur në letrën tuaj. Por pa e parë me sytë e tij pacientin, do të jetë e vështirë, madje edhe për një mjek me përvojë të japë këshillën e duhur.

Natyrisht që do të ishim të gatshëm me shumë kënaqësi, t'ju dërgonim barna ose vitamina, nëse mendoni se do të sillnin dobi.

Gruaja ime i ka shkruar bashkëshortes suaj që nga depozita juaj e vjetër është ende në dispozicionin tuaj një shumë e konsiderueshme.

Pra, ju mund të mbështeteni plotësisht në ndihmën tonë. Ju lutem të na shkruani sërish sa më shpejt!

Me dhimbsuri të thellë marrim pjesë në fatkeqësinë që ju ka rënë juve dhe bashkëshortes suaj, e megjithatë duam të shpresojmë, që e gjithë kjo situatë të marrë një kthesë për mirë!

Me urimet më të mira për ju dhe familjen tuaj, ju përshëndesim përzemërsisht

Gerhard und Marianne Rohlfs

07.10.1968

I dashur zoti Çabej,

Disa të njohur italianë në Kalabri kanë interes të dinë nëse mbiemrat (emrat e familjeve) Varcasía, Filomía, Rodota dhe Misasi (më herët Mišáši) janë me prejardhje shqiptare. – A mund të na thoni diçka në lidhje me këtë?

A e keni marrë letrën e gjatë të bashkëshortes sime (në lidhje me djalin tuaj)?

Përshëndetje miqësore

I juaji

G. Rohlfs

15.09.1969

Komisioni për Hulumtimin e Toponimeve
Pranë Akademisë Bavareze të Shkencave
Mynih

Zotit Profesor Eqrem Çabej – Tiranë

Shumë i nderuar koleg, i dashur mik,

I sapokthyer nga Spanja (Villeggiatura) po gjej këtu në shtëpi dy vëllimet e mrekullueshme "Meshari i Gjon Buzukut" (1555).

Për këtë dhuratë të vyer ju shpreh mirënjohjen time të thellë. Është me të vërtetë një "Opus magnum", vepër për të cilën dua t'ju shpreh gjithë admirimin tim.

Për ta bërë të aksesueshme këtë vepër të shkëlqyer për rrethe më të gjera, sidomos edhe për shkak se i takon fushave të tjera jashtë sferës së punës time kërkimore, të dy vëllimet do t'ia kaloj bibliotekës sonë universitare këtu.

Me urimet më të mira për ju dhe familjen tuaj, ju përshëndes (edhe në emër të bashkëshortes sime)!

I juaji

G. Rohlfs

Me të njëjtën dërgesë postare do merrni edhe 5 separate.

Tübingen, 29.10.1969

Komisioni për Hulumtimin e Toponimeve
Pranë Akademisë Bavareze të Shkencave
Mynih

I dashur mik Çabej,

Kemi marrë letrën tuaj të datës 5 tetor dhe jemi të gëzuar që trajtimi mjekësor i djalit tuaj në Vjenë ka pasur sukses të kënaqshëm.

Njëkohësisht mund t'ju them se në një artikull timin që po e shkruaj aktualisht, jam në gjendje të rikonfirmoj plotësisht dhe përfundimisht me materiale të reja interesante shpjegimin tuaj të bukur të fjalës rumune crŭcium – në shqip kërtsû-ni. Shpjegimi juaj nuk mund të vihet më në dyshim (shih Tagliavini – Storia di parole, f. 514).

Gjithsesi në lidhje me këtë çështje do doja të dija prej jush, nëse në Shqipëri trungu/cungu i prerë i pemës (shqip kërtsu-ni, italisht ceppo) vërtet nuk luan më rol në ritet popullore të festës së Krishtlindjes? Cilat zakone/doke e kanë zëvendësuar këtë rit të lashtë? Dhe cilat janë shkaqet (islamizmi)?

Përshëndetje miqësore, edhe nga gruaja ime, njëkohësisht edhe për kolegët tuaj të dashur!

I juaji

G. Rohlfs

Dhjetor 1972 (format kartoline)

Shumë i nderuar koleg!

Shpresoj ta keni marrë manuskriptin tim, që jua kam dërguar para disa ditësh. – Në cilin vëllim (vit?) është botuar artikulli juaj "Parallele Ausdrücke und Redensarten..." në revistën "Revue internationale des études balkaniques"?

A keni edhe ndonjë separat për mua?

G. Rohlfs

Letër pa datë

I dashur mik Çabej,

më lejoni t'ju kërkoj informacion shkencor në lidhje me çështjen e shtjelluar më poshtë?

Në dialektet greke që fliten në Itali, nocioni "grek" shprehet me anë të fjalës "griko", si në Apulia ashtu edhe në Kalabri. Si "γgikos" kjo fjalë dëshmohet edhe në diplomat kalabreze (atti notariali).

Kjo fjalë nuk shpjegohet as nga latinishtja "graecus" as nga fjala "γgαikós". !në shekullin e 12-të.

Për shkak se supozohet përgjithësisht, që fjalët "graecus" dhe "γgαikós" (fillimisht si një emërtim për grekët epirotë) rrjedhin nga ilirishtja, edhe fjala "grikos" mund të rridhte drejtpërdrejt nga një burim ilir nëpërmjet oskëve dhe mesapëve, p.sh. në formën *grk (krahaso në serbo-kroatisht "grk").

Pyetja ime në lidhje me këto:

a) Si quhet në shqip gjuha greke?
b) A ekziston për këtë një formë dialektore "grik"?
c) A ekziston ndoshta fjala "grik" si mbiemër familjesh ose si toponim?

A do të kishit mirësinë të ma dërgonit informacionin deri në fund të korrikut?

Ju falenderojmë për përshëndetjet tuaja miqësore nga Londra!

Me falenderime ju konfirmoj se kam marrë artikullin tuaj tejet shkencor mbi nomenklaturën gjeografike të shqipes (Kongresi i Studimeve të Onomastikës në Vjenë).

Përshëndetje të përzemërta (edhe nga gruaja ime) për ju dhe bashkëshorten tuaj!

I juaji

G. Rohlfs

Kartolinë e shkurtër, datë 07.11.1974

I nderuar koleg!

Me falenderime konfirmoj marrjen e shkrimit tuaj "Çështja e territorit të prejardhjes së gjuhës shqipe".

Falemnderit për përshëndetjet miqësore nga Bukureshti!

G. Rohlfs

Pyetësor i G. Rohlfs me një shënim shqip të prof. Çabejt të datës 1 qershor 1965.

Pyetësor:

1. Si (me çfarë kursi) këmbehet në Shqipëri marka gjermano-perëndimore?
2. Në cilat vende bregdetare ka një hotel të mirë për turistët? (Si në Durrës)
3. Cilat janë çmimet e pensioneve? – A ka broshura, që mund të na i dërgoni ju ose një agjenci turistike?
4. Ku mund të gjejmë në Gjermaninë Perëndimore një zyrë turistike që ka interes për Shqipërinë?
5. Cilat vende europiane kanë përfaqësi diplomatike në Tiranë?
6. Ku mund ta marrin vizën turistët nga Gjermania Perëndimore: në Romë? Vjenë?
7. Çmimet e benzinës për turistët? A ka benzinë të llojit "Super"? Sa oktanë përmbajnë llojet e benzinave që keni atje?

Shënim në shqip me shkrim dore:
Kërkohet të japim përgjigje për këto
pyetje se vjen në datën 03.06.

Prof. Çabej.

01.06.1965

Kartolinë e shkurtër 28.08.1977

I dashur zoti Çabej,

Me shumë falenderime konfirmoj marrjen e artikullit:

Mbi hulumtimet leksikologjike të gjuhës arumune

Vepra albanologjike e Norbert Joklit

Përshëndetje!

G. Rohlfs

30.08.1977

I dashur mik Çabej,

Me anë të kësaj letre dua t'ju kërkoj sërish informacion shkencor.

Lista e bashkëngjitur përmban emra familjesh (mbiemra) që janë të zakonshme në lokalitetet shqiptare të Kalabrisë. Ato me siguri janë me prejardhje shqiptare (apo greke?).

A do të mund t'i identifikonit ose shpjegonit vallë disa prej këtyre mbiemrave si shqiptarë?

Përshëndetje miqësore dhe urimet më të mira!

I juaji

G. Rohlfs

*Po punoj për një libër të ri "Cognomi e soprannomi in Calabria"

Kartolinë, datë 22.10.1977

I dashur mik Çabej,

i sapokthyer nga një udhëtim i gjatë studimor në Kalabri, po gjej këtu letrën tuaj të datës 18 shtator me udhëzimet tuaja miqësore në lidhje me disa emra familjesh shqiptare. Mille grazie!

Sa i takon shëndetit të bashkëshortes sime, mund t'ju jap vetëm lajme të mira: rreziku i madh (karcinoma) me shumë shpresë është i tejkaluar.

Përshëndetje të përzemërta! (con memori ricordi)

I juaji

G. Rohlfs

Maximilian Lambertz dhe ndihmesa e tij në albanologji

Maximilian Lambertzi lindi më 27 korrik 1882 në Vjenë dhe atje kreu dhe studimet e mesme dhe universitare. Ai studioi në Universitetin e Vjenës, mes të tjerësh me profesorin e shquar Paul Kretschmer, filologji klasike, gjuhësi të krahasuar dhe histori antike, në vitet 1900–1905, ku mori licencën për mësimdhënien e latinishtes, greqishtes, gjermanishtes dhe historisë së antikitetit (Fiedler 1965, 331). Një vit më pas mbaroi edhe doktoratën mbi "Emrat e skllevërve në greqisht" (1907), e cila u vlerësua edhe me çmimin e Fakultetit të Filozofisë. Ende pa mbaruar doktoratën, në vitin 1906 Universiteti i caktoi një bursë studimi për të studiuar dialektet e Greqisë e të Italisë. Në këto vizita studimore ai u njoh edhe me shqipen e folur në këto vende. Prof. Claus Haebler, indoeuropianist i shquar, në eulogjinë e tij për Lambertzin shkruan se ai e tregonte me kënaqësi njohjen e tij me shqipen kur ishte në Greqi për të marrë njohuri më të thelluara në greqishten e mesme e të re (Haebler 1964, 5). Një përshkrim tërheqës jep prof. Emil Lafe për takimin e tij të parë me shqipen e Greqisë: "Në afërsi të Tebës, dëgjoi rastësisht disa barinj që po flisnin një gjuhë të panjohur. Gjithë kureshtje u afrohet e i pyet se ç'gjuhë kishin folur ndërmjet tyre. Barinjtë iu përgjigjën se kishin folur arbërisht e se ata ishin arbëreshë nga fshatrat Kryekuqi e Kuklla. I mrekulluar nga ky zbulim i papritur, nxjerr fletoren e shënimeve dhe fillon të hedhë në letër këtë idiomë të re që nuk e kishte dëgjuar kurrë më parë. Studimit të saj ai do t'i kushtojë pastaj pjesën më të madhe të veprimtarisë së tij shkencore sa të gjatë, aq edhe të frytshme" (Lafe 1982, 178; Domi 1957, 170).[15] Dhe me të vërtetë, gjatë gjithë jetës ai nuk iu nda studimeve mbi gjuhën shqipe. Me gjithë detyrat, funksionet e kërkesat e karrierës akademike, albanologjia u bë fusha kryesore dhe më e dashur e studimeve të tij.

Kur u kthye në Vjenë, ai filloi punë si mësues, por në vitin 1907 deri 1911 u zhvendos në Mynih për të bashkëpunuar për Tezaurusin e Gjuhës Latine (Thesaurus Linguæ Latinæ). Atje shkroi edhe dy artikuj për onomastikën në antikitetin egjiptian dhe romak që u botuan në revistën Glotta (Grimm 1982, 430–440). Në vitin 1911 u kthye përsëri në Vjenë për të vazhduar mësimdhënien si mësues gjimnazi. Në këto vite ai fillon një bashkëpunim me Gjergj Pekmezin, përgjegjës i katedrës së shqipes në Universitetin e Vjenës, me të cilin boton një tekst mësimor dhe leximi për gjuhën shqipe (Lehrund Lesebuch des Albanischen, Vjenë, 1913), botimi i tij i parë në fushën e albanologjisë. Në vitet 1913 dhe 1914 ai shkon për një qëndrim studimi në Italinë e jugut për të hulumtuar të folmet arbëreshe të atjeshme.

Në vitin 1916 Lambertzi udhëtoi për herë të parë në Shqipërinë veriore dhe të mesme, i ngarkuar nga Komisioni Ballkanik i Akademisë së Shkencave të Vjenës për të mbledhur lëndë gjuhësore dhe folklorike. Përshtypjet dhe rezultatet studimore të

15 Këtë detaj Lambertzi ia ka treguar edhe prof. Eqrem Çabejt në bisedë personale me të (Çabej 1962, 174).

udhëtimit të tij ai i botoi në një raport të posaçëm në Kumtarin e Akademisë së Shkencave të Vjenës (Lambertz 1916, 122–146). Ai u kthye përsëri në Shqipëri në dhjetor të vitit 1916, këtë radhë për të kryer shërbimin ushtarak si pjesëtar i trupave austro-hungareze që kishin pushtuar Shqipërinë veriore e qendrore, ku u ngarkua me detyra kulturore, siç ishte mbikëqyrja e shkollave. Në këto vite, duke qëndruar në Shkodër, ai bashkëpunoi me Gjergj Fishtën për botimin e revistës Posta e Shqypnisë (1916–1918) ku shkroi një numër artikujsh me tematikë të ndryshme, gjuhësore, folkloristike, letrare, historike dhe të dhëna antropologjike nga udhëtimet e tij kërkimore nëpër Shqipëri.[16] Ai u pranua si anëtari i parë i huaj i Komisisë Letrare Shqipe, e ngritur nga patriotët shqiptarë dhe autoritetet austro-hungareze për të krijuar një gjuhë të përbashkët shkrimi dhe një drejtshkrim të njësuar për shqipen. Gjatë viteve të qëndrimit në Shqipëri ai iu kushtua studimit të shqipes, folklorit e letërsisë së saj.

Mbas mbarimit të luftës, Lambertzi u kthye në Austri ku rifilloi punën si mësues gjimnazi në Vjenë në vitet 1918 deri 1925 e më pas drejtor shkolle deri në vitin 1934. Me ardhjen në fuqi të regjimit autokratik të Dollfussit, si anëtar i hershëm i Partisë Socialdemokrate të Austrisë ai u detyrua të tërhiqej nga mësimdhënia dhe doli në pension të parakohshëm, duke punuar si studiues privat në Vjenë e Munih. Në ato vite ai iu kushtua studimit në nivel universitar të teologjisë protestante, për të cilën kishte pasur interes nga pikëpamja letrare-filologjike që në rini. Mirëpo nuk arriti ta mbrojë disertacionin që kishte përgatitur mbi çështje të fëminisë së Jezusit, pasi iu refuzua për arsye raciale: e ëma e tij ishte me prejardhje hebreje.

Në vitet e para të luftës II botërore Lambertzi u kthye përsëri në Mynih për të punuar mbi Thesaurusin e latinishtes, ndërsa në vitin 1943 u zhvendos në Laipcig ku bashkëpunoi në Enciklopedinë e Antikitetit të Pauly-Wissowa-s (Realencyclopädie der Altertumswissenschaften). Në këtë qytet ai vuri në punë aftësitë e tij pedagogjike duke dhënë mësim frëngjisht dhe italisht në shkollën e gjuhëve të huaja dhe në vitin 1945, mbasi ishte bërë edhe anëtar i Partisë Komuniste të Gjermanisë, u emërua drejtor i Shkollës së lartë të Gjuhëve të Huaja të Laipcigut. Një vit më vonë, në 1946, filloi të japë mësim edhe në Universitetin e Laipcigut, ku shumë shpejt u bë profesor i rregullt për Gjuhësi të krahasuar në Fakultetin e ri pedagogjik, ku jepte lëndët epigrafi latine, latinishte vulgare, Homerin, greqishten e vjetër dhe të re si dhe kurse mbi gjuhën shqipe (Grimm 1982, 439–440), të cilën e kishte mësuar shumë mirë dhe e fliste shkëlqyeshëm. Nga 1946 deri 1949 ai ushtroi funksionin e dekanit të Fakultetit pedagogjik. Vazhdoi të mbante leksione dhe të drejtonte edhe Institutin e Gjuhësisë indogjermane të Universitetit të Laipcigut deri në vitin 1957 kur doli në pension.

Krahas karrierës së suksesshme akademike në fushë të gjuhësisë krahasuese e të gjuhëve klasike, periudha jetësore e Laipcigut ishte për Lambertzin edhe periudha e lidhjes gjithnjë e më të ngushtë me albanologjinë. Atje ai shkroi veprat e tij më të rëndësishme albanologjike, të cilat pasonin njëra-tjetrën me një intensitet mbresëlënës. Albanologjia erdhi duke u bërë fusha e tij e mirëfilltë e specialitetit. Në kohën kur ishte ai dekan, u formuan për herë të parë në hapësirën gjermanishtfolëse studentë me specialitet kryesor albanologjinë (Fiedler 1965, 332). Ai e vizitoi dy herë Shqipërinë e mbas-

16 Një përshkrim të artikujve të botuar në Posta e Shqypnisë jep Kastrati 1962, 123–124.

çlirimit, në 1954 dhe 1957 dhe, edhe mbas prishjes së marrëdhënieve mes Shqipërisë dhe vendeve të Traktatit të Varshavës, ai nuk i preu lidhjet me Shqipërinë dhe kreu funksione në ambasadën e Shqipërisë në Berlinin lindor.[17] Deri në fund të jetës së tij ai punoi për albanologjinë: kur ndërroi jetë në 26 gusht 1963 kishte përfunduar një monografi prej 187 faqesh për dramën në teatrin modern shqiptar, mbetur në dorëshkrim.[18] Sipas dëshirës së tij të fundit, ai prehet në varrezat e Döblingut në qytetin e tij të lindjes, Vjenë.

Vepra albanologjike

Maximilian Lambertzi e nisi veprimtarinë e tij studimore me antikitetin greko-latin por njohja me gjuhën shqipe ia ktheu vëmendjen dhe interesin shkencor të jetës së tij në studimin e kësaj gjuhe dhe kulturës së saj. Albanologët shqiptarë e kanë vlerësuar lart figurën dhe veprën shkencore albanologjike të Lambertzit, ashtu siç i donte dhe vlerësonte edhe ai kolegët e tij shqiptarë. Eqrem Çabej ka shkruar për të në disa raste jubilare të jetës së tij dhe me rastin e largimit nga jeta. Ai është shprehur me vlerësime të larta për tiparet e Lambertzit si kërkues shkencor, si në rastin e 75-vjetorit të lindjes së tij: "Kërkimet e tij tregojnë një përzjerje të lumtur të gjuhëtarit, të folkloristit e të letrarit. Në këtë mënyrë ato na dalin përpara të shumanshme e të plota, si dëshmia e një njësie mendore të veçantë. Prandaj ato janë bërë tërheqëse për qarqe shkencore të gjera, dhe kanë zgjuar interesin e kërkimtarëve të fushave më të ndryshme t'albanistikës." (Çabej 1957, 127). Po ai me rastin e 80-vjetorit shkruan: "Maksimilian Lambertzi është një dijetar me natyrë artisti i pajisur me një dell letrar të fortë. Nga kjo natyrë e tij shpjegohet pse në veprën e tij janë përfaqësuar disa disiplina të ndryshme, megjithëse të afra në mes të tyre. Tri fusha të veprimtarisë shkencore vihen re te kjo vepër: literatura, gjuhësia e folklori, po këto në një mënyrë të tillë që ato janë të përndara barabar në punimet e tij dhe depërtohen midis tyre me një mënyrë organike." (Çabej 1962, 174). "Në studimet e tij ai me një shumësi tematike të rrallë rrok, mund të themi, kompleksin e studimeve shqiptare në tërësinë e tij." (Çabej 1964, 211).

Këtë shumësi tematike do të përpiqemi ta shtjellojmë sipas fushave të veçanta studimore, duke nisur nga fusha e gjuhësisë, ku përfshihen studimet dialektologjike, studimet gramatikore, veprimtaria mësimore për shqipen, studimet onomastike, çështja e prejardhjes së gjuhës shqipe, çështja e gjuhës letrare shqipe, pastaj fusha e folklorit dhe më në fund studimet për letërsinë shqipe.

17 R. Elsie, The Photo Collection of Maximilian Lambertz. Southern Italy 1913–1914 Albania 1916. http://www.albanianphotography.net/lambertz/ (konsultuar më 13 shkurt 2025)
18 R. Elsie, po aty.

Studimet dialektologjike

Lambertzi i nisi studimet e tij gjuhësore për shqipen me hulumtime dialektologjike në terren. Në udhëtimin e tij kërkimor të viteve 1913–1914 në Italinë e Jugut ai qëndroi katër muaj në fshatrat arbëreshe Montecilfone, Campomarino, Portocannone e Ururi të provincës së Campobasso-s, dhe në Chieuti e Casalvecchio të provincës së Foggia-s, duke mbledhur materiale të shumta dialektore e folklorike. Ai studioi edhe të folmet më veriore arbëreshe më pak të njohura në Abruce dhe Molize, veçanërisht të folmen e Villa Badessa-s. Këto hulumtime u pasqyruan në studimin e tij "Të folmet shqipe në Italinë e Jugut" (Lambertz 1914–1915), i cili përmban edhe një hartë të ngulimeve arbëreshe të Italisë. Sado i përmbledhur e sintetik, ky ishte një studim i parë kushtuar të folmeve arbëreshe në një vështrim përfshirës. Ai paraqet një historik të shkurtër të formimit të ngulimeve arbëreshe, gjendjen e studimeve në këtë fushë dhe rëndësinë e studimeve të të folmeve të diasporës për historinë e gjuhës shqipe, duke qenë se ato ruajnë tipare të shqipes mesjetare, në kushtet kur nuk kemi dokumente të regjistruara nga fazat e vjetra të shqipes. Rëndësinë e paçmuar që kanë të folmet arbëreshe të Italisë e Greqisë e thekson prof. Çabej në shkrimin kremtues për 80-vjetorin e lindjes së kolegut të shquar austriak: "Nga pikëpamja e dialektologjisë historike dhe e historisë së shqipes përgjithësisht një zgjedhje më e mirë nuk mund të bëhej. Këto ligjërime, të cilat së bashku me ishujt gjuhësorë që janë përderdhur andej-këtej nëpër Basilicata, Apuli, Kalabri e Siqeli, përbëjnë një grup më vete brenda degës dialektore të toskërishtes, në pjesën më të madhe rrjedhin nga disa valë shtektimesh prej kohës së luftrave të para me turqit, pra prej shekullit të XV e të XVI. Për këtë arsye këto koloni kanë marrë e kanë ruajtur nga vendi i të parëve disa tipare të cilat në thelb burojnë prej kësaj faze të mëparme të gjuhës e që në atdheun e parë, me zhvillimin më tej të dialekteve, ndërkaq janë bjerrë. Nuk ka nevojë të theksohet dhe aq se me traditën letrare relativisht të re të shqipes idioma e dialekteve italo-shqiptare si dhe e atyre që fliten në Greqi e që janë themeluar pak më parë, është me vlerë të pashoqe për fonetikën e morfologjinë historike të shqipes." (Çabej 1962, 175). Duke hulumtuar tiparet e të folmeve të arbëreshëve të Molizes dhe emrat e familjeve ai arriti në përfundimin se prejardhja e tyre ishte Shqipëria e Mesme dhe e Jugut, por të vendosur në një mjedis të ri italian dhe gjatë kontakteve shekullore mes fshatrave të ndryshme, të folmet e tyre krijuan një tipologji të përbashkët dhe ngjashmëri mes tyre (E. Lafe 1982, 178). Këto përfundime të tij shërbyen si paradigmë edhe për studime të mëvonshme lidhur me krijimin e të folmeve arbëreshe në rajone të tjera të Italisë. Lambertzi iu rikthye më vonë këtij studimi duke e zgjeruar në formë monografie mbi të folmet arbëreshe të Campobassos e të Molizes, botuar në disa numra të revistës për gjuhësi të krahasuar indoeuropiane (Lambertz 1923–1925).

Studimet arbëreshe të Lambertzit mund të lexohen tani edhe në gjuhën shqipe, nën kujdesin e dr. Genc Lafes (Lambertz 2021). Vlerësimin për këto studime të Lambertzit mund ta përmbledhim me fjalët e prof. Emil Lafes në Pasthënien e botimit shqip: "Në këto studime bie në sy përgatitja e lartë profesionale e M. Lambertz-it si dialektolog, kompetenca e fortë shkencore e tij në romanistikë, veçanërisht njohja e

përpiktë e dialekteve të Italisë së Jugut, si edhe shfrytëzimi i një literature të gjerë historike, gjuhësore e folklorike. Në këtë vështrim studimet arbëreshe të tij mbeten një model i lakmueshëm për gjithë studiuesit e kësaj fushe."[19]

Studimet arbëreshe të Lambertzit gjejnë pasqyrim në një tjetër monografi kushtuar veprës së Jul Varibobës "Gjella e Shën Mërisë Virgjër" (1716) të botuar në vitin 1956 në dy numra reviste (Lambertz 1956a). Në këtë vepër ka rëndësi të veçantë nga ana gjuhësore fjalori i nxjerrë nga poema e Varibobës, i pajisur me shpjegime kuptimesh e shënime të shumta nga autori. Fjalorthi ndahet në tri pjesë: 1. Elemente shqipe; 2. Elemente me prejardhje nga greqishtja; 3. Elemente me prejardhje nga italishtja. Në shënimet shpjeguese të autorit shfaqen njohuritë e thella të tij mbi të folmet arbëreshe.

Lambertzi u interesua edhe për dialektet e Shqipërisë, duke mbledhur shprehje dialektore të dialektit të Mirditës nga një koleg shkodran, mësuesi Nikollë Rota që jetonte në Vjenë (Lambertz 1916, 122), por i njohu nga afër ato nëpërmjet udhëtimeve në terren në Shqipërinë veriore në vitin 1916, i ngarkuar nga Komisioni Ballkanik i Akademisë vjeneze për të kryer studime gjuhësore dhe folkloristike. Në këtë rast ai vizitoi malësinë e Grudës, qytetet e Shkodrës, Lezhës, Krujës, Tiranës, luginën e Kirit, krahinat e Shoshit e të Shalës, luginat e Drinit e të Valbonës dhe veçanërisht Mirditën, ku bëri dhe një koleksion fotografish.[20] Kur u kthye përsëri në Shkodër në fund të vitit 1916, ai bëri udhëtime kërkimore në Shqipërinë e Mesme deri në Berat gjatë muajve mars-maj të vitit 1917, duke kaluar në Tiranë, Elbasan, Shpat, Dumre, e nga Berati në kthim nëpër Lushnje, Rrogozhinë e Peqin, gjatë të cilave takoi njerëz të thjeshtë të popullit, mundësisht të moshuar e të pashkollë, nga tregimet e të cilëve krijoi një përfytyrim të qartë për këto dialekte si dhe për besimet e zakonet e vjetra të popullit.[21] Studimi që botoi mbi kërkimet e tij në Shqipëri (Lambertz 1916, 122–146) dha një kontribut të rëndësishëm për dialektologjinë shqipe, pasi për herë të parë jep një ndarje shkencore të dialekteve të gegërishtes në krahina dialektore, me kalimet graduale nga një krahinë në tjetrën. Ai dalloi në dialektet e gegërishtes grupe të folmesh që përbëjnë përvijime të ndarjeve të mëvonshme më të sakta të gegërishtes verilindore, gegërishtes veriperëndimore, gegërishtes qendrore e gegërishtes jugore. Kjo ndarje dialektore përkon në vija të përgjithshme me ndarjen etnografike të zonës gege që ka përcaktuar etnografi Rrok Zojzi (Malsia, Leknia, Gegnia) (Çabej 1964, 212). Diferencimet dialektore të shqipes ai i zhvilloi më tej në punimet e tij të mëpasme mbi dialektet e shqipes, veçanërisht në monografinë "Dialektet e gjuhës shqipe dhe studimi i tyre" (Lambertz 1943a; Lambertz 1948; Lambertz 1957; Lambertz 1959a) dhe janë konfirmuar e saktësuar nga hulumtimet e dialektologëve shqiptarë në të folmet e shqipes në vitet '60-'80. Për toskërishten në raportin e vitit 1916 ai thotë se nuk paraqet kaq shumë ndryshime sa gegërishtja.

Ndarjen e shqipes në dy kryedialekte, gegërishtja në Veri dhe toskërishtja në Jug, Lambertzi e sheh si pasojë e faktorëve historikë e shoqërorë: orientimi i ndryshëm kishtar, fatet historike të ndryshme që kanë kushtëzuar dhe influencat e ndryshme të

19 E. Lafe, Pasthënie (Lambertz 2021).

20 Koleksionet e fotografive nga vizitat në Itali të Jugut dhe në Shqipëri janë paraqitur në faqen e internetit të Robert Elsie-së: http://www.albanianphotography.net/lambertz/.

21 Khs. shënimet e autorit në "Lajmet e Komisisë letrare shqipe në Shkodër", viti I, nr. 1, f. 30–32, Shkodër, janar 1918, në: Kastrati 1962, 141 v.

vendeve pushtuese, organizimi i ndryshëm shoqëror në Veri e në Jug, si dhe ndryshimet e nivelit kulturor e të shtresave shoqërore. Megjithatë, ai thekson se dallimi midis dy grupeve të mëdha dialektore nuk është aq i madh sa ç'është pohuar disa herë nga politikanë jodashamirës të shqiptarëve, përkundrazi ato paraqiten me struktura mjaft homogjene në pikëpamje të fonetikës, morfologjisë e të sintaksës.

Studimet gramatikore

Lambertzi ka dhënë kontribute të rëndësishme edhe në studimin e gramatikës shqipe, e në mënyrë të veçantë të sintaksës. Ai ka shkruar të parën monografi mbi sintaksën shqipe, "Periudha hipotetike në gjuhën shqipe" (Lambertz 1914), një studim thuajse shterues për këtë pjesë të sintaksës, "një punë pioneri në një truall aq të papunuar" (Çabej 1957, 127), botuar në vitin 1914, që e afirmoi si albanolog kur ishte ende në fillimet e veprimtarisë së tij shkencore. Monografia mbështet në një material të pasur nga gjuha e folur, të mbledhur nga tekste të vjetra e të reja folkloristike, që i ka dhënë dorë autorit të zbulojë ndërtime, dukuri e përdorime karakteristike për shqipen lidhur me fjalitë kushtore. Vlerësimet kompetente për punimin kanë vënë në dukje dhe vëzhgimet e aspektit psikologjik dhe të nuancave stilistike të fjalive kushtore në shqipe, njohjen e thellë të shqipes, ngritjen e nivelit shkencor të punimit përmes krahasimeve me gjuhë romane dhe veçanërisht me rumanishten (Çabej 1964, 213). Ky studim edhe sot vlen si model hulumtimi dhe duhet të jetë referencë për çdo prezantim të teorisë së fjalisë së shqipes.

Gramatikës shqipe i kushtohet edhe një artikull i shkurtër për aoristin më *-va*, ku trajton edhe aoristin sigmatik dhe rrudhjen e tij për shkak të përhapjes së aoristit më *-va* dhe tipave të tjerë të aoristit (Lambertz 1949–1952, 302–310). Edhe këtu vihet re metoda e tij e shfrytëzimit të një materiali të pasur burimor dhe e krahasimit me gjuhë të tjera.

Vepra e tij më e gjerë për gramatikën e shqipes është libri "Gramatika e gjuhës shqipe" botuar në vitin 1959 (Lambertz 1959a) si pjesa e tretë e "Kursit të shqipes" (1954). Ky punim është një sintezë e studimeve të tij për gjuhën shqipe që nga fillimi i veprimtarisë së tij në fushë të albanologjisë. Ai mbështetet në antologjitë e botuara më parë prej tij, ku përfshihet letërsia shqipe që nga fillimet e shkrimit të saj e deri në kohët kur shkroi veprën, në vëzhgimet vetjake të gjuhës së folur në Shqipëri e në ngulimet arbëreshe të Italisë e të Greqisë dhe në folklorin shqiptar, të cilin e njohu dhe e studioi me themel.

Tipare sintaksore të ligjërimit poetik analizohen edhe në Këngët e Kreshnikëve (Lambertz 1954–55), ku autori nxjerr në pah pasurinë e madhe e të larmishme të mjeteve shprehëse të epikës sonë legjendare, si p.sh. epitetet e krahasimet, apo përdorimi i formave të habitores, të cilat i vlerëson si mënyra përshkrimi me gjallëri (*Modi der*

lebhaften Darstellung), që e paraqitin veprimin si më të afërt ndaj folësit, sikur zhvillohet përpara syve të tij, etj.[22]

Edhe në punimin për ligjërimin bisedor të Gjirokastrës (Lambertz 1959b) ai u kushton vëmendje tipareve morfologjike e sintaksore të këtij dialekti, duke i ilustruar me shembuj të shumtë nga tekstet e shkrimtares Musine Kokalari.[23] Nga fusha e morfologjisë ai shqyrton rasat e emrit dhe trajtat e tij, emrat foljorë, numërorët, mënyrat e foljeve me format e ndërtimet karakteristike të kësaj të folmeje, trajtat e pjesores, format e diatezës pësore etj. Në sintaksë trajton dukuri si bashkërenditjen si tipar i gjuhës së folur, anakolutën, fjalitë asindetike, elipsën, periudhën hipotetike etj.

Mësimdhënia e shqipes

Në punimet albanologjike të Lambertzit numërohen dhe një varg librash për mësimin praktik të gjuhës shqipe, nga të cilat po ndalemi në disa nga më të rëndësishmit. Siç u përmend më lart, Lambertzi e filloi veprimtarinë e tij në fushën e shqipes në vitin 1913 me një "Manual dhe libër leximi për mësimin e shqipes (Lambertz & Pekmezi 1913) që e botoi bashkë me gjuhëtarin Gjergj Pekmezi, profesor i shqipes në Universitetin e Vjenës. Libri përmban në pjesën e parë njëzet mësime për njohjen e shqipes, në pjesën e dytë tekste nga veprat e autorëve shqiptarë, si Kristoforidhi, Naim Frashëri, Pashko Vasa, Filip Shiroka, Luigj Gurakuqi, Mjeda, Asdreni, Gjeçovi etj., si dhe nga folklori shqiptar, ndërsa në pjesën e tretë një fjalor shqip-gjermanisht dhe gjermanisht-shqip me rreth 2500 fjalë (Kastrati 1962, 122). Në vitin 1948 ai botoi një tjetër libër për mësimin e shqipes, në dy vëllime, me titull "Libër leximi për shqipen", në shqip dhe në gjermanisht (Lambertz 1948). Në këtë libër ai ka përfshirë edhe studimin "Gjeneza e zhvillimi i letërsisë shqiptare", botuar më parë në vitin 1943 (Lambertz 1943b). Kjo vepër është vlerësuar nga E. Çabej për nivelin shkencor që i tejkalon caqet e një doracaku mësimor dhe është një vademekum për të gjithë ata që duan t'i hyjnë mësimit të gjuhës e të letërsisë shqipe (Çabej 1957, 127). Prof. Mahir Domi thekson edhe rëndësinë e antologjive shqipe të botuara nga Lambertzi për popullarizimin e letërsisë dhe folklorit shqiptar në botën shkencore, letrare e kulturore të huaj (Domi 1957, 172).

Një tjetër libër i vëllimshëm për mësimin e shqipes, një ripunim i zgjeruar i Librit të leximit të vitit 1948, është vepra "Kurs i shqipes" (Lambertz 1954, 1955, 1959) në tri pjesë: pjesa e parë është një fjalor shqip-gjermanisht, botuar në 1954, pjesa e dytë është "Krestomacia shqiptare" (1955), një antologji më e pasur se ato të mëparshmet, me përfaqësimin e një numri më të madh autorësh dhe pjesësh të zgjedhura nga folklori shqiptar, nga krijimtaria popullore e shqiptarëve të diasporës etj.[24], dhe pjesa e tretë një gramatikë e gjuhës shqipe (1959), mjaft e plotë, ku jepet një paraqitje sistema-

22 Khs. E. Lafe, "Maximilian Lambertz (27.07.1882–26.08.1963)", skript i kursit "Deutschsprachige Albanologie", mbajtur në degën e gjermanishtes të Fakultetit të gjuhëve të huaja.

23 Shih më gjerë Kore 2018, 625–640. Punimi i Lambertzit mbështetet në lëndën gjuhësore të tre librave të Musine Kokalarit: *Siç më thotë nënua plakë* (1941), *Rreth vatrës* (1944), ... *sa u tunt jeta* (1944).

24 Një recension shumë pozitiv kësaj antologjie i ka bërë në atë kohë studiuesi i ri sovjetik i letërsisë shqipe G. N. Maliniçev, botuar në shqip në Nëndori nr. 2, 1957.

tike e morfologjisë dhe sintaksës shqipe, e shoqëruar me pjesë të zgjedhura të letërsisë dhe folklorit nga të dy dialektet kryesore dhe nga arbërishtja dhe me shënime dialektologjike, të ndërlidhura në mënyrë organike e të paraqitura sipas metodës së tij të njohur të lidhjes së trajtimit shkencor me udhëzimin praktik të didaktikës së gjuhës (Çabej 1964, 213).

Studime onomastike dhe lidhjet iliro-shqiptare

Onomastika është fusha në të cilën Lambertzi e filloi veprimtarinë e tij shkencore, me hartimin e disertacionit të doktoratës mbi "Emrat grekë të skllevërve" (Lambertz 1907) dhe më pas me botimin e dy punimeve nga kjo fushë "Mbi emrat e dyfishtë në Egjipt" (Lambertz 1911) dhe "Përhapja e supernomen-it në Perandorinë romake" (Lambertz 1913–1914). Këtë interes ai e tregoi edhe në fushën e shqipes, veçanërisht me studimin e emrave vetjakë, ku i tërhoqi vëmendjen shkurtimi i emrave të burrave e grave dhe formantet që përdoren për shkurtim. Ai vuri re rëndësinë që kanë emrat vetjakë për gjurmimin e origjinës së popullit shqiptar e të gjuhës së tij. Në punime të ndryshme, e sidomos në artikullin "Dy albanica" (Lambertz 1952), ku trajtoi etimologjinë e emrave vetjakë Lekë dhe Dukagjini, ai vuri në pah faktin që disa emra ilirë vazhdojnë të mbijetojnë në emrat vetjakë shqiptarë, si *Dasas Dasimius Dazios: Dash, Dida: Dedë, Bardus Bardylis: Bardhi* etj. Këtë konstatim disa albanologë e kanë vlerësuar si argument për të vërtetuar vijimësinë iliro-shqiptare.[25] Edhe më vonë Lambertzi ka gjetur rastin t'u kthehet emrave vetjakë të shqipes, si në një recension për artikullin "Emrat e ditve të javës dhe të muajve në gjuhën shqipe" të Wilhelm Gieses në revistën "Südost-Forschungen" (XIV, 1955, 508 vv.), ku flet dhe për emrin e *Prende*-s e cila i përgjigjet perëndeshës Venus të Romakëve e prej së cilës ka marrë emrin dita *e premte* "dies Veneris", dhe lidhur me atë flet edhe për emrin e ditës *e enjte* (Çabej 1964, 214).

Megjithëse nuk u mor posaçërisht me historinë e gjuhës shqipe dhe me origjinën e saj, Lambertzi në artikuj të ndryshëm përgjithësues për gjuhën shqipe përkrahte tezën e prejardhjes ilire të saj. Mendimet e tij për prejardhjen e shqipes paraqiten veçanërisht në dy studime të botuara në gazetën Posta e Shqypniës që botohej në Shkodër në vitet 1916–1918. Në artikullin "Gjuha shqipe" (Lambertz 1917a) ai pohon se shqiptarët janë pasardhës të popujve të lashtë të Ballkanit, ilirëve dhe trakëve, shqipja është gjuhë indoeuropiane, vazhdim i ilirishtes, e cila nuk u romanizua por i ruajti tiparet e saj. Ai e përcakton gjuhën shqipe si iliro-trake, duke përfytyruar pas gjase një përzierje të këtyre dy gjuhëve të Ballkanit antik. Aferisia midis këtyre dy gjuhëve është vënë re që nga njëri prej pararendësve të albanologjisë si Johann Thunmann në vitin 1774, duke nxjerrë nga njoftimet e autorëve antikë se në vendbanimet e ilirëve ka pasur edhe fise trake dhe të njëjtët fise që banonin në krahina të ndërmjetme midis ilirëve e trakasve disa autorë i quajnë ilirë, disa të tjerë trakas. Kjo tezë e një sinteze iliro-trake u përqafua nga një numër i mirë historianësh, arkeologësh e gjuhëtarësh në shek. XX, ndër të tjerë Karl

25 P.sh. W. Cimochowski, khs. Çabej 1964, 214.

Patsch, Franz Nopcsa, Nicola Jorga, Norbert Jokl dhe duket se e përkrah edhe Çabej, duke theksuar se ilirët e trakët sipas burimeve antike janë dy popuj të ndryshëm por megjithatë duhet të kenë pasur njëfarë afërie mes tyre (Çabej 1976, 34v.). Mbi këtë çështje Çabej konkludon: "...edhe për arsye historike mund të thuhet se në formimin e etnosit shqiptar në bazë qëndron elementi ilir, porse mund të ketë pasur dhe një komponente trake, me përmasa gjithsesi më të vogla" (Çabej 2018).

Etnogjenezës ilire të shqiptarëve Lambertzi iu përmbajt deri në fund të jetës së tij, siç është shprehur edhe në recensionin mbi "Historia e Shqipërisë", vëllimi I në "Südost-Forschungen" 1961, f. 353.

Një studim tjetër në të njëjtën gazetë, i botuar në shumë numra të vitit 1917, trajton gjendjen e studimeve për Ilirët deri atëherë "Der heutige Stand der Illyrierfrage" (Lambertz 1917b).

Çështja e gjuhës letrare shqipe

Lambertzi u ndesh me problemin e gjuhës së përbashkët letrare shqipe që në vizitën e tij të parë studimore në Shqipëri. Në raportin e tij të vitit 1916 botuar në Kumtarin (Anzeiger) të Akademisë vjeneze ai tregon se si u prit me gëzim në Shkodër nga mësuesit, pasi do të diskutonin për "çështjen e gjuhës", e cila ishte bërë aktuale në ato vite të pavarësisë, me përpjekjet e patriotëve për hapjen e shkollave kombëtare shqipe. Dy problemet kryesore të kësaj çështjeje ishin: 1. Si do të formohej gjuha e shkruar që do të përdorej në shkolla e në zyra; 2. Cila do të ishte ortografia e saj. Për pikën e parë, pyetja ishte a do të ngrihej kjo gjuhë letrare mbi bazë të një dialekti të caktuar apo gjuha zyrtare e shkollës dhe e administratës do të ishte një gjuhë e përzier, që të bashkonte elemente të gegërishtes e toskërishtes? (Lambertz 1916, 127v.) Si një gjuhë letrare të përzier ai vlerëson lart punën krijuese mjeshtërore të Kristoforidhit për përkthimin e Dhiatës së Re dhe të Psalmeve në një gjuhë që ishte afër dialektit të tij amtar, elbasanishtes, në thelb gegërisht, por e ndikuar fort në leksik, morfologji e sintaksë nga toskërishtja, një punë e cila për fat të keq nuk u njoh në veriun katolik,si një përkthim i ndërmarrë nga Shoqëria biblike britanike. Mbetej për të diskutuar çështja nëse do ngrihet në rangun e një gjuhe shkrimi njëra nga dy gjuhët e letërsisë që janë në përdorim, toskërishtja e Naimit, Asdrenit etj. që bazohen në dialektet e tyre amtare që nuk largohen shumë nga njëri-tjetri, apo gegërishtja e letërsisë artistike të Shkodrës që përdor ose dialektin e pastër shkodran (Junku, Curani) ose një shkodranishte të mbështetur në të folmet e malësive përreth qytetit dhe të pastruar nga turqizmat e shumta (Fishta, Gjeçovi, Zanoni, Hil Mosi, L. Gurakuqi, Zef Harapi etj.) apo më anë tjetër duhej krijuar ose kërkuar një gjuhë e përzier gegë-toske. Mendimin e tij për këto pyetje e propozime Lambertzi e jep në mënyrë të kujdesshme, pa mbajtur qëndrim të prerë e përfundimtar, për shkak të rrethanave historike të kohës së Luftës I botërore kur vetë e ardhmja politike e Shqipërisë ishte e pasigurt, prandaj mund të jepej vetëm një zgjidhje e përkohshme për të bërë të mundur hapjen e shkollave me gjuhë të njësuar. Dhe duke pasur parasysh pikërisht gjuhën që do të mësohej në shkolla, ai shpreh mospajtimin e tij për

të krijuar një gjuhë të përzier gegë-toske, siç mendonte Gjergj Pekmezi, sepse nëse u jepet të rinjve për të mësuar një gjuhë që nuk flitet gjëkundi dhe që gjendet vetëm në letër e do të përdoret në zyrat e shtetit, atëhere do të hapet një humnerë midis njerëzve të zyrës, të shkollës e të kulturës dhe njerëzve të popullit dhe do të krijohet artificialisht një diglosi, nga e cila jeta shpirtërore e popullit do të vuajë rëndë.[26] Gjithashtu nuk i duket e përshtatshme vendosja e një dialekti, ndonëse qendror, si ai i Elbasanit e Durrësit, por të pambështetur në letërsi të shkruar, siç sugjeronte Weigandi. Ai preferon zgjedhjen e një dialekti të gjallë dhe njëkohësisht të sprovuar në letërsi të shkruar dhe për këtë nuk sheh tjetër veç shkodranishten gegoveriore, e cila ka një traditë të hershme shkrimi dhe mbi të gjitha është gjuha e poetit që ai e admiron mbi të tjerët, Gjergj Fishtës, një gjuhë që i ka rrënjët në të folmet e malësorëve, por është ngritur në nivelin e një koineje të gegërishtes veriore me bazë shkodranishten. Prandaj ai bën thirrje për të përqafuar këtë gjuhë letrare e për ta bërë gjuhë të shkollës e të administratës shqiptare, por njëkohësisht ai kërkon edhe që kjo gjuhë e re shkrimi të jetë e hapur ndaj prurjeve të të folmeve të tjera, në mënyrë që të bëhet një pasqyrë e gjendjes shpirtërore të kombit.

Kur u kthye në Shkodër në dhjetor të vitit 1916, ai mori pjesë në një mbledhje të Komisisë letrare të qershorit 1917, ku referoi për udhëtimin studimor që kishte kryer në Shqipërinë e Mesme deri në Berat në pranverën e atij viti. Mbas kësaj mbledhjeje Komisia i kërkoi Komandës së lartë ushtarake emërimin e Lambertzit anëtar të Komisisë letrare. Ai mori pjesë në 13 mbledhje të Komisisë (Lafe 2019, 16–17; Osmani 2009, 33). Ndërkohë, Komisia në mbledhjet e vitit 1916 e kishte marrë vendimin për gjuhën e përbashkët, nën ndikimin sidomos të Luigj Gurakuqit që ishte në përkrahje të dialektit të Elbasanit "si urë në mes dy dialekteve". Por, edhe mbas miratimit të Fishtës, mbetej dyshimi nëse ky dialekt kishte një traditë letrare të mjaftueshme për të qenë gjuhë shkrimi e përbashkët. Atëhere Lambertzi vendosi të ndërmarrë vetë një udhëtim të dytë studimor në Shqipëri të Mesme për të parë në terren gjendjen e këtyre dialekteve dhe nëse tufa dialektore e Elbasanit ka ose jo ndonjë letërsi të shkruar me të.[27] Vizita në këto vende dhe njohja nga afër me "tufën dialektore të Elbasanit" bëri që ai të ndërrojë mendim për gjuhën e ardhshme të përbashkët të shkrimit dhe të pajtohet me vendimin e Komisisë letrare. Në raportin që mbajti në Komisinë letrare për rezultatet e këtij udhëtimi ai bën të ditur njësinë dialektore të gegërishtes jugore me toskërishten veriore që shkon nga jugu i Shkumbinit deri në vijën e Semanit e të Devollit, të cilat, duke përjashtuar pak dallime fonetike, kanë kaq shumë veçori të përbashkëta në morfologji, sintaksë, leksik e intonacion, saqë nuk mund të ndahen nga njëra-tjetra dhe duhen konsideruar një njësi. Kjo njësi e tufës dialektore të Shqipërisë së Mesme mund të shërbejë si bazë dialektore për gjuhën e përbashkët të shkrimit. Nga gjetjet e udhëtimit të tij, që kishin të bënin edhe me ekzistencën e një tradite letrare të mbetur në dorëshk-

26 Këtu Lambertzi e ka fjalën për gjendjen gjuhësore të greqishtes së sotme, ku u krijua një diglosi mes katharevusës si gjuhë letrare konservatore dhe demotikës, greqishtes së re të popullit. Khs. Lambertz 1916, 131.

27 M. Lambertz, "Punësija e komisís letrare": "Nga ky shkak, por sa shkova ndë Shqipni të mjesme, e pash si nji detyrë mâ të parë, me kërkuem se tufa djalektore e Elbasanit, e marrun thjesht gjuhësisht, a âsht e zoja të bâhet nji gjuhë e përbashkme, edhe me studjuem a âsht e vërtetë se kjo tufë djalektore nuk ka kurrnji letratyrë." (Osmani 2009, 285).

rim të kësaj tufe dialektore, ai e kapërceu opinionin e mëparshëm[28] dhe krijoi bindje se dialekti i Elbasanit është i aftë të merret për themel të gjuhës së shkruar shqipe, duke plotësuar edhe disa kërkesa të nevojshme për përhapjen dhe përgjithësimin e tij, si hartimi i një gramatike të këtij dialekti, ngritja e një shtypshkronje në Elbasan për të shtypur librat shkollorë e botime të tjera në elbasanishte të mirë etj., për të cilat duhej të ndihmonte Kryekomanda austro-hungareze dhe Komisia letrare (Lambertz 1916, 287–288). Kështu Lambertzi mbështet vendimin e Komisisë letrare edhe me argumente gjuhësore e letrare për të zgjedhur si gjuhë e përbashkët shkrimi një dialekt qendror të kuptueshëm nga një numër sa më i madh shqiptarësh.

Për sa i përket çështjes së ortografisë të shtruar më lart, ai së pari pajtohet me vendimet e Kongresit të Manastirit për një alfabet latin, i cili mund të shërbejë si bazë për drejtshkrimin e ardhshëm. Parimet e këtij drejtshkrimi sipas tij, duhet të ndjekin një rrugë të mesme, as thjesht fonetike, dhe as thjesht etimologjike. Aty ku toskërishtja ruan veçori të vërtetuara etimologjikisht, që edhe gegërishtja nuk i ka të panjohura, mund të ruhet shkrimi etimologjik (Lambertz 1916, 133–134).

Lambertzi e ndoqi në vazhdimësi zhvillimin e gjuhës letrare shqipe duke qëndruar i përditësuar me letërsinë shqipe bashkëkohore dhe me veprat studimore të gjuhëtarëve shqiptarë. Atij i bën përshtypje zhvillimi i shqipes letrare në një kohë të shkurtër dhe e shpreh këtë sa herë i bie rasti, si p.sh. në recensionin kushtuar veprës së mikut të tij të vjetër të Komisisë letrare, prof. Aleksandër Xhuvanit, "Për pastërtinë e gjuhës shqipe" (Lambertz 1960a; Lafe 1982, 183). Ai vë në dukje faktorët historikë, shkaqet e jashtme e të brendshme që kanë ndikuar në zhvillimin e gjuhës letrare dhe shtron edhe detyra që të studiohen ndryshimet që kanë ndodhur në atë gjysmë shekulli që nga takimi i tij për herë të parë me shqipen në Tebë.

Studimet folkloristike

Lambertzin e tërhoqi në mënyrë të veçantë folklori shqiptar. Mbledhja dhe studimi i folklorit shqiptar ka qenë një nga fushat më të rëndësishme të veprimtarisë studimore të tij. Materialin folklorik që mblodhi në udhëtimet e tij në Shqipërinë veriore ai e përdori në punimet e tij gjuhësore e dialektologjike, por shkroi dhe studime të posaçme për folklorin shqiptar. Në këtë lëmë atë e interesuan kryesisht dy nënfusha: përrallat dhe eposi i kreshnikëve. Çabej i kushton vëmendje të veçantë studimeve mbi folklorin në artikujt e tij kushtuar Lambertzit në raste përkujtimore. Ai vlerëson se "[s]hkrimet e tij edhe këtu nuk janë përfundimet e shpejta të kërkimeve të rastit; ato janë pema e pjekur e përpjekjeve shumëvjeçe e me dashuri të madhe për lëndën." (Çabej 1957, 128). Duke vënë në dukje interesimin e madh të Lambertzit për folklorin shqiptar, krahas gjuhësisë e letërsisë shqipe, ai tregon se si për literaturën artistike, ashtu edhe për poezinë popullore shqiptare albanologu austriak "ka vënë në dukje karakteret origjinale që e dallojnë nga poezia e popujvet fqinj, megjithëse dihet që ka dhe shumë tipare të

28 Lambertzi edhe më vonë ka pohuar se gegërishtja veriore e Shkodrës është tepër e veçantë për t'u imponuar si gjuhë letrare për të gjithë kombin. Khs. *Lehrgang des Albanischen*. Teil III, f. 29–30, cituar nga Lafe 2019, 19.

përbashkëta midis popujve të Ballkanit në këtë fushë" (Çabej 1964, 214). Çabej ndalet në përmbajtjen e punimeve të tij folkloristike dhe vë në pah çështjet që trajtohen, duke intriguar dhe lexuesin me mbresat që i ka lënë mënyra e trajtimit të studiuesit albanolog: "Atë sidomos e ka tërhequr bota laramane e përrallave. Libri "Përralla shqiptare e të tjera tekste të folklorit shqiptar" [...][29], shikohet me të drejtë si një nga kryeveprat e tij. [...] Librit i prin si hyrje një studim i gjatë, në të cilin si shtjellohet literatura, e plotë gjer në atë kohë, rreth përrallës shqiptare, shqyrtohen me imtësi figurat që dalin dhe temat që janë trajtuar në të, motivet e veçanta, forma e përrallave, formulat me të cilat ato nisin e mbarojnë. Elemente të vendit dhe elemente të huaja, figura e emra thjesht shqiptare, e pranë këtyre disa që kanë depërtuar prej popujve fqinjë, e të tjera që, me anë të Bizantinëve e të Osmanëve, janë të ardhura prej Orienti, të gjitha këto na kalojnë përpara tufa-tufa shumë ngjyrash." (Çabej 1962, 176–177). Për Çabejn, kjo vepër është themelore për njohjen e përrallës popullore shqiptare, dhe, për mënyrën krahasimtare si është shikuar lënda në të, ky libër i kapërcen caqet e shqipes; ai ka vlerë të qëndrueshme edhe për studimin e përrallave të mbarë popujve të Ballkanit, si një burim kryesor për vëzhgime të mëtejme (Çabej 1957, 128v.).

Çabej thekson mbi të gjitha "dashurinë e veçantë që ka ushqyer Lambertzi gjatë gjithë jetës së tij për Këngët e Kreshnikëve, për rapsoditë e Veriut që këndojnë me lahutë trimëritë e dy vëllezërve Muji e Halili e të shokëve të tyre në luftrat që bëjnë kundra "Krajlit" e trimave të tij." (Çabej 1964, 215). Kësaj teme ai i kushtoi një studim të gjerë, me titullin "Epika popullore e shqiptarëve" (Lambertz 1954–55), ribotuar dhe më 1958 në formë libri (Lambertz 1958). Kësaj vepre Çabej i bëri një recension të ngjeshur duke vënë në dukje vlerat e punimit, në të cilin "bashkimi aq i lumtur sa edhe i rrallë i gjuhëtarit, folkloristit e historianit të literaturës, që karakterizon veprat e këtij dijetari, ... na shfaqet në mënyrë të veçantë" (Çabej 1975, 186). Në shkrimin *In memoriam* kushtuar Lambertzit Çabej jep një përshkrim mbresëlënës për këtë studim, që meriton të risillet në vëmendje: "Ky studim shquhet për paraqitjen e gjallë të atmosferës ku lëvizin figurat epike. Më anë tjetër të habit analiza e thellë e e gjithanshme që i bëhet mjedisit shqiptar nga kanë dalë këto këngë, mjedis që autori e njeh më së miri. Karakteristika e heronjve, rrëmbimi i grave, ritet e martesës, gostitë, atllarët, të dalët në çetë, bejlegjet, armët, zakonet e lashta shqiptare, pretimet, vrasjet, vëllamia (probatinia), kumbaria, lahuta, kuvendi i pleqve, gjaqet, dashuria motër e vëlla e vëlla me vëlla, besa e pabesia e grave, pritja e mikut, vajet, kullat, qendrat gjeografike, bjeshkët, tartari, motivet e këngëvet, zogu si lajmës, shtazët si ndihmëtare, qeniet e mbinatyrshme të besimit popullor si Orë e Zana, trathtia, mrekullitë, simbolika e numrit, bukuria e vashave, motivi i dredhisë, hiperbolat, hyrjet marrë nga natyra, forma e metrika e këngëvet, rima, ndërtimet emfatike, proliksiteti, përsëritjet, gjuha e stili, krahasimet, betë, formulat stereotipe, këto janë disa nga elementet kryesore që merren në shqyrtim në këtë vepër. Asgjë që të jetë qenësore nuk ka mbetur pa u rrahur në të. Kështu kjo përbën trajtimin gjer sot më të plotin të këtij kapitulli të poezisë sonë popullore; e bashkë me Përrallat

29 Është fjala për librin *Albanische Märchen und andere Texte zur albanischen Volkskunde. Gesammelt und mit Übersetzung herausgegeben von Maximilian Lambertz.* Schriften der Balkan-kommission. Linguistische Abteilung XII. Akademie der Sprachwissenschaft in Wien. (Vienna: Alfred Hölder 1922) 255 pp.

shqiptare paraqet gjer më sot kryeveprën e këtij dijetari. Krahasimet me poemet epike të popujve të tjerë të Europës ja shtojnë vlerën asaj. E përkthimi gjermanisht i 19 rapsodive, që jepet në pjesën e dytë, i jep mundësi botës së jashtme të njihet drejtpërdrejt me eposin popullor shqiptar. Kështu pra me anë të këtij studimi poezia epike shqiptare hyn e zë vendin e saj brenda poezisë së popujve të tjerë t'Europës." (Çabej 1964, 215).

Studimet për letërsinë shqipe

Ndër kontributet e rëndësishme që dha Lambertzi për letërsinë shqiptare duhet përmendur mendimi i tij origjinal që letërsia shqiptare ka filluar dhe është zhvilluar me disa qarqe krahinore-konfesionale (qarku katolik i Veriut, qarku ortodoks i Jugut e qarku italo-shqiptar), të cilat pastaj, në shekullin e XIX, erdhën e u derdhën në rrymën e përbashkët të literaturës nacionale (Çabej 1962, 174). Çabej, që e ka vlerësuar shumë këtë prurje të Lambertzit, e gjykon si "një mendim i cili, po të zgjerohet e të thellohet me një frymë objektive, mund të bëhet pjellor për kuptimin e literaturës shqiptare, meqenëse çel shtigje të reja për të rrokur gjenezën dhe zhvillimin e mëtejmë të kësaj" (Çabej, ibidem).

Nga të parat studime përgjithësuese për letërsinë shqiptare është punimi "Lindja dhe zhvillimi i letërsisë shqiptare" botuar në vitin 1943 (Lambertz 1943). Aty ai jep një panoramë të zhvillimit të kësaj letërsie që nga fillimet me librin e parë shqip e deri në vitet '30 të shekullit XX, ku paraqiten autorët kryesorë dhe dukuritë më të rëndësishme të zhvillimit të letërsisë, duke ndjekur dhe rrugën dhe veçoritë e formimit të gjuhës letrare shqipe dhe përpjekjet për një alfabet të përbashkët. Punimi është vlerësuar lart nga studiuesit e letërsisë shqipe jo vetëm për informacionin e pasur dhe vështrimin e zhvillimit të letërsisë në lidhje të ngushtë me veprimtarinë e intelektualëve rilindas për lëvrimin e gjuhës shqipe, por edhe për një varg gjykimesh, vëzhgimesh dhe mendimesh me vlerë që ka shprehur autori (Bihiku 1982, 194). Lambertzi e ndoqi me interes e dashuri zhvillimin e letërsisë shqiptare deri në fund të jetës së tij, në vitet '60, ku vlerëson dramaturgjinë, të cilës i kushtoi disa punime, si "Drama në teatrin e sotëm shqiptar" (Lambertz 1960b), në mbyllje të së cilës njofton se ka në dorë një monografi 187 faqesh për dramaturgjinë shqiptare, e cila mbeti në dorëshkrim. Nga studimet e veçanta të letërsisë shqiptare përmendet sidomos monografia e vitit 1949 "Gjergj Fishta dhe epi heroik shqiptar Lahuta e Malcís. Një hyrje në botën e legjendave shqiptare" (Lambertz 1949), ku ai analizon me thellësi çdo këngë të kësaj poeme të madhe epike, duke dhënë dhe një karakteristikë të poetit, që ai e vlerëson lart, dhe të veprës së tij. Ai më vonë e përktheu në gjermanisht kryeveprën e Fishtës ("Die Laute des Berglandes" 1958), të pajisur me një hyrje e me shënime të vlefshme, përkthim të cilin Çabej e vlerëson si "artistikisht të përkryer", "i vetmi i plotë gjer më sot dhe më i miri nga përkthimet e këtij epi" (Çabej 1964, 211). Kësaj teme të parapëlqyer, studiuesi i është kthyer shpeshherë në veprat e tij, më në fund në artikullin "Çështja homerike dhe epi i madh shqiptar" (Lambertz 1961), ku shtjellohet në një dritë të re çështja e gjenezës së epit artistik prej këngësh popullore (Çabej 1964, 211).

Një meritë të veçantë ka Lambertzi në popullarizimin e letërsisë shqipe dhe folklorit shqiptar në botën shkencore, letrare e kulturore të huaj. Dy antologjitë e letërsisë shqipe, ajo e vitit 1948 me pjesë të zgjedhura të gjinive e stileve të ndryshme që nga Buzuku e deri në kohën tonë (Lambertz 1948) dhe "Shqipëria tregon" e vitit 1955 (Lambertz 1956b) me pjesë të zgjedhura nga letërsia bashkëkohore shqiptare, të shoqëruara me përkthimin në gjermanisht e me nga një hyrje panoramike mbi zhvillimin e letërsisë shqipe, i kanë shërbyer mjaft njohjes së kësaj letërsie në rrethe më të gjera lexuesish, së pari në botën gjermanishtfolëse, e që këtej edhe në gjuhë të tjera.

Duke përmbyllur vlerësimet e tij për letërsinë shqipe, M. Lambertzi shkruan se karakteri origjinal i saj si shprehje e ndjenjës dhe e mendimit shqiptar i japin kësaj letërsie një vend nderi ndër letërsitë e popujve të Ballkanit dhe në historinë e përgjithshme të letërsisë.[30]

Përfundim

Lambertzi ishte një mik i sinqertë i Shqipërisë e i shqiptarëve. Ai erdhi disa herë në Shqipëri në periudha të ndryshme historike, në kohë të vështira të luftës I botërore e në rrethanat e reja të mbasçlirimit të Shqipërisë nga pushtimet nazifashiste dhe gëzohej për ndryshimet e mëdha që shihte. Në një intervistë dhënë Agjencisë Telegrafike Shqiptare në vizitën e dytë në 1957, ai ndër të tjera tha se "i dukej një çudi e madhe që kjo Shqipëri është një vend krejt të ri, [ndërsa] shqiptarët janë si dikur: guximtarë, bujarë, mikpritës, mendjemprehtë e zemërfortë, por këtyre vetive u është shtuar edhe një tjetër: gëzimi" (Domi 1957, 173–174).

Ai i ndiqte me simpati arritjet e kulturës, letërsisë e shkencës shqiptare dhe u bënte jehonë në shtypin e huaj shkencor duke botuar një numër të konsiderueshëm recensionesh për vepra të letërsisë shqiptare, të historisë, gjuhësisë, për revista e buletine shkencore që dilnin në Shqipëri, për vepra teatrale, botime filologjike të letërsisë arbëreshe etj.

Për ta përmbyllur me fjalët e Wilfried Fiedlerit në shkrimin *in memoriam* kushtuar Lambertzit: "Vepra e Maximilian Lambertzit e parë në tërësinë e saj, të lë përshtypjen e një enciklopedie të vërtetë të disiplinave albanologjike... [ku] në qendër të krijimtarisë së tij ndoshta ishte folklori, dhe ky interes shkencor na duket se nxitej nga dashuria e thellë e dijetarit për shqiptarët dhe karakterin e tyre, një dashuri, që ai e shprehte sa herë që i jepej rasti" (Fiedler 1965, 335).

30 E. Lafe, "Maximilian Lambertz (27.07.1882–26.08.1963)", skript i kursit "Deutschsprachige Albanologie", mbajtur në degën e gjermanishtes të Fakultetit të gjuhëve të huaja, f. 10 v.

Bibliografia

Berisha, Anton N. (2021). *Maksimilian Lamberci për letërsinë shqipe*. ITSHKSH, Shkup.

Bihiku, Koço. (1982). "Maksimilian Lamberci si studiues dhe popullarizues i letërsisë shqiptare". Në: *Studime filologjike*, nr. 4,, f. 193–197.

Çabej, Eqrem. (1964). "Maximilian Lambertz (1882–1963)". Në: *Studime filologjike* nr. 1, 211–216.

Çabej, Eqrem. (1957). "Maximilian Lambertz në 75 vjetorin e ditëlindjes". Në: *Buletin për Shkencat Shoqërore*, nr.2, f. 127–130.

Çabej, Eqrem. (1962). "Maximilian Lambertz". Në: Nëndori 9, f. 174–77.

Çabej, Eqrem. (1975). "Maximilian Lambertz: Epika popullore e shqiptarëve". Në: *Studime Gjuhësore* V. Prishtinë: Rilindja.

Çabej, Eqrem. (1976). "Hyrje në historinë e gjuhës shqipe". Në: *Studime gjuhësore III*. Prishtinë: Rilindja.

Çabej, Eqrem. (2018). "Vështrime mbi prejardhjen e popullit shqiptar dhe të gjuhës së tij". Gazeta shqiptare 5.7.2018, botuar së pari në gazetën *Rilindja*, Prishtinë 23.VII.1977. https://gazetashqiptare.al/2018/05/07/veshtrime-mbi-prejardhjen-e-popullit-shqiptar-dhe-te-gjuhes-se-tij/

Domi, Mahir. (1957). "Prof. Dr. Maksimilian Lamberci mbush 75 vjeç". Në: *Nëndori* nr. 7, f. 170–174.

Elsie, Robert, http://www.albanianphotography.net/lambertz/

Fiedler, Wilfried, "Maximilian Lambertz". Në: *Gjurmime albanologjike* 2, 1965, f. 331–40.

Grimm, Gerhard. (1982). "Lambertz, Maximilian". Në: *Neue Deutsche Biographie* 13 (1982), f. 439–440

[Online-Version]; URL: https://www.deutsche-biographie.de/pnd121916731.html#ndbcontent

Haebler, Claus. (1964). "Maximilian Lambertz (1882–1963)". Në: *Shêjzat*, 1–2, 1964 (përkthyer nga Gnomon 35, 1963, f. 846–48)

Haxhihasani, Qemal (1982). "Kontributi i Maksimilian Lambercit në fushën e folkloristikës shqiptare". Në: *Studime filologjike*, nr. 4, f. 187–191

Kastrati, Jup (1962). "Veprat albanologjike të Doktor Profesor Maximilian Lambertz (Me rastin e 80 vjetorit të lindjes)". *Arësimi popullor*, 5, f. 122–145.

Kore, Mimoza. (2018). "Veçori gjuhësore dhe etnologjike të qytetit të Gjirokastrës në veprën e Maximilian Lambertzit". Në: *Studime albanistike në vendet ku flitet gjermanisht*, ASHAK, Prishtinë, f. 625–640.

Lafe, Emil (2016). "Interpretime filologjike të Ciklit të Kreshnikëve: Këngë të përkthyera e të komentuara prej Maksimilian Lambercit". Në: *Eposi i Kreshnikëve: Monument i Trashëgimisë Kulturore Shqiptare*. Konferencë shkencore ndërkombëtare. Prishtinë, 28–30 gusht 2010. Kryeredaktorë Prof. Dr. Zymer Ujkan Neziri, Prof. Dr. Shaban Sinani. Vëllimi II. Instituti Albanologjik, Prishtinë – Qendra e Studimeve Albanologjike, Tiranë. Prishtinë, f. 513–530.

Lafe, Emil. (1982). "Maksimilian Lamberci, studiues i gjuhës shqipe". Në: *Studime filologjike*, nr. 4, f. 177–185.

Lafe, Emil. (2019). "Pikëpamjet e Maksimilian Lambertz-it për shqipen letrare në vitet e Komisisë Letrare dhe në vijim". Në: *Komisia Letrare Shqipe 100 vjet më pas dhe mendimi albanologjik*. Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi", Fakulteti i Shkencave Shoqërore, Instituti i Studimeve Albanologjike. Shkodër, f. 13–26.

Lambertz, Maximilian. (1907). *Die griechischen Sklavennamen*. Wien:. Im selbstverlage des verfassers.

Lambertz, Maximilian. (1911). "Zur Doppelnamigkeit in Ägypten". Wien: Program.

Lambertz, Maximilian. (1913–1914). "Zur Ausbreitung des Supernomens im Römischen Reich". Në: Glotta 4, 1913, f. 78–143; 5, 1914, f. 99–170.

Lambertz, Maximilian & Pekmezi, Gjergj. (1913). *Lehr- und Lesebuch des Albanischen*, Wien und Leipzig, 182 f.

Lambertz, Maximilian. (1914). "Die hypothetische Periode im Albanischen". Në: *Indogermanische Forschungen*, 34, ff. 44–408. Përkthyer në shqip: *Periudha hipotetike në gjuhën shqipe*, përkthyer nga Veniamin Dashi, rishikuar e plotësuar nga Edmond Malaj. Qendra e Studimeve Albanologjike. Tiranë: Botimet Albanologjike, 2011.

Lambertz, Maximilian (1914–1915). "Albanische Mundarten in Italien. Mit einer Kartenskizze". Në: *Indogermanisches Jahrbuch* 2, f. 1–30.

Lambertz, Maximilian. (1916). "Bericht über meine linguistische Studien in Albanien vom Mitte Mai bis Ende August 1916". Në: Anzeiger der Kaiserlichen Akademie der Wissenschaften in Wien, Phil-hist. Kl., Vienna, 53 Nr. XX. Khs. publikimin online në: https://archive.org/details/anzeiger53stuoft/anzeiger53stuoft/page/122/mode/2up e vijim.

Lambertz, Maximilian. (1917a). "Die albanische Sprache", në: *Posta e Shqypniës*, Shkodër, I, nr. 12, dt. 17.01.1917.

Lambertz, Maximilian. (1917b). "Der heutige Stand der Illyrierfrage". *Posta e Shqypniës*, Shkodër, I, nr. 87–89, 93–94, 99–100, 102; II, nr. 3; dt. 6.10–5.12. 1917.

Lambertz, Maximilian. (1923–1925). "Italo-albanische Dialektstudien". Në: *Zeitschrift für vergleichende Sprachforschung* (KZ), Gütersloh, 51 (1923), f. 259–290; 52 (1924), f. 43–90; 53 (1925), f. 66–79, 282–307.

Lambertz, Maximilian. (1943a). "Die Mundarten der albanischen Sprache und ihre Erforschung". Në: *Leipziger Vierteljahrsschrift für Südosteuropa*, Leipzig, 7, 2–4, f. 123–160.

Lambertz, Maximilian. (1943b). "Das Werden der albanischen Literatur". Në: *Leipziger Vierteljahrsschrift für Südost-europa*. Leipzig, 7, f. 160–174.

Lambertz, Maximilian. (1949–1952). "Zwei Albanica". Në: *Zeitschrift für indogermanische Forschungen* LX, f. 302–310.

Lambertz, Maximilian. (1948). *Albanisches Lesebuch mit Einführung in die albanische Sprache*. I. Teil: Grammatik und albanische Texte, Leipzig: Harrassowitz, 387 f.

Lambertz, Maximilian. (1949). *Gjergj Fishta und das albanische Heldenepos Lahuta e Malcís, Laute des Hochlandes. Eine Einführung in die albanische Sagenwelt*. Leipzig: Harrassowitz, 76 f.

Lambertz, Maximilian. (1952). "Zwei Albanica. 1. Der albanische Aorist auf -va. 2. Kanuni i Lekë Dukagjinit (Etymologie der Personennamen Lekë und Dukagjini)". Në: Indogermanische Forschungen, Zeitschrift für Indogermanistik und allgemeine Sprachwissenschaft, 60, f. 302–310.

Lambertz, Maximilian. (1954–55). "Die Volksepik der Albaner. Der Zyklus von Mujo und Halil I, II". Në: *Wissenschaftliche Zeitschrift der Karl-Marx-Universität Leipzig, Gesellschafts- und Sprachwissenschaftliche Reihe*. Leipzig, 4, f. 243–289; 439–473.

Lambertz, Maximilian. (1956a). "Giulio Variboba". Në: *Zeitschrift für Vergleichende Sprachforschung*, Göttingen, 74, f. 45–122, 185–224.

Lambertz, Maximilian. (1956b). *Albanien erzählt: ein Einblick in die albanische Literatur*. Übersetzt und herausgegeben. Literatur der Volksdemokratien, 7. Berlin: Volk und Welt 1956, 191 f.

Lambertz, Maximilian. (1957). "Die Mundarten der albanischen Sprache. Heutiger Stand der Forschung". Në: *Südost-Forschungen*. Munich, 16, f. 430–435.

Lambertz, Maximilian. (1958). *Die Volksepik der Albaner*. Halle: Max Niemeyer.

Lambertz, Maximilian. (1959a). *Lehrgang des Albanischen*. Teil III: Grammatik der albanischen Sprache. Halle/Saale, 268 f.

Lambertz, Maximilian. (1959b). "Zur albanischen Umgangssprache (Gjirokastra)". Në: *Lingua Posnaniensis*. Poznań, 8, f. 85–144.

Lambertz, Maximilian. (1954, 1955, 1959). *Lehrgang des Albanischen*. Teil I: Albanisch-Deutsches Wörterbuch. Teil II: Albanische Chrestomathie. Teil III: Grammatik der albanischen Sprache. Berlin: Deutscher Verlag der Wissenschaften 1954, Berlin 1955, Halle/Saale 1959. 228 & 251, 268 f.

Lambertz, Maximilian. (1960a). "Aleksandër Xhuvani, 'Për pastërtinë e gjuhës shqipe'", Tiranë, 1956". Në: *Lingua posnaniensis* VIII, f. 293–302.

Lambertz, Maximilian. (1960b). "Das Drama im albanischen Theater von heute". Në: *Südost-Forschungen*. Munich, 19, f. 316–325.

Lambertz, Lambertz, Maximilian. (1961). "Die homerische Frage und das albanische Großepos". Në: *Shêjzat / Le Pleiadi*. Rome, 5, f. 385–391.

Lambertz, Maximilian. (2021). "Studime arbëreshe". Qendra e Studimeve dhe Publikeve për Arbëreshët (QSPA). Onufri, Tiranë, 350 faqe, përkthyer nga Genc Lafe.

Osmani, Tomor. (2009). *Komisia letrare shqipe në Shkodër (1916–1918) dhe Shoqëria e të Shtypuri Shkronja shqip (1879), Shoqëria Bashkimi (1899), Shoqëria Agimi (1901)*. Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi". Shkodër.

Xhuvani, Aleksandër. (1954). "Vizita e prof. Maksimilian Lambercit në Shqipni". Buletin për Shkenca Shoqërore, 3, f. 142–144.

Letërkëmbimi i Ölbergut me Çabejn në gjermanisht

më 8 qershor 1955

Dr. Max Lambertz
Profesor me katedër
Markkleeberg 1
Rruga Dölitzer nr. 10

Zotit
Eqrem Çabej
Instituti i Shkencave
Tiranë/Shqipëri

Shumë i nderuar dhe i dashur zoti Eqrem Çabej!

Me shumë kënaqësi do ju shkruaja në gjuhën e bukur shqipe, por meqë e di që juve ju pëlqen të shkruani dhe të lexoni në gjermanisht dhe meqë e zotëroni kaq shkëlqyer gjuhën gjermane, po ju shkruaj në gjermanisht, ashtu siç më keni shkruar edhe ju. Ju e dini që unë mund të shkruaj gjithashtu në shqip, edhe pse "shkodrançe", siç ka vërejtur një herë me shaka miku ynë i dashur Buda.

Jam i gëzuar që familja juaj është mirë dhe ju lutem të përshëndesni nga unë bashkëshorten tuaj të nderuar dhe fëmijën. Bashkëshortja ime tashmë është shëruar dhe u gëzua kur lexoi letrën tuaj. Ajo i uron familjes suaj gjithë të mirat dhe e kujton me kënaqësi Shqipërinë.

Fakti që ju po përktheni artikullin tim për botimin festiv, në nderim të Xhuvanit, është një kënaqësi e veçantë për mua dhe ju falenderoj për këtë. Shpresoj shumë që me këtë artikull ta gëzoj mikun tonë të vjetër, të mençurin dhe të shkëlqyerin Xhuvani.

Sa i takon artikullit tuaj, mund të rrini i qetë. Do ta dorëzoj, siç dëshironi, te Revista për Fonetikën dhe Gjuhësinë e Përgjithshme (Zeitschrift für Phonetik und Allgemeine Sprachwissenschaft). Unë vetë e lexova artikullin me shumë interes dhe përfitim. Jam kurioz për artikullin tuaj mbi Buzukun. Me siguri që do të paraqesë gjëra me vlerë.

Tani, ju lutem të përshëndesni nga unë të gjithë zotërinjtë e institutit. E me këtë rast do ju lutesha të pyesnit të dy zotërinjtë Mahir Domi dhe Dhimitër Fullani, nëse pakoja për Dhimitër Fullanin ka mbërritur më në fund në duart e tij. Le të më shkruajë, po të dojë. Veçanërisht uroni nga unë edhe një herë Xhuvanin, përshëndesni Papariston, Pollon, Budën, Komninon, Hasanin, Konomin dhe dy zotërinjtë Mahirin dhe Dhimitrin. Edhe dy zotërinjtë e shkëlqyer të muzeut dhe zonjushë Andromakën përshëndetini prej meje. Dhe në fund mos harroni të përshëndesni Limin e shkëlqyer, i cili punon me mençuri dhe besnikëri në fushën e tij.

Dhe së fundmi, ju uroj edhe një herë gjithë të mirat. Mbi fatin e artikullit tuaj do t'ju shkruaj, sapo të kemi të reja.

Ah po, ju lutem, mos harroni gjithashtu, të përshëndesni përzemërsisht Demirajn, studiuesin e Varibobës. Edhe shkrimtarët që pata kënaqësinë të njihja, përshëndetini nga ana ime dhe bëjuni të ditur që këto ditë do të botohet krestomacia shqiptare e hartuar prej meje me pjesë të zgjedhura nga letërisa më e re shqiptare, dhe në nëntor do të shohë dritën e botimit një libër i imi me titullin "Çfarë rrëfen Shqipëria" (Was Albanien erzählt). Aty kam përfshirë tekste të bukura letrare nga krijimtaria e Kol Jakovës, Shuteriqit, Sakos, Gjatës, Balës, Spasses, Çaçit dhe shumë të tjerë. Prej secilit libër do të dërgoj disa ekzemplare në Shqipëri.

Gjithë të mirat

I juaji Lambertz

Nota bene: "Toka jonë" të Kol Jakovës e kam përkthyer në gjermanisht dhe kam nxitur Partinë tonë që të kontaktojë shkrimtarin, me qëllim që kjo dramë madhështore të shfaqet edhe këtu te ne në Berlin apo Leipzig. Kjo do t'i interesojë edhe zotit regjizor Shllaku. Me kënaqësi do të filloja një korrespondencë me të dy zotërinjtë lidhur me këtë çështje. Kini mirësinë, i dashur zoti Çabej, dhe shprehuani këtë të dy zotërinjve kur t'ju jepet rasti!

I juaji Lambertz

Tetor 1955

Instituti për Historinë
e Demokracive Popullore Evropiane
Universiteti "Karl Marks"

Leipzig C1, Rruga "Petersteinweg", nr. 2–8

Profesor Eqrem Çabej
Instituti i Shkencave
Tiranë/Shqipëri

Kemi nderin t'ju bëjmë me dije se bazuar në një vendim të Sekretariatit të Shtetit për Arsimin e Lartë, duke filluar nga data 1 shtator 1955, ka nisur punën e tij Instituti për Historinë e Demokracive Popullore Europiane pranë Universitetit "Karl Marks" në Leipzig. Instituti ka në strukturën e tij departamentet për Historinë e Polonisë, të Çekosllovakisë, të Demokracive Popullore të Europës Juglindore dhe për Historinë e BRSS.

Si detyrë tonën më të rëndësishme konsiderojmë hulumtimin e marrëdhënieve politike, ekonomike dhe kulturore mes popullit gjerman dhe popujve të vendeve europiane të demokracisë popullore. Jemi të bindur se veprimtaria jonë do të kontribuojë në forcimin e miqësisë mes popujve tanë dhe do t'i shërbejë sigurimit të paqes.

Është dëshira jonë e fortë të bashkëpunojmë ngushtë me Institutet e Historisë pranë Akademive të Shkencave, pranë universiteteve dhe pranë të gjitha institucionve shkencore të ngjashme në vendet e demokracive popullore si edhe në vendet e tjera, sepse vetëm në këtë mënyrë mund të përmbushim si duhet detyrat tona. Dëshirojmë të shprehim shpresën që së shpejti të mund të nisim me ju një shkëmbim të gjallë mendimesh mbi objektivat kërkimore dhe rezultatet e kërkimit shkencor, mbi publikimet, planet mësimore e kështu me radhë dhe do kërkonim nga ju mbështetjen dashamirëse të projektit tonë.

Drejtorët e Institutit

Prof. Dr. W. Markov
Prof. Dr. M. Lambertz

Leipzig, 11.09.1956

I dashur dhe shumë i nderuar zoti Dr. Çabej!

Sot po ju shkruaj vetëm shkurtimisht: I dërgova sot paketën me medikamente [*emrat e medikamenteve në kllapa*] me postë rekomandé zotit Filip Prifti, sekretar i Ambasadës së Republikës Popullore të Shqipërisë në Berlin bashkë me një letër në të cilën i lutesha që paketën t'jua dërgonte mundësisht menjëherë në Tiranë me anë të postës diplomatike në rrugë ajrore. Ju lutem të më njoftoni menjëherë, nëse i keni marrë medikamentet dhe kur i keni marrë. Nëse nuk e keni marrë dërgesën deri më së shumti për 14 ditë, drejtohuni menjëherë te zoti Prifti. në Berlin-Karlshorst, adresa: Treskow Allee 77 dhe më shkruani edhe mua që edhe unë të ankohem te zoti Prifti. Pra po pres me patjetër lajmet nga ju.

Sa i takon manuskriptit tuaj të mëparshëm, unë i kam shkruar zotit Valjavec (Mynih) dhe zotit Stadtmüller. Zoti Valjavec do t'ju shkruajë vetë në lidhje me këtë së shpejti. Punimi juaj (Mbi fjalët që fillojnë me "z") është në proces botimi në Berlin. Do t'ju jap më shumë detaje, sapo të ketë zhvillime të reja.

Gruaja ime ju përshëndet ju dhe familjen tuaj të dashur! Edhe unë gjithashtu!

Miku juaj i vjetër

Lambertz

A do të mund të kërkonit në Institut ose në Bibliotekën Kombëtare dhe të më dërgonit njoftim?

A ka përveç shkrimeve të Naimit edhe ndonjë punim tjetër të natyrës prozaike ose poetike mbi Bektashinjtë në Shqipëri?

Ju përshëndes edhe një herë

Lambertzi juaj

Markkleeberg, Dölitzerstraße 10

RDGJ

7.11. 1956

I dashur dhe shumë i vyer, mik Çabej!

Jam shumë i merakosur. Ju kam dërguar medikamentet, madje nëpërmjet zotit Filip Prifti të Ambasadës Shqiptare në Berlin-Karlshorst. I kërkova zotit Prifti, t'jua dërgonte medikamentet përmes postës diplomatike, sepse këtë rrugë e konsiderova si më të sigurtën. Por nuk kam marrë asnjë njoftim prej jush, nëse i keni marrë ato. Përpara se t'i shkruaj zotit Prifti dhe ta fajësoj për neglizhencë, do doja t'ju kërkoja paraprakisht të më bënit me dije, nëse medikamentet kanë mbërritur të plota e në rregull te ju. Në rast se nuk e keni marrë dërgesën, drejtojuni ju lutem vetë zotit Prifti dhe më konfirmoni që medikamentet nuk kanë mbërritur te ju, dhe atëherë unë do të marr masat e duhura ndaj zotit Prifti.

Shumë të fala nga unë dhe gruaja ime për ju dhe familjen tuaj.

Miku juaj i vjetër

Max Lambertz

21.11.1956

I dashur dhe shumë i nderuar, zoti Çabej!

A i keni marrë medikamentet? Ia kam dërguar ato zotit Filip Prifti në Ambasadën Shqiptare në Berlin me lutjen që t'jua dërgonte përmes postës diplomatike. Jam në merak a i keni marrë të gjitha në rregull.

Artikulli juaj do të dalë së shpejti në numrin e radhës së Revistës për Fonetikë dhe Gjuhësi të Përgjithshme (Zeitschrift für Phonetik und Allgemeine Sprachwissenschaft).

Ju rekomandoj prurësin e kësaj letre, zotin Fiedler, për kështillë dhe mbrojtje.

Lutem të më ktheni përgjigje dhe ju dërgoj shumë të fala juve dhe familjes suaj!

I juaji Lambertz

Shumë të fala edhe nga gruaja ime!

26 dhjetor 1956

Dr. Max Lambertz
Profesor universiteti

Markkleeberg – Leipizig
Rruga Dölitzer-Sraße 10

Zotit Profesor Doktor
Eqrem Çabej
Tiranë/Shqipëri

Shumë i nderuar zoti koleg!

Artikulli juaj me titull "Mbi disa fjalë të shqipes që fillojnë me "z" është botuar tani në Revistën për Fonetikë dhe Gjuhësi të Përgjithshme (Zeitschrift für Phonetik und Allgemeine Sprachwissenschaft), volumi 9, nr. 3, 1956, f. 203–229. Redaksia e revistës më ka bërë me dije se për këtë ju takon një honorar prej 108 markash gjermane (DM). Ju lutem të më njoftoni sa më parë, se si do ta dispononi këtë shumë, d. m.th. ku duhet dërguar ajo.

Njëkohësisht ju lutem që të kujdeseni që Instituti i Shkencave të ketë mirësinë e të më dërgojë për Institutin tim numrat e Buletinit të katër viteve të fundit, dhe saktësisht vetëm ato të Departamentit të Shkencave Shoqërore. Ju lutem më informoni edhe për kostot. Do t'i shlyej ato në Ambasadën Shqiptare në Berlin pas marrjes në dorëzim të revistave.

Si vajti puna e medikamenteve? A i morët? Ende nuk kam ndonjë lajm lidhur me këtë dhe jam shumë në merak. Shkruamëni në mirëbesim në lidhje me to që edhe unë të jem i qetë.

Për sot ju uroj Gëzuar Vitin e Ri, të keni shëndetin ju dhe familja juaj! Edhe bashkëshortja ime u bashkohet këtyre urimeve dhe ju përshëndesim përzemërsisht.

I juaji

Max Lambertz

Markkleeberg, 15.01.1957

I dashur dhe shumë i nderuar zoti koleg Çabej!

Ju falenderoj përzemërsisht për letrën tuaj të datës 27.11., e cila deshi një kohë të gjatë për të mbërritur te unë, dhe gjithashtu falemnderit për telegramin e dashur tuajin dhe të bashkëshortes suaj të nderuar me rastin e Vitit të Ri. Urimeve tuaja miqësore, unë dhe bashkëshortja ime u përgjigjemi përzemërsisht për ju dhe familjen tuaj të dashur. Sjelltë viti 1957 shumë gëzime dhe suksese për ju!

Ju falenderoj për lajmet në lidhje me J. G. von Hahn dhe me bektashinjtë. Të gjitha janë shumë të vlefshme për mua.

Më vjen keq që medikamentet nuk erdhën. Unë ia dërgova zotit Filip Prifti, nëpunës në Ambasadën Shqiptare në Berlin-Karlshorst, adresa: Treskow Allee 77, me lutjen që pakon t'jua dërgonte juve me postën diplomatike. Habitem që ai nuk e përmbushi këtë kërkesë timen dhe do t'i shkruaj për këtë. Në qoftë se ai ka harruar dhe nëse medikamentet janë ende aty në Berlin, në ambasadë, do t'i kërkoj me insistim që t'i dërgojë sa më parë. E nëse pakoja ka humbur, atëherë do duhet të duroni deri në prill, sepse vetëm atëherë unë do të shkoj në Berlin dhe medikamentet e dëshiruara mundem t'i gjej vetëm atje. Do t'ju shkruaj pastaj sërish në lidhje me këtë.

Nga Revista për Fonetikën dhe Gjuhësinë e Përgjithshme mora 30 separate të punimit tuaj "Mbi disa fjalë të shqipes që fillojnë me "z" dhe ju lutem të më informoni, si duhet të veproj me këto separate. Gjithashtu ju kam shkruar se do të merrni një honorar nga Berlini. Honorari është ende atje dhe është i kënaqshëm. Më shkruani se si dhe kujt duhet t'ia dërgojë redaksia e revistës honorarin.

Do t'ju isha mirënjohës nëse do të më siguronit nëpërmjet Institutit të Shkencave në Tiranë revistën "Nëntori", nr. 9, 1956, dhe më tej për Institutin tim numrat për Shkencat Shoqërore të viteve 1950, 1951, 1952, 1953, 1954, 1955.

Këta mund t'i dërgoni pjesë-pjesë në pako të vogla, mundësisht nga dy për secilin numër.

Nuk e di nëse ju, Instituti dhe Biblioteka Kombëtare në Tiranë e keni marrë librin tim "Shqipëria tregon" (Albanien erzählt), shtëpia botuese Volk& Wissen, Berlin 1956. Ai paraqet një përzgjedhje të letërsisë shqiptare, veçanërisht të asaj që prej vitit 1944, të përkthyer në gjermanisht, me introduktë, shënime dhe një shtojcë biografike. Nëse ju nuk e keni, do t'jua dërgoj.

Ju lutem më shkruani! Shumë të fala!

Miku juaj i vjetër

M. Lambertz

Eq oturakun
Markkleeberg, 23.03.1957

Shumë i nderuar zoti Çabej,

Shumë falemnderit për letrën tuaj të datës 08.02. Kam informuar zotin Fiedler në lidhje me honorarin tuaj dhe i kam dërguar atij separatet tuaja. Ishin 30 copë. A ju vjen keq që mbajta nga një separat për vete dhe për institutin tim, kështu që tani kanë mbetur vetëm 28 copë që do t'jua sjellë zoti Fiedler?

Sot po ju dërgoj artikullin tim për Halilin dhe Mujin dhe vëllimin "Shqipëria tregon" (Albanien erzählt). Më pas do dërgoj gjëra të tjera. Jam shumë kurioz për artikullin tuaj dhe të Xhuvanit në lidhje me prefikset. Kjo temë dihet që është shumë e rëndësishme dhe unë tashmë jam njohur me disa pjesë të punës suaj rreth temës. Ka për të qenë sërish shumë e vlefshme. Lexova nekrologjinë tuaj për Kretschmer-in te revista "Nëntori". Është shkruar me shumë profesionalizëm dhe respekt.

Sot kam një pyetje: Ç'mendim keni ju dhe Xhuvani për etimologjinë e fjalëve "bir", "bijë"? Ju e njihni literaturën shkencore në lidhje me këtë çështje, apo jo? Ç'mendim keni për fjalën e mesapishtes "bilia", "biliva"? Është një emër i përveçëm, apo është fjala ilire "bijë"? Pikëpamjen e studiuesit Krahe e njihni? Librin e Krahe-s "Die Illyrier" (Ilirët) e konsideroj shumë të mirë. Treimer-i i ka bërë një recension të keq në revistën "Deutsche Literaturzeitung", viti 1957, faqja 104, dhe kjo me pa të drejtë.

Sot kam edhe një kërkesë ndaj jush, t'i luteni zotit Elezi, sekretarit të institutit tuaj, të ketë mirësinë dhe të më abonojë te Fletorja Zyrtare Shqiptare dhe të ma dërgojë atë dhe gjithashtu të shprehë dëshirën se ç'farë librash apo revistash do të kërkonte në këmbim, të cilat unë pastaj do t'ia dërgoj.

Jam duke recensuar për momentin Historinë e Letërsisë Shqipe të Dhimitër Xhuvanit në revistën "Südostforschungen" (Studimet e Evropës Juglindore). Po aty do të botohen së shpejti dy artikuj të mitë mbi veprimtarinë e Institutit të Shkencave në Tiranë dhe mbi gjendjen aktuale të studimeve shkencore në fushën e dialektologjisë në Shqipëri.

Për sot ju uroj juve dhe familjes suaj të shtrenjtë gjithë të mirat,

edhe nga bashkëshortja ime

dhe ju përshëndes ju dhe të gjithë zotërinjtë e institutit!

Miku juaj i vjetër

M. Lambertz

10 gusht 1957

Markkleeberg pranë Leipzig-ut
Rruga Dölitzerstraße 10 – RDGJ
(Republika Demokratike Gjermane)

Markkleeberg – Leipizig
Rruga Dölitzer-Sraße 10

Dr. Max Lambertz
Profesor universiteti

Shumë i nderuar dhe i dashur, zoti profesor Çabej!

Ju falenderoj për letrën tuaj shumë miqësore të datës 24.06., të cilën e gjeta pas kthimit tim së bashku me artikullin tuaj "Ringinschriften aus Nordalbanien" (Mbishkrimet e unazave të Shqipërisë veriore). E lexova artikullin tuaj mbi mbishkrimet e unazave, më pëlqeu shumë dhe më bindi. Këtë punim do ta dorëzoj te Revista Historike (Historische Zeitschrift) që botohet në universitetin tonë, me qëllim që të botohet sa më parë. Ju përgëzoj për idetë e bukura të shprehura aty, për spjegimin dhe datimin e mbishkrimeve. Do t'ju shkruaj rreth publikimit të artikullit, sapo të kemi zhvillime. Është kënaqësi për mua të lexoj, që jeni duke përkthyer në gjuhën shqipe punimin tim mbi epikën popullore, gjithashtu edhe që ai do të botohet në Buletin. Sa u takon vërejtjeve tuaja në lidhje me "tërthorçe", "brigjak", "dredho", do t'ju lutesha që pikëpamjet tuaja t'i shënoni pa hezitim te shënimet në fund të faqes lidhur me paragrafët përkatës duke vendosur emrin tuaj. Kjo është e rëndësishme për lexuesit dhe aspak e pakëndshme për mua, madje kështu është në përputhje me ndershmërinë shkencore.

Gjithashtu ju falenderoj edhe për letrën me të cilën më dërguat kopjen e artikullit të revistës "Diturija" (1927), nr. 2 (rreth bektashinjve). Më hyn shumë në punë dhe do ta studioj menjëherë. Në lidhje me Fletoren Zyrtare, ju lutem shumë t'i kërkonit zotit Elezi të ketë mirësinë dhe të kryejë abonimin tim sapo të mbyllet viti. Do t'i isha shumë mirënjohës për këtë. Paratë e abonimit kam ndërmend – mendoj se kjo është më e mira – t'ia transferoj me bankë zotit Ambasador të Republikës Popullore të Shqipërisë në Berlin-Karlshorst, në valutën e këtushme, dhe prandaj ju lutem që mirësisht të më informoni për çmimin e abonimit. Nëse konsideroni si më të përshtatshme një tjetër mënyrë për shlyerjen e këtij borxhi, ju lutem ma shkruani.

Dhe tani ju falenderoj shumëfish për urimet miqësore me rastin e 75-vjetorit tim të lindjes, të cilat m'i dërguat me telegram së bashku me zotërinjtë Aleksandër Xhuvani dhe Mahir Domi. Të dy zotërinjve do t'u shkruaj veçmas. Ishte një kënaqësi shumë e madhe për mua, që ju i nderuar dhe i dashur, zoti Çabej, si edhe miqtë e tjerë eruditë shqipëtarë më kujtuat në këtë mënyrë të përzemërt dhe plot nderim. Është gjëja më e çmuar për mua në këtë moshë të vjetër, që burrat më të shquar të inteligjencës dhe shkencës shqiptare e vlerësuan dhe e gjykuan pozitivisht me fjalë dhe urime plot da-

shuri veprimtarinë time në fushën e albanologjisë. Ju falenderoj shumë përzemërsisht për këtë!

Tani një falenderim të përzemërt për fjalët e mira për bashkëshorten time. Edhe ajo ju çon të fala dhe ju uron juve, bashkëshortes suaj të nderuar dhe fëmijëve tuaj veç të mira për të sotmen dhe të ardhmen!

Për sot po e mbyll me përshëndetje të sinqerta miqësore.

M. Lambertzi juaj që ju vlerëson shumë.

(Me shkrim dore)

Shumë urime për themelimin e universitetit! U bëftë Universiteti Shtetëror i Tiranës një qendër e lavdishme e punës shkencore!

M. Lambertz

Kartolinë pa datë

Urime të përzemërta për Vitin e Ri

dhe shumë të fala për ju, bashkëshorten tuaj dhe fëmijët tuaj nga unë dhe gruaja ime!

Punimet tuaja të bukura e me baza shkencore mbi gjuhën shqipe dhe etnografinë e folkorin shqiptar do të botohen në Almanakun Gjerman për Etnografinë dhe Folklorin (Deutsches Jahrbuch für Volkskunde).

Bocat e korrekturës do t'ju dërgohen dhe kopjes së tyre unë do t'i hedh një sy me kënaqësi. Së shpejti do t'ju shkruaj të tjera informacione në lidhje me këtë. Përshëndesni të gjithë miqtë në Tiranë!

Gjithë të mirat!

Miku juaj i vjetër, Lambertz

23.01.1961

Max Lambertz
Profesor universitar
Markkleeberg 1, Dölitzer Straße 10
Leipzig

Shumë i nderuar dhe i dashur zoti koleg dhe mik, E. Çabej!

Me kënaqësi ju shkruaj në gjuhën gjermane, të cilën ju e zotëroni në mënyrë të përkryer. Ju falenderoj për librin tuaj të bukur "Bambi". Historinë tërheqëse me kafshë të autorit F. Salten ju e keni përkthyer në një shqipe admirueshmërisht të bukur. Përzgje-

dhja nga ana juaj e këtij krijimi të këndshëm të Salten-it dëshmon se çfarë panorame të gjerë e të thelluar të letërsisë gjermane keni arritur të përftoni, por gjithashtu dëshmon edhe shijen tuaj të hollë përzgjedhëse. Shqiptarët, patriotët tuaj të shkëlqyer, do t'ju jenë shumë mirënjohës për këtë talent. Edhe mua leximi më zbaviti shumë, dhe siç e thamë, pikërisht falë shqipes së shkruar kaq mjeshtërisht prej jush. Ju falenderoj për këtë!

Zonjës Neka Turkeshi i them falemnderit për përkthimin e mrekullueshëm të 53 përrallave të vëllezërve Grimm të përzgjedhura mirë. Përzgjedhja, përkthimi dhe skicat fine janë të arrira. Mua libri më dha kënaqësi, edhe në Shqipëri do të pëlqehet nga të gjitha moshat. Të dy librave do t'u bëj recension në revistën "Studime të Europës Juglindore" (Südostforschungen). Më tej ju falenderoj për recensionin tuaj dashamirës të librit tim "Epika popullore shqiptare" në revistën "Lingua Posnaniensis".

Ju kam dërguar veprën time të nëntë "Kolë Jakova, Toka jonë" të përkthyer dhe shpresoj që ka mbërritur pa probleme te ju. Në ditët në vijim do t'ju dërgoj një ekzemplar të botimit tim "Epika Popullore", që është botuar si libër i mëvetësishëm në shtëpinë botuese "VEB Max Niemeyer" në Halle.

Do të përzgjedh edhe gjëra të tjera dhe do t'jua dërgoj. – Ju falenderoj gjithashtu për separatet e punimeve tuaja të bukura e plot përmbajtje "vise etj." dhe "probleme etj."[31] nga revista "Lingua Posnaniensis" VII, VIII dhe Academia "Studii si cercetari etj." 1959 (X, 4), të cilat janë shumë të vyera për mua dhe më ofrojnë një panoramë për pasurinë e dijeve tuaja dhe metodën suaj rigoroze.

Artikujt mbi "viset..." i kisha lexuar tashmë te revista "Lingua Posnaniensis", të cilën e drejtoj. Edhe një herë falemnderit! – Esenë tuaj mbi folklorin shqiptar e mori përsipër me kënaqësi zoti Balduin Varia dhe më ka shkruar që do ta çojë te SOF (Südostforschungen – Studimet mbi Europën Juglindore). Që Valjavec-u ka vdekur, këtë me siguri e dini. – Edhe diçka: Jeni njohur tashmë me botimin e ri të Buzukut nga Namik Resuli e me kritikën e [Narcenaj-it]? Unë i posedoj të dyja, gjithashtu edhe artikujt e Camajt mbi Buzukun. Edhe ju vetë jeni aktiv në fushën e Buzukut.

Transkriptim i letrës së datës 05.08.1961 të shkruar në gjuhën shqipe, e kopjuar në përputhje me origjinalin

Fort i nderuemi Zotni profesor Çabej!

Ju falemi nderit nga zemra për urimin me rastin e ditëlindjes sime! Edhe unë ju uroj juve edhe familjes së Zotnis Sate shumë të mira edhe suksese të bukura në punë shkencore! Unë gëzohem, sepse mundem të ju shkruaj, se vepra e Zotnis Sate përmbi folklorin do të jetë e shtypun tashti në revistën shkencore e "Institut für Geschichte der Volksdemokratien" der Karl-Marx-Universität Leipzig! ["Instituti për Historinë e Demokracive Popullore" i Universitetit "Karl Marks" të Leipzig-ut.] Shpresoj se keni me qenë i kënaqun me atë zgjidhjen e çështjes përmbi veprën e Zotnis Sate e vlefshme dhe

31 Lambertz nuk përmend të gjithë titullin e artikullit, por vetëm nga një fjalë kyçe për secilin [shënim i përkthyesit].

e bukur edhe interesantshme [sic!], si kanë thanë të gjithë, që e kanë lexue. Kam me ju shkrue përsëri përmbi atë punë.

Për sot po ju dërgoj juve shumë përshëndetje e të fala për ju, Zonjën edhe për Artanin e Brikenën, edhe nga ana e Zonjës seme.

Unë mbetem n'miqsi të vjetër

Gjithmonë i juaji

M. Lambertz

20.06.1962

Josefa Lambertz
Leipzig-Markkleeberg
Dölitzer Straße 10

Zotit Prof. Dr. Eqrem Çabej
Universiteti i Tiranës
Tiranë (Shqipëri)

I dashur zoti profesor!

Mes shumë miqve të dashur e të njohurve, të cilëve bashkëshorti im u është falenderues për shumë e shumë orë të bukura e plot vlerë të jetës së tij të gjatë e të pasur, dua t'ju bëj të ditur edhe juve, që në datën 27 korrik 1962 ai do të festojë ditëlindjen e tij të 80-të gjatë periudhës së lejes në Austri. Të shpresojmë që të ketë mundësinë ta përjetojë këtë ditë me freskinë fizike dhe gjallërinë mendore, të cilat ende vazhdon t'i gëzojë.

Adresa e tij e pushimeve është:

Prof. Dr. Max Lambertz
Bad Aussee
Hotel "Sonne"
Austri/Steiermark.

Me siguri, i dashur zoti profesor, do t'i falnit një kënaqësi të madhe bashkëshortit tim, nëse do të bëheshit i gjallë.

Përshëndetje të përzemërta!

Do të gëzohesha po të ritakohesha me ju dhe bashkëshorten tuaj të dashur, të cilën gjithashtu e përshëndes nga zemra.

E juaja

Josefa Lambertz

31.08.1963

Të dashur zoti profesor dhe zonja Çabej!

Meqë tani po udhëtoj drejt Vjenës, ku do të varroset urna e bashkëshortit tim, pikësëpari dëshiroj t'ju falenderoj në emër të tij për urimet miqësore me rastin e ditëlindjes së tij. Ai u gëzua shumë për to, si gjithmonë, sa herë merrte letra nga miqtë shqiptarë. Edhe atëherë ai ishte sëmurë, me regjim shtrati – për shkak të problemeve me qarkullimin e gjakut – dhe vazhdonte të punonte për punimin e tij të fundit (mitologjia shqiptare), deri sa në natën e datës 30.07. pësoi një goditje në tru, e cila e paralizoi nga ana e djathtë dhe ai nuk mundi më as të fliste.

Bashkë me të vdiq një prej miqve më të mirë, më fisnikë e më besnikë të shqiptarëve!

Ju falenderoj edhe një herë për gjithçka të mirë e të dashur që keni bërë dhe ju përshëndes shumë përzemërsisht ju dhe bashkëshorten tuaj!

E juaja

Josefa Lambertz

Vjenë, 21.09.1963

I dashur zoti profesor!

Vërtet nuk mbaj mend, nëse ju kam falenderuar edhe ju dhe bashkëshorten tuaj të dashur për ngushëllimet e përzemërta. Nëse jo, kini mirësinë t'ia vini fajin për këtë shpirtit tim të trazuar. Jam ngujuar tani këtu në Vjenë dhe po pres e po pres urnën e bashkëshortit tim, që duhet varrosur këtu te varri i të atit. Përveç kësaj më duhet të shkoj nëpër kaq shumë zyra e institucione, saqë nuk kam kohë as të marr frymë. Si miqtë tanë të mirë që jeni, duhet t'ju tregoj edhe një herë se si ndodhi kaq shpejt vdekja e burrit tim. Fillimisht pati probleme me qarkullimin e gjakut në këmbën e majtë, kaloi ditëlindjen (27.07.) duke u përmirësuar, në datën 30 shkuam te agjencia e udhëtimeve për të rezervuar fluturimin për Vjenë, atë pasdite u ankua se nuk ndjehej mirë dhe në orën 20.30 pësoi goditjen cerebrale, u paralizua në anën e djathtë dhe humbi edhe të folurit. Të vetmet fjalë që mund të thoshte, ishin "por ku, por ku, por ku, ku, ku". Dhe kështu ishte e domosdoshme të çohej në spital. Më 23 gusht vendosa ta transportonim për në shtëpi, sepse nga fjalët që belbëzonte, kuptova se dëshironte të shkonte në shtëpi. Ende në datën 24 mjeku konstatoi "Kur e vështron zotin profesor, nuk do ta besoje që është i sëmurë". Por, më datë 26 gusht, nga dreka e tutje, gjendja e tij mori të tatëpjetën me ritme të shpejta dhe pikërisht në orën 19.00 mori frymë për të fundit herë. Ai kishte një karakter fisnik, altruist, nuk mendonte kurrë për të përfituar vetë dhe ndihmonte sa herë që jepej mundësia. Të tillë njerëz gjenden rrallë.

E tani, i dashur zoti Çabej, kam një kërkesë të rëndësishme për ju. Ju e zotëroni gjermanishten e përveç kësaj, jeni filolog dhe miku ynë. A do të kishit mirësinë e të shkruanit një nekrologji për bashkëshortin tim, e cila të botohej në gazetat vjeneze dhe ato të RDGJ-së? Kjo do t'i shërbente edhe lavdisë së popullit shqiptar!

Punimin e fundit të bashkëshortit tim, të cilin ai e përfundoi në shtrat e i sëmurë para goditjes cerebrale, do ta transkriptoj këtu në Vjenë me makinë shkrimi. Ka të bëjë me "mitologjinë shqiptare" dhe do të botohet në kuadrin e një vepre madhore që titullohet "Mitologjia e popujve". Një punim tjetër i madh do të duhej të shtypej, pikërisht me temën "Drama në teatrin e sotëm shqiptar".

Do qëndroj në Vjenë deri në fillim të janarit, më pas do të udhëtoj drejt Leipzig-ut për të inspektuar dhe vënë në rregull bibliotekën e bashkëshortit tim.

Si jeni ju dhe familja juaj e dashur? Shpresoj që të gjithë të jeni mirë. Më i madhi, nga i cili kam edhe një fotografi, tani duhet të jetë 10 vjeç e disa muaj. Ju përshëndes të gjithëve shumë përzemërsisht, veçanërisht bashkëshorten tuaj që e njoha në hotel Dajti.

E juaja

Josefa Lambertz

Kartolinë falenderuese:

Për të gjitha dëshmitë e dashurisë dhe nderimit me gojë dhe shkrim, për lulet dhe shoqërimin e fundit që iu bë të dashurit tim të ndjerë

Prof. Dr. Maximilian Lambertz

Ju falenderoj me gjithë zemër!

Josefa Lambertz

Gusht 1963

Markkleeberg-Mitte, Dölitzer Straße 10

17.01.1964

Të dashur zoti dhe zonja profesor!

Mos ma merrni për keq që po i përgjigjem vetëm sot letrës suaj të datës 28 tetor, por kam pasur pambarimisht shumë punë për të përfunduar në Vjenë. Pa marrë parasysh ecejaket e zakonshme nëpër zyra dhe shkresat e shumta pas një ndodhie kaq dëshpëru-

ese, më është dashur të transkriptoj me makinë shkrimi një punim shkencor të bashkëshortit tim, të cilin ai arriti ta përfundonte i shtrirë në shtrat ende pa pësuar goditjen cerebrale. Shtëpitë botuese këmbëngulën për këtë, sepse bëhet fjalë për një kontribut për një botim gjithëpërfshirës me titullin "Die Mythologie der Völker" (Mitologjia e popujve), dhe ku natyrisht, shqiptarët trima nuk duhet të mungojnë. Po, i dashur profesor Çabej, kjo për mua ishte një punë e vështirë, edhe pse edhe më parë isha unë ajo që i hidhja në makinë shkrimi të gjitha punimet e tij, por më pas Lamberci i mirë i korrigjonte vetë ato, por kësaj radhe m'u desh që ta kopjoja me saktësi të madhe manuskriptin e tij. Te ky punim ai ka cituar edhe disa prej botimeve tuaja dhe i ka listuar ato te bibliografia. Këtu kam një manuskript tuajin, ende të pa botuar, ku thuhet: "Ky artikull (në vija të përgjithshme i përfunduar që në vitin 1942) nuk synon një trajtim të mëvetësishëm e të pavarur të temës së folklorit/etnografisë. Është konceptuar si një plotësim i artikujve të mëparshëm "Sitten und Gebräuche der Albaner" (Doket dhe zakonet e shqiptarëve), Revue Internationale des Etudes Balkaniques, II/1 (1935), 556–572, "Die albanische Volksdichtung" (Poezia popullore shqiptare), Leipziger Vierteljahresschrift für Südosteuropa, viti i 3-të, numri 3, etj. Siç po shoh nga korrespondeca, bashkëshorti im është përpjekur shumë që ky manuskript i juaji të botohet. Por fatkeqësisht pa sukses. Te revista "Südost-Forschungen" nuk synonin ta botonin artikullin edhe pse e kishin vlerësuar si interesant, dhe në Berlin u refuzua duke marrë parasysh situatën aktuale të tensionuar. A mos duhet vallë t'jua dërgoj mbrapsht këtë punim?

Në Vjenë u sëmura dhe isha gati për infarkt kardiak dhe tani duhet të inspektoj dhe të vë në rregull gjithë bibliotekën e bashkëshortit tim, por para se të merrem me këtë, më duhet të kopjoj edhe një punim të madh "Die Dramen der Neuzeit" (Dramat e kohës së re). Por nuk njoh ende asnjë shtëpi botuese që do ta botonte këtë punim. Do të ishte me interes të madh për mbarë botën të mësonte se çfarë kanë krijuar artistët shqiptarë që nga rivendosja e Republikës së Shqipërisë.

Më thanë që në muajin shtator paskeni qenë në Vjenë. Sa keq, do t'ju kisha takuar e do të kisha biseduar me kënaqësi me ju. M'i përshëndesni të gjithë shqiptarët, veçanërisht zotërinjtë Mahir Domi, Dh. Fullani, Stefanaq Pollo, Kol Paparisto, le të themi të gjithë miqtë shqiptarë të bashkëshortit tim. Ju përshëndes shumë përzemërsisht ju, bashkëshorten tuaj të dashur dhe fëmijët!

E juaja

Josefa Lambertz

Vjenë, 20.05.1964

Të dashur zonja dhe zoti profesor!

I mora letrat tuaja të datës 08.03 dhe 05.04. dhe ju falenderoj shumë për to. Të më falni që po përgjigjem kaq vonë, por m'u desh të vija prapë në Vjenë, sepse duhet të kryeja disa gjëra këtu. Nuk po gjej dot qetësi, e ndërkohë në shtëpi më presin shumë punë. E përveç kësaj, ende më duhet të transkriptoj me makinë shkrimi punimin e fundit të bashkëshortit tim mbi dramat më të reja të teatrit shqiptar. Në të vërtetë ende nuk kam gjetur ndonjë shtëpi botuese që mund ta botonte këtë punim. Ju e dini që në vendin tonë rrethanat kanë ndryshuar dhe që nuk ka më interes për punimet nga albanologjia. Më pas duhet të mendoj edhe për shqyrtimin dhe katalogizimin e bibliotekës. Kur të merrem me këtë punë, do të gjej rastin të plotësoj kërkesën tuaj për separate, gjë që do ta bëj me kënaqësi, sepse ju jeni miq të mirë të bashkëshortit tim. Ju kam shkruar dy letra, por nuk di a i keni marrë. Kam frikë se jo, sepse i kam shkruar edhe "Zërit të Popullit" dhe zotit, prof. Mahir Domi për t'u shprehur falenderimet e mia për ngushëllimet për vdekjen e tim shoqi, por kam frikë se këto letra nuk kanë mbërritur. Edhe rektorit të universitetit tuaj i kam dërguar një letër falenderimi.

Ju falenderoj jashtë mase për besnikërinë tuaj ndaj bashëshortit tim!

[vazhdon me shkrim dore]

21.05.1964

M'u desh ta ndërprisja letrën. Kur të kthehem në Markkleeberg, do të përpiqem që punimin tuaj në lidhje me folklorin/etnografinë shqiptare (që e disponoj këtu), t'ia dërgoj revistës "Südost-Forschungen" (zotit, prof. Saria), që më në fund të mund të botohet.

Nëse do të më dërgonit separatin e revistës belge "Orbis", do t'jua dija shumë për nder.

Ju përshëndes shumë përzemërsisht ju, bashkëshorten tuaj dhe të dy fëmijët!

E juaja,

Josefa Lambertz

P.S. Në datën 01.06. do të fluturoj sërish drejt Leipzig-ut.

Markkleeberg, 03.07.1964

Shumë i nderuar zoti profesor Çabej!

Ju bëj me dije se sot, në përputhje me dëshirën tuaj, i kam dërguar me postë rekomande artikullin tuaj revistës SOF, zotit prof. Saria, në Mynih. Jam e gëzuar që më në fund artikulli juaj do të botohet.

Jam ulur e po punoj me zell për të transkriptuar me makinë shkrimi punimin e fundit të bashkëshortit tim "Die albanischen Dramen von heute" (Dramat shqiptare të ditëve të sotme). Shpresoj shumë të më botohet. Kur dhe ku mbetet ende enigmë. Po mundohem shumë, sepse nuk jam gjuhëtare dhe nuk duhet të bëj asnjë gabim. Përndryshe njerëzit do të thonë "Lambertz-i paska qenë i paaftë, e paska punimin me kaq shumë gabime"!

Por unë duhet dhe do t'ia dal. Bashkëshorti im e meriton për të gjithë ne!

Shpresoj që ju, bashkëshortja juaj e dashur dhe fëmijët të jeni mirë dhe që po kaloni pushime të bukura. Përshëndetje të përzemërta për të katërt!

E juaja

Josefa Lambertz

(Me shkrim dore)

Nuk e kam harruar premtimin ndaj jush. Pasi të mbyll punën që kam në dorë, do të merrem me shqyrtimin e bibliotekës dhe ju do të merrni pastaj, siç e do miqësia shqiptare, punimet ende të përziera të tim shoqi! Shumë të fala edhe profesorëve Mahir Domi, Dhimitër Fullani, Stefanaq Pollo etj. etj.

Letër me shkrim dore, pa datë

Miqve të mi besnikë, çiftit të dashur Çabej!

Ju falenderoj për urimet e dashura me rastin e ndërrimit të viteve që natyrisht jua kthej me gjithë zemër. Shumë suksese në punën tuaj shkencore! Ju lutem, i dashur zoti profesor Çabej, ma kushtoni mua një separat të punimit tuaj që u botua nga revista SOF (Prof. Saria).

Ju përshëndes shumë përzemërsisht ju dhe familjen tuaj dhe ju lutem t'u përcillni të falat e mia edhe zotërinjve: Rektorit Këlliqi, Kostallari, Paparisto, Mahir Domi, Fullani etj.

E juaja

Josefa Lambertz

Markkleeberg, 08.01.1965

Shumë i nderuar zoti Profesor!

E dashur zonja Çabej!

Jam gëzuar jashtë mase për kartolinën dhe urimet e vitit të ri. Ju falenderoj shumë përzëmërsisht për gjithë dashurinë tuaj dhe ju kthej të njëjtat urime! Do të gëzohesha shumë, nëse do të merrja nekrologjinë (Orbis XIII). Me këtë rast dëshiroj t'ju pyes, i dashur zoti professor, nëse e keni marrë letrën time të fundit ku ju bëja me dije se në datën 03.01.1964 i kisha dërguar me postë rekomande zotit prof. Saria në Mynih punimin tuaj, ashtu siç dëshironit. As profesor Saria nuk ma ka konfirmuar marrjen e postës, prandaj jam pakëz e shqetësuar. Sepse, tek e fundit, bëhet fjalë për punimin tuaj, punimin e një miku të mirë të Lambertz-ëve, dhe do të më vinte keq, nëse do të kishte humbur. Ju lutem, më shkruani në lidhje me këtë.

Për disa javë isha në Vjenë dhe aty në rrethin e miqve shqiptarë festova edhe festën tuaj të çlirimit. Bisedova edhe me zotin ministër Gaqo Nesho dhe me atashehun e tij, zotin Bardhi, që në verë të vija në Shqipëri së bashku me djalin tim, sepse djali për shkak të sëmundjes duhet të qëndrojë buzë detit. Do të gëzohesha që pas një kohe kaq të gjatë të kisha mundësinë të ritakoja edhe një herë ju, familjen tuaj dhe miqtë e mirë shqiptarë. Sa bukur do të kishte qenë nëse edhe profesor Lambertz-i do të kishte ardhur me ne.

E tani ju përshendes përzemërsisht së bashku me gruan dhe fëmijët.

Gjithë të mirat!

E juaja

Josefa Lambertz

Markkleeberg, 08.04.1965

I dashur zoti profesor Çabej!

Të më falni që nuk kam mundur t'ju falenderoj më parë për dërgesën e të dy nekrologjive për bashkëshortin tim, dhe pikërisht atë në "Orbis" dhe atë në gjuhën shqipe; besoj do të jetë botuar te *Studime Filologjike*.

Shqiptarët me të vërtetë janë miq besnikë, "besa" për ta nuk është vetëm një fjalë goje, por ata e praktikojnë edhe në realitet atë. Unë u gëzova shumë për sa më sipër, gjë që tani po më ndodh rrallë. Nuk kam gjë tjetër veçse telashe, kurrfarë ndihme dhe jashtëzakonisht shumë punë.

Për më tepër jam edhe seriozisht e sëmurë. Dhe patjetër që kam nevojë të shlodhem tani e tutje. Në muajin maj më duhet të kryej ca punë në Vjenë dhe pas kësaj do të

udhëtoj diku për të pushuar. Do të merrni prapë lajme prej meje. Në Vjenë do të kem këtë adressë: Wien II, Rueppgasse 13/14.

Me sa po shoh nga nekrologjia e botuar në "Orbis", ju, i dashur zoti profesor, nuk e keni ditur që bashkëshorti im ka shkruar mbi "Doppelnamigkeit in Ägypten" (Emërtimi i dyfishtë në Egjipt). Prandaj po i bashkëngjis kësaj letre menjëherë edhe një separat. Me shkresën e datës 8 mars 1964 m'u lutët t'ju dërgoja ndonjë separat që do ta gjeja te dokumentet e trashëguara nga im shoq.

Aktualisht disponoj këto separate:

Recension Norbert Jokl: Linguistisch-historische Untersuchungen aus dem Bereiche des Albanischen (Hulumtime historiko-gjuhësore nga fusha e gjuhës shqipe). Deutsch.Lit.Ztg., Numri 21, 1924, kolonat 1548–1551.

Buletin i Institutit të Shkencavet, Viti III, Nr. 1./2. Tiranë, 1949.

Deutsch.Lit.Ztg., Numri 4/5, Prill/Maj 1950, kolonat 153–156

Cimochowski Waclaw, Dushmani Dialekt: Zschr.f.Phonetik u.allgem.Spr.Wschaft, viti i 7-të, Numri 5/6, 1953.

Aleksandër Xhuvani: Për pastërtinë e gjuhës shqipe. LP 8, f. 293–302.

Studime gjuhësore, Tiranë 1956, 227 SS. LP. F. 271–279.

Max Lambertz: Zur albanischen Umgangssprache (Gjirokastra) [Mbi gjuhën e folur të përditshme shqipe (Gjirokastra)], LP VII, 1958, f. 85–144.

Max Lambertz: Das wissenschaftliche Institut in Tirana (Instituti i Shkencave në Tiranë). SOF.

Vol. XVI, 1957, gjysmëvëllimi i parë, faqja 160 ff.

Max Lambertz: Zur albanischen Literaturgeschichte (Mbi historinë e letërsisë shqiptare). SOF.

Vol. XVII, 1958, gjysmëvëllimi i parë, f. 237 ff.

Max Lambertz: Wissenschaftliche Tätigkeit in Albanien 1957 und 1958 (Veprimtaria shkencore

në Shqipëri 1957, 1958). SOF. Vol. XVIII, 1959, gjysmëvëllimi i dytë, f. 399 ff.

Max Lambertz: Das Drama im albanischen Theater von heute (Drama në teatrin shqiptar të ditëve të sotme). Vol. XIX. SOF. 1960, f. 316 ff.

Max Lambertz: Bibliographie d. J. 1915, Griechisch. Indogerm.Jb. Vol. IV. Viti 1916, Strasburg 1917.

Max Lambertz: Der literarische Charakter der kretischen Dramen Stathes und Gyparis (Karakteri letrar i dramave krete Stathes dhe Gyparis), Byzant.Zschr. XLI.2.

Max Lambertz: Dy Albanica. Zeitschrift für Indogermanische Forschung. Vol. LX, numri 3.

Max Lambertz: Italo-albanische Dialektstudien (Studime dialektore italo-shqiptare). Zschr.f.vergl.Spr.Forschg. LIII, pjesa e 3-të, Volkstümliche Texte aus den Kolonien der Molise (Tekste popullore nga kolonitë e molisëve), f. 66 ff.

Max Lambertz: si më sipër, pjesa e 4-t, Revista si më sipër, f. 282 ff.

Max Lambertz: Sprachliches aus Septuaginta und Neuem Testament (Çështje gjuhësore nga Septuaginta dhe Testamenti i Ri). Wissenschaftliche Zeitschrift der Universität Leipizig, viti 1952/53, numri 3.

Max Lambertz: Ein Kapitel albanischer Umgangssprache. Zu den Interjektionen. (Një kapitull i gjuhës së folur të përditshme shqipe. Rreth pasthirrmave.), Wissenschaftliche Zeitschrift der Universität Leipzig, viti i 9-të, 1959/60, nr. 2.

Ju lutem të zgjidhni çfarë të dëshironi nga këto separate. Nëse do të gjej edhe gjëra të tjera, do t'jua dërgoj me kënaqësi.

Me aq sa mjaftojnë njohuritë e mia të shqipes, nga *Studime Filologjike I* po kuptoj se ju, në datën 6 shtator 1963, keni qenë në Milano bashkë me zotin profesor Kostallari. A ishin shumë interesante kumtesat?

E tani dua t'ju pyes si janë vallë bashkëshortja juaj e dashur dhe të dy fëmijët? Shpresoj që të katërt të jeni shëndoshë e mirë. Ju përshëndes shumë përzemërsisht ju dhe miqtë shqiptarë me të cilët kam njohje!

E juaja

Josefa Lambertz

Vjenë, 18.08.1965

Shumë i nderuar zoti Profesor!

Kur mbërrita në Vjenë, gjeta letrën tuaj të dashur të datës 10.05., për të cilën ju falenderoj shumë. U gëzova jashtmase për përshëndetjet miqësore. Unë arrita e sëmurë në Vjenë. Mjekja ime nuk e kishte me sy të mirë që të udhëtoja drejt Vjenës, por unë kisha ca punë këtu. Që nga vdekja e bashkëshortit tim, që në datën 26 të këtij muaji mbushen dy vjet, kam pasur pak gëzime. Ishte gjë e mirë që kam pasur shumë punë. Puna të ndihmon të kapërcesh shumë të këqija.

Punimin e fundit të tim shoqi "Das Drama im albanischen Theater" (Drama në teatrin shqiptar) e kam transkriptuar në makinë shkrimi, por për fat të keq nuk kam asnjë mundësi ta botoj diku.

Separatet e dëshiruara jua ka dërguar në datën 2 korrik një i afërt i burrit tim nga Markkleeberg. Shpresoj që edhe ju t'i keni marrë ato.

Me siguri do ta keni marrë vesh që, për fatin tim të keq, nuk mund t'i përgjigjem ftesës tejet miqësore të miqve shqiptarë të bashkëshortit tim. Jam shumë e mërzitur për këtë, por për fat të keq, kur doja të vizitoja varrin e tim shoqi, unë e gjora u rrëzova te shkallët që të çojnë te metroja dhe më është dashur të ngujohem në shtrat për javë të tëra, pata edhe temperaturë dhe shtrëngimi i kraharorit (Angina pectoris) më lodhi shumë.

Më 7 shtator do të kthehem sërish me avion në Markkleeberg.

Zoti Bardhi nga konsullata shqiptare këtu më tregoi që ju, i dashur profesor, në fjalimet e shumta që mbani, përmendni herë pas here emrin dhe njohuritë e mëdha të Max Lambertz-it. Shqiptarët janë me të vërtetë një "popull besnik". Për këtë edhe unë

ju shpreh falenderimet e mia të përzemërta dhe ju uroj shumë suksese në punën tuaj shkencore dhe shumë kënaqësi me fëmijët. Fotografinë e djalit tuaj e kam ruajtur me kujdes. Sa keq që nuk kam edhe një foto të vajzës. Por ndoshta vitin tjetër do të kem mundësinë të vij në Tiranë.

Përshëndetje shumë të përzemërta për ju dhe gruan tuaj!

E juaja

Josefa Lambertz

701 Leipzig, 31 dhjetor 1965

Shumë i nderuar zoti profesor!

Meqë viti po shkon drejt fundit, ju uroj juve dhe familjes suaj të dashur gjithçka të mirë e të bukur për

Vitin e Ri 1966.

Ju uroj të gjithëve shëndet dhe natyrisht juve, i dashur zoti profesor, ju uroj shumë suksese në punën tuaj shkencore! Shpresoj që të jeni shëndoshë e mirë që të katërt!

E tani dëshiroj t'ju bëj me dije që jam shpërngulur nga vila ku jetoja së bashku me burrin tim dhe kam hyrë në një apartament më të vogël, por mjaftueshëm të madh për mua, në një ndërtesë të re mu në qendër të qytetit të Leipzig-ut.

Në datën 18.08. ju kam dërguar një letër nga Vjena, në të cilën ju njoftoja që separatet e punimeve të tim shoqi, të kërkuara nga ju, janë dërguar nga Leipzig-u. A e keni marrë këtë dërgesë dhe letrën e sipërpërmendur? Jam paksa e shqetësuar, sepse edhe letrat mund të humbasin. Prandaj ju lutem të më bëni me dije, nëse i keni marrë këto gjëra.

Në datën 10.05. ju, i dashur zoti profesor, më pyesnit si është situata me trashëgiminë shkencore të profesor Lambertz-it. Nuk di në ju kam treguar që punimin e tij të fundit "Albanische Dramen von heute" (Dramat shqiptare të ditëve të sotme) e kam transkriptuar me makinë shkrimi gati për shtyp. Por për fat të keq nuk di se ku mund ta botoj këtë punim. Këtu?! Ju e dini se si janë rrethanat momentalisht. Për këtë s'është nevoja t'ju raportoj. A mund të më jepni ndonjë këshillë?


E tani ju përshëndes shumë përzemërsisht ju, bashkëshorten dhe fëmijët.

E juaja

Josefa Lambertz

Aneksi

Letra origjinale nga Hermann Ölberg për Çabejn



Institut für
Vergleichende Sprachwissenschaft
der Universität Innsbruck

Innsbruck, 6. Dezember 1964
Innrain 52 · Ruf 26741

Herrn
Univ.-Prof.Dr. F. Çabej
T i r a n a

Sehr verehrter Herr Professor!

Selten erhalte ich Briefe, die mich so freuen wie Ihre und so danke ich Ihnen ganz besonders für Ihre Worte vom 9. November.

Nicht minder hat mich Ihr grandioses Schriftenverzeichnis beeindruckt, in das ich mich ganz besonders vertieft habe; ein Teil ist mir Gott sei Dank zugänglich, einen Teil hoffe ich über Wien zu erhalten, um es hier zu lichtpausen, und das Bulletin wird in Teilen vielleicht doch noch von Ihrer Bibliothek kommen. In der Tat ist uns photokopiert von der Bibliothek Ihre Arbeit über die lateinischen Lehnwörter zugegangen: an dieser Leistung sitze ich nun manche Stunden, sie ist so umfassend, dass ich Satz für Satz durchgehen muss; ich komme darauf bestimmt zurück; die Lokalisierung der alten römerzeitlichen Sitze scheint mir überzeugend, soweit ich dazu überhaupt eine Meinung haben darf. Vor allem wäre es wichtig, die Toponomastik zusammenfassend bearbeitet zu finden, ist dies noch nicht in Angriff genommen worden in Ihrem Institut? Interessant wäre auch die Bildungsweise, die echte Bildung, albanischer Flussnamen, finden sich solche und lassen sich irgendwelche geographische Räume finden?

Die illyrisch-albanische Frage muss wohl offen bleiben, Ihre Argumentation ist zweifellos die geradlinigste und einfachste und hängt wohl die ganze Angelegenheit so lange in der Luft, als nicht irgendwelche chronologische Fixpunkte für die Kentum- oder Satementwicklung des Albanischen gefunden werden. Die vielfältigen Vertretungen im Albanischen sind mir unerklärlich, am ehesten müssen da chronologische Schichtungen vorliegen. Die ursprünglichen Satemvertretungen in den verschiedenen idg. Sprachen sind doch eigentlich spontan und unabhängig von den nachfolgenden Lauten, was mir ein entscheidender Einwand gegen einen Hinweis auf die romanischen Entsprechungen von lat. k, die ja durch die nachfolgenden Vokale bedingt sind, zu sein scheint.

Besonders dankbar bin ich Ihnen für die Zusage, dass Sie mir hie und da Separata künftiger Arbeiten zusenden wollen; bei unserer Isoliertheit hier von doppeltem Wert; ich wäre aber auch schon dankbar für die Mitteilung, dass und wo wieder etwas erschienen ist; irgendwo lässt sich die Publikation dann schon auftreiben. Überhaupt ist doch schon so lange nichts mehr von Ihnen in den Indogermanischen Forschungen erschienen, ist dies nicht schade? Nachdem nun mein Chef, Prof. Schmid, diese Zeitschrift zusammen mit Krahe redigiert, wäre es doch möglich, Sie nicht allzu lange mit einer Drucklegung eines ev. Beitrages warten zu lassen. Verwundert bin ich über die Tatsache, dass so wenige Ihrer Veröffentlichungen in der Bibliographie linguistique aufscheinen, kann man da keine Abhilfe schaffen?

./.

Neben den studime rreth etimologjisê, die mir vorläufig noch nicht zugänglich sind, war ich freudig überrascht über die Hyrje në historinê e gjuhês shqipe, endlich was ich schon so lange suche. Erscheint diese in Lieferungen (dispencê?) als selbständige Publikation und ist sie im Buchhandel erhältlich? Die ähnliche Arbeit von Barič ist mir immer noch nicht zugänglich und soll, nach dem Urteil von Doz. Selta, auch nicht besonders sein.

Sind eigentlich gründlichere Arbeiten über Bogdans Cuneus unternommen worden? Glossare, Kommentare, sprachliche Untersuchungen? Ich habe mir das alte Exemplar der Wiener Nationalbibliothek kommen lassen, um es hier zu lichtpausen; das ist hervorragend gelungen, wie neu, während das Original doch sehr angegriffen ist. Ich hätte mich gerne in ihn vertieft und wäre um ein paar Hinweise dankbar. Wird bei Ihnen im Unterrichtsbetrieb so etwas wie"Altalbanisch"betrieben?Dürfte ich einmal ein Vorlesungsverzeichnis erhalten?

Ich habe mir für das kommende Jahr den Kongress in Marburg vorgemerkt; es ist zu hoffen, dass Sie als Vertreter Albaniens dorthin delegiert werden und ich hätte keinen grösseren Wunsch als Sie dort zu treffen. Ich halte beide Daumen!

In einiger Zeit wird ein kleiner Weihnachtsgruss von mir eintreffen, ich hoffe, er bereitet Ihnen Freude. Dies wäre mein Wunsch. So verbleibe ich inzwischen in der Hoffnung, dass Sie einmal wieder eine kleine Pause für mich finden können,

Ihr sehr ergebener

Hermann Ölberg

NB.: Wenn Ihnen Artikel nicht zugänglich sein sollten, die Sie benötigen, so schreiben Sie es mir bitte. Ich könnte Ihnen manches wohl lichtpausen lassen.

z. B. Barić in Godišnjak I Sarajevo, das bin vorhanden ist.

Hermann Ölberg
Innsbruck

Innsbruck, am 10.1.1964

Herrn
Univ.-Prof.Dr. Eqrem Çabej
Rruga B. Curri 260
shk.7, ap.15
T i r a n a

Sehr verehrter Herr Professor!

Anlässlich des Jahreswechsels möchte ich Ihnen, sehr verehrter Herr Professor, meine aufrichtigen Glückwünsche für dieses nun vor uns liegende Jahr entbieten und hoffen, dass es Ihnen viel Schönes und Erfreuliches bringen möge! Schon lange möchte ich Ihnen schreiben und Ihnen danken für die schöne Begegnung in Amsterdam während des Kongresses. Hoffentlich hatten Sie eine gute Weiterreise und Heimfahrt. Gerade während der Tage Ihres Aufenthaltes in Wien war Doz. Solta in Innsbruck, was ihn, als ich von Ihnen ihm erzählte, furchtbar ärgerte. Verständlich, hatte er Sie doch noch nicht gekannt! Hatten Sie schönen Aufenthalt und Erfolg in Ihrer Nachforschung nach Jokls Nachlass? Er läge im der Nationalbibliothek, wie Solta mir sagte. Es würde mich dies alles sehr interessieren.

Ich denke oft auch daran, ob Sie schöne Bilder gemacht haben? Bekommen Sie Patronen nachgeliefert? Es wäre mir eine grosse Freude, wenn ich Ihnen ansonsten helfen könnte.

Ich habe mich nun ein bisschen in den wissenschaftlichen Zeitschriften besonders nach Ihren Arbeiten umgesehen und mit Freude gesehen, dass ja bereits allerhand vorliegt. Freilich, neuere Arbeiten, die in östlichen Zeitschriften (Rumänien etc.) erschienen sind, stehen mir leider hier nicht zur Verfügung und ich wäre Ihnen um einige Sonderdrucke sehr verbunden. Auch um den Beitrag de quelques problèmes fond. de l'histoire ancienne de l'Albanais, den ich von Prof. Knobloch zur Einsicht kurz erhielt. Ich weiss, dass Sie die Autochthonität der Albaner vertreten und gerade darum war mir dies Arbeit so sehr wertvoll, aber all das, was Popović in der Zeitschrift für slav. Philologie 26,1957,301 ff. dagegen vorgebracht hat, scheint mir doch auch sehr beachtlich. Sie werden ja sicherlich auf diese Argumente andernorts eingegangen sein. Über das mir von Ihnen mitgeteilte Wort trual finde ich in IF 36. 137 den Hinweis auf terriola, bzw. besser – nach Jokl – terra + -ola, also eine lateinische Bildung? Bitte geben Sie mir doch darüber einige Details, schon wegen meiner Arbeit.

Mit Ihrer Universitätsbibliothek habe ich Fühlung aufgenaommen and auch eine sehr freundliche positive Antwort erhalten. Mein erstes Paket hinunter scheint aber verloren gegangen zu sein, das von der Bibliothek angekündigte Paket ist hier noch nicht eingetroffen, aber nach solchen Anfangsschwierigkeiten wird sich hoffentlich eine gute Zusammenarbeit ergeben. Ich sandte mein erstes Paket nicht rekommandiert, vielleicht ein Fehler. Heute geht ein weiterer Brief ab. Haben Sie meinen bescheidenen Sonderdruck erhalten?

Bitte würden Sie auch Ihrem Kollegen, der in Amsterdam mit war, recht herzliche Grüsse von mir bestellen.

Für heute verbleibe ich

Ihr sehr ergebener

Hermann Ölberg

Innsbruck, 4.5.1964

Sehr verehrter Herr Professor!

Mit ausserordentlicher Freude habe ich Ihren Brief vom 22.3. erhalten und danke Ihnen vielmals dafür. Er zeigt mir, dass Sie wohlbehalten sind und meine Briefe erhalten haben. Auch danke ich Ihnen für die beiden Sonderdrucke, während der eine aus Lingua Posnaniensis bei uns ist, da wir diese Zeitschrift besitzen, ist die andere Publikation über Ihre Konferenz für mich ausserordentlich lehrreich; ich hatte ihn ja schon leihweise damals von Prof. Knobloch einsehen können; Ihre Argumentation ist so solid aufgebaut, dass man sich den Folgerungen schwerlich entziehen kann; umso mehr interessiert es mich Ihren Publikationen en detail nachzuspüren, was hier schwierig ist. Wenn ich also sehr unbescheiden sein dürfte, wäre ich sehr glücklich, wenn ich noch Sonderdrucke Ihrer Veröffentlichungen haben könnte, die hier ganz unzugänglich sind, etwa in Studi si Cerc. X, Revue de linguistique VII, und dann all die, die in dem Buletin Ihrer Universität erschienen sind. Als Beginn des Tausches mit Ihrer UB habe ich vom Buletin die Hefte von 1962 und 1963 bekommen , und in meiner Antwort gebeten, mit besonders diejenigen Hefte aus früherer Zeit zugehen zu lassen, die Beiträge von Ihnen enthalten. Dazu habe ich nichts mehr gehört und auch noch nichts zugesandt erhalten, hoffe aber doch, dass meine Bitte Gehör findet, soweit diese Hefte eben noch verfügbar sind. Sehr verbunden wäre ich Ihnen auch um ein Schriftenverzeichnis, bes. eben der Nachkriegspublikationen, ich würde mir die Dinge von Wien kommen lassen und sie lichtpausen. Jede albanologische Forschung muss ja schliesslich bei Ihnen ausgehen. Wie mir Prof. Nilse Kolé mitteilte, habe er die neue alb. Zeitschrift für mich bestellt! Ich will mich natürlich entsprechend revanchieren.

1962:1-4, 1963:1

Grosse Freude bereitet es mir zu hören, dass Sie mit Prof. Kostallari – mit Überraschung las ich, dass er der Direktor des Institutes ist – so lange in Wien sein konnten, und Sie haben sicherlich ein paar Schätze aus Jokls Nachlass in der Nationalbibliothek finden können. Können wir also noch einiges erwarten? Hat es Ihnen dort auch gefallen? Dass Sie Doz. Solta dennoch noch in Wien treffen könnten, freut mich sehr; er hat ja leider die Berufung nach Innsbruck abgelehnt; was ihm sehr geschadet hat, wie man jetzt an der Nachfolgewahl für Wien sieht, worauf er doch gerechnet haben dürfte nach dem Abgang von Prof. Kronasser. Nun scheint auch hier die Nachfolge geregelt zu sein, wahrscheinlich nimmt Doz. Schmid aus Tübingen (Krahe-Schüler und Mitherausgeber der Indogerm. Forschungen) an. Das wäre eine gute Besetzung.

in Innsbr.

Ich freue mich natürlich sehr, von Ihnen vielleicht auch die deutsche Version dieser Problèmes fondamentaux zu behalten; nehmen Sie eigentlich an, dass diese Satementwicklung erst eine späte alban. Erscheinung ist, dergestalt dass man es als Kentum-Sprache mit dem Kentum-Illyr. zusammenstellen kann? Muss das Albanische, auch wenn es alte Sitze im illyr. Raum hat, trotzdem unbedingt ein direkter Nachfahre des Illyrischen sein?

Ich beabsichtige, zum Phonetikkongress nach Münster zu fahren; kommen Sie auch? Es wäre mir eine grosse Freude Sie wieder zu treffen mit der weiteren Bedingung, dass Sie in Innsbruck unterbrechen müssen!

Nun danke ich Ihnen nochmal recht herzlich und verbleibe inzwischen Ihr sehr ergebener

Hermann Ölberg

Innsbruck, 12.12.1965

Sehr verehrter Herr Professor!

Darf ich Ihnen recht herzlich danken für Ihren Brief, der mich unendlich gefreut hat. Ich hoffe, dass es Ihnen gut geht und Sie mit Ihrer Familie gesund sind. In Gedanken bin ich oft und viel bei Ihnen und hundertmal schon wollte ich schreiben, aber es geht oft so konfus zu, dass man kaum zur Besinnung und Ruhe kommt. Wir hatten auch einen schlechten Sommer, meteorologisch, familienmässig, die Universität wurde auch gründlich umgebaut, sodass alles in Schutt lag, kurzum, ein wenig erfolgreiches Jahr. So hatte auch ich gar nicht Lust auf einen Kongress zu fahren, wobei ich mich immer fragte, ob Sienwohl dort sind? Nun haben alle drei Kinder noch Schafblattern bekommen, die Kleine hat es am stärksten hergenommen und wir sind seit einem Monat aufs Äusserste beansprucht. So schliesse ich nun diesen Teil in der Hoffnung, dass Weihnachten oder das Neue Jahr besser werden mögen.

Ein kleiner Gruss zu den kommenden Tagen des Friedens folgt separat und ich hoffe, dass Sie ein bisschen Freude damit haben, vielleicht können Sie einmal doch hierher kommen. Für nächstes Jahr würde ich ich gerne nach Sofia zu diesem ersten Balkankongress fahren, und ich hoffe sehr, dass Sie auch dort sein werden. Es würde mich so vieles interessieren, bestünde eventuell die Möglichkeit, über Tirana zu fahren? Ich hätte mir gerne die Universität, Ihr Institut und den Stand der Albanologie angesehen. Aber dies ist vorläufig nur eine stille Hoffnung.

Wie Sie wissen werden, ist Prof. Schmid schon lange wieder nach Göttingen und ~~nach einer längerer Vakanz~~ ist nun Prof. Meid aus Würzburg hieherberufen worden. Der einzige Keltologe wohl, der existiert imdeutschen Sprachraum, und so denke ich, dass er nicht allzu lange hier bleiben wird, hoffentlich aber so lange, bis ich meine Habilitation zu Ende haben. Heuer habe ich eigentlich nur eine grössere Untersuchung über die Kelten in unserem Raume herausgebracht, die im Frühjahr als Festschriftbeitrag für Prof. Franz, unserem Frühgeschichtler, erscheinen wird. Prof. Schmid ist nun Alleinherausgeber der Indogermanischen Forschungen und schon seinerzeit hätte es ihn sehr gefreut, wenn Sie wieder einmal in seiner Zeitschrift publiziert hätten; hoffentlich habe ich Ihnen dies seinerzeit schon geschrieben? In Deutschland ist ja jetzt einiger albanologischer Nachwuchs, in Bonn und Münschen, sehr erfreulich. Ich selbst würde mich gerne einmal die relative Chronologie der Lautwandelungen genauer untersuchen, die zeitlose junggrammatische Forschungsmethode also historisieren. – Darf ich Sie bitten mir mitzuteilen, ob bei Ihnen eine zusammenhängende Bearbeitung der albanischen Dialekte in Griechenland durchgeführt wurde oder über den von Salamis? Das steht in Zusammenhang mit der Habil.-Arbeit von Haebler, die jüngst bei Harrassowitz erschienen ist.

Ich erwarte mit grosser Spannung Ihre angekündigten Sonderdrucke und bitte Sie noch, mir vielleicht eine kleine Zusammenstellung Ihrer Publikationen für 1964 und 1965 gelegentlich zu geben, wenn dies nicht allzu unverschämt ist. Dann hätte ich damit eine Ergänzung zur seinerzeitigen Liste.

Von Ihrer Universitätsbibliothek haben wir erhalten die Studime filologjike und historike, während die Studia albanica anscheinend nicht mehr verfügbar sind. Ich weiss aber nicht, ob

wir die noch verfübaren Teile erhalten werden. Leider ist auch das Buletini sehr unvollständig und Herr Kole Luka hat sich sehr bemüht, mir noch einige Hefte zu beschaffen, wie ich überhaupt mit ihm einen recht guten Tausch habe.

Ich gebe Ihnen im Folgenden eine Aufstellung der hier vorhandenen Bestände und bitte Sie an uns zu denken, wenn Sie zufällig das eine oder andere Heft erhalten sollten:

Studia Albanica fehlen

Buletini 1962 komplett, 1963 fehlt Heft 2 (trotz wiederholter Urgenzen bei Ihrer UB nicht erhalten): 1957, 1,2.

Wenn Sie von dieser Serie noch etwas auffinden könnten? Besonders natürlich Ihre Beiträge.

